

UDHËZIM

Nr. 6 , Datë 30.01.2015

“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Financave, udhëzon,

Neni 1

Qëllimi i Udhëzimit

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat mbi zbatimin e TVSH-së sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në ligjin nr 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Përkufizime të Përgjithshme

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e mëposhtme të përdorura në këtë udhëzim kanë kuptimin:

1. “Ligji”- ligjin nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
2. “TVSH/tatim” – Tatimi mbi Vlerën e Shtuar sipas kuptimit të ligjit.
3. Faturë tatimore- fatura tatimore e TVSH-së sipas kuptimit të ligjit.
4. “Autoriteti tatimor” është Administrata Tatimore Qendrore e Republikës së Shqipërisë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit tatimor nëpërmjet strukturave të saj, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore ku personi i tatueshëm është i regjistruar.
5. “Legjislacion tatimor” është kuadri ligjor siç përcaktohet në ligjin “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
6. “Autoriteti doganor” është Administrata Doganore e Republikës së Shqipërisë, përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit doganor, dhe çdo autoritet tjetër i ngarkuar me ligj për të zbatuar dispozita të veçanta të legjislacionit doganor.
7. “Legjislacion doganor” është kuadri ligjor siç përcaktohet në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.
8. “Biznese të vogla” janë personat e tatueshëm, të cilët i nënshtrohen regjimit të Bizneseve të Vogla sipas seksionit I, të Kreut XI të ligjit, qarkullimi i të cilave është nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në.
9. Marrëveshje kuadër donacioni/granti është marrëveshja e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, në të cilën është përcaktuar qartësisht kushti që këto donacione/grante nuk do të përdoren për të paguar tatime në Shqipëri.

10.Marrëveshje vjetore donacioni/granti është marrëveshja që bazohet në marrëveshjen kuadër sipas pikës “9” më lart dhe që detajon për vitin në fjalë donacionin/grantin.

10/1. Program i financuar nga asistenca financiare e Bashkimit Evropian është një plan veprimi vjetor ose shumëvjeçar i miratuar nga Komisioni Evropian për zbatimin e asistencës financiare IPA për Republikën e Shqipërisë, duke përcaktuar objektivat, rezultatet e pritshme, aktivitetet kryesore, metodat e zbatimit, buxhetin dhe treguesit, afatin kohor, të gjitha veprimet mbështetëse të lidhura dhe metodën për monitorimin e rezultateve të zbatimit të programi

11. Projekte konkrete janë projektet e parashikuara në marrëveshjet vjetore të donacionit/grantit dhe që mbulojnë një fushë të caktuar **projektet e përcaktuara në programe/protokolle bashkëpunimi apo dokumente strategjike.**

12.Zbatuesi i projektit është personi juridik (institucioni/organizata/entiteti), në cilësinë e njësisë zbatuese të projektit, të cilën donatori e ka caktuar si përgjegjës për zbatimin e projektit, të financuar me fonde të marra në bazë të marrëveshjes së donacionit/grantit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në personin fizik që është caktuar si përgjegjës direkt për menaxhimin e këtij projekti.

13.Përfituesi/it i/e projektit nënkupton/jnë personin juridik (institucioni/organizata/entiteti) që është/janë përfituesi/it përfundimtar i donacionit / grantit / punimeve / furnizimeve / shërbimeve, objekt i projektit, të financuar me fonde të marra në bazë të marrëveshjes së donacionit/grantit.

14.Kontraktori është subjekti, i cili kontraktohet, sipas rastit, nga zbatuesi i projektit, ose përfituesi/it i/e projektit, ose edhe vetë donatori i projektit, me qëllim realizimin e projektit.

(Shtuar me Udhëzim Nr. 11 datë 13.04.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 66, datë 19.04.2023)

(Shtuar me Udhëzimin nr. 27, datë 13.9.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.137, datë 20.09.2023)

Neni 3

Fusha e Zbatimit

Në kuptim të nenit 2 të ligjit, një transaksion është në fushën e zbatimit të TVSH-së në Republikën e Shqipërisë, nëse është furnizim malli ose furnizim shërbimi, i kryer kundrejt pagesës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë, në kuptimin që ligji i jep secilit prej koncepteve përkatësisht furnizim malli, furnizim shërbimi, kundrejt pagesës, vendi i furnizimit, person i tatueshëm.

Gjithashtu importi i mallrave sipas kuptimit të ligjit është në fushën e zbatimit të TVSH-së.

Transaksionet në fushën e zbatimit të TVSH-së janë transaksione të tatueshme me TVSH në Shqipëri. Këto transaksione mund të jenë të tatueshme me TVSH sipas shkallës së TVSH-së së aplikueshme sipas ligjit, ose të përjashtuara nga TVSH kur ligji përcakton përjashtimin.

Sipas këtij ligji tatohen me TVSH:

Furnizimet e mallrave të kryera kundrejt pagesës nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë; furnizimet e shërbimeve të kryera kundrejt pagesës nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë; dhe importet e mallrave.

2.1 Një nga kriteret që duhet marrë parasysh për sa i përket zbatimit të TVSH-së është vendi ku kryhet transaksioni. Për të përcaktuar vendin e furnizimit, për pasojë vendin ku zbatohet TVSH-ja, duhen dalluar:

vendi i furnizimit të mallrave dhe /ose

vendi i furnizimit të shërbimeve.

Furnizimet e mallrave ose shërbimeve, vendi i furnizimit të të cilave është në Republikën e Shqipërisë janë furnizime të tatueshme me TVSH sipas shkallës tatimore të TVSH-së në Republikën e Shqipërisë, përveç se kur ky ligj në mënyrë eksplicite i ka përjashtuar nga TVSH.

Ndërkohë nëse vendi i furnizimit nuk është në Republikën e Shqipërisë atëherë furnizimi i mallit ose shërbimit nuk është objekt i aplikimit të TVSH-së në Shqipëri. Për furnizime të tilla nuk përmbushet kriteri i vendit të furnizimit.

2.2 Gjithashtu që një transaksion të konsiderohet në fushën e zbatimit të TVSH, duhet të ekzistojë një lidhje e drejtpërdrejtë mes furnizimit të kryer dhe kundërvlerës (pagesës) së marrë.

Për të provuar lidhjen e drejtpërdrejtë duhet të verifikohen kushtet e mëposhtme, të cilat duhet të plotësohen njëkohësisht:

Avantazhi që transaksioni i sjell klientit, pra nëse klienti ka marrë një furnizim të drejtpërdrejtë ose të individualizuar ose jo.

Çmimi, pra nëse ky çmim ka lidhje me avantazhin e marrë prej klientit ose jo.

Shembull 1: Shërbimet e bëra nga një organizatë jofitimprurëse në dobi të komunitetit, shërbime të cilat mbulohen nga donacionet dhe jo nga pagesat që kryejnë ata që përfitojnë shërbimin, nuk përfshihen në fushën e zbatimit pasi nuk janë shërbime të individualizuara.

Shembull 2: Kuota e anëtarësimit në një shoqatë prej 1000 lekë që paguhet nga anëtarët. Kjo shumë nuk përkon me atë që presin anëtarët nga kjo shoqatë në këmbim, pra kuota e anëtarësimit nuk përfshihet në fushën e zbatimit të TVSH-së.

Kur një organizëm kryen një veprim kolektiv, por që shkon për interesa të veçanta dhe në këtë mënyrë paguesit e kuotizacioneve përfitojnë një avantazh të drejtpërdrejtë, plotësohet kushti në lidhje me marrjen e një avantazhi të individualizuar. Është e nevojshme që paguesit e kuotizacioneve të përfitojnë një avantazh të drejtpërdrejtë nga ky veprim kolektiv. Në këtë rast furnizimi është në fushën e zbatimit të TVSH-së.

Shembull 3: Një organizëm ngarkohet nga anëtarët e tij për të bërë promovimin e produkteve që vetë ata prodhojnë. Shërbimi i dhënë në këtë rast mund të jetë kolektiv, por paguesit e kuotave për organizimin e promovimit përfitojnë një avantazh të drejtpërdrejtë dhe çmimi i paguar është i lidhur me avantazhin e marrë prej klientit.

Shembull 4: Një shoqatë sindikaliste e autorizuar nga disa prej anëtarëve të saj kryen shërbim kolektiv për të mbrojtur trojet që rrezikohen nga lumi, me anë të një kuotizacioni të caktuar në mënyrë proporcionale me interesin e drejtpërdrejtë të çdo pronari të trojeve. Në këtë rast, kjo shoqatë ushtron një aktivitet brenda fushës së zbatimit të TVSH-së.

Mbi përmbushjen e kushteve për përcaktimin e lidhjes së drejtpërdrejtë, pa u kufizuar vetëm në to, mund të gjykohet mbi:

Ekzistencën e një angazhimi të qartë nga ana e furnizuesit të mallit/shërbimit për të kryer një furnizim malli/shërbimi të caktuar kundrejt personit që mbulon (siguron) financimin;

ose në mungesë të një angazhimi të qartë, kur është ndërmarrë një veprim apo kur janë vënë në zbatim mjete që mundësojnë të vërtetohet ekzistenca e një angazhimi të tillë. Për ekzistencën e këtij angazhimi kërkohen edhe elementet e të drejtës apo faktit (marrëveshjet, etj).

2.3. Për ekzistencën e lidhjes direkte transaksion-kundërvlerë nuk është kusht që çmimi si kundërvlerë e furnizimit të paguhet domosdoshmërisht nga përfituesi i furnizimit.

Kundërvlera mund të paguhet nga një i tretë, i cili është një person i ndryshëm nga përfituesi i furnizimit të mallit/shërbimit:

ose tërësisht: Për shembull në rastin kur një kompani sigurimesh në vend të klientit kryen pagesat për këstet që normalisht ky i fundit duhet t'i paguante një shoqërie leasing.

ose pjesërisht: Për shembull në rastet e subvencioneve publike që plotësojnë çmimin e paguar nga përdoruesit e një shërbimi publik të tatueshëm (p.sh. çmimi i transportit të kryer nga një ndërmarrje paguhet pjesërisht nga përdoruesit (bileta) dhe pjesërisht nga pushteti publik.

2.4. Emërtimi që palët në transaksion i bëjnë pagesës është i parëndësishëm për të përcaktuar lidhjen e drejtpërdrejtë. Në këtë mënyrë, bizneset përdorin gjithnjë e më shumë praktikën e kompensimit ose faljes së detyrimeve/ borxheve midis tyre apo subvencioneve pikërisht për të rregulluar vështirësitë ekonomike me të cilat përballen disa prej tyre. Kur një subjekt financohet nga shuma që cilësohen si ndihma, subvencione, falje detyrimesh ose borxhesh, duhet verifikuar rast pas rasti nëse:

Shumat e paguara përbëjnë në fakt kundërvlerën e një transaksioni të realizuar në përfitim të palës që ka paguar shumat, termi “subvencion” është i papërshtatshëm. Në këtë rast, bëhet fjalë për çmimin e paguar për një shërbim të marrë apo për një furnizim të kryer. Ky transaksion është në fushën e zbatimit të TVSH-së dhe ky “subvencion” është i tatueshëm, përveç rastit kur ligji parashikon përjashtim nga TVSH-ja për furnizimin.

shumat e derdhura plotësojnë çmimin e një transaksioni të tatueshëm, në formën e një subvencioni për çmimin, i cili është në fushën e zbatimit të TVSH-së .

Në rastin kur subvencioni, ndihma apo donacioni nuk përdoret si në rastet e përshkruara më lart, ato nuk taten me TVSH.

Kur një organizëm financohet nga shuma që cilësohen si “ndihma, grante, donacione, subvencione”, verifikohet rast pas rasti, nëse shumat e derdhura përbëjnë kundërvlerën e një furnizim malli ose furnizim shërbimi të realizuar në përfitim të palës që ka derdhur shumat, apo nëse shumat e derdhura plotësojnë çmimin e një furnizim malli apo shërbimit të tatueshëm, atëherë pavarësisht përdorimit të çdonjërit prej këtyre termave për të emërtuar pagesën, nuk do të thotë që në këtë rast transaksioni është jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së. Në një rast të tillë bëhet fjalë për çmimin e paguar për një shërbim të marrë apo për një furnizim malli. Ky transaksion hyn në fushën e zbatimit të TVSH-së dhe shumat e marra në formë granti, donacioni, subvencioni janë të tatueshme për TVSH-në, përveç rastit kur ky furnizim malli ose shërbimi është i përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.

Neni 4

Personat e tatueshëm, veprimtaria ekonomike

Person i tatueshëm është çdo person qoftë ky individ, person fizik ose juridik, ose i organizuar në çdo formë tjetër të njohur nga legjislacioni në Republikën e Shqipërisë, i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari ekonomike sipas kuptimit të ligjit, pavarësisht vendit, qëllimit, ose rezultatit të kësaj veprimtarie. Për TVSH-në nuk është i rëndësishëm rezultati (humbje/fitim) i veprimtarisë ekonomike.

Elemente që nuk ndikojnë në përcaktimin e të qenit personi i tatueshëm janë: mungesa e fitimit; statuti i personave ose forma e organizimit; përgjegjësia përkundrejt llojeve të tjera të tatimeve; kryerja efektive ose jo e pagesës së TVSH-së.

Në kuptim të nenit 4 të ligjit veprimtari ekonomike është çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra ose shërbime, përfshirë veprimtarinë nxjerrëse, bujqësore dhe aktivitetet profesionale.

Gjithashtu konsiderohet veprimtari ekonomike shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, kur bëhet me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm. Me pasuri të trupëzuar dhe pasuri të patrupëzuar kuptohen përkatësisht aktivet materiale (të luajtshme dhe të paluajtshme) dhe aktivet jo-materiale.

Nocioni i pavarësisë në lidhje me cilësinë e personit të tatueshëm

Të qenit person i tatueshëm me TVSH rrjedh nga realizimi në mënyrë të pavarur i transaksioneve që lidhen me një aktivitet ekonomik, siç përcaktohet në nenin 5 të ligjit.

Personat që veprojnë në mënyrë të pavarur janë ata që ushtrojnë një aktivitet nën përgjegjësinë e tyre dhe gëzojnë liri të plotë në organizimin dhe zbatimin e veprimeve që përmban ky aktivitet.

Mund të veprojnë në mënyrë të pavarur personat që ushtrojnë një aktivitet profesional bazuar në një kontratë/ marrëveshje, me anë të së cilës një person merr përsipër të kryejë një punë për dikë tjetër, duke ruajtur pavarësinë e tij në kushtet e zbatimit të detyrave që i janë ngarkuar ose, bazuar në një kontratë përfaqësimi/marrëveshje me anë të së cilës një person merr përsipër të veprojë në emër të një personi tjetër që e përfaqëson juridikisht.

Personat që konsiderohen se nuk veprojnë në mënyrë të pavarur, pra veprojnë në mënyrë të varur nuk konsiderohen si persona të tatueshëm për TVSH- në. Si të tillë përmenden:

Punëmarrësit dhe persona të tjerë që lidhen me një kontratë pune apo me çdo lloj tjetër lidhje juridike duke krijuar marrëdhënie varësie në lidhje me kushtet e punës, modalitetet e pagesës, ose përgjegjësinë e punëdhënësit;

punëtorët që punojnë në shtëpi, të ardhurat e të cilëve konsiderohen si pagë ose shpërblim, nëse ata e ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas formave dhe kushteve të parashikuara nga Kodi i Punës.

Në kuptim të nocionit të pavarësisë në lidhje me cilësinë e personit të tatueshëm, si persona që nuk veprojnë në mënyrë të pavarur, pa u kufizuar, përmenden gjithashtu persona të tjerë punëmarrës të cilët, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, janë në një gjendje varësie kundrejt punëdhënësit të tyre, nëpërmjet kontratës së punës, të shërbimit, apo kriterëve për të vlerësuar ekzistencën e lidhjeve të varësisë; si: praktikantët, artistët e spektaklit, gazetarët, korrespondentët lokalë të shtypit; fotomodelët; punëtorët që punojnë në shtëpi; bashkëpunëtorë rastësorë të shërbimit publik dhe të gjitha format e punësimit të parashikuara në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Regjistrimi i personit të tatueshëm

Çdo person i tatueshëm sipas nenit 3 të ligjit regjistrohet duke u përfshirë në regjistrin e TVSH-së. Këta persona i nënshtrohen regjimit normal të TVSH-së, përveç atyre që i nënshtrohen regjimit të bizneseve të vogla siç përcaktohet në seksionin 1 të Kreut XI të ligjit dhe udhëzimit në zbatim të tij.

Në zbatim të nenit 91 të ligjit, çdo person i tatueshëm duhet të regjistrohet në regjimin normal të TVSH-së, brenda 15 ditëve nga data e fillimit të veprimtarisë ekonomike, sipas procedurës së parashikuar për identifikimin dhe regjistrimin në ligjin “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe ligjin “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Në regjimin normal të TVSH-së regjistrohet çdo person i tatueshëm që vepron si i tillë dhe parashikon të tejkalojë kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, pra që nuk i nënshtrohet regjimit të biznesit të vogël sipas ligjit, si dhe regjimit të veçantë “Për skemën e kompensimit të Prodhuesve Bujqësor”.

Është i detyruar t’i nënshtrohet regjimit normal dhe të regjistrohet për TVSH-në, çdo person fizik apo juridik që kryen importe të mallrave qarkulluese (mallra që tregton apo për t’u tregtuar), pavarësisht qarkullimit të realizuar apo qarkullimit të pritshëm.

Përfshihen nga ky rregull personat e tatueshëm që realizojnë ose parashikojnë të realizojnë qarkullim nën kufirin minimal të regjistrimit dhe importojnë mallrat e grupit AQT të tilla si: makineri dhe pajisje pune, instalime teknike, makineri e pajisje energjetike, instrumente e vegla, mjete transporti, mobilie e orendi zyresh, pajisje zyresh e informatike, mallra që përdoren në funksion të veprimtarisë ekonomike, dhe jo për t’u tregtuar.

Këta persona të tatueshëm mund të kryejnë importe mallrash të investimit për qëllim të përdorimit të veprimtarisë së tyre ekonomike që i nënshtrohet regjimit të biznesit të vogël në kuptim të ligjit, pa qenë të detyruar t’i nënshtrohen regjimit normal të TVSH-së.

Gjithashtu nuk janë të detyruar t’i nënshtrohen regjimit normal të TVSH-së personat e tatueshëm që kryejnë eksporte, qarkullimi i të cilëve është nën kufirin minimal të regjistrimit të TVSH-së.

Ka të drejtë të regjistrohet dhe t’i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së çdo person i tatueshëm, i cili kryhen furnizime të tatueshme, pavarësisht se nuk plotëson kushtet për të qenë i regjistruar. Në këtë rast ky person i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në nenin 120 të ligjit dhe dispozitave të këtij udhëzimi.

Nuk detyrohet të regjistrohet dhe t’i nënshtrohen regjimit normal për TVSH-në, çdo organizatë jofitimprurëse që nuk kryen veprimtari ekonomike, pra kur përfitojnë pagesa nga kuotizacionet,

nëse kanë të tilla, ose fonde, grante, donacione të përfituara për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, në përputhje me ligjin për organizatat jofitimprurëse. Nëse këto organizata përfitojnë pagesa si rezultat i veprimtarisë ekonomike, janë të detyruar të regjistrohen, përveç kur përcaktohet ndryshe në ligj apo në aktet nënligjore të tij.

Çdo person i cili plotëson kriteret për t'u regjistruar si person i tatueshëm për TVSH-në dhe nuk është regjistruar, e as ka kërkuar të regjistrohet për TVSH-në, regjistrohet në mënyrë të detyrueshme nga autoriteti tatimor në momentin (periudhën) që konstatohet. Detyrimet për TVSH-në për furnizimet (shitjet) e kryera për periudhat e mëparshme që ka qenë i detyruar të regjistrohej, i llogariten me efekt nga data kur ka qenë i detyruar të regjistrohej. Këto detyrime do të vlerësohen në regjistrin e TVSH-së në emër të personit të tatueshëm në periudhën e parë që ai regjistrohet për TVSH-në.

Neni 6

Çregjistrimi nga TVSH i Personit të Tatueshëm

Çdo person i tatueshëm i regjistruar në regjimin normal të TVSH-së, ka të drejtë të kërkojë të çregjistrohet nga TVSH, në rastet e mëposhtme:

Kur personi i tatueshëm mbyll veprimtarinë e tij ekonomike. Personi i tatueshëm, i regjistruar në regjimin normal të TVSH-së, i cili përfundon veprimtarinë e tij ekonomike, detyrohet të bëjë kërkesë për çregjistrim brenda 15 ditëve nga data e mbylljes së veprimtarisë ekonomike.

Në këtë rast kërkesa për çregjistrim i drejtohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe për dijeni i adresohet edhe autoritetit tatimor përkatës. Procedura e çregjistrimit kryhet siç është përcaktuar në ligjin dhe udhëzimin e procedurave tatimore. Autoriteti tatimor reflekton ndryshimet për çregjistrim të personit të tatueshëm në regjistrin tatimor, pasi njoftohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Në rastin e organizatave jofitimprurëse kërkesa për çregjistrim i drejtohet Drejtorisë Rajonale Tatimore, e cila kryen procedurën në përputhje me ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe ligjin “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Kur personi i tatueshëm ka plotësuar kushtet dhe procedurën për t'iu nënshtruar regjimit të bizneseve të vogla, siç përcaktohet në këtë udhëzim.

Kur personi i tatueshëm i regjistruar në regjimin normal të TVSH- së për shkak se ka ushtruar të drejtën e zgjedhjes për t'iu nënshtruar vullnetarisht këtij regjimi, heq dorë nga zgjedhja për të qenë i regjistruar për TVSH-në pasi ka plotësuar kushtet dhe procedurën që përcaktohet në këtë udhëzim për t'iu nënshtruar regjimit të bizneseve të vogla.

Kur personi i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në nuk ka qenë asnjëherë i detyruar të jetë i regjistruar dhe as nuk e ka ushtruar vullnetarisht të drejtën e zgjedhjes për t'u regjistruar për TVSH-në.

Ky person çregjistrohet në momentin kur konstatohet që as ka qenë i detyruar dhe as nuk e ka ushtruar vullnetarisht të drejtën e zgjedhjes për tu regjistruar për TVSH-në.

Ky person i tatueshëm është përgjegjës për të përmbushur çdo përgjegjësi për TVSH-në që nga momenti që është regjistruar deri në momentin që çregjistrohet nga TVSH-ja.

Kërkesa për çregjistrimin e personit të tatueshëm për rastet b) dhe c) i drejtohet Drejtorisë Rajonale Tatimore, e cila kryen procedurën përkatëse. Autoriteti tatimor ka detyrimin ligjor që pasi personi i tatueshëm të jetë çregjistruar nga regjimi normal i TVSH-së, të njoftojë brenda tre ditëve kalendarike Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për ndryshimin dhe evidentimin e këtij ndryshimi në regjistrin tregtar, përse ka të bëjë me ndryshime në regjistrim.

Neni 7

Të tjera për procedurën e çregjistrimit nga TVSH

Nëse personi i tatueshëm që çregjistrohet ose kërkon të çregjistrohet nga TVSH-ja ka mallra stok (inventar) të pa-shitura, ose mallra kapitale, aktive të tjera të përdorura për veprimtarinë, ku TVSH-ja mbi këto mallra ka qenë tërësisht apo pjesërisht e zbritshme, në bazë të nenit 9 të ligjit, këto mallra do të konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës dhe personi i tatueshëm është i detyruar të llogarisë ose rregullojë TVSH-në për këtë furnizim.

Bazuar në nenin 38 të ligjit, vlera e tatueshme e këtij furnizimi duhet të jetë e përbërë nga çmimi i blerjes së këtyre mallrave ose në mungesë të çmimit të blerjes nga vlera e kostos e përcaktuar në momentin kur personi i tatueshëm përfundon veprimtarinë e tij ekonomike të tatueshme.

Në këtë rast mallrat inventar (për t'u shitur) do të konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës, ndërsa për mjetet –aktive të luajtshme ose të paluajtshme do të bëhet rregullimi i zbritjes së TVSH-së në përputhje me afatin e përdorimit të këtyre aktiveve për qëllime të veprimtarisë. Rregullimi bëhet për afatin 5 vjet për aktivet e luajtshme dhe 10 vjet për aktivet e paluajtshme në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim.

Personat e tatueshëm që nuk kryejnë me veprimtari ekonomike dhe do të çregjistrohen janë të detyruar të deklarojnë furnizimet e kryera për qëllime të pikës 1 të këtij neni, në deklaratën që i përket periudhës më të fundit kur ai ka kryer furnizime të tatueshme.

Personi i tatueshëm që çregjistrohet nga regjimi normal dhe kalon në regjimin e bizneseve të vogla, ose kur është regjistruar vullnetarisht për TVSH-në, detyrohet të paraqesë këto furnizime në deklaratën e TVSH-së të periudhës së fundit që është i regjistruar për TVSH-në.

Neni 8

Veprimtaria e organizatave jofitimprurëse

Bazuar në nenin 3 të ligjit, nuk konsiderohet person i tatueshëm çdo organizatë jofitimprurëse për pagesa të përfituara nga kuotizacionet, nëse kanë të tilla, ose fonde, grante, donacione të përfituara për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, në përputhje me ligjin për organizatat jofitimprurëse, përveç kur kjo organizatë përfiton pagesa si rezultat i veprimtarisë ekonomike.

Një organizatë jofitimprurëse që përfiton pagesa të tilla si kuotizacionet, nëse ka të tilla, fonde, grante, donacione prej donatorëve për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, në përputhje me ligjin për organizatat jofitimprurëse dhe si kundërvlerë e këtyre pagesave të përfituara nuk i kryen donatorëve një furnizim malli ose shërbimi, por pagesat e përfituara i përdor

për të realizuar qëllimin e veprimtarisë së saj jofitimprurëse, atëherë këto shuma të përfituara nuk janë në fushën e zbatimit të TVSH-së. Organizata që kryen veprimtarinë e saj në këto kushte nuk është person i tatueshëm për TVSH-në dhe si e tillë nuk është e detyruar të regjistrohet për TVSH-në.

Bazuar në kriteret që duhet të përmbushen që një transaksion të jetë në fushën e zbatimit të TVSH-së, sipas të cilave një furnizim malli ose shërbimi duhet t'i sjellë avantazh të drejtpërdrejtë klientit dhe kundërvlera ose çmimi i mallit apo shërbimit duhet të këtë lidhje me avantazhin që klienti ka marrë, nëse nuk plotësohen këto 2 kushte, atëherë transaksioni është jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së.

Kështu furnizimet e shërbimeve të bëra (jo kundrejt pagesës) nga një organizatë jofitimprurëse për grupime të ndryshme, p.sh. njerëz në nevojë nuk përfshihen në fushën e zbatimit të TVSH-së pasi nuk janë shërbime të individualizuara për një klient të caktuar dhe klienti apo përfituesi i shërbimit në këtë rast nuk paguan për shërbimin e marrë në mënyrë që të krijohet lidhja midis avantazhit të marrë nga klienti dhe kundërvlerës ose pagesës. Këto shërbime mbulohen me fonde apo donacione që një organizatë jofitimprurëse përfiton si rezultat i veprimtarisë së saj jofitimprurëse.

Një rast tjetër kur një pagesë e marrë nuk është në fushën e zbatimit të TVSH-së, përmendet p.sh. kuota e anëtarësimit në një shoqate, kuotë, e cila krijon mundësinë dhe i jep të drejtën atij që e paguan që të jetë anëtar i saj dhe në këmbim të kësaj kuote anëtari nuk merr një shërbim të drejtpërdrejtë të individualizuar, pra shuma e paguar si kuotë anëtarësimi nuk përkon me ç'ka anëtari pret të marrë në këmbim nga shoqata. Kështu kuota e anëtarësimit nuk përfshihet në fushën e zbatimit të TVSH-së.

Në kuadër të veprimtarisë jofitimprurëse që kryejnë organizatat jofitimprurëse të tilla si: shoqatat, fondacionet, qendrat, të cilat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti, bazuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", përfshihet çdo veprimtari jo-ekonomike ose ekonomike, me kusht që të ardhurat ose pasuritë e organizatave jofitimprurëse, kur ka të tilla, të përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në statutin e organizatës.

Në veprimtarinë jofitimprurëse përfshihet përveç veprimtarisë jo-ekonomike edhe veprimtaria ekonomike e një OJF-je, e cila është veprimtaria që kryen një organizatë jofitimprurëse, me qëllim nxjerrjen e të ardhurave në këmbim të ofrimit të shërbimeve apo të mallrave të ofruara, për të mundësuar misionin e organizatës, me kushtin që kjo veprimtari nuk përbën qëllimin parësor të organizatës, si dhe të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit.

Kështu pavarësisht qëllimit për të cilin organizata jofitimprurëse kryen veprimtari ekonomike, vendi, qëllimi, ose rezultati i kësaj veprimtarie në zbatim të nenit 3 të ligjit, nuk është përcaktues për të konsideruar një person juridik si person të tatueshëm për TVSH-në. Përcaktues për të konsideruar një organizëm si person të tatueshëm për TVSH-në në zbatim të nenit 4 të ligjit është, kryerja e një veprimtarie ekonomike në mënyrë të pavarur.

Në rastin kur një organizatë jofitimprurëse përfiton pagesa si rezultat i veprimtarisë së saj ekonomike, pavarësisht nëse kjo veprimtari nuk është veprimtari kryesore e saj, për qëllime të

TVSH-së kjo organizatë është person i tatueshëm dhe transaksionet që ajo kryen janë në fushën e zbatimit të TVSH-së si furnizime të tatueshme, përveç nëse janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, siç është përcaktuar në nenin 51 të ligjit.

Organizata jofitimprurëse burimi i të ardhurave të të cilës janë:

Të ardhurat nga kuotizacioni kur ka të tilla dhe të ardhura nga fonde, grante ose donacione të ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj që janë jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së (nuk ofrohet një furnizim si kundërvlerë e pagesës së përfituar, pavarësisht emërimit të saj), nuk janë persona të tatueshëm për TVSH-në dhe si të tillë nuk janë të detyruar të regjistrohen për TVSH-në.

Të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe shfrytëzimi i pasurive në pronësi të organizatës jofitimprurëse, ose të ardhurat nga shërbimet e ofruara si kundërvlerë e pagesave të përfituara prej organizatës, kryejnë transaksione në fushën e zbatimit të TVSH-së dhe si të tilla duhet të regjistrohen për TVSH-në, përveç kur furnizime të tilla janë të përjashtuara nga TVSH-ja, sipas ligjit.

Të ardhurat që organizatat jofitimprurëse përfitojnë si rezultat i kontraktimeve me organet publike, nëpërmjet procedurave në fushën e sipërmarrjes, të tenderimit dhe të prokurimit të granteve, të kontraktimeve dhe të shitblerjeve nga ana e organeve shtetërore të shërbimeve publike, të mallrave dhe të pasurive publike, si dhe të transferimit të shërbimeve publike dhe pasurive përkatëse nga sektori publik tek organizatat jofitimprurëse, procedura të cilave u nënshtrohen në të njëjtën kohë dhe kanë të drejtë të marrin pjesë edhe personat e tjerë juridikë, duke e trajtuar si një rast në kushtet e konkurrencës me çdo subjekt tjetër tregtar, konsiderohen si transaksione në fushën e zbatimit të TVSH-së dhe për këtë qëllim organizata konsiderohet person i tatueshëm për TVSH-në dhe duhet të regjistrohen, përveç kur furnizime të tilla janë të përjashtuara nga TVSH-ja sipas ligjit.

Nëse një OJF realizon njëkohësisht të ardhura nga kuotizacioni, të ardhura nga fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse, atëherë kjo OJF do të deklarojë dhe paguajë TVSH-në vetëm për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve nga veprimtaria ekonomike apo nga shfrytëzimi i pasurisë së organizatës, nëse si rezultat i kësaj veprimtarie ekonomike realizon ose parashikon të realizojë një qarkullim vjetor që kalon kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në.

Organizatat jofitimprurëse, të cilat fitojnë personalitetin juridik pasi regjistrohen në gjykatë, sipas nenit 13 të ligjit “Për Organizatat Jofitimprurëse”, për qëllime tatimore regjistrohen në autoritetin tatimor kompetent sipas ligjit “Për Procedurat Tatimore në RSH”. Në momentin e regjistrimit, organizata jofitimprurëse deklaron edhe statusin lidhur me përgjegjësinë tatimore për TVSH-në, në përputhje me veprimtarinë që ajo do të kryejë. Regjistrohet për TVSH-në çdo organizatë, e cila është e detyruar të regjistrohet si e tillë, ashtu siç përcaktohet në pikën 5 të këtij neni.

Neni 9

Organet Publike

Në zbatim të nenit 6 të ligjit, organet e pushtetit qendror dhe vendor dhe organe të tjera të së drejtës publike nuk konsiderohen si persona të tatueshëm për veprimtari ose për veprime që ushtrojnë për qëllim dhe në ushtrimin e funksionit të tyre si autoritete publike, pavarësisht nëse përfitojnë taksa, tarifa, kontribute dhe pagesa, përveç kur të qenit person jo i tatueshëm shkakton shtrembërim të konkurrencës.

Personat juridikë të së drejtës publike përmenden kryesisht:

- . organet e pushtetit qendror përfshirë administratën në nivel qendror;
- . organet e pushtetit vendor, njësitë territoriale lokale (vendore si bashkitë, komunat, rajonet ose ndarjet e tjera administrative dhe grupimet e tyre);
- . institucionet dhe entet publike të shtetit, përfshirë këtu dhe ato që kanë një karakter industrial apo tregtar;
- . grupimet e përbëra ekskluzivisht nga personat juridikë të së drejtës publike, nëse ata sigurojnë misione të shërbimit publik dhe funksionojnë me pjesëmarrjen dhe nën kontrollin e autoritetit publik, financimi i të cilave sigurohet në gati tërësinë e tyre nga fondet publike, etj.

Në rastin kur këto organe të së drejtës publike nuk konsiderohen persona të tatueshëm, veprimtaria e tyre është jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së.

Në rastin kur të qenit person jo i tatueshëm i këtyre organeve, shkakton shtrembërim të konkurrencës, veprimtaria e tyre është në fushën e zbatimit të TVSH-së.

Nocioni i konkurrencës, i cili merret për referencë për të ditur nëse një organizëm i të drejtës publike është i tatueshëm apo jo me TVSH, shihet në një kuadër që tejkalon kufijtë e zonës në të cilën ai organizëm ushtron aktivitetin. Sipas rastit, fusha konkurrenciale mund të variojë në funksion të fushës së veprimit gjeografik të organizmit në fjalë, të shtrirjes së tregut apo të klientelës drejt së cilës orientohet ky aktivitet.

Karakter i konkurrues i aktivitetit të një organizmi publik mund të vendoset vetëm në raport me të njëjtin aktivitet apo një aktivitet të ngjashëm, për të cilin ndërmarrjet private i nënshtrohen TVSH-së. Nga kjo rrjedh që, organizmit publik që ushtron të njëjtin aktivitet me një organizëm privat veprimtaria e të cilit është e përjashtuar, nuk i kërkohet të jetë person i tatueshëm për TVSH-në.

Si rregull praktik, duhet të konsiderohen se mund të hyjnë në konkurrencë me sektorin privat veçanërisht shërbimet publike me karakter industrial dhe tregtar të organizmave të së drejtës publike, të cilat mund t'u jepen me koncesion ndërmarrjeve private.

Kur një person juridik i të drejtës publike konsiderohet si i tatueshëm me TVSH, sepse ushtron një aktivitet që i nënshtrohet detyrimisht TVSH-së, ose sepse ndodhet në konkurrencë me një veprimtari private, operacionet që ai kryhen i nënshtrohen efektivisht pagesës së TVSH-së, përveç kur ato nuk përfitojnë nga një përjashtim me karakter të përgjithshëm.

Për zbatimin e këtij neni, fillimisht përcaktohen aktivitetet e kryera nga personat juridikë të së drejtës publike, aktivitete të cilat nuk vendosen në fushën e zbatimit të TVSH-së, me qëllim për t'i dalluar ato nga operacionet e tatueshme ose të përjashtuara.

Janë mënyrat e ushtrimit të këtyre aktiviteteve që bëjnë të mundur përcaktimin e pa tatueshmërisë së këtyre organizmave, dhe jo objekti apo qëllimi i këtyre aktiviteteve. Në këtë kontekst pa-tatueshmëria mund të lidhet dhe me aktivitete ekonomike që kryhen nga persona të së drejtës publike, kur ato aktivitete nuk shkaktojnë shtrembërim të konkurrencës.

Nëse ekzistojnë rrethana të veçanta, të cilat nuk mund të vlerësohen rast pas rasti, duhet të kihet parasysh që aktivitetet e personave juridikë të së drejtës publike, të cilat mund të kryhen gjithashtu nga operatorë privatë, mund të ndahen në tre kategori. Për të vlerësuar nëse një aktivitet i ushtruar nga një person juridik i të drejtës publike ndodhet apo jo në fushën e zbatimit të TVSH-së, duhet të përcaktohet se në cilën nga tre kategoritë e mëposhtme përfshihet ky aktivitet.

Veprimtaritë e kryera nga organet publike klasifikohen:

Aktivitetet e ushtruara në bazë të pushtetit të sovranitetit apo interesit të përgjithshëm si autoritet publik

Aktivitetet e ushtruara në bazë të pushtetit të sovranitetit apo interesit të përgjithshëm si autoritet publik konsiderohen detyrat administrative bazë dhe të detyrueshme, që shteti dhe organet publike ushtrojnë në bazë të funksionit të tyre të pushtetit publik (mbrojtja kombëtare, arsimi kombëtar, policia, siguria publike, drejtësia, diplomacia, shëndeti publik, gjendja civile, mbledhja e tatimeve, etj.).

Të ardhurat e marra nga personat juridikë të së drejtës publike në kuadrin e ushtrimit të këtyre funksioneve të pushtetit publik, janë jashtë fushës së TVSH-se dhe nuk janë të tatueshme. P.sh. tarifrat që përfitojnë institucionet publike për lëshimin e dokumenteve të caktuara.

Gjithashtu aktivitetet e ushtruara si autoritet publik, janë ato që kryejnë organizmat e të drejtës publike në kuadrin e funksionit të tyre të përcaktuar me aktin sipas të cilit, ky autoritet është i organizuar dhe funksionon, me përjashtim të aktiviteteve që ata ushtrojnë në të njëjtat kushte juridike si operatorët ekonomikë privatë.

Për qëllime të përcaktimit të fushës së zbatimit të TVSH-së, nuk është e rëndësishme nëse gjatë ushtrimit të këtyre aktiviteteve merren taksa, tarifa, kontribute apo pagesa. Këtu përfshihen edhe aktivitete të cilat, ndonëse nuk lidhen me ushtrimin e sovranitetit dhe nuk kërkojnë ushtrimin e pushtetit, ushtrohen nga personat juridikë të së drejtës publike në funksionin e autoritetit publik. Si shembull mund të përmendet rasti i tarifave që merren prej autoritetit publik si kundërvlerë për hyrjen në një park kombëtar.

Aktivitetet e shërbimeve të organeve publike, pa-tatueshmëria e të cilave mund të shkaktojë shtrembërim të kushteve të konkurrencës

b/1 Aktivitetet për të cilat moskonkurrenca duhet të prezumohet (merret e mirëqenë) dhe që ndodhen jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së

Këtu përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

operacionet që lidhen ngushtë me asistencën sociale dhe sigurimet shoqërore. Janë pikërisht operacionet që kryhen në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit dhe qendrat e strehimit publik. Për shkak të mënyrës së tyre të funksionimit dhe karakterit social shumë të theksuar, pa-tatueshmëria e këtyre institucioneve nuk mund të shkaktojë shtrembërime të konkurrencës;

furnizimet e shërbimit dhe furnizimet e mallrave që lidhen ngushtë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve (qendrat publike të argëtimit, kampet publike të pushimeve);

shërbimet sportive dhe kulturore, publike. Këtu përfshihen tarifat e marra për hyrjen dhe shfrytëzimin e një biblioteke, të muzeve, monumenteve historike, si dhe taksat ose tarifat e marra nga organizimi i ekspozitave (panaireve) me interes lokal e kombëtar dhe të ardhurave që lidhen me aktivitetet e mësimdhënies muzikore apo artistike;

shërbimet e informimit on-line që kryhen në kuadrin e një misioni të shërbimit publik (p.sh. shërbimi i informimit on-line i bashkisë).

b/2 Aktivitetet për të cilat konkurrenca duhet të prezumohet dhe që ndodhen brenda fushës së zbatimit të TVSH-së

Këtu përfshihen aktivitetet të cilat për nga natyra e tyre, shtrirja apo klientela së cilës i drejtohet dhe mjetet e vëna në zbatim (reklama, tarifat e aplikuara) janë në konkurrencë të drejtpërdrejtë me ndërmarrjet tregtare që propozojnë shërbime të ngjashme.

Shembull: I tillë është rasti i të ardhurave që lidhen me shfrytëzimin e një fushe golfi, një kopshti zoologjik apo botanik, një parku lojërash, një sallë spektaklesh apo kinemaje, institucionet për kurat termale dhe organizimi i spektakleve apo i festivaleve (muzikorë apo teatralë).

b/3 Aktivitete të tjera

Regjimi i TVSH-së që zbatohet për aktivitete të tjera të personave juridikë të së drejtës publike duhet të vlerësohet rast pas rasti duke marrë në konsideratë mundësinë ose jo të sektorit privat për të përmbushur nevojat në fjalë.

Kështu kur një aktivitet i ushtruar nga një person juridik i të drejtës publike nuk ndodhet jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së në bazë të kriterëve të shprehura në nenin 2 të ligjit (referencat e pikave të udhëzimit më sipër) ai ndodhet domosdoshmërisht brenda fushës së zbatimit të këtij tatimi dhe do të jetë ose i tatueshëm ose i përjashtuar.

Për Shembull, institucionet arsimore publike dhe kopshtet publike kryejnë veprimtari në fushën e zbatimit të TVSH-së të tatueshme me TVSH, por përjashtohen në zbatim të nenit 51, pika g) dhe gj).

Aktivitete të cilësuarat të tatueshme që kryhen nga organe të së drejtës publike

Bazuar në nenin 6 pika 3 të ligjit, për aktivitetet të listuara më poshtë përcaktohet shprehimisht zbatimi i TVSH-së, kur këto aktivitete kryhen nga persona juridikë të së drejtës publike dhe nuk janë të papërfillshme.

Këto aktivitete listohen si më poshtë:

Shërbimet e telekomunikacioneve.

Furnizimi me ujë, gaz, energji elektrike dhe termike.

Transporti i mallrave.

Kryerja e shërbimeve portuale dhe aeroportuale.

Transporti i personave.

Shitjet e mallrave të reja, të prodhuara për shitje.

Veprimet e organizmave bujqësorë të ndërhyrjes, lidhur me produkte bujqësore, të kryera në zbatim të rregulloreve mbi organizimin e përbashkët të tregjeve të këtyre produkteve.

Menaxhimi i panaireve dhe i ekspozitave me karakter tregtar.

Shërbimi i magazinimit.

Veprimtaritë e zyrave të publicitetit tregtar.

Veprimtaritë e agjencive të udhëtimit.

Menaxhimi i shitjeve, i kooperativave, i mensave të ndërmarrjeve dhe të ngjashme.

Menaxhimi i enteve radio-televizive, kur nuk janë të përjashtuara, mbi bazën e nenit 51, shkronja “m”, të këtij ligji.

Këto aktivitetet do të konsiderohen se nuk janë të papërfillshme nëse të ardhurat e krijuara prej kësaj veprimtarie zënë më shumë se 10 % të të ardhurave totale në dispozicion të organit publik.

Shitjet në ankand publik

a. Furnizimi i mallrave që kryhen nga persona juridikë të së drejtës publike, të shitura nëpërmjet procedurës së ankandit publik siç parashikohet në ligjin “Për ankandin publik”, është jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së. Kështu shitjet në ankand publik të realizuara në përputhje me ligjin “Për ankandin Publik”, nuk tatohen me TVSH, kur shitja në ankand kryhet nga këto organizma që veprojnë si autoritete publike.

Shembull 1: Shitja e këtyre mallrave nëpërmjet procedurës së ankandit publik kryhet nga administrata publike qendrore ose vendore, apo entet publike që kryejnë veprimtarinë e tyre jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së.

Shembull 2: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ose organe publike të tjera kryejnë shitje në ankand të mallrave të konfiskuara, kur nuk i është paguar TVSH-ja, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre për qëllime të detyrimeve tatimore.

Përjashtim nga ky rregull përbën rasti i shitjes në ankand publik sipas ligjit “Për Ankandin Publik”, kryer nga persona juridikë të së drejtës publike, për mallra të reja, ose mallra të cilat janë tatuar me TVSH në import dhe janë të papërdorura, pavarësisht nëse janë mallra të konfiskuara ose të blera prej vetë këtyre organeve. Këto mallra i nënshtrohen TVSH-së në përputhje me dispozitat e ligjit.

Shembull : Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ose organe publike të tjera kryejnë shitje në ankand të mallrave të konfiskuara, për të cilët është paguar TVSH-ja, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre për qëllime të detyrimeve tatimore.

Neni 10

Furnizimet e tatueshme

Për qëllime të TVSH-së duhet të bëhet qartë dallimi midis furnizimit të mallrave dhe furnizimit të shërbimeve për zbatimin e dispozitave në lidhje me vendin e furnizimit (vendi i tatimit), kërkueshmërinë, momentin e lëshimit të faturës, shkallën e TVSH-së ose përjashtimin, si dhe në lidhje me regjimet e ndryshme tatimore.

Ligji i përcakton transaksionet si:

të tatueshme nga natyra dhe këto janë pikërisht furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të tatueshme, përveç kur bëjnë pjesë në transaksionet e përjashtuara;

të tatueshme, kur ligji i përcakton si të tilla. Këto transaksione të tatueshme sipas ligjit edhe pse nuk janë transaksione të tatueshme për nga natyra, trajtohen si transaksione të tatueshme kundrejt pagesës, sepse nëse nuk tatohen ato shkaktojnë shtrembërim të konkurrencës.

Shembull: Një person i tatueshëm, super-market, furnizon mallra ushqimore. Në fund të vitit u shpërndan dhuratë punonjësve të super-marketit nga një shportë mallrash me vlerë 7.000 lekë për festat e fundvitit. Ky person i tatueshëm kryen furnizime të tatueshme sipas natyrës pasi ai furnizon mallra ushqimore të tatueshme me TVSH. Ndërkohë mallrat që shpërndan si dhuratë për punonjësit, edhe pse nuk janë shitur, për qëllime të TVSH-së ligji i konsideron si furnizim kundrejt pagesës dhe si të tilla konsiderohen transaksione të tatueshme, sepse ligji i përcakton të tillë.

Në transaksionet e tatueshme nga natyra siç përcaktohet në nenet 7,8,10 dhe 11 të ligjit përkufizohen kategoritë që hyjnë në fushën e zbatimit të TVSH-së, konkretisht:

furnizimi i mallrave të trupëzuara, ku përfshihen mallra të luajtshëm dhe të paluajtshëm;
furnizimi i shërbimeve;

Shpesh disa operacione paraqesin një karakter të përzier malli dhe shërbimi. Përsa i përket furnizimeve të përziera sipas nenit 17 të ligjit përcaktohet se furnizimi i shërbimeve i përfshirë në furnizimin e mallrave është furnizim malli. Ashtu sikurse furnizimi i mallrave, i përfshirë në furnizimin e shërbimeve, është furnizim shërbimi. Furnizimi i shërbimeve, i përfshirë në importin e mallrave, është pjesë e importit të mallrave.

Këto raste janë të një natyre të tillë që duhet të analizohen rast pas rasti në varësi të transaksionit që kryhet, por duhet të kuptohet që nuk është vlera ose kosto ajo që bën përcaktimin nëse një furnizim është furnizim malli ose shërbimi.

Shembuj të aktiviteteve që paraqesin karakter të përzier përmendim: Punimet e instalimit lidhen në të njëjtën kohë me furnizimin e materialeve dhe me shërbimin për vendosjen e tyre.

Po ashtu, duhet bërë dallimi mes riparimit që ka karakterin e një furnizimi shërbimi (malli që riparohet e ruan cilësinë e tij si objekt i përdorur edhe pse për të kryer riparimin mund të furnizohen në të njëjtën kohë edhe materiale, ndërkohë që rinovimi dhe përpunimi i një malli karakterizohen me krijimin e një malli të ri dhe për pasojë me një furnizim malli të fabrikuar.

Shërbimi që merr pacienti në spital kur shkon për t'u diagnostikuar është shërbim për realizimin e të cilit përdoren edhe materiale apo mallra spitalore, por ajo që është vendimtare në këtë rast, është konsulta, vizita e mjekut, trajtimi i pacientit, si një furnizim shërbimi pasi ky është edhe qëllimi i hospitalizimit.

Nga ana tjetër, tirazhi i fotografive që konsiston thjesht në printimin e skedarëve që i dorëzohen klientit duke bërë ndoshta edhe ndonjë përmirësim të standardizuar (dimensionet, kontrolli i cilësisë), konsiderohet si furnizim malli, ndryshe nga fotografitë që bëhen nga një profesionist i fushës, të cilat karakterizojnë punën e fotografit për të zgjedhur modelin, sugjeruar pozicionin, etj. dhe jo thjesht nga printimi i fotove. Pra, realizimi i fotografive me anë të shkrepejeve të aparatit të fotografit, me kërkesë të klientit, do të konsiderohet si furnizim shërbimi.

Po ashtu, do të konsiderohen si furnizime malli rastet e prodhimit dhe shitjes në një numër të madh kopjesh të artikujve tregtarë si kartolinat e ndryshme, portretet e artistëve apo të personaliteteve, etj.

Nocioni i serisë (p.sh. prodhimi në seri) shpesh bën dallimin mes furnizimit të mallrave dhe furnizimit të shërbimeve për operacionet që kryhen me filmat. Ashtu sikurse furnizimi i standart-software, të cilët prodhohen në seri, është furnizim malli ndërkohë që furnizimi i software-ve të ndërtuar dhe konceptuar (përshtatur) sipas nevojave specifike dhe kërkesës së klientit është furnizim shërbimi.

Puna e krijimit dhe vendosjes së imazheve në një suport publicitar ose manjetik, ose prodhimi i një software special (sipas porosisë), janë një furnizim shërbimi për aq kohë sa vlera e shërbimit nuk mund të krahasohet në vlerën e suportit të tij material, ose e shprehur ndryshe, shërbimi nuk materializohet tërësisht në produkt.

Përkundrazi, shitja e riprodhimeve në një numër të madh kopjesh filmash konsiderohet si furnizim malli, sepse pjesa e furnizimit të produktit seri tejkalon gjerësisht vlerën e shërbimit të fotografimit dhe të tirazhit.

Neni 11

Furnizimi i mallit

1. Furnizimi i mallrave

Sipas nenit 7 pika 1 të ligjit, me furnizim malli kuptohet transferimi i së drejtës për të disponuar si pronar një mall të trupëzuar. Ky përcaktim përjashton mallrat e patrupëzuara duke i konsideruar ato për qëllime të TVSH-së si furnizim shërbimi, bazuar në nenin 10 të ligjit. Për qëllime të ligjit, pasuria e trupëzuar është pasuria e luajtshme ose e paluajtshme.

Transferimi i së drejtës për të gëzuar dhe disponuar lirisht një mall brenda kufijve të caktuar nga ligji, përbën transferimin e pronësisë, sipas së drejtës civile në Republikën e Shqipërisë. Rasti me i përgjithshëm i transferimit të pronësisë së mallit si një mall i trupëzuar është shitja e tij.

Nga ana tjetër, transaksionet që kanë të bëjnë me transferimin e pronësisë së mallrave të luajtshme të patrupëzuara (transferimet e të drejtave, licencave, markave të prodhimit, etj.) konsiderohen si furnizim shërbimi.

Gjithashtu për qëllime të ligjit, janë mallra të trupëzuara të luajtshme energjia elektrike, gazi, energjia për ngrohje ose ftohje, dhe uji si i ngjashëm me këto mallra për nga mënyra e disponimit ose shpërndarjes.

Sipas nenit 7 të ligjit, konsiderohet furnizim malli, transferimi i pronësisë së një malli të trupëzuar që kryhet me urdhër ose sipas kërkesës së autoritetit publik. Për shembull, kur bëhet një shpronësim për nevoja publike, kryer nga autoriteti publik kundrejt pagesës, personi i tatueshëm që shpronësohet përfiton një pagesë si kundërvlerë. Ky transaksion është furnizim i tatueshëm malli. Nuk lind TVSH-ja kur furnizimi i mallit që shpronësohet është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja sipas përcaktimeve për furnizimet e përjashtuara të bëra në nenet 51, 53, 54, 55 dhe 56 ligjit, p.sh. shpronësimet kundrejt pagesës së truallit ose ndërtesës.

Është furnizim malli dorëzimi i mallrave në bazë të një kontrate, ku parashikohet shitja me këste e mallit, kalimi i pronësisë i të cilit bëhet me pagesën e këstit të fundit;

Kjo dispozitë gjen zbatim në rastet e kontratave të shitjeve me këste ku transferimi i pronësisë parashikohet deri në pagesën e plotë të çmimit dhe të gjitha kontratave të shitjes që përmbajnë klauzolën e shitjes me rezervë të pronësisë e që kanë të njëjtin efekt. Shitja me rezervë e pronës bazuar në Kodin Civil përcakton se kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e këstit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rreziqet që në çastin e dorëzimit. Kalimi me rezervë i pronësisë me kushtin e sipërm duhet të pasqyrohet në kontratë.

Sipas dispozitës së ligjit, elementi që shihet si përbërës i furnizimit të mallit është dorëzimi material i mallit dhe jo transferimi i së drejtës për të zotëruar një mall si pronar.

Kështu edhe pse pronësia e mallit në një shitje me këste fitohet normalisht nga disponuesi apo ata që gëzojnë të drejtën, jo më vonë se pagesa e këstit të fundit, sipas një kontrate që përmban klauzolën e shitjes me rezervë të pronësisë, furnizimi i mallit kryhet kur bëhet dorëzimi i mallit dhe jo sipas kësteve të pagesës dhe pavarësisht kalimit të pronësisë.

Bazuar në nenin 8 të ligjit, furnizim malli konsiderohet gjithashtu furnizimi i pasurisë së trupëzuar si p.sh:

- Të drejtat mbi pasurinë e paluajtshme, të cilat i japin mbajtësit të drejtën për ta shfrytëzuar pasurinë, përveç qiradhënies që është furnizim shërbimi.
- ii) Të drejtat reale të cilati japin atij që i gëzon, të drejtën e përdorimit mbi pasurinë e paluajtshme;
 - Të drejtat (aksione, interesa ose të ngjashme) që i japin mbajtësit të tyre juridikisht ose faktikisht, të drejtën e pronësisë ose të posedimit të pasurisë së paluajtshme ose të një pjese të saj, pasuri e cila është e përjashtuar sipas gërmave “g” dhe “gj” të nenit 53 të ligjit.

Sipas të drejtës civile, këto të drejta kanë të bëjnë me të drejta që pronari i një pasurie të paluajtshme i jep (dhuron) shfrytëzuesit të pasurisë, për të shfrytëzuar dhe fituar të mirat prej pasurisë së paluajtshme. Një nga format e kësaj të drejte është uzufukti ose të drejta të tjera reale siç përcaktohen në të drejtën civile të Republikës së Shqipërisë, që i japin mbajtësit të drejtën e shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme, ose aksionet e të drejta të ngjashme që i japin mbajtësit ose juridikisht, ose faktikisht të drejtën e pronësisë, ose të posedimit të pasurisë së paluajtshme, ose një pjesë të saj.

Kështu bazuar në Kodin Civil, uzufrukti është e drejta e një personi (uzufruktari) për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë. Uzufrukti mbi një send të paluajtshëm duhet të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Uzufruktari gëzon të drejtat e tjera reale që do t'i gëzonte vetë pronari, përveç kufizimeve të parashikuara në aktin e krijimit të uzufruktit apo në ligjin përkatës.

Neni 12

Furnizimi i shërbimit

Sipas nenit 2 të ligjit, TVSH zbatohet mbi furnizimet e shërbimit që kryhen kundrejt pagesës nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë.

Me furnizime shërbimi sipas nenit 10 e 11 të ligjit kuptohen ato furnizime që nuk konsiderohen si furnizime mallrash në kuptim të nenit 7,8 dhe 9 të ligjit.

Të tillë janë për shembull transferimet (shitjet), koncesionet e mallrave të patrupëzuara (jomateriale); qiradhënia e mallrave të trupëzuara dhe të patrupëzuara; qiradhënia e mallrave të paluajtshme; transportet dhe shërbimet dytësore; punimet në pasuritë e paluajtshme, kryerja e procesit të ndërtimit, mirëmbajtjes, kryerja e operacioneve të realizuara nga ndërmjetës që veprojnë në emër dhe për llogari të dikujt tjetër; i punimeve studimore, kërkimore dhe të ekspertizës;

Në mënyrë të përgjithshme, janë furnizime shërbimi kryerja e të gjitha operacioneve që lidhen me kontratat me anë të së cilave një person angazhohet të kryejë me anë të një pagese të përcaktuar apo shkëmbimi me një mall ose shërbim tjetër një punë çfarëdo, apo të ushtrijë aktivitete që sjellin përfitime të ndryshme, pavarësisht nëse paguhet në formë shpërblimi, zbritjeje, përqindje e caktuar, ose detyrimi reciprok; operacionet e ndërhyrjes që kryhen nga përfaqësuesit apo nga shoqëritë përfaqësuese që marrin komision për ndërhyrjet e tyre në operacionet e importeve; kur detyrohesh të mos bësh apo tolerosh një akt apo një situatë; operacionet, përfshirë negocimin, në lidhje me valutat, kartëmonedhat bankare dhe monedhat që janë mjete pagese të ligjshme, me përjashtim të monedhave dhe kartëmonedhave të koleksionit; operacionet që lidhen me aksionet, pjesëmarrjet e shoqërisë, obligacionet dhe titujt e tjerë, me përjashtim të titujve përfaqësues të mallrave dhe kuotat e interesit, posedimi i të cilave siguron sipas të drejtës apo faktit dhënien e pronësisë apo gëzimin e një malli të paluajtshëm, ose një pjese të një malli të paluajtshëm, etj.

Punimet e ndërtimit dhe të mirëmbajtjes që kryhen gjatë procesit të ndërtimit konsiderohen gjithashtu furnizim shërbimi.

Nuk është furnizim shërbimi siç është trajtuar në pikën 3 të nenit 4 të këtij udhëzimi, shërbimi i bërë nga një i punësuar për punëdhënësin e tij për arsye të punësimit sipas kushteve të një kontrate sipas Kodit të Punës.

Neni 13

Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës

Të përgjithshme

Furnizimi i mallit ose furnizimi i shërbimit konsiderohet i kryer kundrejt pagesës, tërësisht ose pjesërisht, nëse furnizuesi direkt apo indirekt merr apo ka të drejtë të marrë, pagesë në para a në natyrë për atë furnizim, si prej personit të furnizuar apo ndonjë personi tjetër.

Kur një person i tatueshëm furnizon një mall ose shërbim, ky furnizim konsiderohet i kryer kundrejt pagesës nëse furnizuesi direkt prej personit të furnizuar, ose indirekt prej një personi tjetër që mbulon pagesën për llogari të furnizimit ose të të furnizuarit, merr pagesë ose ka të drejtë të marrë pagesë, pavarësisht nëse kjo pagesë është në para apo në natyrë.

Gjithashtu bazuar në nenin 9 dhe 12, ligji vendos në fushën e zbatimit të TVSH-së duke i përcaktuar si të tatueshme:

furnizimet e mallrave të kryera kundrejt pagesës, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë;

Furnizimet e shërbimeve të kryera kundrejt pagesës, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë.

Një furnizim i kryer kundrejt pagesës është në fushën e zbatimit të TVSH-së, ç'ka supozon ekzistencën e një kundërvlere, por gjithashtu edhe një furnizim që konsiderohet i kryer kundrejt pagesës sipas përcaktimeve të nenit 9 dhe 12 të ligjit është në fushën e zbatimit të TVSH-së.

Furnizimet e mallrave dhe furnizimet e shërbimeve si pjesë e veprimtarisë ekonomike, të kryera kundrejt pagesës janë të tatueshme me TVSH. Transaksione të kryera kundrejt pagesës kuptojnë të gjithë elementet që përfshihen në furnizim, kur blerësi i mallit apo përfituesi i shërbimit paguajnë një kundërvlerë, cilado qoftë vlera ose natyra e saj (para, mall i furnizuar apo shërbim i dhënë, etj.).

Furnizim kundrejt pagesës është operacioni me anë të të cilit vetë personi i tatueshëm me ose pa ndërhyrjen e një të treti, merr një mall (furnizim malli) apo një shërbim nga mallrat, elementet apo mjetet që i përkasin dhe janë në përdorim të veprimtarisë ekonomike të vetë personit të tatueshëm (furnizim shërbimi), për:

Qëllim privat të tij ose të stafit të tij, për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike,

E kalon për përdorim privat kur nuk kryen më veprimtari ekonomike (për t'u çregjistruar);

Shërbimet jepen pa pagesë për nevoja personale ose të stafit ose për qëllime të ndryshme nga ato të biznesit të tij.

Furnizimet sipas të cilave personi i tatueshëm i trajton mallrat ose shërbimet e biznesit jo për t'i përdorur për qëllimet e veprimtarisë njihen si përdorim privat i mallrave ose shërbimeve të veprimtarisë dhe konsiderohen furnizime kundrejt pagesës për qëllime të TVSH-së.

Furnizim kundrejt pagesës zbatohet gjithashtu për operacionin me anë të të cilit personi i tatueshëm me ose pa ndërhyrjen e një të treti, merr një mall (furnizim malli) apo një shërbim nga mallrat, elementet apo mjetet që i përkasin dhe janë në përdorim të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm (furnizim shërbimi), për t'i përdorur për qëllime të një veprimtarie jo më të

drejtë të plotë zbritjeje të TVSH-së, në rastin kur e drejta e zbritjes mbi këtë mall ose shërbim, nëse do të blihej nga një person tjetër i tatueshëm, nuk do të ushtrohej.

Vetëfurnizimi

Bën përjashtim nga ky rregull, veprimi me anë të të cilit personi i tatueshëm me ose pa ndërhyrjen e një të treti, merr një mall (furnizim malli) apo një shërbim nga mallrat, elementet apo mjetet që i përkasin dhe janë në përdorim të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm (furnizim shërbimi), për t'i përdorur për qëllime të veprimtarisë së tij ekonomike të tatueshme.

Bazuar në nenin 15 të ligjit, në këtë rast, personi i tatueshëm konsiderohet se ka kryer një vetëfurnizim të mallrave dhe shërbimeve me kushtin që këto mallra e shërbime të përdoren për qëllime të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, jo të përjashtuar të personit të tatueshëm.

Personi i tatueshëm përdor për nevoja të biznesit të tij një mall të prodhuar, nxjerrë, përpunuar, blerë, importuar ose shërbime të kryera në kuadër dhe për qëllime të veprimtarisë së tij ekonomike të tatueshme.

Personi i tatueshëm i furnizon dhe gjithashtu i trajton këto mallra ose shërbime si furnizime të marra prej tij, për qëllime të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, duke aplikuar zbritshmërinë e TVSH-së, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Për këtë, personi i tatueshëm lëshon një faturë për furnizimin si furnizues i mallit ose shërbimit dhe në të njëjtën kohë si blerës i këtij furnizimi për nevoja të biznesit të tatueshëm.

Kujdes në rastin kur personi i tatueshëm, merr një mall të biznesit të tij ose e përdor mallin për qëllime të furnizimeve të përjashtuara (pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së) që ai kryen në kuadër të veprimtarisë së tij, kur ky mall ka pasur të drejtë të plotë ose të pjesshme të zbritjes së TVSH-së në momentin e blerjes, ky person nuk kryen vetëfurnizim të mallit, por një furnizim kundrejt pagesës pasi malli do të përdoret për një veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja.

Gjithashtu konsiderohet furnizim kundrejt pagesës furnizimi i një shërbimi nga personi i tatueshëm për qëllime të veprimtarisë së tij ekonomike, në rastin kur ky shërbim po t'i furnizohej nga një person tjetër i tatueshëm, TVSH-ja e furnizimit nuk do të ishte tërësisht e zbritshme.

Për Shembull: Kur shoqëritë e ndërtimit të licencuara profesionalisht, do të ndërtojnë objekte për qëllim përdorimi në funksion të aktivitetit të tyre të tatueshëm (jo për furnizime të përjashtuara) kemi të bëjmë me vetëfurnizim të ndërtesave. Për çdo muaj, shoqëria ndërtuese përpilon situacionin e punimeve të kryera. Bashkëngjitur çdo situacioni mujor, do të jetë detyruesisht edhe fatura tatimore. Personi i tatueshëm është i detyruar të llogarisë TVSH-në çdo muaj kalendarik. Fatura tatimore e përpiluar si më sipër, regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjeve dhe të shitjeve të shoqërisë. Një vetëfurnizim i tillë duhet të jetë objekt i TVSH-së.

Vetëfurnizimi zbatohet vetëm në rastin kur kemi të bëjmë me një furnizim të tatueshëm dhe për qëllime përdorimi të veprimtarisë së tatueshme.

TVSH është e zbritshme pjesërisht apo tërësisht në varësi të qëllimit të përdorimit për një veprimtari të tatueshme të ndërmarrjes, përveç rastit kur malli përjashtohet nga e drejta e zbritjes për shkak të natyrës apo përdorimit të tij në këtë furnizim për nevoja të ndryshme nga ato të veprimtarisë ekonomike (përdorimi i tij për nevoja të ndryshme nga ato të veprimtarisë ekonomike ka ndodhur që në blerje të mallit) ose kur përdoret për një aktivitet të përjashtuar.

I tillë është rasti kur TVSH-ja në blerjen e autoveturës nuk është e lejuar të zbritet sipas ligjit dhe përse TVSH-ja nuk është zbritur që në momentin e blerjes së autoveturës, atëherë nuk përbën rëndësi qëllimi i përdorimit të saj, pra nëse do të përdoret për veprimtarinë e zbritshme pjesërisht apo tërësisht.

Furnizimi i mallrave të përdorura për nevoja të ndryshme nga ato të aktivitetit ekonomik

Furnizimi i mallrave të përdorura për nevoja të ndryshme nga ato të aktivitetit ekonomik janë të tatueshme me TVSH edhe nëse ndërmarrja i ka prodhuar apo ndërtuar vetë ato, ose i ka blerë dhe i ka furnizuar në atë gjendje, në rastin kur TVSH –ja në blerjen apo importimin e këtyre mallrave ose të mallrave dhe shërbimeve të përdorura për prodhimin e tyre është zbritur tërësisht apo pjesërisht gjatë blerjes apo importimit.

Kur një mall apo një shërbim i blerë nga ndërmarrja ose i krijuar me mjetet e ndërmarrjes përdoret për nevoja të ndryshme nga ato të ndërmarrjes, por TVSH e paguar në blerje për mallrat ose mjetet nuk është i zbritshëm, për pasojë nuk do të konsiderohet si furnizim kundrejt pagesës.

Në të kundërt, furnizimi është i tatueshëm nëse këto mallra dhe shërbime, gjatë blerjes apo importimit të tyre, ishin caktuar për realizimin e operacioneve me të drejtë zbritje, edhe nëse zbritja ka qenë totale apo e pjesshme pavarësisht nëse është kryer efektivisht apo jo.

Shembull: Një prodhues apo shitës televizorësh ose makinerish transferon pa pagesë tek një klient, furnizues apo një punonjës i stafit të tij një televizor apo makineri të marrë nga stoku, atëherë jemi në kushtet e një furnizimi kundrejt pagesës.

Konsiderohet furnizim shërbimikundrejt pagesës edhe në rastin kur nuk i transferon dhe as i përjashton nga stoqet në bilanc, por t'ua lë t'i përdorin pa pagesë (vetëm për një periudhë të shkurtër kohore që përkon me provën apo demonstrimin e tyre).

Shembull: Një ndërtues ndërtesash i cili ka ndërtuar një ndërtesë pjesërisht për ta shitur dhe pjesërisht e jep me qira të tatueshëm. Ky ndërtues rezervon të drejtën e përdorimit të një ambienti apo një pjesë të ndërtesës për qëllime të ndryshme nga ato të shitjes (banim personal, strehim pa pagesë për stafin e tij). Megjithatë, theksohet se përse ai e përdor ambientin për realizimin e operacioneve të tatueshme (qiradhënie për shembull), përdorimi prej tij i ambienteve ose i stafit të tij për strehim, konsiderohet furnizim kundrejt pagesës dhe si i tillë tatohet me TVSH.

Mbyllja e veprimtarisë ekonomike të tatueshme

Mbyllja e veprimtarisë ekonomike dallohet nga transferimi i veprimtarisë ekonomike. Transferimi i ndërmarrjes përmban transferimin e saj kundrejt pagesës apo pa pagesë, me vazhdimësi të veprimtarisë. Në të kundërt, me mbyllje të veprimtarisë kuptohet në mënyrë të përgjithshme braktisja, përfundimi i tërësisë së aktivitetit industrial apo tregtar për shkak të mbylljes përfundimtare të ndërmarrjes, ose nga

ndarja e shoqërisë në mënyrë vullnetare, ose në kuadrin e një procedure gjyqësore. Në parim, mbyllja e veprimtarisë, fillon nga data kur personi i tatueshëm nuk kryen më aktivitet, nuk tregton mallra ,etj.

P.sh. një ndërmarrje, objektivi i të cilës është shitja e mallrave, duhet të konsiderohet sikur e ka mbyllur aktivitetin e saj jo më vonë se data në të cilën ajo ka shitur tërësinë e stokeve të mallrave.

Mallrat për investim (aktivet) gjendje në datën e mbylljes së aktivitetit janë objekt i rregullimeve të TVSH-së së zbritshme nëse nuk janë shitur.

Megjithatë, për qëllime të TVSH-së konsiderohet se mbyllja e aktivitetit ndodh në datën kur stoqet (inventari) janë transferuar (shitur), ose në datën kur të gjitha mallrat kapitale të luajtshme janë transferuar (shitur) apo janë nxjerrë jashtë përdorimit nëse kjo procedurë ka qenë e nevojshme të zbatohet.

Mallrat e luajtshme të investimit gjendje, të cilat kalojnë për përdorim privat gjatë mbylljes së aktivitetit të personit të tatueshëm, janë objekt i rregullimit të TVSH-së së zbritur më parë, nëse këto mallra kanë pasur të drejtë zbritje të plotë apo të pjesshme të TVSH-së. Mallrat e paluajtshme janë objekt i rregullimit të TVSH-së së zbritur më parë gjithashtu.

Furnizimi kundrejt pagesës i mallrave që përdoren për një sektor aktiviteti të përjashtuar, pa të drejtë zbritje të TVSH-së

Ky rast i aplikimit të TVSH-së si një furnizim kundrejt pagesës, përfshin tërësinë e mallrave të luajtshme ose të paluajtshme. Personat e tatueshëm që kryejnë veprimtarinë e tyre në sektorë të tatueshëm dhe sektorë të përjashtuar pa të drejtë zbritje, duhet që në rastin e ndryshimit të përdorimit të një malli që ka pasur të drejtë zbritje të plotë apo të pjesshme të TVSH-së gjatë blerjes apo përdorimit të tij të mëparshëm, t’ia nënshtrojë TVSH-në përdorimin e këtij malli në sektorin e përjashtuar pa të drejtë zbritje të TVSH-së. TVSH-ja për këtë rast është e pazbritshme.

Në këtë rast, kur kemi ndryshim të përdorimit të një malli në kuadër të veprimtarisë së personit të tatueshëm, nga një veprimtari e tatueshme e tij me të drejtë të zbritjes së TVSH-së, ose pjesërisht e tillë (zbritje e pjesshme), në një veprimtari të përjashtuar pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së, në momentin kur ndodh ndryshimi i përdorimit të mallit në kuadër të veprimtarisë, për t’ia nënshtuar këtë transaksion TVSH-së, bazuar në nenin 9 të ligjit, zbatohet rregullimi i TVSH-së së zbritshme siç përcaktohet në këtë udhëzim.

Gjithashtu, mallrat stok që janë objekt i një ndryshimi në përdorimin e tyre (kalimi në asete të veprimtarisë) në kuadrin e të njëjtit aktivitet apo në kuadrin e përdorimit në sektorë të tjerë të aktivitetit të shoqërisë, janë objekt i aplikimit të TVSH-së si furnizim kundrejt pagesës, por me të drejtë të zbritjes së TVSH-së nëse këto mallra përdoren për të njëjtën veprimtari të tatueshme, dhe pa të drejtë zbritje të TVSH-së në rastin kur përdoren për një veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja. Në këtë rast kryhet furnizim kundrejt pagesës siç përcaktohet në nenin 9 të ligjit.

Neni 14

Furnizimi i mallrave kundrejt pagesës

Në zbatim të nenit 9 të ligjit parashikohet se tatohen me TVSH veprimet e mëposhtme që ngjasojnë, sipas rastit, me furnizime malli apo furnizime shërbimi të kryera kundrejt pagesës.

Ngjasojnë me furnizime malli të kryera kundrejt pagesës rastet kur:

Sipas pikës 2/a të nenit 9, një personi i tatueshëm merr mallra që janë pjesë e pasurisë së ndërmarrjes, për qëllim privat të tij apo të stafit të tij ose i transferon ato pa pagesë, duke i përdorur përgjithësisht për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike nëqoftëse ka zbritur tërësisht apo pjesërisht TVSH në blerje të këtij malli apo elementeve që përbëjnë mallin.

Nocioni “nevoja të ndryshme nga ato të veprimtarisë ekonomike” i përkufizon këto nevoja si nevojat e drejtuesve apo stafit të ndërmarrjes apo dhe të tretëve. Pra, ato nuk furnizohen ose nuk kryhen për nevojat e aktivitetit ekonomik.

Sipas pikës 2/b të nenit 9 të ligjit, në rastin kur një person i tatueshëm përfundon veprimtarinë e tij ekonomike, të gjitha mallrat në pronësi të personit të tatueshëm apo të personave që gëzojnë të drejtën, nëqoftëse është zbritur tërësisht apo pjesërisht TVSH-ja në blerje të mallrave apo në përdorimin e tyre në përputhje me paragrafin e dytë.

Në rastin e mbylljes së një veprimtarie mallrat inventar, të luajtshme dhe të paluajtshme që personi i tatueshëm disponon për të cilat është zbritur tërësisht ose pjesërisht TVSH-ja në blerje do të konsiderohen furnizime kundrejt pagesës.

Në këtë rast mallrat inventar (që janë për t'u shitur) do të konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës, ndërsa për mjetet –aktive të luajtshme ose të paluajtshme të pa shitura do të bëhet rregullimi i zbritjes së TVSH-së në përputhje me afatin e përdorimit të këtyre aktiveve për qëllime të veprimtarisë. Rregullimi bëhet për afatin 5 vjet për aktivet e luajtshme dhe 10 vjet për aktivet e paluajtshme në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim.

Sipas pikës 2/c të nenit 9 të ligjit një person i tatueshëm përdor për nevojat e ndërmarrjes së tij një mall të prodhuar, të nxjerrë, të përpunuar, të blerë, të importuar në kuadrin e aktivitetit të tij dhe kur blerja e këtij malli tek një person tjetër i tatueshëm, e kryer në momentin e përdorimit të tij për nevojat e ndërmarrjes, nuk do të kishte të drejtë të plotë zbritje sepse e drejta e zbritjes mbi këtë mall përbën objekt përjashtimi, kufizimi apo mund të jetë objekt rregullimi; kjo dispozitë zbatohet edhe në rastet kur mallrat përdoren për operacione jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së.

Shembull: Një shoqëri e cila tregon karburant, për nevoja të mjeteve të ndërmarrjes së vet kësaj shoqëri i nevojiten 500 litra karburant gazoil në një muaj për t'i përdorur për autoveturat e shoqërisë që ka në dispozicion. Sasia e karburantit të përdorur prej 500 litra gjatë një periudhe tatimore për nevojat e autoveturave të shoqërisë do të trajtohet si furnizim kundrejt pagesës i tatueshëm me TVSH, përse e drejta e zbritjes së TVSH-së mbi karburantin e përdorur për autoveturat, është objekt kufizimi sipas ligjit.

Sipas pikës 2/ç të nenit 9 të ligjit një person i tatueshëm përdor një mall në një sektor aktiviteti të përjashtuar pa të drejtë zbritje, në rastin kur ky mall ka pasur të drejtë të plotë ose të pjesshme zbritje të TVSH-së në momentin e blerjes apo përdorimit të tij në përputhje me paragrafin më sipër.

Shembull: Një person i tatueshëm që tregton bojëra për lyerje për të cilat e ka zbritur TVSH-në në blerje, ndërkohë ka edhe një ambient të cilin e lëshon me qira si furnizim të përjashtuar. Personi i tatueshëm një sasi boje prej bojërave që tregton, e përdor për lyerjen e ambienteve që lëshon me qira. Pra përdorimi i bojërave prej tij është bërë për një sektor aktiviteti të përjashtuar nga TVSH-ja pa të drejtë zbritje të TVSH-së, kështu furnizimi i bojërave do të konsiderohet furnizim kundrejt pagesës i tatueshëm me TVSH.

Në secilin nga rastet e mësipërme (1 deri 4), siç parashikohet në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, të pikës 2, të nenit 9 të ligjit, bazuar në nenin 38 pika 1 të ligjit, vlera e tatueshme e furnizimit përbëhet prej çmimit të blerjes së këtyre mallrave apo të mallrave të ngjashme ose, në mungesë të çmimit të blerjes, nga vlera e kostos, e përcaktuar në momentin, në të cilin kryhen veprimet e përdorimit, disponimit apo mbajtjes.

Neni 15

Furnizime shërbimi kundrejt pagesës

Furnizimi kundrejt pagesës i shërbimeve është veprimi me anë të të cilit një person merr një furnizim shërbimi të tatueshëm nga mallrat, elementet apo mjetet që i përkasin pasurisë së ndërmarrjes. Ky person mund të përdorë edhe të tretët për kryerjen e plotë apo të pjesshme të furnizimit.

Ngjasojnë me furnizime shërbimi të kryera kundrejt pagesës rastet kur:

Sipas pikës 2/a të nenit 12 të ligjit, përdorimi për qëllime private i një malli që bën pjesë në pasurinë e ndërmarrjes, nga personi i tatueshëm apo stafi i tij, apo përgjithësisht për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike, në qoftë se ky mall ka qenë objekt i një zbritje të plotë apo të pjesshme të TVSH-së.

Shembull: Një shoqëri transporti mallrash, një kamion të shoqërisë së saj për të cilin ka zbritur TVSH-në në blerje e vë në dispozicion të administratorit ose financieres së shoqërisë për transportimin e mallrave personale të shtëpisë. Në këtë rast ky shërbim transporti duke përdorur mallin(pasurinë) e ndërmarrjes konsiderohet si furnizim shërbimi kundrejt pagesës.

Sipas pikës 2/b të nenit 12 të ligjit, furnizimi i shërbimeve të kryera pa pagesë nga një person i tatueshëm për nevojat e tij personale apo të stafit të tij, apo përgjithësisht për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike.

Shembull: Një person i tatueshëm arkitekt i bën dizenjimin e shtëpisë djalit të vet pa pagesë. Në këtë rast arkitekti kryen një furnizim kundrejt pagesës.

Shembull: Një shoqëri pastrimi, person i tatueshëm njëherë në javë vë në dispozicion një punonjës pastrues të shoqërisë për të pastruar shtëpinë e Drejtorit të Financës. Në këtë rast kryen një furnizim shërbimi kundrejt pagesës.

Në secilin nga rastet e mësipërme, në rastin e furnizimit të shërbimit, të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 12, të ligjit, bazuar në nenin 38 pika 2 të ligjit, vlera e tatueshme përbëhet nga kostoja e plotë e shpenzuar nga personi i tatueshëm për kryerjen e shërbimeve.

Sipas nenit 12, pika 2 shkronja c) furnizimi i shërbimeve nga një person i tatueshëm, për qëllime të veprimtarisë së tij ekonomike, në rastin kur TVSH-ja për furnizimin e këtij shërbimi, po të ishte kryer prej një personi tjetër të tatueshëm, nuk do të ishte tërësisht e zbritshme.

Për rastin e këtij furnizimi shërbimi, të kryera nga personi i tatueshëm për nevojat e biznesit së vet, sipas nenit 38/3, vlera e tatueshme do të jetë vlera e tregut e shërbimit të furnizuar.

Shembull: Një person i tatueshëm, shoqëri që jep shërbime inxhinierie, arkitekturore, desing, et.,j projektin të zgjerojë veprimtarinë e saj edhe me një shkollë universitare të arkitekturës dhe një pjesë për zyrat e saj të projektimit.

Shoqëria bën projektimin e ambienteve të universitetit dhe kryen kështu një furnizim kundrejt pagesës, vlera e tatueshme e të cilit është vlera e tregut e shërbimit të projektimit. Nëse ky shërbim do të ishte kryer prej një personi tjetër të tatueshëm për shoqërinë nuk do të ishte tërësisht i zbritshëm në varësi të qëllimit të përdorimit pjesërisht si shkollë (furnizime të përjashtuara) dhe pjesërisht për zyra për furnizim të tatueshëm.

Neni 16

Përcaktimi i dhuratave me vlerë të vogël dhe mostrave (kampioneve)

Bazuar në pikën 3 dhe 4 të nenit 9 të ligjit nuk konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës rastet kur një person i tatueshëm përdor, shfrytëzon mallra të biznesit si dhurata me vlerë të vogël apo mostra (kampione).

Për qëllime të aplikimit të dispozitës së parashikuar, mostër (kampion) konsiderohen ato objekte të lidhura drejtpërdrejtë me kryerjen e aktiviteteve të personave të tatueshëm, që i ofrohen konsumatorëve, klientëve të zakonshëm apo atyre potencial dhe nuk janë për qëllime shitje. Këto objekte nuk janë për qëllime shitje ose nuk shiten pasi kanë trajtën që pamundëson shitjen e tyre. Mallrat që jepen si mostra biznesi duhet të jenë të shenjëzuara si të tilla dhe duhet ta kenë trajtën ose paketimin ndryshe krahasuar me mallrat (objektet) të cilat kanë për qëllim shitjen.

Për qëllime të aplikimit të dispozitës së parashikuar, dhuratë me vlerë të vogël, konsiderohet një mall me vlerë individuale të tregut më të vogël se 2.000 lekë, që shpërndahet pa pagesë për qëllim të zgjerimit, publicitetit dhe promovimit të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm, të cilën personi i tatueshëm ia jep konsumatorëve të rregullt ose konsumatorëve potencial.

Në rastin kur dhuratat janë nga mallrat e biznesit ky rregull lejohet të zbatohet vetëm për një objekt për të njëjtin përfitues dhe vetëm një herë në vit, pavarësisht vlerës së mallit, por jo më shumë se vlera e përcaktuar. Duhet të provohet qartësisht nga ana e personit të tatueshëm që një dhuratë me vlerë nën 2,000 lekë është përfitur vetëm për një objekt, njëherë të vetme nga i njëjti klient përgjatë një viti.

Gjithashtu mallra dhuratë me vlerë të vogël konsiderohen mallrat e përdorura si artikujt publicitarë dhe promocionalë të veprimtarisë ekonomike, me vlera të vogla për njësi dhe që publikojnë një logo a emër të personit të tatueshëm

Si parim kur mallrat merren apo përdoren nga ndërmarrja konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës të tatueshme me TVSH. Brenda kësaj kategorie përfshihen pikërisht mallrat që merren për qëllime private dhe nuk përdoren për realizimin e transaksioneve të tatueshme nga ndërmarrja ose kur këto mallra nuk përdoren për nevojat e shfrytëzimit të saj.

Megjithatë, bazuar në nenin 9 të ligjit parashikohet një përjashtim nga parimi, për mallrat me vlerë përdorimi si mostra (kampionë) dhe dhuratave me vlerë të vogël që merren, përdoren ose shpërndahen pa pagesë për nevojat e veprimtarisë ekonomike.

Marrja e një “malli me vlerë të vogël” të transferuar pa pagesë nga mallrat e ndërmarrjes nuk është furnizim kundrejt pagesës në kuptim të ligjit dhe nuk kërkohet të zbatohet TVSH nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

Përdorimi kryhet për nevojat e veprimtarisë ekonomike.

Përdorimi lidhet me një mostër (kampion) ose me një objekt me vlerë të vogël

Gjatë blerjes, importim ose prodhimit të këtij malli, të drejtat e zbritjes së TVSH-së së mallit janë ushtruar sipas kritereve të së drejtës së zbritjes.

Nëse dy kushtet e mësipërme nuk plotësohen, pavarësisht vlerës së mallit që mund të jetë nën vlerën e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, furnizimi konsiderohet i kryer kundrejt pagesës.

Shembull: Furnizimi duhet t'i nënshtrohet TVSH-së kur malli që merret pa pagesë nga inventari i ndërmarrjes, ndonëse në vlerë të vogël p.sh. 1000 lekë, përdoret për nevojat private të drejtuesve të ndërmarrjes dhe jo për nevojat e veprimtarisë ekonomike.

Në zbatim të parimeve të së drejtës së zbritjes së TVSH-së nuk lejohet zbritja e TVSH-së për blerjet e mallrave ose prodhimin e mallrave të caktuara të destinuara për t'u transferuar pa pagesë, përveç se për mostrat (kampionë), ose për mallra me vlerë të vogël të përcaktuara sipas pikës 2 të këtij neni.

Shembull: Një tregtar televizorësh, për të promovuar një produkt të ri blen radio dorë me vlerë 3000 lekë (më e madhe se 2000 lekë, vlera maksimale e lejuar) dhe i dhuron ato pa pagesë. Në këtë rast këto mallra konsiderohen furnizim kundrejt pagesës përse ato mallra janë një produkt i ri i përshtatshëm për rishitje dhe nuk është blerë me qëllim për t'i shërbyer veprimtarisë të tatueshme të shitjes së televizorëve.

Shembull: Një ndërmarrje i ofron një mall dhuratë një klienti të saj të rregullt. Në këtë rast, paraqiten dy situata:

malli që i dhurohet klientit nuk bën pjesë në rastin përjashtues të parashikuar, Nëse nuk plotësohen të dy kushtet sipas pikës 3 të këtij neni dhe në këtë rast kemi një furnizim kundrejt pagesës të tatueshëm me TVSH.

malli që i dhurohet klientit bën pjesë në rastin përjashtues siç është parashikuar më sipër pasi plotësohen të dy kushtet (vlera totale e mallit është nën 2000 lekë dhe dhurohet si një klient i rregullt, si dhe për të promovuar mallin e ri të sezonit/ vetëm një herë në vit), dhe në këtë rast nuk kryhet furnizim kundrejt pagesës edhe pse TVSH-ja e mallit është zbritur në momentin e blerjes së tij nga personi i tatueshëm.

Neni 17

Qiraja financiare, rregulla për tu zbatuar

Kontrata e qirasë financiare ose leasing është një kontratë që analizohet si një qiradhënie për klientin ose qiramarrësin, të cilit i jepet një mundësi e thjeshtë blerjeje duke paguar një çmim të miratuar, i cili merr në konsideratë, të paktën pjesërisht, pagesat e kryera në formën e pagesave periodike.

Ky operacion konsiderohet si qiradhënie që ndiqet nga shitja dhe pronari mund të mos jetë domosdoshmërisht ish- qiramarrësi.

Bazuar në ligjin nr 9396, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare”, nëpërmjet një kontrate të "Qirasë financiare" krijohet një marrëdhënie juridike, sipas së cilës qiradhënësi i blen furnizuesit një send të përzgjedhur nga qiramarrësi pranë furnizuesit dhe ia jep atë qiramarrësit për ta përdorur për një afat të caktuar, kundrejt një çmimi të caktuar në kontratë dhe, me mbarimin e afatit të kontratës, qiramarrësi mund ta blejë sendin, të vazhdojë ta mbajë me qira për një afat tjetër ose t’ia kthejë atë qiradhënësit.

Palët në qiranë financiare janë qiradhënësi, qiramarrësi dhe furnizuesi, ku "Qiradhënësi" i cili është personi juridik që ka dhe ruan të drejtën e pronësisë mbi mallin dhe që i jep qiramarrësit (individ, person fizik ose juridik) të drejtën të mbajë dhe të përdorë sendin gjatë afatit të kontratës së qirasë, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Qiramarrësi mund të fitojë të drejtën e pronësisë pasi ka mbajtur në përdorim sendin gjatë afatit të kontratës së qirasë dhe pasi ka shlyer të gjitha pagesat e qirasë dhe çmimin përfundimtar të blerjes, i cili është shuma e paracaktuar, që qiramarrësi paguan pas mbarimit të afatit të kontratës së qirasë, kur ose nëse vendos ta blejë sendin.

Furnizuesi, person fizik ose juridik, në bazë të kontratës së furnizimit, që lidh me qiradhënësin për sendin e përzgjedhur nga qiramarrësi, në përputhje me përcaktimet e qiramarrësit dhe me kushtet e miratuara prej tij, me anë të së cilës qiradhënësi fiton të drejtën e pronësisë mbi atë send, i shet qiradhënësit sendin që i jepet me qira qiramarrësit.

Bazuar në nenin 7 të ligjit furnizimi i mallit (sendit) i kryer nga furnizuesi për qiradhënësin sipas kontratës së furnizimit është furnizim malli. Furnizuesi lëshon faturë tatimore me TVSH 20% për furnizimin dhe TVSH lind mbi vlerën e mallit.

Qiradhënësi qoftë ky institucion financiar ose bankë, ose jo, kur lejohet kryejë veprimtari të qirasë financiare, sipas kërkesave të legjislacionit të fushës do të zbatojë rregullat siç përcaktohet në vijim:

- 3.1 Qiradhënësi, nëpërmjet një kontrate të qirasë financiare, që lidhet ndërmjet tij dhe qiramarrësit i jep me qira financiare sendin qiramarrësit. Sipas kësaj kontrate përcaktohet afati i përdorimit të sendit, përkundrejt pagesave periodike, shuma e të cilave është sa vlera reale në treg e sendit, por që mbulon investimin e qiradhënësit dhe siguron një fitim mbi investimin.
- 3.2 Qiradhënësi e regjistron faturën e lëshuar nga furnizuesi si blerje me TVSH duke e regjistruar përkatësisht në librin e blerjes dhe ka të drejtë të zbresë TVSH-në e shënuar në faturë.
- 3.3 Në përputhje me afatin e përcaktuar të qirasë financiare, qiradhënësi i dorëzon mallin qiramarrësit dhe për çdo periudhë mujore i faturon qiramarrësit pagesat e qirasë. Pagesat e qirasë ashtu siç përcaktohet në legjislacionin e fushës janë pagesat periodike, që bën qiramarrësi gjatë afatit të kontratës së qirasë financiare, sipas kushteve të përcaktuara në të. Qiraja është në formë pagesash, të cilat përlllogariten duke vlerësuar edhe normën e amortizimit të sendit, të një pjese ose të pjesëve thelbësore të tij.
- 3.4 Vlera e tatueshme që shënohet në faturën tatimore me TVSH është sa vlera e pagesës periodike tëqirasë, përveç interesit, me TVSH 20%. Faturat regjistrohen nga qiradhënësi në librin e shitjes dhe deklarohen si shitje të tatueshme, sipas periudhave tatimore që i takojnë.
- 3.5 Qiramarrësi, kur është person i tatueshëm që i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së ushtron të drejtën të zbresë TVSH-në e shënuar në faturën e qirasë financiare në përputhje me parashikimet e kapitullit X të ligjit përse i përket zbritshmërisë së TVSH-së.
- 3.6 Në fund të periudhës së kontratës, nëse qiramarrësi do të ushtrojë mundësinë e blerjes së mallit të përcaktuar në të, qiradhënësi lëshon për të një faturë përfundimtare me vlerë të tatueshme për vlerën shtesë që duhet të paguajë siç është përcaktuar në kontratë nëse ushtron të drejtën e blerjes së mallit.

E njëjta procedurë si më sipër kryhet në rastin kur qiradhënësi e prodhon vetë mallin, me ndryshimin që përjashtohet nga skema roli i furnizuesit.

Edhe kur qiradhënësi është një bankë ose institucion financiar që kryen edhe aktivitetin e qirasë financiare përveç se duhet ta ushtojë këtë veprimtari në përputhje me kërkesat e legjislacionit për qiranë financiare duhet të zbatojë rregullat për aplikimin e TVSH-së sipas pikës 3 të këtij neni.

Aktiviteti i qirasë financiare është i tatueshëm për TVSH-në, pavarësisht nga cilësia e personit të tatueshëm që e kryen këtë aktivitet. Nëse banka ose një institucion financiar kryen aktivitetin e qirasë financiare, atëherë kryen furnizime të tatueshme për TVSH-në dhe ka të drejtë të zbresë TVSH-në e aplikuar prej furnizuesit për blerjen e mallit objekt i qirasë financiare dhe të llogarisë TVSH-në për pagesat periodike të qirasë financiare të llogaritura për çdo muaj për qiramarrësin përveç interesit.

Çdo pagesë e arkëtuar ose vlerë e faturuar nga qiradhënësi për qiramarrësin mbi baza mujore, përtej vlerës së pagesave periodike të qirasë në kuadër të kontratës së qirasë financiare, konsiderohet element i vlerës së tatueshme të pagesave për furnizimin e qirasë financiare dhe si element përbërës i vlerës së tatueshme të furnizimit të qirasë financiare është e tatueshme me TVSH 20%, përveç interesit.

Furnizimi i qirasë financiare është furnizim i tatueshëm për TVSH-në kur objekti i qirasë financiare është një mall, i cili nëse do të blihej ose do të vihej në dispozicion të qiramarrësit në kushte normale do të ishte i tatueshëm me TVSH, jo i përjashtuar.

Faturat e blerjes dhe shitjes përkatësisht regjistrohen në librin e blerjes dhe shitjes dhe deklarohen në periudhën përkatëse në deklaratën e TVSH-së.

Nëse aktiviteti i qirasë financiare kryhet nga një bankë, përveç veprimtarisë së qirasë financiare, banka në të njëjtën kohë kryen edhe veprimtarinë e saj si bankë, të përjashtuar nga TVSH sipas përcaktimeve të nenit 53 të ligjit. E drejta për të zbritur TVSH-në ushtrohet në përputhje me kapitullin X të ligjit dhe me këtë udhëzim

Neni 18

Dhënia në përdorim e aktiveve të veprimtarisë

Në rastet kur një person i tatueshëm, i cili tregton mallra i jep klientit të tij në përdorim, pa pagesë, aktive të qëndrueshme të trupëzuara pjesë e veprimtarisë së tij, me qëllim mbajtjen, ruajtjen me qëllim tregtimi të mallrave që ai furnizon, (frigoriferë, banakë frigoriferikë dhe të tjera të kësaj natyre) trajtimi i TVSH-së do të jetë si më poshtë:

Në rast se klienti, të cilit i është dhënë në përdorim aktivi nga furnizuesi i tij, paguan të njëjtin çmim si edhe një klient, i cili thjesht blen mallra pa marrë në përdorim aktive të kësaj natyre, atëherë nuk llogaritet TVSH mbi dhënien në përdorim të aktiveve.

Në rast se klienti, të cilit i është dhënë aktivi në përdorim nga furnizuesi i tij, paguan një vlerë më të madhe për mallrat e furnizuara nga ky i fundit se një klient i cili thjesht blen mallra, atëherë llogaritet TVSH, me shkallë tatimore 20%, mbi diferencën e çmimit. Kjo diferencë konsiderohet si vlerë e dhënies në përdorim të aktivit. Ky parim zbatohet vetëm aty ku nuk ka detyrim për blerësin për të bërë një pagesë në para ose në natyrë, për përdorimin e aktivit.

Si kusht për këtë trajtim nevojitet:

Midis furnizuesit (pronar i aktivit) dhe klientit, të ekzistojë një kontratë e lidhur sipas së cilës furnizuesi kryen furnizime të vazhdueshme të atij malli, për ruajtjen e të cilit janë të domosdoshme aktivet përkatëse. Në të njëjtën kontratë sqarohet që dhënia në përdorim e këtyre aktiveve bëhet pa pagesë.

Zbatimi në praktikë i kësaj kontrate, pra furnizimet e vazhdueshme të furnizuesit (pronar i aktivit) për klientin të jenë konkretizuar me dokumente justifikuese. Në rast se konstatohet që klienti të cilit i është dhënë në përdorim aktivi nuk është më klient i furnizuesit pra nuk ka marrë më furnizime të mallit në fjalë tek furnizuesi për një periudhë të caktuar kohe që duhet të jetë e përcaktuar në kontratë dhe aktivi nuk i është kthyer furnizuesit, atëherë aktivi në fjalë për të cilin është zbritur TVSH-ja në blerje do të konsiderohet si furnizim kundrejt pagesës.

Furnizuesi i paraqet këto aktive në dokumentet e tij të kontabilitetit kundrejt të gjitha rregullave, si pronë të tij.

Trajtimi i mësipërm është i vlefshëm vetëm në rastet kur nuk ka detyrim për klientin (blerësin) për të bërë një pagesë në vlerë ose natyrë për llogari të furnizuesit, për marrjen në përdorim të aktivitetit. Është në përgjegjësinë e furnizuesit të provojë dhe dokumentojë që për aktivin nuk është marrë pagesë në vlerë ose natyrë prej klientit. Për të vërtetuar këtë fakt përveç kontratës klienti duhet t'i lëshojë një vërtetim furnizuesit ku të vërtetojë që atij nuk i është kërkuar të kryejë asnjë pagesë nga furnizuesi për dhënien në përdorim të aktivitetit.

Nëse dhënia në përdorim e këtyre aktiveve/mallrave, ose e drejta për t'i përdorur ato, bëhet kundrejt pagesës, atëherë kemi të bëjmë me furnizim të tatueshëm dhe mbi transaksionin zbatohet TVSH 20%. Çdo pagesë e marrë nga furnizuesi në formën e një garancie për një furnizim, konsiderohet element i vlerës së tatueshme të furnizimit si pagesë për dhënien në përdorim të aktivitetit dhe si e tillë është e tatueshme me TVSH.

Në rastet kur një person i tatueshëm, i cili kryen një furnizim shërbimi ose malli për klientët e tij dhe për qëllime të kryerjes së furnizimit vë në përdorim mallra të veprimtarisë së tij si pjesë e furnizimit të shërbimit, atëherë çdo mall i vënë në dispozicion i nevojshëm për ofrimin e shërbimit prej furnizuesit, është pjesë e furnizimit. Çdo vlerë e paguar nga klienti ose çdo vlerë e mbajtur, marrë në formë garancie nga furnizuesi i shërbimit në funksion të realizimit të kontratës së shërbimit për vetë shërbimin ose për çdo mall të përfshirë në furnizimin e shërbimit përbëjnë ose përfshihen në vlerën e tatueshme të furnizimit të tatueshëm.

Në rastin kur vlera e mbajtur ose marrë si garanci në kushtet e mësipërme i kthehet klientit atëherë bëhen saktësimet e nevojshme edhe për qëllimet e TVSH-së.

Shembull: Në momentin e lidhjes së kontratës për marrjen e një shërbimi telefonie furnizuesi i shërbimit i cili bën të mundur krijimin e infrastrukturës për kapjen e sinjalit prej përfituesit të shërbimit, në mënyrë që të garantojë që klienti i tij nuk e tjetëron kontratën për një periudhë të caktuar kohe (p.sh. 1 vit), i mban atij një garanci në vlerë të përcaktuar në kontratë. Vlera e kësaj garancie konsiderohet si pagesë e bërë në funksion të realizimit të shërbimit dhe si e tillë konsiderohet element i vlerës së tatueshme të furnizimit.

Përfundim nga ky rregull, bëjnë garancitë e marra dhe të depozituara në një bankë ose të një treti, pa të drejtë përdorimi, për aq kohë sa qëllimi i garancisë nuk është plotësuar.

Nëse për çdo arsye, në përfundim të afatit të garancisë, për arsye të plotësimit ose mosplotësimit të qëllimit të garancisë, një pjesë e garancisë mbahet nga personi i tatueshëm, atëherë pjesa e mbajtur tatohet për TVSH-në si pjesë e furnizimit të tatueshëm.

Garancitë e marra në lidhje me një shërbim apo mall, i cili është i përjashtuar nga TVSH sipas parashikimeve të ligjit, për qëllime të TVSH-së trajtohet e përjashtuar nga TVSH, Nëse furnizimi i mallit ose shërbimit me të cilin pagesa e garancisë lidhet është i përjashtuar nga TVSH, p.sh. garanci për shitjen e pasurive të paluajtshme.

Neni 19

Transaksionet e ndërmjetësve

Bazuar në dispozitat e ligjit dallojmë dy lloje ndërmjetësish:

Ndërmjetës që veprojnë për llogari të një personi tjetër, por në emrin e tyre;

Ndërmjetësit që veprojnë për llogari dhe në emër të një personi tjetër

Koncepte të përgjithshme mbi transaksionet e ndërmjetësve

Çdo ndërmjetës ndërhyr mes dy personave, personi në emër të të cilit ai vepron (më poshtë do të quhet “klient-i”) dhe një të treti.

Aktivitetet e ndërmjetësve karakterizohen:

juridikisht, nga ekzistenca e një mandati (dokument- kontrate) që parashikon mundësitë e pagesës së ndërmjetësit dhe ekzistencën e një pasqyre llogarish.

Ky dokument i mundëson ndërmjetësit të veprojë për llogari të një personi tjetër dhe ndërkohë personit në emrin e të cilit ai vepron i mundëson të disponojë një pasqyrë të qartë të veprimtarisë së ndërmjetësit (ndërmjetësi nuk vepron me iniciativën e tij);

ekonomikisht, nga fakti që ndërmjetësit nuk e bëjnë furnizimin e mallit dhe të shërbimit me mjetet e shfrytëzimit të tyre në transaksionin ku ata ndërhyjnë.

Në këtë mënyrë, ndërmjetësit nuk janë pronarë të mallrave për të cilat janë ngarkuar t’i blejnë apo t’i shesin.

Sipas dispozitave të ligjit, aktivitetet e ndërmjetësve i nënshtrohen regjimeve të ndryshëm, nëse ata veprojnë në emër të tyre ose në emër të një personi tjetër.

Ndërmjetës që veprojnë për llogari të një personi tjetër, por në emrin e tyre

Bazuar në nenin 13 të ligjit kur një person i tatueshëm, i cili vepron në emrin e tij, por për llogari të një personi tjetër, merr pjesë në kryerjen e një furnizimi shërbimi, ai konsiderohet sikur ka marrë dhe ka furnizuar vetë këtë shërbim.

Gjithashtu bazuar në nenin 7, pika 2, c) të ligjit, transferimi i mallrave bazuar në një kontratë, sipas së cilës paguhet komision për blerjen apo për shitjen, konsiderohet furnizim malli dhe personi konsiderohet sikur e ka marrë dhe e ka furnizuar vetë këtë mall.

Këto dispozita zbatohen për personat e tatueshëm, ndërmjetës në lidhje me një furnizim malli ose furnizim shërbimi, që veprojnë për llogari të një personi tjetër, i cili mund të jetë ose klienti ose një i tretë, por në emrin e tyre.

Ndërmjetësit veprojnë në “emrin e tyre” atëherë kur ata i furnizojnë vetë mallrat dhe shërbimet. Këta ndërmjetës konsiderohen sikur e kanë blerë ose furnizuar vetë mallin kur ata ndërmjetësojnë furnizimet e mallrave, apo sikur e kanë furnizuar ose marrë personalisht shërbimin në ndërmjetësimet e furnizimeve të shërbimit.

Shembuj:

Një ndërmjetës për “shitjen” e mallrave konsiderohet se ia blen mallrat klientit të tij dhe ia shet ato një blerësi të tretë;

një ndërmjetës për “blerje” mallrash konsiderohet se ia blen mallrat një furnizuesi të tretë dhe ia shet ato klientit të tij.

I njëjti parim është i vlefshëm edhe për ndërmjetësit që ndërhyjnë në furnizimet e shërbimit.

Shembull: Një njësi shitje e vendosur në një qendër tregtare ka nevojë për shërbimin e pastrimit, pra ka nevojë të blejë shërbimin e pastrimit. Ajo kontakton me zyrën e administrimit të qendrës tregtare, e cila në rolin e ndërmjetësit për llogari të njësisë së shitjes, por në emër të vet, kontraktin një furnizues të shërbimeve të pastrimit dhe ia shet këtë shërbim njësisë për llogari të së cilës ndërmjetësoi. Zyra e administrimit të qendrës tregtare blen furnizimin e shërbimit të pastrimit dhe i rishet këtë shërbim njësisë tregtare. Pra zyra e administrimit nuk i ka pajisjet dhe mundësinë që ta kryejë vetë pastrimin, por sillet sikur e kryen vetë.

Këto rregulla përmbajnë dy pasoja:

Ndërmjetësi konsiderohet se e furnizon vetë mallin apo kryen vetë shërbimin për klientin (subjekti kontraktues) nëse ndërmjetëson për një “blerje”;

ndërmjetësi konsiderohet se e blen vetë mallin apo e blen vetë shërbimin prej klientit të tij (subjekti kontraktues) nëse ndërmjetëson për një “shitje”.

Shembull: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh. A.), që një shoqëri tregtare me seli në Shqipëri, ka lidhur me SEE CAO një shoqëri tregtare me seli në Malin e Zi, një marrëveshje sipas së cilës SEE CAO do të veprojë në emër të SEE CAO, por për llogari të OST sh.a. për të gjitha aktivitetet e zhvillimit të ankandeve për alokimin e kapaciteteve të interkoneksioneve. Në këtë rast OST sh.a. do të lëshojë ndaj SEE CAO (ndërmjetësi) një faturë për alokimin e kapaciteteve interkoneksioneve, sipas nenit 13 të ligjit, duke konsideruar se SEE CAO e ka marrë vetë këtë shërbim. Në këto kushte, në kuptim të nenit 24, pika 1 e ligjit, vendi i furnizimit të shërbimit do të jetë Mali i Zi dhe OST sh.a. do të lëshojë faturën (e sipërpërmendur) ndaj SEE CAO, pa TVSH”.

Furnizuesi i mallit apo i shërbimit, kur ndërmjetësi ndërmjetëson klientin për “blerje”, ose ndërmjetëson për “shitje” konsiderohet se ia furnizon mallin ose shërbimin ndërmjetësit. Vlera e tatueshme e këtij transaksioni e blerë nga ndërmjetësi është e barabartë me çmimin pa komision.

Vlera e tatueshme e transaksionit të ndërmjetësit është e barabartë me shumën totale të transaksionit, e cila është çmimi i paguar nga subjekti ose nga klienti duke përfshirë edhe komisionin.

Në rastin e këtyre transaksioneve që realizohen nga ndërmjetësit që veprojnë në emër të tyre, komisioni është “i fshehur” dhe nuk tatohet më vete si i tillë, por tatohet me TVSH përkatësisht vlera e plotë e transaksionit.

Ndërmjetësit që veprojnë për llogari dhe në emër të një personi tjetër

Kjo kategori ndërmjetësish bën dallim nga kategoria e parë. Ndërmjetësit që veprojnë për llogari dhe në emër të një personi tjetër kryejnë një furnizim shërbimi të ndërmjetësit në kuptim të nenit 10 të ligjit. Këta ndërmjetës quhen ndërmjetës transparent, pasi në marrëdhëniet e tyre me kontraktorët (blerësit apo shitësit), ndërmjetësi që vepron në emër të dikujt tjetër shfaqet qartë si përfaqësues i klientit.

Transaksionet e ndërmjetësisë të këtyre ndërmjetësve konsiderohen si furnizime shërbimi ndërmjetësimi dhe i nënshtrohen të gjitha rregullave përkatëse.

Vlera e tatueshme e furnizimit të shërbimit të ndërmjetësit është komisioni i cili i faturohet prej ndërmjetësit personit që ai përfaqëson.

Gjithashtu, duhet konsideruar se një ndërmjetës vepron në emër të një personi tjetër nëse ai lidh dy persona që kontraktjnë mes tyre. Në këtë rast, ndërmjetësit nuk i furnizojnë vetë mallrat dhe shërbimet, por ata kryejnë një shërbim për njërën ose tjetrën palë kundrejt një komisioni të përcaktuar mbi vlerën e transaksionit të kryer. Furnizimi i mallit ose shërbimit kryhet përkatësisht drejtpërdrejtë nga personi i tatueshëm furnizues për klientin dhe ndërmjetësi, i cili është në rolin e komisionerit përfiton komision për shërbimin e kryer ose nga blerësi nëse ka ndërmjetësuar për blerjen ose nga shitësi nëse ka ndërmjetësuar për shitjen përkatësisht sipas kontratës.

Në rolin e ndërmjetësit transparent, ndërmjetësi në emër dhe për llogari të një personi tjetër mund të kontrakttojë personalisht me një të tretë në rastet kur:

kontrata noteriale shpreh qartë se ai (ndërmjetësi) nuk vepron në emër të tij, por vepron në emër dhe për llogari të një personi tjetër dhe kushti plotësohet vetëm nëse në kontratë shkruhet emri, identiteti, adresa, si dhe NIPT-i i klientit, për të cilin parashikohet ndërmjetësimi;

fatura për një furnizim në këto raste lëshohet drejtpërdrejtë nga klienti për të tretin (ndërmjetësimi “për shitjen”) apo i adresohet drejtpërdrejtë klientit nga i treti (ndërmjetësimi “për blerje”) dhe ndërmjetësi faturon vetëm komisionin e ndërmjetësit.

Por nëse fatura për vlerën e furnizimit lëshohet nga ndërmjetësi dhe jo vetë nga klienti duhet të tregohet qartë në kontratë me shkrim që ky i fundit vepron në emër të një personi tjetër dhe të bëhen të qarta dhe transparente, identiteti dhe të dhënat e personit në emër të të cilit vepron ndërmjetësi edhe në faturën që lëshon për blerësin.

Në mungesë të faturës (në rastet kur fatura nuk është e detyrueshme të lëshohet për furnizimet e realizuara me persona të pa-tatueshëm), duhet që të tregohen rrethana, situata apo fakte që (pikërisht shqyrtimi i kushteve të kontratës që lidh ndërmjetësin me klientin) të mundësojnë, të vërtetojnë se i treti kishte njohuri për faktin se ndërmjetësi vepronte në emër të një personi tjetër.

Shembull: Raste apo situata të tilla mund të jenë ndërmjetësit transparentë të shërbimeve, p.sh. agjencitë e biletave të transportit ndërkombëtar ajror dhe detar; shitja e kohës së bisedës për klientët e operatorëve të telefonisë; shitja e kartave të platformave digitale apo transmetimeve televizive; shitjet e biletave të lotarive televizive me çmime të parashtypura, ku klienti është në dijeni dhe e vërteton në çdo moment faktin se shërbimet e mësipërme i furnizohen nga personi i tatueshëm dhe ndërmjetësi vepron në emër të tij.

Në rastin kur, në rolin e ndërmjetësit transparent, furnizimi kryesor faturohet nga vetë furnizuesi i mallit ose shërbimit për blerësin dhe ndërmjetësi i faturon vetëm komisionin klientit të tij, atëherë qarkullimi vjetor për qëllime të kufirit minimal të regjistrimit për TVSH-në është vlera totale e komisioneve të përftuara.

Në rastin kur, në rolin e ndërmjetësit transparentë, ndërmjetësi në emër të furnizuesit kryesor (klientit) sipas kontratës me të, faturon furnizimin e shërbimit ose furnizimin e mallit në rolin e furnizuesit duke e bërë transparent faktin se në emër të cilit vepron, atëherë qarkullimi vjetor për qëllime të kufirit minimal të regjistrimit për TVSH-në llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që paguan blerësi për vlerën e furnizimit, pa përfshirë TVSH-në.

REGJIME PËR SEKTORËTË VEÇANTË

Bazuar në nenin 10, të ligjit dhe dispozitat e këtij udhëzimi me qëllim zbatimin në praktik të aplikimit të TVSH-së në disa sektorë të veçantë zbatohen regjimet sektoriale të mëposhtme:

4.1.Kartat me parapagim ose mbushja/rimbushja me kohë bisede/abonime televizive

Operatorët kryesorë të telekomunikacionit dhe operatorët kryesorë të transmetimeve televizive tokësore dhe satelitorë, llogarisin dhe paguajnë TVSH për vlerën e plotë të kartave të parapaguara, ose të kodeve tarifore/ paketave tarifore të telekomunikacionit/abonime transmetimi televizive me parapagesë, që ata u furnizojnë distributorëve të tyre.

Furnizimi i këtyre kartave, ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave, ose abonimeve të transmetimit televiziv, nga distributorët nuk është objekt i aplikimit të TVSH-së, pasi TVSH është aplikuar për çmimin përfundimtar nga operatori kryesor që furnizon shërbimin e telekomunikacionit ose shërbimin e transmetimit televiziv.

Distributorët nuk kanë të drejtë të zbresin vlerën e TVSH-së së faturuar nga operatorët kryesorë për furnizimin e kryer me karta/kode tarifore/paketa tarifore telekomunikacioni/abonime televizive, përse ata nuk kanë të drejtë të aplikojnë TVSH për furnizimet e mëtejshme të kryera në fazat pasardhëse.

Për qëllime dokumentimi të çdo transaksioni që kryejnë në fazat pasardhëse për shitjen e kartave/kodeve tarifore/paketave tarifore të telekomunikacionit/abonimeve televizive, distributorët duhet të lëshojnë faturë tatimore pa llogaritur TVSH, në të cilën çmimi i këtyre furnizimeve është i barabartë me çmimin përfundimtar (përfshirë TVSH-në) të faturuar prej operatorit kryesor në momentin e furnizimit të këtyre produkteve. Ndërkohë, distributorët e këtyre produkteve të parapaguara i faturojnë operatorit kryesor vlerën e komisionit që ato përfitojnë për shërbimin e ndërmjetësimit që kryejnë. TVSH e llogaritur në këtë rast, është e zbritshme për operatorin kryesor. Nëse distributori i nënshtrohet regjimit të biznesit të vogël sipas ligjit, ai nuk llogarit TVSH për komisionin. Të gjitha transaksionet e kryera si më sipër regjistrohen nga secila palë në librin e shitjes dhe të blerjes.

Distributori faturën e blerjes e regjistron si blerje me TVSH jo të zbritshme dhe faturën e shitjes e regjistron si shitje pa TVSH. Faturën për komisionin e regjistron si shitje me TVSH. Distributori ka të drejtë të zbresë TVSH-në për furnizimet e marra për qëllime të veprimtarisë së tij të tatueshme si distributor. Qarkullimi i distributorit në përputhje me nenin 119 të ligjit është qarkullimi i realizuar për të gjitha transaksionet e kryera prej distributorit (shitjet e kartave/paketave ose abonimeve dhe komisioni) dhe llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që duhet të paguajë blerësi.

Shembull: Supozojmë që operatori kryesor i telekomunikacionit X hedh në treg karta telefonike me çmim të 1.000 lekë (përfshirë TVSH).

Kjo shoqëri do të lëshojë një faturë ku TVSH e llogaritur do të jetë:

$833.4 + 166.6(TVSH) = 1.000$ lekë.

Shoqëria distributore Y që blen kartën me faturën e mësipërme, nuk llogarit më TVSH në rishitjen e kësaj karte dhe nuk ka të drejtë të zbresë 166.6 lekë TVSH të faturës së lëshuar nga operatori kryesor.

Në rast se për shërbimin që i kryen operatorit X, distributori Y përfiton një komision në masën 15 %.

TVSH e llogaritur do të jetë: $150:6=25$ lekë pra, $125+25(TVSH) = 150$ lekë.

Operatori kryesor X ka të drejtë të zbresë TVSH në blerje për shumën 25 lekë. Distributori regjistron në librin e blerjes dhe në deklaratën e TVSH-së faturën e blerjes së kartave si blerje me TVSH jo të zbritshme dhe faturën e shitjes së tyre si shitje pa TVSH. Faturën e komisionit me TVSH 25 lekë e regjistron si shitje me TVSH. Distributori ka të drejtë të zbresë TVSH-në për furnizimet e marra për qëllime të veprimtarisë së tij si distributor

4.1/1. Operatorët kryesorë të telekomunikacionit mund të zgjedhin të aplikojnë furnizimin e kartave të parapaguara ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave të parapaguara, me anë të distributorëve /furnizuesve të ndërmjetëm, duke zbritur direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg për të gjithë distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm.

Operatori kryesor që zgjedh të aplikojë furnizimin e kartave të parapaguara ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave të parapaguara, duke zbritur direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse, duhet paraprakisht të depozitojë në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse një deklaratë me shkrim, sipas së cilës të shprehet zgjedhja e dëshiruar. Kjo deklaratë duhet të përmbajë veç të tjerash, listën e distributorëve/furnizuesve të ndërmjetëm.

Në rast se operatori kryesor zgjedh të aplikojë zbritjen direkt në faturë, për vlerën e ndërhyrjes në treg, duhet ta bëjë këtë për të gjithë distributorët/furnizuesit e tij të ndërmjetëm dhe për një periudhë jo më pak se 12 muaj të njëpasnjëshëm. Gjithashtu, nëse operatori kryesor heq dorë nga zgjedhja me qëllim që të aplikojë furnizimin e kartave të parapaguara ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave të parapaguara, siç parashikohet në pikën 4.1 më lart, atëherë ai duhet të njoftojë paraprakisht organin tatimor.

Edhe në këtë rast operatorët kryesorë llogarisin dhe paguajnë TVSH për vlerën e plotë të kartave të parapaguara, ose të kodeve tarifore/paketave tarifore të telekomunikacionit, që ata u furnizojnë distributorëve/ndërmjetësve të tyre. Operatori kryesor zbrit direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg për të gjithë furnizuesit e mëvonshëm pa ndikuar TVSH-në e llogaritur, si më lart.

Furnizimi i këtyre kartave, ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave nga distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm në furnizimet e mëtejshme nuk është objekt i aplikimit të TVSH-së, pasi TVSH është aplikuar për çmimin përfundimtar nga operatori kryesor që furnizon shërbimin e telekomunikacionit, por në çdo rast furnizimi tek furnizuesit e ndërmjetëm bëhet duke zbritur direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg, pa llogaritur TVSH. Distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm nuk kanë të drejtë të zbresin vlerën e TVSH-së së faturuar nga operatorët kryesorë për furnizimin e kryer, përse ata nuk kanë të drejtë të aplikojnë TVSH për furnizimet e mëtejshme të kryera në fazat pasardhëse.

Për qëllime dokumentimi të çdo transaksioni që kryejnë në fazat pasardhëse për shitjen e kartave/kodeve tarifore/paketave tarifore të telekomunikacionit, distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm duhet të lëshojnë faturë tatimore pa llogaritur TVSH, në të cilën çmimi i këtij furnizimi është i barabartë me çmimin përfundimtar (përfshirë TVSH-në) për konsumatorin final, të faturuar prej operatorit kryesor në momentin e furnizimit të këtyre produkteve. Po kështu në çdo faturë të lëshuar në furnizimet e mëtejshme nga distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm do të zbritet vlera e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse.

Shembull: Supozojmë që operatori kryesor i telekomunikacionit “X” hedh në treg karta telefonike me çmim me pakicë për konsumatorin final të barabartë me 1.000 lekë (përfshirë TVSH). Kjo shoqëri do të lëshojë një faturë ku TVSH e llogaritur do të jetë:

$833.4 + 166.6(TVSH) = 1.000$ lekë. TVSH-ja deklarohet dhe paguhet normalisht nga Operatori kryesor “X”. Po në këtë faturë Operatori kryesor i telekomunikacionit “X” zbret vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse, p.sh. 150 lekë, pa ndikuar në TVSH-në e llogaritur si me sipër. Pra, fatura e lëshuar nga Operatori kryesor “X” për distributorin/furnizuesin e ndërmjetëm “Y” do të paraqitet:

Përshkrimi i mallit ose shërbimit	Vlera pa t.v.sh.	t.v.sh.	Vlera me t.v.sh.
<i>Kartë e parapaguar</i>	<i>833.4</i>	<i>166.6</i>	<i>1.000 lekë</i>
<i>Zbritje për ndërhyrjen në treg</i>	<i>(150)</i>	<i>-</i>	<i>(150)leke</i>
<i>Totali</i>	<i>683.4</i>	<i>166.6</i>	<i>850 lekë</i>

Shoqëria distributore/furnizuese e ndërmjetme “Y” që blen kartën me faturën e mësipërme, nuk llogarit më TVSH në rishitjen e kësaj karte dhe nuk ka të drejtë të zbresë 166.6 lekë TVSH të faturës së lëshuar nga operatori kryesor.

Distributori/furnizuesi i ndërmjetëm i regjistron në librin e blerjes dhe në deklaratën e TVSH-së faturën e blerjes së kartave si “blerje pa TVSH” dhe faturën e shitjes së tyre si “shitje pa TVSH”.

Qarkullimi i distributorit/furnizuesit të ndërmjetëm në përputhje me nenin 119 të ligjit llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që duhet të paguajë blerësi (konsumator final) për shërbimet e mësipërme.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 15, datë 18.05.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 26.05.2017).

4.2.Furnizimi i cigareve

Bazuar në nenet 7, 10, 13 të ligjit për qëllime të tregtimit të cigareve, operatorët e mëposhtëm do të zbatojnë skemën e deklaramit dhe pagesës së TVSH-së në një fazë të vetme, **përveç rastit të përcaktuar në nënparagrafin “vi” të rregullave të përgjithshme.** (Ndryshuar me Udhëzim nr. 22, datë 11.12.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 220, datë 15.12.2017.)

Për qëllime të zbatimit të kësaj skeme, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

"Furnizues kryesor" konsiderohen importuesit dhe prodhuesit vendas të cigareve.

"Furnizues të ndërmjetëm" konsiderohen tatimpaguesit që furnizohen me qëllim për të rishitur te furnizues të tjerë të ndërmjetëm dhe/ose te njësitë e shitjes me pakicë.

"Njësi të shitjes me pakicë" konsiderohen tatimpaguesit që furnizohen për të shitur te blerësit, konsumatorë finalë.

"Furnizim i parë" është furnizimi që furnizuesi kryesor bën për furnizuesit e ndërmjetëm apo për njësitë e shitjes me pakicë.

"Çmim i shitjes me pakicë" është çmimi i paguar nga blerësi, konsumator final.

TVSH për cigaret paguhet tërësisht nga “Furnizuesi kryesor” në “Furnizimin e parë”

Furnizuesi kryesor e llogarit TVSH-në mbi vlerën e tatueshme të bazuar në çmimin me pakicë për çdo furnizim të kryer. Pra, vlera e tatueshme e çdo furnizimi, të kryer nga furnizuesi kryesor për të tretët, përcaktohet si produkt i sasisë së cigareve të shitura, me çmimin e shitjes me pakicë, pa përfshirë TVSH-në.

Furnizuesi kryesor zbret direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg për të gjithë furnizuesit e mëvonshëm pa ndikuar TVSH-në e llogaritur sipas pikës 3.2. më lartë.

Blerësi i parë, qoftë ai “Furnizues i ndërmjetëm” ose “Njësi e shitjes me pakicë”, që merr furnizimin nga “Furnizuesi kryesor”, nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e faturuar në faturën e lëshuar prej “Furnizuesit kryesor”.

Furnizimi i cigareve në vazhdim nga furnizuesit e ndërmjetëm, do të kryhet pa llogaritur TVSH në faturë pasi TVSH-ja është paguar nga “Furnizuesi kryesor” bazuar në çmimin e shitjes me pakicë, i cili është edhe çmimi përfundimtar i këtij artikulli tek konsumatori final. Në çdo faturë të lëshuar nga furnizuesit e ndërmjetëm do të zbritet vlera e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse.

“Furnizuesi kryesor” përcakton çmimin maksimal të shitjes me pakicë të cigareve dhe është i detyruar ta deklarojë atë çmim në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar, jo më vonë se 10 ditë para datës së aplikimit të çmimit të ri.

“Furnizuesi kryesor” është i detyruar të publikojë deklaratën e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete në jo më pak se dy gazeta ditore kombëtare dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e aplikimit të çmimit të ri. Për efekte marketingu çmimet maksimale mund të vazhdojnë të publikohen në çdo media të shkruar apo elektronike për aq kohë sa ato çmime janë në fuqi.

Shembull:

Çmimi i shitjes me pakicë për një paketë cigare të një markës "1" është 300 lekë dhe çmimi me pakicë i një pakete cigare të markës "2" është 240 lekë.

Furnizuesi Kryesor "K" furnizon një Furnizues të Ndërmjetëm (Rishitës) "N" me cigare të këtyre markave dhe "K" do të faturojë "N" me çmimet që vijnë: $250 + 50 \text{ (TVSH)} = 300 \text{ lekë}$ dhe $200 + 40 \text{ (TVSH)} = 240 \text{ lekë}$. TVSH-ja deklarohet dhe paguhet normalisht nga Furnizuesi Kryesor.

Po në këtë faturë, Furnizuesi Kryesor zbrit vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse, p.sh. 60 lekë dhe 50 lekë, pa ndikuar në TVSH-në e llogaritur si më sipër. Pra fatura e lëshuar nga furnizuesi Kryesor "K" do të paraqitet:

Furnizuesi Kryesor "K" për furnizuesin e ndërmjetëm "N"

Nr.	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	Njësia e Matjes	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Vlefta pa TVSH	TVSH	Vlefta me TVSH
1	Cigare markal	Copë	1	250	250	50	300

2	Zbritje për ndërhyrje në treg				(60)	-	(60)
3	Cigare marka 2	Copë	1	200	200	40	240
4	Zbritje për ndërhyrje në treg				(50)	-	(50)
TOTALI					340	90	430
Furnizime të tatueshme					340		
Furnizime të pa-tatueshme					0		

Furnizuesi i ndërmjetëm "N" nuk ka të drejtë të zbresë TVSH prej 90 lekë.

E njëjta skemë zbatohet kur furnizuesi kryesor "K" furnizon direkt një njësi të shitjes me pakicë "P".

Kur Furnizuesi i Ndërmjetëm "N" furnizon një Furnizues tjetër të Ndërmjetëm "N1", furnizimi është jashtë skemës së TVSH, pasi TVSH-ja është paguar nga "Furnizuesi kryesor", dhe faturimi bëhet duke lëshuar faturë tatimore me çmimin final pa aplikuar TVSH-në, duke zbritur vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse. Pra "N" do të faturojë "N1" si vijon:

Furnizuesi i ndërmjetëm "N" për furnizuesin e ndërmjetëm "N1"

Nr.	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	Njësia e Matjes	Sasia	Çmimi për njësi TVSH	Vlefëta pa TVSH	TVSH	Vlefëta me TVSH
1	Cigare marka 1	Copë	1	300	300	-	300
2	Zbritje për ndërhyrje në treg				(40)	-	(40)
3	Cigare marka 2	Copë	1	240	240	-	240
4	Zbritje për ndërhyrje në treg				(30)	-	(30)
TOTALI					470	-	470
Furnizime të tatueshme					0		
Furnizime të pa-tatueshme					470		

E njëjta skemë zbatohet kur "Furnizuesi i Ndërmjetëm "N" furnizon direkt një "Njësi të shitjes me pakicë" "P".

Kur "Furnizuesi i Ndërmjetëm "N1" furnizon Njësinë e Shitjes me Pakicë "P" faturimi bëhet duke lëshuar faturë tatimore me çmimin final pa aplikuar TVSH, duke zbritur vlerën e ndërhyrjes

në treg të hallkës pasardhëse (pra të njësisë së shitjes me pakicë). Fatura që "N1" i lëshon Njësisë së Shitjes me Pakicë "P" paraqitet:

Furnizuesi i ndërmjetëm "N1" për Njësinë e Shitjes me Pakicë "P"

Nr.	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	Njësia e Matjes	Sasia	Çmimi për njësi TVSH	Vlefë pa TVSH	TVSH	Vlefë me TVSH
1	Cigare markat 1	Copë	1	300	300	-	300
2	Zbritje për ndërhyrje në treg				(30)	-	(30)
3	Cigare markat 2	Copë	1	240	240	-	240
4	Zbritje për ndërhyrje në treg				(20)	-	(20)
TOTALI					490	-	490
Furnizime të tatueshme					0		
Furnizime të patatueshme					490		

Në çdo rast çmimi maksimal me pakicë i cigareve për konsumatorin final do të jetë ai i deklaruar nga "Furnizuesi kryesor". Në rastin e këtij shembulli, çmimi maksimal me pakicë do të jetë respektivisht 300 lekë dhe 240 lekë.

Rregulla të përgjithshme

Furnizuesi kryesor është i detyruar të publikojnë deklaratën e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete në jo më pak se dy gazeta ditore kombëtare dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e aplikimit të çmimit të ri. Për efekte marketingu çmimet maksimale mund të vazhdojnë të publikohen në çdo media të shkruar apo elektronike për aq kohë sa ato çmime janë në fuqi.

~~Me momentin e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë furnizuesi kryesor në rolin e kryesorit dhe me cilesinë e personit përgjegjës të ngarkuar për deklarimin e çmimit maksimal detyrohet të deklarojë në Drejtorinë Rajonale Tatimore inventarin e mallit të pashitur ende tek konsumatori perfundimtar, inventar i cili do të nenshtrohet çmimit të ri. Përpara ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë, furnizuesi kryesor në rolin e kryesorit dhe me cilesinë e personit përgjegjës të ngarkuar për deklarimin e çmimit maksimal, deklaron dhe paguan tvsh në e papaguar, llogaritur si prodhim i ndryshimit të çmimit të ri me atë të mëparshmin me sasinë e nxjerre në qarkullim prej furnizuesit kryesor (të shitur prej tij në hallkën/hallkat pasardhëse) por të pashitur ende tek konsumatori final në momentin e aplikimit të çmimit të ri. Shfuqizohet~~

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 22, datë 11.12.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 220, datë 15.12.2017.)

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është e detyruar të publikojë në faqen e saj të internetit çmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë të cigareve jo më vonë se dy ditë para datës së zbatimit të çmimeve të reja. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të publikojë çmimet maksimale të shitjes me pakicë të cigareve në çdo formë tjetër publikimi.

Ndalohet shitja e cigareve me çmim më të lartë se çmimi maksimal i shitjes me pakicë, i deklaruar dhe publikuar prej “Furnizuesit Kryesor” dhe i publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Drejtoria Rajonale Tatimore kontrollon zbatimin e çmimeve maksimale të shitjes me pakicë të cigareve. Shitja e një pakete cigare me çmim më të lartë se çmimi i deklaruar, konsiderohet shkelje dhe penalizohet në përputhje me dispozitat e ligjit “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Furnizuesit e ndërmjetëm dhe njësitë e shitjes me pakicë të cigareve janë të detyruar të dokumentojnë të gjitha shitjet e cigareve të kryera me fatura tatimore apo kupon tatimor fiskal. Ata janë të detyruar t’i regjistrojnë, evidentojnë në librin e shitjes dhe në librin e blerjes transaksionet e shit-blerjes së cigareve, në përputhje me kërkesat ligjore të këtij udhëzimi dhe procedurat tatimore në fuqi. Si furnizime pa TVSH, evidentimi dhe regjistrimi i këtyre faturave në librin e blerjeve dhe të shitjeve do të bëhet në rubrikat “Shitje pa TVSH” dhe “Blerje pa TVSH” dhe do të deklarohet në rubrikat respektive të deklaratës së TVSH-së.

Në momentin e ndryshimit (rritjes) të çmimit maksimal të shitjes me pakicë nga furnizuesi kryesor (importuesi ose prodhuesi), në cilësinë e personit përgjegjës për deklarimin e çmimit maksimal të shitjes me pakicë, furnizuesi kryesor, furnizuesit e ndërmjetëm dhe njësitë e shitjes me pakicë, për qëllime të llogaritjes dhe të pagesës së TVSH-së për inventarin gjendje (stoku), në momentin e rritjes së çmimit, inventar ky i cili do t’i nënshtrohet çmimit të ri, detyrohen të zbatojnë procedurën e mëposhtme:

Furnizuesi kryesor (importuesi ose prodhuesi) njofton rritjen e çmimit në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi dhe inventarizon cigaret gjendje (për të cilat ka njoftuar rritjen e çmimit me pakicë), në ditën e fundit të çmimit të vjetër. Një kopje e këtij inventari dërgohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar furnizuesi kryesor, brenda 5 ditëve pune nga data e aplikimit të çmimit të ri. Furnizuesi kryesor llogarit dhe paguan TVSH-në për çmimin e ri me pakicë, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi, për çdo furnizim nga data e aplikimit të çmimit të ri.

) Furnizuesi i ndërmjetëm, që është furnizuar nga furnizues kryesor me qëllim për të rishitur te furnizues të tjerë të ndërmjetëm dhe/ose te njësitë e shitjes me pakicë,

inventarizon cigaret gjendje në ditën e fundit të aplikimit të çmimit të vjetër të shitjes me pakicë. Një kopje e inventarit dërgohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore, ku është i regjistruar furnizuesi i ndërmjetëm, brenda 5 ditëve pune nga data e aplikimit të çmimit të ri. Furnizuesi i ndërmjetëm është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e TVSH-së, për sasinë e cigareve që ka gjendje në ditën e fundit para aplikimit të çmimit të ri. Për deklarimin dhe pagesën e kësaj TVSH-je, furnizuesi i ndërmjetëm plotëson dhe lëshon një faturë tatimore shitjeje për veten e tij, ku figuron edhe shitës edhe blerës. Artikujt e kësaj fature janë emërtimet (markat) e cigareve gjendje, për të cilat ka rritje çmimi; sasia është gjendja në ditën e fundit të aplikimit të çmimit të vjetër; ndërsa si çmim për njësi pa TVSH është 5/6 e rritjes së çmimit me pakicë për çdo paketë. Mbi vlerën e tatueshme zbatohet TVSH në shkallën standarde, e cila është e pagueshme nga furnizuesi i ndërmjetëm dhe jo e zbritshme prej tij. Kjo faturë regjistrohet vetëm në librin e shitjeve si shitje e tatueshme me TVSH, në shkallën standarde 20%. TVSH-ja deklarohet dhe është e pagueshme në periudhën tatimore që është lëshuar fatura tatimore si më lart.

Shembull. Furnizuesi i ndërmjetëm N ka gjendje 100.000 paketa të markës X, për të cilat çmimi me pakicë është rritur me 10 lekë për paketë. Furnizuesi i ndërmjetëm N bën një faturë shitjeje për vete me të dhënat që vijojnë: Përshkrimi: “Rritje çmimi cigareje, marka X”; njësia “Paketa”; sasia: 100.000 paketa; çmimi pa TVSH = 8,333 lekë; vlera pa TVSH = 833.300 lekë; TVSH = $833.300 \times 20\% = 166.700$ lekë, e cila paguhet nga furnizuesi i ndërmjetëm.

Çdo furnizues tjetër i ndërmjetëm (shitës me shumicë), tatimpagues TVSH-je, që furnizon me shumicë të njësitë e shitjes me pakicë, të cilat janë të regjistruar ose jo në TVSH apo çdo shitës me pakicë i regjistruar si tatimpagues TVSH-je, është i detyruar të inventarizojë cigaret gjendje, në ditën e fundit të çmimit të vjetër të shitjes me pakicë. Një kopje e inventarit dërgohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar furnizuesi i ndërmjetëm apo shitësi me pakicë tatimpagues TVSH-je, brenda 5 ditëve pune nga data e aplikimit të çmimit të ri.

Procedura e faturimit për vete, e deklarimit dhe e pagesës së TVSH-së nga çdo furnizues i ndërmjetëm, shitës me shumicë apo me pakicë, tatimpagues TVSH-je, është njëlloj me procedurën e ndjekur nga furnizuesi i parë i ndërmjetëm, siç përcaktohet në shkronjën “b” më lart.

ç) Furnizuesi kryesor (importuesi apo prodhuesi), llogarit stokun e cigareve gjendje të tatimpaguesit që i nënshtrohen regjimit për bizneset e vogla (njësitë e shitjes me pakicë pa TVSH), bazuar në llogaritjet si vijon:

Për çdo markë cigaresh për të cilat është deklaruar rritje çmimi, furnizuesi kryesor merr në konsideratë sasinë e shitura prej tij gjatë 90 ditëve të fundit para aplikimit të çmimit të ri, në bazë të të cilave llogarit shitjet mesatare ditore. Për rastet kur një markë cigaresh ka më pak se 90 ditë që furnizohet në treg, atëherë për llogaritjen e shitjes mesatare ditore merren ditët faktike nga dita e parë e furnizimit të kësaj marke cigareje.

Furnizuesi kryesor është përgjegjës për TVSH-në shtesë për vlerën e rritur nga rritja e çmimit me pakicë, për stokun gjendje te shitësit me pakicë, tatimpagues të biznesit të vogël, që nuk janë të regjistruar në TVSH, duke u bazuar në furnizimin mesatar ditor shumëzuar me 30%. Për sasinë e stokut të llogaritur në këtë mënyrë, furnizuesi kryesor lëshon një faturë për vete dhe llogarit, deklaron dhe paguan TVSH-në për vlerën e rritur nga rritja e çmimit me pakicë, njëllon siç vepron furnizuesi i ndërmjetëm për stokun e vet, siç përcaktohet në shkronjën “b” më lart.

Procedura e mësipërme zbatohet në rastin e rritjes së çmimit maksimal të shitjes me pakicë të cigareve si pasojë e ndryshimit ligjor (rritjes) të nivelit të akcizës.

Kjo procedurë zbatohet gjithashtu edhe në rastin e rritjes së çmimit maksimal të shitjes nga furnizuesi kryesor (importuesi dhe prodhuesi vendës të cigareve), por vetëm sipas kushteve të mëposhtme:

Furnizuesi kryesor ka gjendje stoku në magazinat e veta jo më pak se 50% të sasisë së importuar/prodhuar për atë markë cigaresh.

Rritja e çmimit, tej çmimit të deklaruar fillimisht, nuk mund të bëhet më shumë se një herë në vit për atë lloj marke cigaresh.

Rritja e çmimit, tej çmimit të deklaruar fillimisht, nuk mund të bëhet për më shumë se 25% të llojeve të markave të cigareve që importohen dhe tregtohen. (Ndryshuar me Udhëzim nr. 22, datë 11.12.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 220, datë 15.12.2017.)

Neni 20

Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes

Punimet në pasuritë e paluajtshme

Bazuar në nenin 11, pika c), operacionet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe mirëmbajtjes, janë furnizim shërbimi në kuptim të ligjit të TVSH-së.

Bazuar në nenin 53, pika g) furnizimi i shërbimeve të ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, punimeve të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes, janë furnizime të tatueshme për TVSH-në.

Ndërtimi përcaktohet si çdo operacion që ka për rezultat përfundimin tërësor ose pjesor të një ndërtese të re ose substancialisht të ndryshuar.

Mirëmbajtja përcaktohet si çdo operacion i kryer mbi tokë ose në ndërtesë, për të parandaluar degradimin ose dëmtimin dhe për t'i mbajtur tokën dhe ndërtesat me pamje të mirë dhe rregull funksionimi, duke përfshirë pastrimin.

Punime që kanë të bëjnë me procesin e ndërtimit, pa u kufizuar vetëm në to, janë:

Punimet e ndërtimit të ndërtesave dhe punime të tjera të ndërtimit;

punimet për pajisjen e ndërtesave që kanë si efekt të përfshijnë përfundimisht vendosjen e aparateve apo materialeve të instaluar;

punimet e restaurimit dhe të riparimit të ndërtesave, si dhe instalimet me karakter të paluajtshëm.

Në punimet e ndërtimit bëjnë pjesë:

Punimet e ndërtimit që kryhen nga grupe të ndryshme profesionesh që marrin pjesë në ndërtimin e ndërtesave, të tilla si: gërmimet, krijimi i themeleve, spastrimi dhe nivelimi i territorit, pusët dhe gërmimet paraprake për ndërtimin e pasurive të paluajtshme, punimet e ekipit të terrenit (sjellja e ujit, gazit, energjisë, ndërtimi i kanaleve dhe lidhja e rrjetit, rrugët e brendshme dhe rrugët dytësore); muratoria, beton arme, armaturat, çatitë/tarracat; zdrukthëtaria (p.sh. vendosja e dyerve, dritareve, shkallëve, parketeve); vendosja e bravave, punimet e metalit dhe të hekurit që përdoren për ndërtesat, persianet, kanatet, që përbëjnë pajisjet e domosdoshme dhe normale të ndërtesës; shtrimi i dyshemesë dhe veshja e mureve; vendosja e pllakave, mozaiku, shtrimi me kalldrëm, punimet me mermer, vendosja e pasqyrave; restaurimi i fasadave, suvatë, bojatisja dhe punimet paraprake (p.sh. pastrimet, kruajtjet); vendosja e xhamave dhe paneleve me xham; mbylljet e ndryshme, grilat, dyert; tabelat e trupëzuara në fasadat e ndërtesave; tabelat e reklamave të pikturuara direkt mbi mure, fasada etj, monumentet me natyrë imobiliare, etj.;

punët publike të tilla si: rrugët, hekurudhat, urat dhe të gjitha veprat e artit, pistat e fluturarimit, stadiumet; portet, kanalet, skelat, digat, përfshire portat; ujësjellësi, kanalet, drenazhet, vaditjet, kanalizimet; punimet, pastrimi i shtratit të lumenjve nga shkëmbinjtë, nivelimi për të thelluar apo krijuar një kanal, një urë etj, rregullimi i parqeve dhe kopshteve, etj.

punimet me fletët metalike të ndërtesave si dhe ndërtimet metalike të tilla si punimet e grumbullimit apo të qarkullimit: fuçitë, cisternat, siloset, bunkerët metalikë, gazometrat, depot e ujit, tubacionet hidraulike, tubacionet e gazit/naftës, kanalizimet, oxhaqet; depot, shtyllat, veprat e artit, skeletet metalike të minierave, aparate të mëdha të ngritjes, etj.

punimet e rregullimit të territorit që sjellin modifikimin e relievit ekzistues të tilla si: zbulimet e guroreve, nivelim i shpateve; gërmimi dhe mbushja e gropave; spastrimi i dheut; punimet për mbjelljen e barit, të cilat nuk mund të ndahen nga punimet për spastrimin e dheut, punimin dhe hapjen e tokës, si dhe nivelimin e terrenit; heqja e

shkurreve, punimi dhe hapja e tokës, të cilat, nga njëra anë kërkojnë ndërhyrjen e një ndërmarrje të specializuar të pajisur me material të rëndësishëm (buldozerë, makina për gjermimin e tokës) dhe nga ana tjetër, ato sjellin një modifikim të ndjeshëm të relievit ekzistues.

Operacionet e numëruara më sipër nuk janë shteruese. Këto operacione, por jo vetëm, përbëjnë punimet që kryhen në pasuritë e paluajtshme.

Disa punime, pa u kufizuar vetëm në to që lidhen me ndërtesat dhe me pasurinë e paluajtshme gjithashtu edhe pse qëllimi kryesor nuk është ndërtimi i objektit, konsiderohen si furnizime shërbimi të tilla si: pastrimet e caktuara vetëm për mirëmbajtjen dhe hapjen e kanaleve të vegjël në porte, lumenj, etj; punimet kërkimore për shtresat e ujit, naftës, mineraleve; punimet studimore të tokës që çojnë në krijimin e një dosjeje teknike; sondazhet për minierat jo prodhuese; lyerja dhe lustrimi i parketeve; fshirja, heqja e pluhurave, pastrimi i oxhaqeve; pastrimi i puseve, kanaleve, gropave, plehërimi; ripyllëzimi, shpyllëzimi, spastrimi i drizave, spastrimi i shtresave të ndryshme, çminimi; montimi dhe qiradhënia e skelave të ndërtimit; punimet për pastrimin e dëborës.

Punimet që përfshihen në punimet për pasurinë e paluajtshme

Punimet e instalimit që përmbajnë vendosjen e elementeve që e humbin karakterin e tyre të luajtshëm për shkak të përfshirjes së tyre në një tërësi të paluajtshme, për zbatimin e TVSH-së duhet të konsiderohen, si pjesë e pasurisë të paluajtshme përderisa ato kanë si qëllim të përfshijnë në ndërtime të paluajtshme aparate apo punime që janë objekt instalimi.

Konsiderohen si të tilla kur heqja e materialit të instaluar nuk mund të kryhet pa dëmtime të rënda që pëson ky material apo ndërtesa që e mban atë.

Për shembull, operacionet e mëposhtme bëjnë pjesë në punimet në pasuritë e paluajtshme:

Instalimet dytësore në ndërtimin e ndërtesave të tilla si instalimet elektrike (drita, energjia, zilha); instalimet sanitare (lavamanë, dushe, pllaka dushi); instalimi i aparateve që prodhojnë ujë të ngrohtë të përfshira në ndërtesë; instalimi i ngrohjes, i pajisjeve hidraulike, për thithjen e tymit etj; instalimi i shtresave të dyshemesë, etj., kur veshja e realizuar është solide me tokën me anë të një ngjitjeje të përshtatshme dhe mund të hiqet vetëm nëse shkatërrohet; instalimi i mureve të holla ndarëse të palëvizshme të caktuara për të zëvendësuar muret tradicionale prej muratorie, dhe në parim, nuk mund të zhvendosen pa u dëmtuar; instalimi i një antene kolektive radioje apo televizioni në një ndërtesë; instalimet e organove madhështore; instalimet e kanalizimeve të ndryshme me karakter të paluajtshëm me të cilat lidhen grupet elektrogjene; instalimet e grupeve që

furnizojnë me ujë kaldajat, centralet termike; instalimet e aparateveqë shërbejnë për seleksionimin e korrespondencës në ambientet e Postës; instalimet elektrike dhe hidraulike për funksionimin e portave të baseneve dhe ekluzeve; grupi mekanik (motopompa) dhe kanalizimi i instalimeve të aparateve të palëvizshme të mjeljes (elementet e luajtshme: bidonët për mjelje, kovat i nënshtrohen regjimit të shitjes); instalimet për zhvendosje: vinçat lëvizës, shirit transportieri, rripat transportues, ashensorët, makarët etj. instalimet e ajrit të kondicionuar, heqjes së pluhurit, ventilimit, ngrirjes (dhomat e ftohta); instalimet telefonike dhe orë shpërndarjes, me përjashtim të aparateve marrëse që nuk janë të njëjtat me ato të inter-komunikacionit; instalimet e sinjalistikës rrugore, ajrore, hekurudhore; *instalimet e ndriçimit publik*; instalimet në fasadat e ndërtesave ose në ndërtimet me korniza metalike heqja e të cilave do të prishte fasadën; instalimet kirurgjikale: pajisjet hidraulike, qarku për lëndën ftohëse dhe energjinë, furnizimi dhe vendosja e gjeneratorëve dhe e qarqeve të ajrit të rralluar; instalimet e tavolinave dhe etazherëve në laboratorët e spitalit.

Punimet që nuk përfshihen në punimet për pasuritë e paluajtshme janë ato të cilat, cilado qoftë natyra e ndërtesës ku kryhen instalimet e objekteve apo aparateve të luajtshme, në momentin që vendosen e ruajnë karakterin e tyre të luajtshëm.

Konsiderohen si të tilla instalimet e aparaturave si: pajisjet elektro-shtëpiake, pajisjet e pavarura të ngrohjes me energji apo gaz, sobat e thjeshta dhe materiali i kuzhinave të specializuara, dollapët frigoriferikë, pajisjet e ndriçimit, llambat, llambadarët, aparatet matëse, të kontrollit, televizorët apo aparatet telefonike; elementet e sistemit si: raftet, pasqyrat e murit, dollapë farmacie, biblioteka, mobilet e tualetit, mbajtëse peshqirësh, raftet e lavamanit.

Instalimi i makinerive dhe pajisjeve në një uzinë të tilla si:

të gjitha materialet dhe makineritë që përbëjnë elemente të pavarura që mund të çmontohen pa u dëmtuar dhe të ripërdoren në të njëjtën gjendje në një vend tjetër pune (p.sh. tharëset, pompat, furrat, grupet elektrogjenë, vinçat dhe vagonët në shina);

të gjitha makineritë që përbëjnë mjetet e një uzine, të cilat, edhe nëse vendosen në themele të veçanta dhe pavarësisht mënyrës së montimit, mund të hiqen pa shkaktuar dëmtime të rënda.

Bashkimi i tubacioneve që sjellin ujin, vajin, gazin apo që heqin tymin, pluhurat, etj., nuk e ndryshon regjimin fiskal të këtyre instalimeve. Në këtë mënyrë, vendosja e makinerive-mjete, cilado qoftë natyra, pesha apo vëllimi i tyre (tornot, trapanot, mjetet e zdrukthëtarisë, presat, tezgjahët, etj.) nuk mund të ngjasojnë me një punë në pasuritë e paluajtshme. Punimet në inxhinierinë civile të kryera para instalimit të këtyre makinerive (p.sh. bazamentet prej betoni, gropat, kanalizimet) ndjekin regjimin e punimeve në pasuritë e paluajtshme.

Objektet, mjetet dhe makineritë e përfshira e ruajnë karakterin e tyre të luajtshëm edhe nëse furnizimi i tyre parashikohet në kuadrin e një serie punimesh që lidhen me një instalim me karakter të paluajtshëm dhe nëse çmimi i tyre i shitjes përfshihet në shumën e përgjithshme të punimit (p.sh. aparatet e telefonit në një instalim telefonik, pompat e luajtshme në instalimin e një kantine).

Nëse heqja e mjeteve të montuara mund të kryhet pa dëmtime të rënda për vetë ato apo për ndërtesën në të cilën janë instaluar, këto instalime e humbin karakterin e tyre të luajtshëm për shkak të përfshirjes së tyre në këtë ndërtesë dhe duhet të tatohen sipas regjimit të punimeve për pasuritë e paluajtshme.

Është pikërisht kështu për instalimet e tendave të jashtme (tenda sipas stilit italian, tenda të jashtme veneciane, qepena) të caktuar për të zëvendësuar mbylljet tradicionale, cilado qoftë natyra e ambienteve apo instalimet e realizuara.

Saktësohet se:

vendosja e zbukurimeve metalike në çatitë apo dritaret e një ndërtese me rastin e instalimit të tendave ndjek të njëjtin regjim tatimor si ky instalim;
furnizimi dhe vendosja e zbukurimeve metalike në çatitë apo dritaret e një ndërtese pa instalimin e tendave analizohen si një shitje e shoqëruar me një furnizim shërbimi;
ri-fiksimi dhe riparimet e rëndësishme të zbukurimeve metalike apo të shinave të një instalimi ekzistues duhet t'i nënshtrohen të njëjtit regjim si ai që zbatohet për instalimet e reja.

Punimet e restaurimit apo të riparimit që kanë si qëllim rinovimin e një ndërtese apo të një instalimi me karakter të paluajtshëm konsiderohen si punime në pasuritë e paluajtshme

Konsiderohen si të tilla kur operacionet e realizuara përmbajnë vendosjen e materialeve apo të elementeve që integrohen në një pasuri të paluajtshme ose kur këto operacione kanë si qëllim zëvendësimin e elementeve të përdorura të një instalimi me karakter të paluajtshëm ose shtimin e elementeve të reja që përfshihen në këtë instalim apo në ndërtesën që i mban ato.

Nga këto operacione, mund të citojmë:

restaurimin e fasadave që përmban punimet për pastrimin e fasadave të ndërtesave të vjetra apo që mund të integrohen në një cikël të plotë të ndërtimit të ri;

riparimi i çative, oxhaqeve, parketeve, dyerve dhe dritareve;

ripunimi apo riparimi i një instalimi elektrik (çelësi, siguresa, etj.), riparimet hidraulike (tubacionet, rubinetet, etj.), e oxhaqeve;

zëvendësimi i një grile persiane, i vaskës, i kaldajës apo një radiator të ngrohjes qendrore;

vendosja e një radiator shtesë;

transformimi i instalimit të ngrohjes qendrore me qymyr në një instalim me mazut;

trajtimi i armaturave dhe parketeve kundër insekteve (kandrrave) me anë të injektimit të një produkti anti-parazitar në masë ose me pluhurizim në sipërfaqe;

mbrojtja e armaturave dhe parketeve duke i lyer me një bojë që mbron nga djegja.

Vlera e tatueshme e punimeve të ndërtimit

Vlera e tatueshme e punimeve të ndërtimit duhet të përfshijë gjithçka që përbën vlerën korresponduese që furnizuesi i shërbimit të punimeve të ndërtimit merr ose do të marr nga blerësi në këmbim të furnizimit.

Vlera korresponduese është vlera e tregut dhe pikërisht është shuma e plotë që blerësi për të përfituar shërbimin e ndërtimit, në të njëjtën fazë të tregtimit në të cilin furnizimi kryhet, duhet ti paguajë me kushtet e konkurrencës së barabartë furnizuesit të shërbimit, i cili vepron si i pavarur. Kjo vlerë e tatueshme e punimeve të ndërtimit përcaktohet në mënyrë analitike nga vlerat përkatëse të zërave të elementeve të punimeve që përbëjnë situacionin e punimeve të kryera, ose shërbimeve përkatëse duke shtuar dhe çdo element që përfshihet në vlerën e tatueshme të një furnizimi sipas nenit 39 të ligjit. Këto vlera pasqyrohen në situacionin mujor të punimeve të kryera, vlera totale e të cilit reflektohet në faturën tatimore me TVSH, të cilës situacioni i bashkëngjitet për të justifikuar çdo zë të punimeve të kryera.

Gjithashtu, përcaktimi i kostos reale në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, përcaktohet në bazë të metodologjisë së dhënë në vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit”. Këto metodologji të llogaritjes së kostos minimale fiskale, çmimit dhe fitimit minimal fiskal për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, do të shërbejnë si metodologji alternative të vlerësimit.

Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim

TVSH-ja në ndërtim zbatohet :

Kur një person i tatueshëm, shoqëri ndërtimi kryen punime ndërtimi të çdo lloji për punë private ose publike, punime në të cilat përveç vlerës së punës përfshihet edhe vlera e materialeve të përdorura, punime rikonstruksioni, restaurimi të një objekti ose ndërton një objekt (ndërtesë) të re, ose kryen punime që kanë të bëjnë me punë publike (rrugë, rregullim terrenesh, etj), është i detyruar që çdo muaj të situacionojë punimet e kryera nëpërmjet një situacioni analitik ku të tregojë të gjitha zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura në sasi e vlerë dhe çdo element tjetër punimesh të përfshirë në situacionin e punimeve, përfshirë edhe tatimet apo taksat apo detyrime të tjera që llogariten dhe përfshihen në vlerën e tatueshme të punimeve të kryera, përveç TVSH-së.

Bazuar në nenin 99, pika 5 të ligjit fatura në ndërtim lëshohet çdo muaj. Çdo situacioni mujor të punimeve të kryera i bashkëngjitet detyrimisht fatura tatimore me numër serial. TVSH-ja llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve, e cila është edhe vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%.

Gjithashtu çdo person i tatueshëm që kryen punime të pjesshme në ndërtimin e një objekti si p.sh. punimet elektrike të objektit është i detyruar të tregojë në faturë zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura dhe vlerat përkatëse për çdo zë më vete.

Vlera e çdo situacioni mujor të shoqëruar me faturën tatimore me TVSH regjistrohet në librin e shitjeve dhe deklarohet në deklaratën e TVSH-së të periudhës që i përket.

Në rastin kur ndërtohet një objekt ose kryhen punime ndërtimi prej një personi të tatueshëm, i cili ka marrë përsipër të ndërtojë sipas porosisë së investitorit një objekt, i cili do të ketë apartamente banimi dhe ambiente për qëllime tregtare, të cilat investitori do ti shesë veprohet si më poshtë:

Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore investitorit të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana tjetër, investitorit të objektit, i cili do të furnizojë apartamentet dhe ambientet e ndryshme, bazuar në dispozitat përkatëse që kanë të bëjnë me zbritshmërinë e TVSH-së, kapitulli X i ligjit, nuk i lind e drejta të zbresë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim do të përdoret për një veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja siç është furnizimi i ndërtesave, pra nuk i shërben furnizimeve të tatueshme për TVSH-në. Faturat e blerjeve të punimeve të kryera nga investitori regjistrohen si blerje të përjashtuara në librin e blerjes dhe në deklaratën e TVSH-së.

Kur një person i tatueshëm ndërtues i licencuar si e tillë ndërton shtëpi banimi për vete, ose për çdo person tjetër, ai kryen furnizim kundrejt pagesës dhe për këto furnizime llogarit dhe paguan TVSH mbi vlerën e situacioneve të punimeve të kryera.

Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata:

Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm;

Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm.

Përsa i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm. Për shembull ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbrësë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, përse kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.

Përsa i përket pikës 4, rasti b), ku objekti që ndërtohet do t'i shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm, për shembull ndërtohet një magazinë që personi i tatueshëm e përdor për magazinimin e mallrave për t'u shitur, atëherë:

Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të tatueshme, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, i lind e drejta e zbritjes së TVSH-në së paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim do të përdoret për një veprimtari të tatueshme me TVSH, për pasojë

bazuar në parimin e neutralitetit të TVSH-së do t'i shërbejë një veprimtarie nga e cila lindin pagesa të TVSH-së.

Kur një person i tatueshëm njëkohësisht ndërtues edhe investitor ndërtën një objekt për t'u shfrytëzuar nga vetë ai për kryerjen e një veprimtarie të tatueshme (jo të përjashtuar) që do të kryejë pasi të përfundojë investimi. Për shembull ndërtohet një hotel. Personi i tatueshëm ndërtues për kryerjen e punimeve blen materiale, mallra, shërbime, etj., të nevojshme për kryerjen e punimeve. Këto blerje regjistrohen në librin e blerjes si blerje me TVSH të zbritshme përsa i shërbejnë punimeve të ndërtimit për të cilat paguhet TVSH. Çdo muaj për punimet e kryera harton situacionet përkatëse së bashku me faturën ku llogarit TVSH-në. Personi i tatueshëm ndërtues i cili në këtë rast është vetë edhe investitor i objektit, në faturën e lëshuar për çdo situacion do të paraqitet si shitës dhe blerës në të njëjtën kohë. Personi i tatueshëm ndërtues do të situacionojë dhe faturojë punimet që i përkasin objektit që do të shfrytëzohet nga vetë shoqëria për veprimtari të tatueshme. Këto fatura përkatësisht regjistrohen si vetëfurnizim, në librin e shitjes si shitje me TVSH 20 % dhe në librin e blerjes si blerje me TVSH të zbritshme. Është e rëndësishme që të jetë e verifikueshme në çdo rast që kemi të bëjmë me ndërtimin e një hoteli, nga shfrytëzimi i të cilit do të lindin pagesa të TVSH-së.

Kur një person i tatueshëm ndërtues, njëkohësisht edhe investitor ndërtën një objekt i cili pjesërisht është për t'u shitur, ndërsa pjesërisht për t'u shfrytëzuar nga vetë shoqëria për një veprimtari të tatueshme që shoqëria do të kryejë pasi të përfundojë investimi.

Personi i tatueshëm ndërtues për kryerjen e punimeve blen materiale, mallra, shërbime, etj., të nevojshme për kryerjen e punimeve. Këto blerje regjistrohen në librin e blerjes si blerje me TVSH të zbritshme. Çdo muaj harton situacionet përkatëse të punimeve të kryera dhe llogarit TVSH. Përsa personi i tatueshëm ndërtues është vetë edhe investitor i objektit në faturën e lëshuar për çdo situacion ai do të paraqitet si shitës dhe blerës në të njëjtën kohë.

Personi i tatueshëm ndërtues do të situacionojë dhe faturojë të ndarë më vete në një faturë (faturë pjesën e punimeve që i përkasin pjesës së objektit që do të shfrytëzohet nga vetë shoqëria për veprimtari të tatueshme dhe në faturë më vete (faturë 2) pjesën e objektit për t'u shitur si shitje ndërtese e përjashtuar nga TVSH-ja bazuar në nenin 53 pika g) të ligjit. Gjithashtu në përqindje ndërtuesi do të vlerësojë edhe ndajë edhe pjesën e punimeve të përbashkëta si themele, tarraca, korridore, ashensorë duke ndarë pjesën në përqindje që i takon shfrytëzimit të objektit për veprimtari të tatueshme dhe pjesën në përqindje që i takon objektit për veprimtari të përjashtuar. Këto fatura përkatësisht regjistrohen në librin e shitjes si shitje me TVSH 20 % dhe në librin e

blerjes regjistrohen përkatësisht, fatura 1- si blerje me TVSH të zbritshme dhe fatura 2- regjistrohet në vlerë totale si blerje me TVSH jo të zbritshme.

Është e rëndësishme dhe duhet të jetë qartësisht e përcaktuar që në fillim të ndërtimit të objektit në planimetrinë e tij, pjesa që do të përdoret për shfrytëzim nga vetë personi i tatueshëm dhe pjesa që do të jetë ambiente për t'u shitur. P.sh. 30 % e ndërtesës do të shfrytëzohet për qëllime të veprimtarisë së tatueshme të personit të tatueshëm, për t'u përdorur vetë prej tij si kinema ose restorant dhe ambiente argëtimi, por jo si ambiente për t'u shfrytëzuar për veprimtari të cilat janë të përjashtuara sipas ligjit, (p.sh. lojëra fati, kazino, etj.). Ndërkohë 70 % e ndërtesës do të jetë për t'u shitur. Përveç se punimet e ndërtimit për pjesën që i përkasin veprimtarisë së tatueshme duhet të jenë faturuar dhe situacionuar më vete nga pjesa tjetër, për punimet e përbashkëta si themelet, tarraca, ambientet e përbashkëta, etj, që janë në funksion të të dyjave qëllimeve do të ndahen në bazë të përqindjes përkatëse sipas së cilës janë planifikuar të shfrytëzohen ambientet e objektit.

Në rastin kur pjesa që personi i tatueshëm ndërtues dhe investitor do të mbajë për vete për veprimtarinë e tij janë ambiente për zyra dhe ky investitor kryen edhe veprimtari të tatueshme dhe të përjashtuar (p.sh. investitori në ndërtim, kryen ndërtime si veprimtari e tatueshme dhe furnizon apartamente apo jep me qira ato si veprimtari e përjashtuar), atëherë TVSH-ja e zbritshme që ai vetëfurnizon për ndërtimin e zyrave duke i situacionuar më vete nga pjesa tjetër e punimeve, është e zbritshme pjesërisht në proporcion me pjesën që zë veprimtaria e tatueshme e ndërtimit si ndërtues dhe veprimtaria e tij si furnizues i ndërtesave si furnizim i përjashtuar nga TVSH.

Rregulla të përgjithshme

Rastet e mësipërme janë ilustruese të situatave të ndryshme në ndërtim, por nuk janë shtruese.

Në çdo rast përse i përket ndërtimit por edhe çdo fushe tjetër të veprimtarisë, rregullat për qëllime të TVSH-së, si në këtë rast, përcaktohen për të rregulluar dhe sqaruar zbatimin e tatimit për një veprimtari të kryer bazuar në legjislacionin e fushës ku ushtrohet veprimtaria (p.sh. ndërtim, bankë, tregti, hidrokarbure) duke siguruar në çdo moment që çdo operacion, transaksion, furnizim, është kryer në përputhje me lejet, licencat, kërkesat, kriteret, etj.), të kërkuara sipas legjislacionit të fushës.

Për qëllime të zbatimit të dispozitave të ligjit dhe përcaktimeve të këtij neni për veprimtarinë në ndërtim duhet që:

Në çdo rast të përcaktohet qartë në lejet përkatëse përveç të dhënave që lidhen me ndërtuesin dhe investitorin, të dhënat për llojin e objektit, natyrën dhe qëllimin e

përdorimit të tyre. Kur qëllimi i përdorimit të objektit është i përzier të jetë përcaktuar qartë në përputhje me planimetrinë e objektit pjesa përkatëse dhe qëllimi i përdorimit.

Duhet të përcaktohet në leje qartësisht lloji i objektit dhe përdorimi i tij, në mënyrë që të jetë i mundur të vërtetohet qëllimi i përdorimit në lidhje me veprimtarinë, pasi e drejta e zbritjes së TVSH-së për vetëfurnizimin ushtrohet më parë sesa të jetë provuar qëllimi i përdorimit të objektit të vetëfurnizuar për veprimtari të tatueshme. Për vet specifikën që paraqet veprimtaria e ndërtimit, sidomos në rastet e vetëfurnizimeve në ndërtim, ku ndërtimi i objektit (situacionimi dhe faturimi i punimeve) shtrihet për një periudhë kohe, më të gjatë se një periudhë tatimore dhe nga njëra anë zbritja e TVSH-së kryhet në momentin e përcaktuar me ligj sipas nenit, ndërkohë që mbarimi i punimeve që ka të bëjë me momentin e fillimit të përdorimit të objektit ndodh në një moment tjetër të ndryshëm nga momenti i lindjes së zbritshmërisë të TVSH-së, është kusht i domosdoshëm që përveç se objekti i kësaj natyre duhet të jetë i tillë që të jetë i destinuar për kryerjen e aktiviteteve të tatueshme, por duhet të jetë i një tipi të tillë, që lloji, natyra dhe qëllimi i përdorimit të tij të shpallet dhe aprovohet në lejen e ndërtimit të dhënë sipas legjislacionit të fushës në fuqi.

Përkatësisht, në rastin e një investimi p.sh. një kinema, ose një qendër tregtare, kur kemi vetëfurnizim të objektit, duhet të jetë paracaktuar dhe të shprehet qartë në lejen e ndërtimit të objektit që objekti në tërësi ose një pjesë e tij, duke përcaktuar sipërfaqen përkatëse, do të përdoret nga shoqëria ndërtuese ose investitorë (sipas rastit) duke përcaktuar edhe veprimtarinë për të cilën do të përdoret sipërfaqja e ndërtuar. Ky kusht do të bëjë më të qartë dhe të besueshëm llojin dhe qëllimin e përdorimit të objektit të vetëfurnizuar për të cilin është zbritur TVSH-ja.

Barra e provës për të provuar dhe plotësuar çdo kërkesë si më sipër është e personit të tatueshëm.

Data e përfundimit të ndërtimit të objektit është momenti i përfitimit të mallit për qëllime të aplikimit të rregullave për rregullimin e zbritjes së TVSH-së në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 80 të ligjit.

Për çdo punim në ndërtim të kryer në shkelje të lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës, ose çdo punim të kryer përpara se leja përkatëse e kërkuar nga legjislacioni i fushës, të jetë lëshuar, personi i tatueshëm ndërtues është i detyruar të paguajë TVSH për pjesën e punimeve të kryera, por ndërkohë atij nuk i lejohet të zbresë TVSH-në për blerjet e kryera që i korrespondojnë situacioneve (pjesës së punimeve) në fjalë, përsa për kryerjen e punimeve nuk janë respektuar kërkesat dhe dispozitat ligjore të fushës përkatëse. Nga ana tjetër

investitorit të objektit, nëse e ka zbritur TVSH-në e punimeve të kryera prej personit të tatueshëm ndërtues, nuk i lejohet të zbresë TVSH-në përkatëse të punimeve të ndërtimit të kryera në kushtet e shkeljes.

Paradhënia në ndërtim

Nëse arkëtohet paradhënie për punimet e ndërtimit që do të kryhen, atëherë personi i tatueshëm që merr paradhënien detyrohet të lëshojë faturë në momentin e marrjes së saj dhe këtë faturë e regjistron në librin e shitjes së periudhës tatimore në të cilën është marrë paradhënia. Për vlerën e paradhënies do të llogaritet TVSH-ja përkatëse.

Nëse arkëtohet paradhënie për furnizimin e ndërtesës, personi i tatueshëm që merr paradhënien detyrohet të lëshojë një faturë për vlerën e arkëtuar, por përsa shitja e ndërtesës është e përjashtuar nga TVSH-ja dhe paradhënia e arkëtuar për këtë qëllim është e përjashtuar nga TVSH-ja.

Neni 21

Transferimi i veprimtarisë ekonomike

Transferimi tërësor apo i pjesshëm i veprimtarisë ekonomike

Bazuar në nenin 16, të ligjit nuk përbën furnizim malli ose furnizim shërbimi dhe për pasojë nuk është i tatueshëm për TVSH-në, transferimi kundrejt pagesës ose jo, apo në formën e një kontributi në një sipërmarrje, i tërësisë së aseteve apo të një pjese të tyre, kur kjo realizohet midis dy personave të tatueshëm për TVSH-në, nëse marrësi siguron vazhdimësinë e veprimtarisë së transferuar.

Përkufizimi

Termi i “transferimit kundrejt pagesës ose jo apo në formën e një kontributi në një shoqëri, i tërësisë së aseteve apo një pjese të tyre” lidhet me “transferimin e tërësisë së veprimtarisë ekonomike ose të një pjese autonome të një veprimtarie që përfshin, elemente të trupëzuara dhe, sipas rastit, të patrupëzuara, të cilat së bashku formojnë një veprimtari (sipërmarrje) ose një pjesë të një sipërmarrje, e cila në gjendjen që transferohet të mund të vazhdojë një aktivitet ekonomik të pavarur, në kushte të ngjashme si përpara transferimit”.

Nuk konsiderohen transferim i veprimtarisë ekonomike rastet e mëposhtme, por duke mos u kufizuar vetëm në to; transferimet e mallrave dhe shërbimeve që realizohen në përfitim të një personi të tatueshëm që nuk synon të shfrytëzojë tërësinë e transmetuar, por thjesht likuidon aktivitetin në fjalë ose kërkon ta shesë atë.

Transferimi i mallrave, si shitja e një stoku produktesh ose një shitje e izoluar e një malli/ mallrave të luajtshëm ose paluajtshëm të ndërmarrjes.

Kalimi i aseteve ose një pjesë të tyre që i përkasin një personi të tatueshëm të destinuara prej tij për të kryer një veprimtari, veprimtari e cila në fakt nuk është ushtruar nga transferuesi.

2. Modalitetet e zbatimit

Marrësi i transferimit duhet të konsiderohet si pasardhësi i transferuesit dhe të vazhdojë të shfrytëzojë tërësinë e transferuar në një formë apo një tjetër. Megjithatë, nuk kërkohet që ai të ketë ushtruar paraprakisht të njëjtin aktivitet me transferuesin apo të vazhdojë më pas në mënyrë strikte të njëjtin aktivitet me atë që ka ushtruar më parë transferuesi.

Si një element thelbësor i transferimit, pas transferimit duhet të sigurohet, autonomia (pavarësia) e tërësisë së aseteve që transferohen, qoftë kjo si një transferim tërësor të aseteve ose si një transferim i një tërësie të pjesshme.

Në përputhje me këtë parim, konsiderohet si transferim i tërësisë së aseteve apo një pjesë të tyre (një tërësie të pjesshme) kontributet globale që kryhen në kuadrin e një operacioni bashkimi, përthithje apo ndarje dhe kontributet e pjesshme të aseteve të konstatuara për shembull në rastin e ristrukturimit të një grupi (kontributet e një dege të plotë aktiviteti).

Gjithashtu konsiderohen transferim:

transferimet kundrejt pagesës së fondit të investimeve të një ndërmarrjeje bujqësore, tregtare apo profesionale, që ka të bëjë me një tërësi të aseteve ose një tërësie të pjesshme të tyre;

transferimet e pjesshme që realizohen në kuadrin e planeve të transferimit nëse ato lidhen me transferimin e degëve të plota të aktivitetit;

transferimi tërësor i pasurisë që realizohet në kuadrin e operacionit të ndarjes pa likuidim, etj.

Shembull: Transferimi tërësor apo i pjesshëm i aseteve

Pyetje: A ekzistojnë veçori në lidhje me operacionet e bashkimit apo të ndarjes pa likuidim të personave juridike?

Përgjigje: Marrësi i transferimit në varësi të rastit kur nuk lind e nevojshme të bëhet rregullim i TVSH-së së zbritshme, mund të përfitojë nga transferimi i TVSH- së së zbritshme që lidhet me personin juridik të përthithur apo të ndarë, rimbursimi i të cilit nuk është kërkuar nga ky person para humbjes së statusit juridik.

Natyra e transferuesit dhe e marrësit të transferimit

Mosaplikimi i TVSH-së për transferimet e një tërësie të plotë apo të pjesshme të aseteve kërkon që transferimi të kryhet midis dy personave të tatueshëm që e shfrytëzojnë veprimtarinë e transferuar për një veprimtari të tatueshme si rezultat i së cilës do të paguajnë TVSH.

Në këtë mënyrë, mosaplikimi i TVSH-së nuk zbatohet kur transferimi realizohet nga një person i tatueshëm që paguan TVSH në përfitim të një personi të tatueshëm të përjashtuar (jo pagues të TVSH).

Nga ana tjetër, mosaplikimi i TVSH-së lejohet kur transferimi realizohet mes dy personave, kur njëri prej tyre ose të dy kanë cilësinë e tatimpaguesit të pjesshëm për tërësinë e transferuar. Sipas këtyre hipotezave, marrësi i transferimit, i cili trajtohet si pasardhës i transferuesit, duhet të kryejë, për mallrat e investimit të transferuara brenda afatit të rregullimit, rregullimet e TVSH-së të zbritur më parë.

Mallrat dhe shërbimet e përfshira

Transferimi i veprimtarisë zbatohet për tërësinë aseteve (të mallrave dhe shërbimeve) që i përkasin tërësisë së transferuar, ose tërësisë së pjesshme të transferuar, cilado qoftë natyra e tyre.

Tërësia e aseteve të një personi të tatueshëm në një veprimtari ekonomike përbën fondin e investimit, i cili përfshin stokun, pasurinë e paluajtshme, aktive të trupëzuara, ose të patrupëzuara, patentat e ndryshme, kontratat e punësimit, etj.

Kalimi (transferimi) i fondit të investimit apo i një pjese të tij mund të jetë kundrejt pagesës ose jo, ose në formën e një kontributi në një sipërmarrje të caktuar.

Të gjithë elementet e mëposhtëm, por jo vetëm, përbëjnë fondin e investimit dhe si të tillë përmenden:

- transferimet e mallrave të reja dhe mallrave të tjera që mbahen në stoqe;
- transferimet e mallrave të trupëzuara për investim që kanë hapur të drejtën për zbritjen e plotë apo të pjesshme të TVSH gjatë blerjes së tyre, importit apo vetëfurnizimit;
- transferimet e mallrave të patrupëzuara për investim;
- transferimet e ndërtesave dhe trojeve për ndërtim;
- transferimin e tëdrejtave dhe detyrimeve respektive (kontratave të punësimit), etj.

Transferimi i veprimtarisë ka të bëjë me transferimin e të gjithë këtyre elementeve që përbëjnë fondin e investimit.

Transferimi i një aktivi të patrupëzuar të fondit të investimit

Transferimi i një elementi të patrupëzuar, pjesë e fondit të investimit përbën në përgjithësi një furnizim të zakonshëm, i cili sjell si pasojë kërkueshmërinë e TVSH-së.

Në këtë mënyrë, tatohen normalisht meTVSH:

Transferimi nga koncensionari i një marke tregtare i të drejtës së tij për të ushtruar kufizimin e plotë apo të pjesshëm të saj;

transferimi i të drejtës për të shfrytëzuar një gurore apo një minierë, etj.;

transferimi i të drejtës që lidhet me një film;

transferimi nga një ndërmarrje shtypi i të drejtës së riprodhimit;

Dhënia e një elementi të ndarë nga fondi (marka, licenca...), kryer kundrejt pagesës përbën një transaksion të tatueshëm.

Qiradhënia e fondit të investimit (klientela, blerësit rastësorë, e drejta e qiradhënies, logoja, emri tregtar, marka e fabrikës, licencat, mallrat e luajtshme, mjetet, materiali...) përbën një furnizim shërbimi të kryer kundrejt pagesës që tatohet me TVSH. Ky transaksion përbën për qiradhënësin një mënyrë shfrytëzimi të aktivitetit të tij tregtar, e cila i jep këtij operacioni një karakter tregtar duke e bërë të tatueshëm me TVSH.

Procedura e transferimit të veprimtarisë dhe rregullat që duhet të zbatohen, por jo domosdoshmërisht dhe kur janë të identifikueshme:

Në përgjithësi transferimi i veprimtarisë bazohet mbi një kontratë (akt transferimi) të noterizuar midis transferuesit dhe marrësit të transferimit. Ky akt regjistrohet në pasqyrat financiare të ndërmarrjes dhe me këtë akt njoftohet administrata tatimore. Përkatësisht detyrimet dhe të drejtat e transferuesit të evidentuar në pasqyrat financiare, ose të njohura para kohës së transferimit, zhvendosen duke u bërë detyrim dhe e drejtë e marrësit të transferimit.

Të gjitha të dhënat, librat dhe regjistrimet që kanë të bëjnë me tërësinë e asetëve apo pjesën e tyre që është transferuar të detyrueshme për t'u mbajtur, pas transferimit, në vend të transferuesit duhet të mbahen nga marrësi i transferimit.

Bazuar në nenin 16 të ligjit kërkohet që transferimi të bëhet ndërmjet dy personave të tatueshëm të regjistruar për TVSH-në. Personat e tatueshëm, palë në

procesin e transferimit të veprimtarisë ekonomike, duhet të njoftojnë me një njoftim me shkrim Drejtorinë Rajonale Tatimore përkatëse, të paktën 45 ditë kalendarike përpara se të ndodhë transferimi.

Për qëllime të pikës 6 të nenit 16 të ligjit, për aktivet e luajtshme që transferohen afati i rregullimit në përputhje me ligjin fillon nga data e blerjes ose prodhimit të aktivit nga personi i tatueshëm transferues. Kështu edhe afati i rregullimit të TVSH-së së zbritshme transferohet duke ruajtur numërimin e viteve të përdorimit që nga momenti i blerjes ose prodhimit të këtyre aktiveve prej transferuesit. Rregullimi i TVSH-së së zbritur kryhet gjithmonë kur kërkohet sipas dispozitave dhe në përputhje me parashikimet e ligjit për të drejtën e zbritjes së TVSH-së.

Shembull: Transferohet një veprimtari ekonomike që plotëson kushtet për t'u transferuar. Pjesë e aseteve është edhe një pajisje (makineri prodhimi). Makinaria është blerë nga personi i tatueshëm A (transferuesi) më janar 2013. Personi i tatueshëm A në prill 2015 transferon veprimtarinë ekonomike tek personi i tatueshëm B marrës i transferimit, i cili do të vazhdojë të kryejë veprimtarinë ekonomike si personi i tatueshëm A. Personi i tatueshëm B (marrësi i transferimit) në tetor 2016 mbyll veprimtarinë ekonomike. Pajisja nuk është shitur përgjatë procesit të likuidimit.

Personi i tatueshëm B duhet të rregullojë TVSH-në e zbritshme të pajisjes në momentin e mbylljes së veprimtarisë ekonomike. Afati 5-vjeçar i rregullimit të TVSH-së së zbritshme do të fillojë nga data e blerjes së aktivit tek personi i tatueshëm A më janar 2013 dhe jo nga data e transferimit të veprimtarisë tek personi i tatueshëm B, prill 2015. Kështu janar 2013 deri më tetor 2016 për qëllime të këtij rregulli konsiderohen 4 vjet. Rregullimi i TVSH-së së zbritshme nga B për këtë pajisje do të bëhet për ¼ e TVSH-së që kanë qenë zbritur për aktivin në momentin e blerjes së tij sipas faturave përkatëse tatimore.

Rregullime të TVSH-së së zbritshme, bazuar në parimin dhe të drejtën e zbritjes, sipas rastit do të bëhen përkatësisht kur kemi të bëjmë me ndryshime të veprimtarisë e për pasojë me ndryshime të përdorimit të aktivit nga transferuesi tek i transferuari pas transferimit, pra aktivi që përdorej për një veprimtari të tatueshme tek marrësi i transferimit përdoret më pas për një veprimtari të përjashtuar ose pjesërisht të tillë.

Palët e përfshira në transferim, në aktin e transferimit, kontratën përkatëse midis tyre, në rastin kur transferuesi në momentin e transferimit rezulton me TVSH të zbritshme, të cilën akoma nuk e ka kërkuar për rimbursim duhet të shprehen dhe të evidentojnë qartazi këtë fakt si dhe të shprehen nëse e drejta e kalimit të TVSH-

së së zbritshme duke evidentuar edhe shumën përkatëse, i kalon ose jo marrësit të transferimit.

Në këtë rast transferuesi duhet të rregullojë TVSH-në e zbritshme të zbritur prej tij, e cila vazhdon të zbritet prej marrësit të transferimit në përputhje me kërkesat e ligjit.

Nëse transferuesi nuk ka kryer dhe nuk ka evidentuar rregullimin e TVSH-së së zbritshme të transferuar në momentin e transferimit atëherë autoriteti tatimor bën vetë rregullimin përkatës dhe personi i tatueshëm marrës i transferimit nuk gëzon të drejtën të njohë si të zbritshme TVSH-në përkatëse.

Në çdo rast akti i transferimit (kontratë e noterizuar) përveç evidentimit të veprimeve në pasqyrat përkatëse financiare të secilit prej personave të tatueshëm, shoqërohet detyrimisht me një kartelë ku evidentohet çdo aktiv i trupëzuar (i luajtshëm dhe i paluajtshëm), vlera e tatueshme dhe TVSH-ja e zbritshme në momentin e blerjes ose prodhimit të aktivit të vërtetuar me dokumentacionin përkatës të blerjes së aktivit dhe data e blerjes së tij. Gjithashtu në një kartelë të dytë analitike kërkohet të evidentohen në mënyrë analitike çdo aset (aktiv) i transferuar si aktive të patrupëzuar, mallra inventar që transferohen, të drejta e detyrime të tjera, etj., zëra sipas bilancit.

Transferuesi përveç dokumentacionit të kërkuar e dokumenton me faturë tatimore shitje transferimin e tërësisë së aseteve ose tërësisë së pjesshme ku evidentohen zërat përkatës të bilancit që transferohet dhe vlera totale e transferimit. Nëse transferuesi edhe pse mund të jetë në kushtet e zbatimit të dispozitave të nenit 16 të ligjit për TVSH-në, lëshon një faturë që përfshin TVSH-në, ai është përgjegjës për TVSH-në e faturuar. Në raste të tilla, marrësi i transferimit nuk gëzon të drejtën të zbres TVSH-në.

Transferuesi dhe marrësi i transferimit detyrohen që të njoftojnë autoritetin tatimor (Drejtorinë Rajonale Tatimore) kur kryejnë transferim të veprimtarisë ekonomike sipas këtij udhëzimi.

Njoftimi me shkrim depozitohet në dosjen e tatimpaguesit dhe përmban:

Të dhënat në lidhje me transferuesin dhe marrësin e transferimit;

Kontrata në lidhje me kushtet e transferimit të biznesit;

Specifikat përfshirë përshkrimin, sasinë dhe vlerën e pasurisë, e cila transferohet sipas kartelave analitike;

Vendndodhja e pasurisë që transferohet.

Një deklaratë me shkrim, që specifikon dhe detyron për korrigjim (rregullim) të TVSH-së së zbritshme për secilin mall të kapitalit, që duhet të nënshkruhet nga të dy palët nga furnizuesi dhe pranuesi. Kjo deklaratë duhet që ti dërgohet administratës tatimore jo më

vonë se data e dorëzimit të deklaratës së TVSH-së në periudhën në të cilën ka ndodhur transferimi. Rregullimi i TVSH-së së zbritshme kur kërkohet sipas ligjit nga transferuesi bëhet në kutinë përkatëse të librit të blerjes dhe ky rregullim evidentohet në kutinë përkatëse të deklaratës së TVSH-së.

E drejta e marrësit të transferimit është që të njoftohet nga transferuesi për të gjitha detyrimet tatimore që rezultojnë të papaguara Nëse ka të tilla, në mënyrë që blerësi të ketë të qartë detyrimet tatimore për transferimin e këtij biznesi. Në një transferim tërësor të veprimtarisë ekonomike detyrimet tatimore të papaguara në datën e transferimit i transferohen marrësit të transferimit.

Përsa i përket transferimit të tërësisë së pjesshme të biznesit, bartja e detyrimeve tatimore dhe TVSH-së së zbritshme duhet të përcaktohet qartë prej transferuesit tek transfert-marrësi.

Mosnjoftimi i kryerjes së procedurës së transferimit të veprimtarisë ekonomike sipas këtij udhëzimi, konsiderohet mosdhënie informacioni dhe penalizohet në përputhje me nenin 126, të ligjit për procedurat tatimore.

Neni 22

Vendi i Furnizimit të mallrave

Vendi i tatueshmërisë së furnizimeve të mallrave të luajtshme të trupëzuara ndryshon nëse mallrat dërgohen apo transportohen, nëse montohen apo instalohen apo nëse furnizohen në bordin e një anijeje, të një mjeti fluturues apo të një treni.

Vendi i furnizimit të mallrave të luajtshme të trupëzuara të parashikuara në nenin 7, 8, 9 të ligjit, e për rrjedhojë vendi i tatimit të tyre për qëllime të TVSH-së, përcaktohet në nenet 18 deri në nenin 21 të ligjit.

Furnizimet e mallrave pa dërgesë apo pa transport

Bazuar në nenin 18 të ligjit kur malli nuk dërgohet ose nuk transportohet, vendi i furnizimit të mallit është në Republikën e Shqipërisë, nëse malli ndodhet në Republikën e Shqipërisë në momentin kur i vihet në dispozicion blerësit pavarësisht vendndodhjes apo vendbanimit të këtij të fundit brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast furnizimi i mallit është i tatueshëm në Republikën e Shqipërisë sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

Në të kundërt, nëse malli i cili nuk dërgohet, ose nuk transportohet, ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë në momentin e vënies në dispozicion të blerësit, vendi i furnizimit të mallit nuk është në Republikën e Shqipërisë dhe furnizimi nuk është i tatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Furnizimi i mallrave me dërgesë ose me transport nga shitësi, blerësi ose një palë e tretë për llogari të tyre**Pikënisja (fillimi) i dërgimit ose i transportit të mallit ndodhet në Shqipëri.**

Bazuar në nenin 19 të ligjit, kur malli dërgohet apo transportohet nga Republika e Shqipërisë, vendi i furnizimit të mallit ndodhet në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht destinacionit të mallit në një vend jashtë saj, Ky rregull zbatohet në të gjitha rastet, pavarësisht se dërgesa ose transporti kryhet nga blerësi ose nga një palë e tretë për llogari të tij.

Kur vendi i furnizimit të mallrave ndodhet në Republikën e Shqipërisë tatueshmëria e mallrave për qëllime të TVSH-së bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim.

Pikënisja e dërgimit apo e transportit të mallit ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë dhe vend-mbërritja në Republikën e Shqipërisë

Bazuar në nenin 19 të ligjit, kur pikënisja (fillimi) e dërgimit apo e transportit të mallit ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë, vendi i furnizimit të mallrave është i ndryshëm në varësi të faktit se prej cilit person kryhet furnizimi (importimi).

Bazuar në nenin 22 dhe 34 të ligjit, importimi i mallrave i nënshtrohet TVSH gjatë importimit në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj, përveç rasteve kur vetë ligji ka parashikuar përjashtim nga TVSH-ja në import.

b/1 Furnizimi kryhet nga importuesi ose për llogari të tij

Në përputhje me dispozitat e nenit 22 të ligjit, kur furnizimi kryhet nga importuesi ose për llogari të tij, vendi i furnizimit të mallit të dërguar apo të transportuar, pikënisja e të cilit ndodhet jashtë Shqipërisë dhe vend-mbërritja është në Shqipëri, është vendi i importimit të mallrave.

Shembull: Malli i dërguar apo transportuar nga një vend apo territor jashtë Shqipërisë, importuesi i së cilës është një person i tatueshëm në Shqipëri, vendi i furnizimit përputhet me vendin e importimit të mallrave dhe ky mall i nënshtrohet procedurave të importit në Shqipëri.

I nënshtrohen të njëjtit rregull furnizimet që lidhen me mallin e importuar, pikërisht ato furnizime që përfshihen në vlerën e tatueshme të mallit dhe që ndjekin furnizimin e kryer nga importuesi, gjithmonë kur pikënisja ndodhet jashtë Shqipërisë.

b/2 Furnizimi kryhet nga një person i ndryshëm nga importuesi

Vendi i furnizimit në lidhje me një mall që ndodhet jashtë territorit të Shqipërisë gjatë nisjes së tij me destinacion blerësin, nuk është në Shqipëri kur ky furnizim nuk kryhet nga importuesi. (ose kur blerësi i mallit është një person i ndryshëm nga importuesi i tij)

Ky rregull zbatohet edhe kur furnizimi i mallit është kryer jashtë Shqipërisë, ose para zhdoganimit të mallit dhe vetë blerësi i tij procedon me importimin e mallit. Në këtë rast TVSH është i kërkueshëm për importin e mallrave të kryer nga blerësi, gjatë zhdoganimit.

Furnizimi i mallrave me montim apo instalim nga shitësi apo për llogari të tij

Bazuar në nenin 19 të ligjit, vendi i furnizimit të mallrave të luajtshme të trupëzuara është në Shqipëri nëse malli ndodhet në Shqipëri gjatë montimit apo instalimit nga shitësi apo për llogari të tij.

Ky rregull është i vlefshëm edhe nëse shitësi është person i tatueshëm që nuk është i vendosur në Shqipëri.

Kur një person i tatueshëm që nuk është vendosur në Shqipëri, importon në këtë vend mallra të destinuara për t'u montuar apo instaluar nga ky person i tatueshëm apo për llogari të tij, ky operacion është i tatueshëm sipas dispozitave të ligjit. Në këtë rast, personi i tatueshëm realizon në Shqipëri një operacion importi dhe nga ana tjetër një furnizim mallrash me montim ose instalim, furnizim i tatueshëm në Shqipëri.

Furnizimet e mallrave në bordin e anijeve, aeroplanëve apo trenave

Bazuar në nenin 20 të ligjit, vendi i furnizimit të mallrave të luajtshme të trupëzuara të shitura në bordin e anijeve, aeroplanëve apo trenave për transport ndërkombëtar të pasagjerëve, është në Shqipëri kur mallrat ndodhen në Shqipëri në momentin e nisjes së transportit, vend-mbërritja e të cilit ndodhet në territorin e një shteti tjetër jashtë Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet vetëm për mallrat e luajtshme të trupëzuara që tregtohen (shiten) në bord, por nuk janë të destinuara për t'u konsumuar në bord, ose kryhen dhe konsumohen në të njëjtën kohë në bordin e këtyre mjeteve të transportit.

Nuk është objekt i kësaj dispozite, pra nuk bëjnë pjesë në këtë rregull, furnizimi i mallrave i destinuar për furnizimin e mjeteve përkatëse të transportit.

Shitjet e mallrave, të realizuara në bordin e një anijeje apo aeroplani, të destinuara për t'u konsumuar në bord nuk i nënshtrohen TVSH-së në Shqipëri si furnizime të ngjashme me eksportet.

Ky rregull zbatohet vetëm në bordin e mjeteve për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve si p.sh. për ushqim dhe shërbim restoranti, mallra “*duty free*”, etj., të kësaj natyre. Nuk zbatohet dhe nuk përfshihen në këtë rregull furnizimi i mallrave për qëllime tregtare.

Furnizimi i gazit natyror, energjisë elektrike, ujit, energjisë për ngrohje dhe ftohje nëpërmjet sistemeve të shpërndarjes

a)Mallrat për të cilat zbatohen këto rregulla:

Bazuar në nenin 21 të ligjit rregullat e parashikuara në këtë nen zbatohen për gazin natyror, energjinë elektrike, energjinë për ngrohje dhe ftohje të furnizuara nëpërmjet sistemeve (rrjeteve) të transportit ose shpërndarjes me destinacion blerësin. Këto rregulla gjithashtu zbatohen edhe për vendin e furnizimit të ujit, i cili nëShqipëri furnizohet nëpërmjet sistemeve të shpërndarjes (rrjeti i ujit).

Këto rregulla të vendit të furnizimit të këtyre mallrave nuk zbatohen nëse dërgimi i tyre drejt konsumatorit apo përdoruesit nuk kryhet me anë të sistemeve (rrjeteve) të transportit ose të shpërndarjes. P.sh. vendi i furnizimit nuk përcaktohet sipas këtij neni nëse transporti i gazit natyror bëhet me mjete të lëvizshme të posaçme për t’u përpunuar në gaz natyror të djegshëm ose për t’u tregtuar.

b)Vendi i furnizimit të këtyre mallrave

Vendi i furnizimit të gazit natyror, energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe ftohje dhe ujit është në Shqipëri nëse:

këto mallra janë konsumuar apo përdorur efektivisht në Shqipëri, pavarësisht vendndodhjes së blerësit ose shitësit;

në mungesë të konsumit apo përdorimit efektiv të këtyre mallrave në Shqipëri, kur blerësi person i tatueshëm ka në Shqipëri selinë e veprimtarisë së tij ekonomike apo njësinë fikse ku furnizohen mallrat ose në mungesë të tyre vendi ku ai ka adresën e përhershme ose ku ai banon. I tillë është rasti i operacioneve të blerjes-rishitjes të gazit natyror, energjisë elektrike, ngrohjes dhe ftohjes.

Kur energjia elektrike, gazi natyror, energjia për ngrohje apo ftohje konsumohen apo përdoren jashtë Shqipërisë, vendi i furnizimit të tyre nuk është në Shqipëri. Furnizuesi i këtyre mallrave një person i tatueshëm në Shqipëri i nënshtrohet formaliteteve, rregullave dhe detyrimeve që kërkojnë nga legjislacioni doganor në fuqi.

Kur furnizuesi person i tatueshëm është i vendosur në Shqipëri dhe pretendon se këto mallra nuk janë furnizuar ose konsumuar në Shqipëri, ai duhet të justifikojë me dokumentacionin përkatës

ligjor dhe tatimor që këto mallra janë transportuar për t'u konsumuar ose tregtuar jashtë Shqipërisë.

Dokumentet që mund të kërkohen për të vërtetuar sa më sipër janë për shembull: lejet e posaçme që kërkohen, kontratat, faturat, të dhënat e blerësit (destinuesit) të energjisë, dokumentet që lidhen me kërkesën për akses në linjat e transmetimit (interkoneksionet), faturat e shërbimit të transportit apo të shpërndarjes ose të lejimit të përdorimit të rrjeteve apo linjave, deklaratat doganore përkatëse në përputhje me procedurën dhe legjislacionin doganor, vërtetime për vendndodhjen e blerësit të lëshuar nga autoritetet tatimore të vendit të destinacionit, leje e lëshuar nga autoritetet e ngarkuara për energjinë për të ushtruar aktivitetin e blerjes për rishitje, kur kërkohet nga legjislacioni i fushës.

5.1 Furnizimet me gaz natyror, energji elektrike, ngrohje apo ftohje të tatueshme në vendin e konsumit

Furnizimi me gaz natyror, energji elektrike, ngrohje apo ftohje është i tatueshëm në Shqipëri nëseblerësi, pavarësisht vendit ku ndodhet selia e veprimtarisë së tij ekonomike apo vendndodhja e qëndrueshme, konsumon apo përdor efektivisht në Shqipëri gazin natyror, energjinë elektrike, ngrohjen apo ftohjen.

Në rastin kur këto mallra konsumohen ose përdoren nga konsumatori, praktikisht, vendi i konsumit apo i përdorimit efikas të gazit natyror, energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose ftohje është vendi ku ndodhet matësi i gazit natyror, energjisë elektrike, energjisë për ngrohje apo ftohje.

Ky rregull zbatohet edhe për furnizimin me ujë nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes.

5.2 Furnizimet me gaz natyror, energji elektrike, ngrohje apo ftohje të tatueshme në vendin ku ndodhet blerësi

Furnizimet me gaz natyror, energji elektrike, ngrohje apo ftohje për qëllime të ndryshme nga ato të konsumit apo të përdorimit të tyre nga blerësit, janë të tatueshme në Shqipëri kur blerësi person i tatueshëm ka në Shqipëri selinë e veprimtarisë së tij ekonomike apo një vendndodhje të qëndrueshme siç përcaktohet në nenin 23 të këtij udhëzimi, ku furnizohen këto mallra ose në mungesë të tyre, vendin ku ai ka adresën e përhershme ose ku ai banon.

I tillë është rasti i personave të tatueshëm që blejnë gaz natyror, energji elektrike, ngrohje apo ftohje me qëllim rishitjen e tyre në Shqipëri. Ky furnizim është i tatueshëm në Shqipëri sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

Kur një person i tatueshëm blerës- rishitës që ka një vendndodhje të qëndrueshme në Shqipëri blen nga një furnizues jashtë Shqipërisë energji për ta ri-shitur jashtë Shqipërisë, (blerja e energjisë nga furnizuesi i është faturuar ri-shitësit), atëherë vendi i furnizimit të energjisë është në Shqipëri, në vendin ku personi i tatueshëm rishitës ka vendndodhjen e qëndrueshme. Ky transaksion është i tatueshëm në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligj. Dokumentimi bëhet në përputhje me legjislacionin tatimor dhe doganor në fuqi.

Shembull 1: Një person i tatueshëm ka selinë e veprimtarisë së tij ekonomike jashtë Shqipërisë, por ka në Shqipëri një vendndodhje të qëndrueshme (degë), blen gaz natyror tek një furnizues i huaj (Transaksioni nr.1). Furnizuesi i huaj ia faturon transaksionin vendndodhjesë qëndrueshme në Shqipëri. Gazi natyror shitet nga vendndodhja e qëndrueshme pjesërisht tek një klient konsumator në Shqipëri (Transaksionin nr. 2) dhe pjesërisht i shitet një klienti të vendosur në një vend jashtë Shqipërisë, p.sh. Kosovë (Transaksioni nr. 3).

Këto transaksione realizohen si më poshtë:

Transaksioni nr. 1: Furnizimi është i tatueshëm në Shqipëri në vendin ku është vendosur blerësi. Vendndodhja e qëndrueshme është pague e TVSH-së në import.

Transaksioni nr. 2: Furnizimi është i tatueshëm në Shqipëri. Vendndodhja e qëndrueshme kryen furnizimin e gazit të Shqipëri për klientin konsumator, konsum i cili matet në vendin e veprimtarisë së klientit ku është vendosur matësi. Dega furnizon dhe paguan TVSH-në për furnizimin.

Transaksioni nr. 3: Furnizimi ndodh në Shqipëri në vendin ku ndodhet dega e cila për sasinë që rishet për klientin e vendosur jashtë Shqipërisë, në Kosovë kryen eksport dhe e dokumenton sipas procedurave doganore.

Furnizimet me gaz natyror, energji elektrike, ngrohje apo ftohje që pasojnë furnizimin e parë janë të tatueshme ose jo në Shqipëri sipas rregullave që zbatohen për çdo furnizim në lidhje me vendin e furnizimit të këtyre mallrave.

Neni 23

Vendi i Furnizimit të Shërbimeve Përkufizime, rregulla të përgjithshme

Vendi i furnizimit të shërbimeve dhe rregullat përkatëse parashikohen përkatësisht në nenet 23 deri 30 të ligjit.

Në zbatim të rregullave të përgjithshme të parashikuara në nenin 24 të ligjit, vendi i furnizimit të shërbimeve është në Shqipëri nëse:

Shërbimi është marrë nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë dhe ka në Shqipëri selinë e veprimtarisë së tij ekonomike ose një vendndodhje të qëndrueshme për të cilën janë kryer shërbimet, ose në mungesë të tyre, banesën ose rezidencën e zakonshme;

Shërbimi është marrë nga një person i pa-tatueshëm dhe furnizuesi i shërbimit, person i tatueshëm ka në Shqipëri selinë e veprimtarisë së tij ekonomike ose një vendndodhje të qëndrueshme, nga e cila janë ofruar shërbimet ose në mungesë të tyre, banesën ose rezidencën e zakonshme.

Ligji 92/2014, datë 24.07.2014	Vendi është vendosur furnizuesi person i tatueshëm	ku	Vendi ku është vendosur marrësi shërbimit, person i tatueshëm	Vendi ku është vendosur marrësi shërbimit, person i pa- tatueshëm	Vendi furnizimit shërbimit/tatimit
Neni 24/1	Në Shqipëri	Jashtë Shqipërisë			I pa-tatueshëm në Shqipëri
	Jashtë Shqipërisë	Në Shqipëri			I tatueshëm në Shqipëri
Neni 24/2	Në Shqipëri			Jashtë Shqipërisë	I tatueshëm në Shqipëri
	Jashtë Shqipërisë			Në Shqipëri	I pa-tatueshëm në Shqipëri

Në rastet e shërbimeve të parashikuara në nenet 25 deri 30 të ligjit, zbatohen përjashtime nga dy rregullat e përgjithshme më sipër, me qëllim që të merret në konsideratë më mirë parimi i tatimit në vendin e konsumit efektiv të furnizimit të shërbimit

Nocioni i personave të tatueshëm

Meqenëse rregullat e vendit të furnizimit të shërbimit janë të ndryshme nëse marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm apo i pa-tatueshëm, cilësia e marrësit të shërbimit është e rëndësishme për përcaktimin e vendit të furnizimit të shërbimeve dhe për pasojë përcaktimin e vendit të tatimit.

Në përputhje me nenin 23 të ligjit, përveç personave të tatueshëm të parashikuar në nenin 3 të ligjit, duhet të konsiderohen gjithashtu si persona të tatueshëm, për sa i përket rregullave të përcaktimit të vendit të furnizimit të shërbimit, personat e mëposhtëm:

Persona të tatueshëm pjesërisht

Për zbatimin e rregullave në lidhje me vendin e furnizimit të shërbimit, konsiderohet si person i tatueshëm për të gjitha shërbimet që i janë furnizuar, edhe një person i tatueshëm kur ai realizon gjithashtu operacione në kuadrin e një aktiviteti të vendosur jashtë fushës së zbatimit të TVSH, dheshërbimet janë blerë për nevojat e kësaj veprimtarie, por ndërkohë kjo organizatë kryen edhe veprimtari ekonomike

Shembull 1 : Një organizatë jofitimprurëse e cila përfiton grante për të kontribuar për njerëz në nevojë. Ndërkohë kjo organizatë në funksion dhe për të kryer veprimtarinë e saj jofitimprurëse ushtron edhe veprimtari ekonomike duke ofruar shërbime konsulence dhe shet studime të kryera në fushën sociale kundrejt pagesës. Organizata blen një software special jashtë Shqipërisë në funksion të veprimtarisë së saj jashtë fushës, për të zbatitur fëmijët në nevojë. Kjo organizatë konsiderohet person i tatueshëm për TVSH-në për shërbimin e marrë nga jashtë.

Shembull2: Një shoqëri holding, përveç administrimit të pjesëmarrjeve, kryen furnizime shërbimi kundrejt pagesës për filialet e saj. Për të përcaktuar vendin e furnizimit të shërbimeve që ajo blen, shoqëria holding konsiderohet si një person i tatueshëm.

b. Persona juridikë të pa-tatueshëm dhe të identifikuar me TVSH

Për zbatimin e rregullave në lidhje me vendin e furnizimit të shërbimeve, konsiderohet si person i tatueshëm një person juridik i pa-tatueshëm që ka një numër identifikimi të TVSH- së.

Një person juridik i pa-tatueshëm i së drejtës publike që nuk kryen veprimtari ekonomike por që për nevoja të ushtrimit të funksionit të vet publik merr një furnizim shërbimi jashtë Republikës së Shqipërisë për qëllime të ligjit, konsiderohet person i tatueshëm.

c. Persona të tatueshëm jo tatimpagues të TVSH-së

Një subjekt që nuk është tatimpagues i TVSH-së për shkak se i nënshtrohet regjimit të biznesit të vogël siç parashikohet në kapitullin XI, seksioni I të ligjit, ose,

Një subjekt që nuk është tatimpagues i TVSH-së për shkak të përjashtimit nga TVSH-ja që zbatohet për furnizimet që realizon, sipas përcaktimeve në këtë ligj;

Këta persona të cilët kanë cilësinë e personit të tatueshëm dhe janë të pajisur me një numër identifikimi për TVSH-në sipas nenit 3 të ligjit, kur blejnë shërbime të ofruara nga një furnizues i vendosur jashtë Shqipërisë, janë persona të tatueshëm edhe për qëllime të përcaktimit të vendit të tatimit të furnizimit të shërbimeve të marra nga jashtë Shqipërisë.

2.Nocioni i selisë ekonomike dhe vendndodhjes së qëndrueshme

Përkufizimi i selisë ekonomike

Për të përcaktuar për qëllime të TVSH-së, vendin e selisë së veprimtarisë ekonomike të një personi të tatueshëm, merren në konsideratë një sërë treguesish, si selia statutore e shoqërisë, vendi i administratës qendrore, vendi ku mblidhen drejtuesit e shoqërisë, si dhe vendi, që zakonisht është i njëjti, ku vendoset për politikën e përgjithshme të kësaj shoqërie.

Në rast të treguesve kontradiktorë, vendi i selisë së aktivitetit ekonomik është përfundimisht vendi ku merren vendimet kryesore në lidhje me drejtimin e përgjithshëm të shoqërisë apo dhe ai ku ushtrohen funksionet e administratës qendrore të kësaj të fundit.

Prania e një shoqërie vetëm me “kutinë postare” apo atyre “fantazmë” nuk do të mund t’i jepte statusin e selisë së veprimtarisë ekonomike një personi të tatueshëm, që nuk përmbush kushtet e mësipërme.

Përkufizimi i vendndodhjes së qëndrueshme

Përkufizimi i vendndodhjes së qëndrueshme në fushën e TVSH-së duhet të dallohet nga përkufizimet që merren në konsideratë për tatimet dhe taksat e tjera që kanë të bëjnë kryesisht me të ardhurat.

Në lidhje me këtë çështje, një vendndodhje e qëndrueshme karakterizohet nga një shkallë e mjaftueshme qëndrueshmërie dhe një strukturë e aftë si nga personeli, ashtu dhe nga pajisjet teknike, e cila bën të mundur furnizimin e shërbimit nga kjo vendndodhje, ose përdorimin nga kjo vendndodhje të shërbimeve që i janë furnizuar.

Në këtë mënyrë, është e nevojshme që vendndodhja nga e cila kryhet furnizimi i shërbimit, të jetë e aftë të furnizojë shërbimet e duhura, ose vendndodhja që ka marrë shërbimin e furnizuar, të jetë e aftë të marrë dhe të përdorë shërbimet e duhura.

Nocioni i banesës dhe rezidencës së zakonshme

Vendi i banesës së një personi fizik, i tatueshëm apo i pa-tatueshëm, është në fakt ai që rezulton nga adresa e deklaruar në administratën tatimore nëse e ka deklaruar.

Rezidenca e zakonshme e një personi fizik, i tatueshëm apo i pa-tatueshëm, është vendi ku, në momentin e furnizimit të shërbimeve, ky person banon zakonisht për shkak të lidhjeve personale dhe profesionale apo në rastin e një personi pa lidhje profesionale, për shkak të atyre personale që shprehen me lidhjet e ngushta të këtij të fundit dhe vendit ai ku banon.

Vendi i furnizimit të shërbimeve kundrejt një personi të tatueshëm që vepron si i tillë**Rregulli i përgjithshëm**

Bazuar në nenin 24 pika 1 të ligjit, si rregull i përgjithshëm, vendi i furnizimit të shërbimeve përveç atyre të parashikuara në nenin 25, 26 të ligjit (përjashtimet nga rregulli i përgjithshëm), është në Shqipëri, kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm që vepron si i tillë dhe ka në Shqipëri, selinë e veprimtarisë së tij ekonomike apo një vendndodhje të qëndrueshme për të cilën janë kryer shërbimet ose në mungesë të tyre, ka banesën ose rezidencën e zakonshme.

Përndryshe, vendi i furnizimit të shërbimit nuk ndodhet në Shqipëri, kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm që vepron si i tillë në një vend jashtë Republikës së Shqipërisë, pra marrësi nuk është i vendosur në Shqipëri.

Për çdo shërbim të kryer nga një person i tatueshëm për një person tjetër të tatueshëm që nuk është i renditur si rast përjashtimor në asnjërin nga nenet 25 dhe 26 të ligjit, vendi i furnizimit të shërbimit përcaktohet sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar në nenin 24 pika 1 të ligjit, duke përcaktuar si vendin e furnizimit të shërbimit vendin e marrësit të shërbimit. Kështu vendi i shërbimit është në Shqipëri kur marrësi i tij person i tatueshëm është në Shqipëri.

Cilat shërbime bëjnë pjesë në këtë rregull?

Shërbimet e parashikuara në këtë dispozitë janë të gjitha shërbimet që nuk përfshihen në rastet që bëjnë përjashtim nga ky rregull përkatësisht shërbimet e përmendura në nenet 25, 26 të ligjit, shërbime për të cilat vendi i furnizimit të shërbimit përcaktohet rast pas rasti siç parashikohet në secilin nen të ligjit.

Kështu kur shërbimi kryhet ndërmjet dy personave të tatueshëm, personi i tatueshëm furnizues është jashtë Shqipërisë dhe personi i tatueshëm marrës i shërbimit në Shqipëri, vendi i furnizimit të shërbimit është në Shqipëri, sepse aty është vendosur marrësi i shërbimit.

Kështu kur shërbimi kryhet ndërmjet dy personave të tatueshëm, personi i tatueshëm furnizues është në Shqipëri dhe personi i tatueshëm marrës i shërbimit jashtë Shqipërisë, vendi i furnizimit të shërbimit nuk është në Shqipëri, sepse marrësi i shërbimit nuk është i vendosur në Shqipëri.

Kur shërbimi i furnizohet një vendndodhje të qëndrueshme të marrësit (dege), e cila ndodhet në Shqipëri ndërkohë që selia e shoqërisë ndodhet jashtë Shqipërisë (p.sh. në Kosovë), furnizimi tatohet atje ku ndodhet vendndodhja e qëndrueshme, pra në Shqipëri.

Në rastin kur vendi i tatimit është në vendin e marrësit të shërbimit dhe marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm jashtë Shqipërisë, atëherë shërbimi nuk tatohet me TVSH-në në Shqipëri. Në faturën e TVSH-së të lëshuar nga furnizuesi ku jepet përshkrimi i saktë i llojit të shërbimit të furnizuar dhe të dhënat e qarta të marrësit të shërbimit nuk llogaritet TVSH, pasi ky shërbim nuk është objekt i aplikimit të tatimit në Shqipëri. Në faturë duhet të shënohet neni i ligjit, të cilit i referohet trajtimi i shërbimit pa TVSH. Është kusht që të jepet përshkrimi i plotë i shërbimit në faturë.

Për përcaktimin e vendit të furnizimit të shërbimit, në vendin e marrësit të shërbimit, furnizuesi është i detyruar të provojë që shërbimi i është furnizuar një personi të tatueshëm që nuk është i vendosur në Shqipëri, pra marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm për TVSH-në që vepron si i tillë jashtë Shqipërisë, referuar kuptimit të nocionit të personit të tatueshëm sipas dispozitave të nenit 23 të ligjit.

Në çdo rast kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm i TVSH-së jashtë Shqipërisë, atëherë, për të përcaktuar vendin e tatimit të furnizimit të shërbimeve, furnizuesi një person i tatueshëm i vendosur në Shqipëri, duhet të marrë dhe disponojë informacionet e nevojshme nga marrësi i shërbimit duke siguruar në një nivel të arsyeshëm verifikimin e këtyre informacioneve.

Dokumentacioni i nevojshëm është:

Kontrata për shërbimin ku të identifikohet qartë emri i personit të tatueshëm, të dhënat e tij identifikuese, si dhe të identifikohet vendndodhja e qëndrueshme si marrës shërbimesh;

Vërtetim nga autoritetet tatimore të vendit të marrësit të shërbimit ku të shprehet qartë që personi i tatueshëm është i regjistruar për TVSH-në dhe numri i identifikimit të TVSH-së së personit të tatueshëm është aktiv;

Elementet e pagesës nëpërmjet llogarisë bankare, nga llogaria e personit të tatueshëm furnizues në llogarinë e personit të tatueshëm marrës të shërbimit, të identifikuar nominalisht me të dhënat e shoqërisë;

Në faturën e shërbimit që furnizuesi do të lëshojë për personin e tatueshëm marrës të shërbimit duhet të evidentojë të dhënat e sakta dhe të plota që kërkon fatura si p.sh. emrin e personit të tatueshëm me të cilin është identifikuar blerësi pranë autoritetit tatimor të vendit të tij, nr. e identifikimit të TVSH-së, si dhe adresën e saktë të vendndodhjes së qëndrueshme ose selisë së përhershme së cilës i është kryer shërbimi;

Në faturë duhet të jepet përshkrimi i plotë i shërbimit të kryer dhe të shënohet neni i ligjit, të cilit i referohet trajtimi i shërbimit.

Furnizuesi ngarkohet të mbledhë çdo element tjetër që vërteton se marrësi i furnizimit të shërbimit vepron si person i tatueshëm.

Me qëllim zbatimin me korrektësi të rregullave të vendit të furnizimit të shërbimit, sipas ligjit është përgjegjësi e furnizuesit të shërbimit të sigurohet për cilësinë e marrësit të shërbimit si person i tatueshëm i identifikuar për TVSH-në në vendin e tij dhe është detyrim i tij të verifikojë dhe ti provojë autoritetit të tij tatimor vlefshmërinë e numrit të identifikimit të marrësit të shërbimit.

Në të kundërt, në çdo rast kur furnizuesi i shërbimit një person i tatueshëm i vendosur në Shqipëri, nuk është në gjendje të vërtetojë sa më sipër, pra të tregojë që vepron në kushtet e pikës 1, të nenit 24 të ligjit, sipas së cilës furnizimi i shërbimit i është ofruar një personi të tatueshëm të identifikuar për TVSH-në jashtë Shqipërisë, atëherë vendi i furnizimit të shërbimit është në vendin e furnizuesit të shërbimit në Shqipëri në përputhje me pikën 2, të nenit 24 të ligjit.

Kur marrësi i furnizimit të shërbimit është një person i tatueshëm në kuptim të nenit 3 dhe nenit 23 të ligjit, i vendosur në Shqipëri për furnizimet e shërbimit të marra jashtë Shqipërisë vendi i furnizimit të të cilave është në vendin e marrësit të shërbimit, vendi i tatimit përcaktohet të jetë në Shqipëri dhe marrësi i furnizimit duhet të aplikojë TVSH-në në Shqipëri në përputhje me nenin 99 pika 2 dhe nenin 86 pika 2 të ligjit dhe përcaktimeve në këtë udhëzim.

Për këtë marrësi i shërbimit lëshon një faturë tatimore në të cilën do të llogarisë TVSH-në mbi vlerën totale të faturës së marrë nga furnizuesi i shërbimit. Fatura duhet të përpilohet sipas kërkesave të nenit 101 të ligjit dhe në të duhet të evidentohet dukshëm shënimi siç përcaktohet në pikën II) të nenit 101 të ligjit “Auto-ngarkesë e TVSH-së- reverse charge”.

Marrësi i shërbimit një person i tatueshëm për TVSH-në, për rastet kur vendi i furnizimit është në Shqipëri, auto-ngarkon TVSH-në për furnizime të cilat nëse do të kryheshin brenda vendit do të ishin të tatueshme, jo të përjashtuara nga TVSH-ja.

Shembuj: Marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm në Shqipëri

Shembull 1- A person i tatueshëm i identifikuar për TVSH-në në Francë i kryen një shërbim konsulencë juridike mbi legjislacionin në Francë një personi të tatueshëm B që ka vendndodhjen

e qëndrueshme në Shqipëri. Vlera e shërbimit të kryer është 1000 euro. Bazuar në nenin 24, pika 1 të ligjit vendi i furnizimit të këtij shërbimi është në Shqipëri në vendin ku marrësi B i shërbimit një person i tatueshëm ka vendndodhjen.

B për vlerën e shërbimit të marrë sipas faturës lëshon një faturë tatimore në të cilën sillet sikur e ka kryer vetë shërbimin për vete, në mënyrë që të bëjë të mundur të ngarkojë shërbimin e marrë me TVSH- në Shqipëri prej 20 %. Vlera e transaksionit llogaritet e konvertuar në monedhën shqiptare me kursin e ditës kur lëshohet fatura. P.sh. 1000 euro = 140.000 lekë x 20% = 28.000 lekë është vlera e TVSH-së. Kjo faturë regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjes dhe atë të shitjes së personit të tatueshëm. Në faturë duhet të shkruhet “Auto-ngarkesë e TVSH-së- reverse charge”.

Shembull 2. Në rastin kur personi B, person i tatueshëm për TVSH-në në Shqipëri, merr një shërbim të konsulencës juridike në Francë dhe ndërkohë B është një shoqëri që ofron furnizime shërbimi në fushën e sigurimeve të përjashtuara nga TVSH, bazuar në nenin 53 të ligjit, atëherë ai është pagues i TVSH-së në Shqipëri. B si person i tatueshëm marrës i shërbimit në Shqipëri do të ngarkojë me TVSH në Shqipëri shërbimin e marrë përsa vendi i furnizimit të shërbimit është në vendin e marrësit. Nga ana tjetër ky person nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e këtij shërbimi që i shërben furnizimeve të përjashtuara, të cilat kryen në kuadër të veprimtarisë së tij dhe për pasojë detyrohet të paguajë TVSH-në në Shqipëri.

Shembull 3. Një shoqëri X në Shqipëri i krijon mundësinë një studenti të shkojë të bëjë praktikën në një kompani Y që ka selinë në Austri. Shoqëria austriake Y në përfundim të praktikës ia faturon këtë shërbimin shoqërisë X në Shqipëri për 2.000.000 lekë.

A do të paguajë TVSH-në 20 % për këtë shërbim shoqëria X në Shqipëri?

Shoqëria X do të lëshojë një faturë dhe do të llogarisë TVSH 20% prej 400.000 lekë dhe do të paguajë TVSH-në. Shoqëria X nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e faturës së lëshuar si auto-ngarkesë e TVSH-së- reverse charge, pasi ky shërbim nuk i shërben veprimtarisë ekonomike të shoqërisë. (Kompania X ka sponsorizuar praktikën e një studenti).

2.Furnizuesi në Shqipëri, marrësi i shërbimit një person i tatueshëm jashtë Shqipërisë

Shembull 4. Një person i tatueshëm X i identifikuar për TVSH-në në Shqipëri i kryen një shërbim konsulencë financiare një personi të tatueshëm Z të identifikuar për TVSH-në në Kosovë. Personi i tatueshëm X i lëshon faturë pa llogaritur TVSH-në personit të tatueshëm në Kosovë. Në faturë duhet të shënohen të dhënat e sakta identifikuese të blerësit të shërbimit, si dhe të përshkruhet qartë lloji i shërbimit. Gjithashtu duhet të shkruhet neni i ligjit ku bazohet mos-tatueshmëria e këtij shërbimi në Shqipëri. P.sh. neni 24, pika 1 e ligjit 92/2014, datë 24.07.2014. Këto shitje do të regjistrohen në librin e shitjes dhe deklaratën e TVSH-së në kutinë me emërtimin “shitje pa

TVSH”. Personi i tatueshëm furnizues i shërbimit duhet të provojë që shërbimi i ofrohet një personi të tatueshëm të identifikuar për TVSH-në jashtë Shqipërisë duke siguruar dokumentacionin sipas pikës 2 të këtij neni.

Shembull 5: Furnizuesi i shërbimit është një person i tatueshëm A në Shqipëri, i cili i njeh ose jep të drejtën një personi të tatueshëm B në Malin e Zi, të shërbimit kundrejt pagesës të vënies në dispozicion të kapaciteteve të transmetimit të energjisë për persona të tretë që aksesojnë këto kapacitete transmetimi. Personi i tatueshëm A në Shqipëri i furnizon një shërbim personit të tatueshëm B në Malin e Zi, vendi i furnizimit të të cilit është në vendin ku është vendosur personi i tatueshëm B, pra jashtë Shqipërisë. Ky furnizim shërbimi është i pa-tatueshëm në Shqipëri bazuar në vendin e furnizimit të tatimit sipas rregullit të përcaktuar në nenin 24 pika 1, të ligjit dhe në këtë udhëzim.

Neni 25

Vendi i furnizimit të shërbimeve kundrejt personave të pa-tatueshëm

Rregulli i përgjithshëm

Bazuar në nenin 24 pika 2 të ligjit, vendi i furnizimit për furnizimet e shërbimeve kundrejt një personi të pa-tatueshëm, përveç rasteve përjashtuese të parashikuara në nenet 25, 27, 28, 29, 30 të ligjit, është në të gjitha rastet në Shqipëri, kur shërbimet furnizohen nga furnizuesi, i cili ka në Shqipëri, selinë e aktivitetit të tij ekonomik ose një vendndodhje të qëndrueshme nga e cila kryhet shërbimi, ose në mungesë të tyre banesën apo rezidencën e tij të zakonshme.

Shërbimet e parashikuara në këtë dispozitë janë të gjitha shërbimet që nuk përfshihen në rastet që bëjnë përjashtim nga ky rregull përkatësisht shërbimet e përmendura në nenet 25, 27, 28, 29, 30 të ligjit, shërbime për të cilat vendi i furnizimit të shërbimit përcaktohet rast pas rasti siç përcaktohet në secilin nen dhe lidhet ose me vendin e kryerjes efektive të shërbimit, ose vendi i shërbimit nuk është në vendin e furnizuesit, por në vendin ku ka adresën ose banon personi i pa-tatueshëm marrës i shërbimit.

Në kuptim të nenit 3 dhe nenit 23, të ligjit, persona të pa-tatueshëm, përveç individëve, janë gjithashtu edhe çdo person tjetër që nuk është i pajisur me një numër identifikimi për TVSH-në ose nuk sillet si person i tatueshëm.

Sipas parimit të rregullit të përgjithshëm, siç përcaktohet në nenin 24, pika 2, vendi i furnizimit të shërbimit dhe për pasojë i tatimit është në Shqipëri kur furnizuesi i këtij shërbimi një person i tatueshëm është i vendosur në Shqipëri. Marrësi i shërbimit në këtë rast është një person i pa-tatueshëm.

Ndërkohë përsa i përket shërbimeve të listuara në nenin 29 dhe 30 të ligjit:

Në rastin kur personi i tatueshëm furnizues nuk është i vendosur në Shqipëri, vendi i furnizimit është në Shqipëri në vendin ku shërbimi merret (përdoret).

Në rastin kur personi i tatueshëm furnizues është i vendosur në Shqipëri, vendi i furnizimit është në Shqipëri kur shërbimi përdoret (merret) nga persona të pa-tatueshëm në Shqipëri. Nëse shërbimi merret nga persona të pa-tatueshëm jashtë Shqipërisë vendi nuk është në Shqipëri, por në vendin e marrësit të pa-tatueshëm.

Në rastin kur shërbimet e përcaktuara në nenet 29 dhe 30, të ligjit furnizohen nga një person i tatueshëm për një person të tatueshëm, përsa nuk është rast përjashtimor i parashikuar në ligj, vendi i furnizimit të shërbimit përcaktohet sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar në nenin 24, pika 1, të ligjit sipas të cilit vendi është në vendin e marrësit të shërbimit.

Furnizimet e shërbimeve që i furnizohen personave juridikë të së drejtës publike vendosur jashtë Shqipërisë, nga një person i tatueshëm në Shqipëri, i nënshtrohen normalisht TVSH në Shqipëri nëpërmjet furnizuesit të shërbimit. Nëse këta persona të së drejtës publike nuk kanë cilësinë e personit të tatueshëm në vendin e tyre. Përndryshe këto shërbime nuk tatohen në Shqipëri.

Gjithashtu furnizimet e shërbimeve që i furnizohen personave juridikë të së drejtës publike të vendosur në Shqipëri, prej një personi të tatueshëm jashtë Shqipërisë, sipas parimit që shërbimi tatohet në vendin e marrësit të shërbimit, i nënshtrohen normalisht TVSH-në Shqipëri kur këta persona të së drejtës publike bëhen persona të tatueshëm për TVSH-në në Shqipëri, përse edhe përdorimi i këtyre shërbimeve kryhet në territorin e Shqipërisë.

Në të kundërt, nëse marrës i shërbimit një person juridikë i së drejtës publike nuk bëhet person i tatueshëm në Shqipëri dhe si i tillë konsiderohet person i pa-tatueshëm paguan TVSH-në në Shqipëri për çdo shërbim të marra nga jashtë Shqipërisë të listuar në nenin 29 dhe 30 të ligjit. Për shërbimet e tjera që nuk listohen në këto nene, vendi i furnizimit të shërbimit është në vendin e furnizuesit dhe TVSH paguhet në vendin e furnizuesit të shërbimit, jashtë Shqipërisë.

Furnizimi i shërbimeve elektronike kundrejt personave të pa-tatueshëm

Në zbatim të nenit 29 të ligjit, vendi i furnizimit të shërbimeve të telekomunikacionit, të transmetimit dhe shërbimeve elektronike ndaj personave të pa-tatueshëm, shërbime këto furnizuar (kryer) nga persona të tatueshëm me vendndodhje në Shqipëri ose jo, janë në Shqipëri kur realizohen në përfitim të personit të pa-tatueshëm që është vendosur apo ka banesën e tij të zakonshme në Shqipëri.

Tabelë përmbledhëse e shërbimeve të furnizuara në rrugë elektronike, bazuar në nenin 29 dhe 30 të ligjit, kundrejt personave të pa-tatueshëm

	Vendikuështë vendosur furnizuesi	Vendi ku është vendosur marrësi i pa-tatueshëm i shërbimit	Vendi i tatimit
Nenet 29, 30 të ligjit 92/2014, datë 24.07.2014	Në Republikën e Shqipërisë	Jashtë Shqipërisë	I pa-tatueshëm në Shqipëri
	Jashtë Shqipërisë	Në Shqipëri	I tatueshëm në Shqipëri

Në zbatim të nenit 29 dhe 30 të ligjit vendi i furnizimit të shërbimeve të përcaktuara në këto dispozita, furnizuar personave të pa-tatueshëm, është në Shqipëri, përveç se kur furnizuesi i shërbimit, një person i tatueshëm në Shqipëri është në gjendje të vërtetojë dhe dokumentojë në çdo formë e me çdo mjet, se personat e pa-tatueshëm marrës të furnizimit janë vendosur jashtë Shqipërisë dhe këto shërbime efektivisht janë përdorur dhe shfrytëzuar prej tyre jashtë Shqipërisë, në adresën e përhershme apo ku banon zakonisht.

Në të kundërt kur shërbimi është marrë nga persona të pa-tatueshëm në Shqipëri, (në adresën e tyre të përhershme apo ku zakonisht banojnë), vendi i furnizimit të shërbimeve të përcaktuara në dispozitat e nenit 29 dhe 30 të ligjit, është në Shqipëri dhe këto shërbime duhet të tatohen me TVSH në Shqipëri.

Këtu përfshihen shërbimet e mëposhtme:

transferimet dhe koncesionet e të drejtave të autorit, patentave, licencave, markave të prodhimit dhe të drejtave të tjera të ngjashme;

qiradhëniet e mallrave të luajtshme të trupëzuara, me përjashtim të mjeteve të transportit;

shërbime publiciteti;

shërbimet e konsulentëve, avokatëve, inxhinierëve, zyrave projektuese në të gjitha fushat, llogaritarëve;

përpunimi i të dhënave dhe dhënia e informacionit;

transaksionet bankare, financiare dhe të sigurimit apo të ri-sigurimit, me përjashtim të qiradhënies së kasafortave;

furnizimi me personel;

detyrimet për të mos ushtruar, qoftë edhe pjesërisht, një aktivitet profesional apo një të drejtë të parashikuar në nenin 30 të ligjit;

shërbimet e telekomunikacionit;

shërbime transmetimi radio-televizive janë: çdo transmetim tingujsh apo imazhesh, me përjashtim të imazheve që konsistojnë kryesisht në gërma, shifra apo imazhe fikse, të arritshme në kohë reale dhe në mënyrë të njëkohshme dhe identike për gjithë publikun apo një kategori të tij, përbën një shërbim transmetimi radio-televiziv;

shërbime të furnizuara në mënyrë elektronike si web-site, web-hosting, mirëmbajtje në distancë e programeve, soft-ware;

shërbimet e lejit të aksesit në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes të gazit natyror dhe energjisë elektrike, si dhe gjithë shërbimet e tjera që lidhen drejtpërdrejtë me to, etj

Të tjera shërbime që nuk lidhen me vendin ku është i vendosur furnizuesi ose marrësi i shërbimit, por me vendin ku kryhet efektivisht shërbimi.

Vendi i furnizimit të shërbimit për shërbimet që përmenden në nenin 25 të ligjit, nuk është i lidhur me vendin ku është i vendosur personi i tatueshëm që jep apo merr shërbimin dhe as me cilësinë e këtyre personave.

Si përjashtim, nga rregulli i përgjithshëm që parashikohet në nenin 24 të ligjit, përcaktimi i vendit të tatimit të shërbimeve të listuara më poshtë, kryhet në funksion të kriterëve të tjera, p.sh. të vendit të kryerjes faktikisht të tyre, pavarësisht cilësisë së marrësit të shërbimit:

qiradhëniet afatshkurtra të mjeteve të transportit;

shërbimet që lidhen me një pasuri të paluajtshme;

furnizimet e transportit të pasagjerëve;

shërbimet e furnizuara një personi të pa-tatueshëm që kanë si qëllim aktivitetet kulturore, artistike, sportive, shkencore, edukative, zbavitëse apo aktivitete të ngjashme të tilla si panairët dhe ekspozitat, përfshirë shërbimet e organizatorëve të aktiviteteve të tilla, si dhe shërbimet mbështetëse të këtyre aktiviteteve;

shitjet që konsumohen në vend;

shërbimet e furnizuara personave të tatueshëm përfshirë dhe shërbimet mbështetëse të cilat lejojnë aksesin në aktivitetet kulturore, artistike, sportive, shkencore, edukative, zbavitëse apo aktivitete të ngjashme të tilla si panairët dhe ekspozitat;

shërbimet e agjencive të udhëtimit;

Pavarësisht nëse këto shërbime furnizohen nga një person i tatueshëm në Shqipëri ose jashtë saj, dhe pavarësisht se nëse personi që merr shërbimin është person i tatueshëm ose jo, i vendosur ose jo në Shqipëri, vendi i furnizimit të tyre dhe për pasojë vendi i tatimit është në Shqipëri, në vendin ku ndodhet pasuria, ku kryhet efektivisht shërbimi, ku kryhet fizikisht shërbimi, ose ku vihet në dispozicion mjeti që kryen shërbimin, etj., sipas llojit të shërbimit të përcaktuar në nenin 25 të ligjit.

Nocioni i përdorimit apo shfrytëzimit efektiv

Kriteret e përdorimit apo shfrytëzimit “faktikisht” dhe “fizikisht” marrin në konsideratë natyrën e çdo shërbimi të parashikuar në nenet 25,26,27,28 dhe kushtet sipas të cilave përdoret apo shfrytëzohet secili nga shërbimet e përcaktuara në këto nene, të cilat duhet të analizohen rast pas rasti.

Për të sqaruar kuptimin përmendim shembujt e mëposhtëm:

a) Kështu shërbimet e publicitetit janë kryer në Shqipëri kur vendi nga i cili shpërndahen spotet publicitare për një publik të synuar ndodhet në Shqipëri. I tillë është rasti për shembull i një fushate publicitare që kryhet me anë të afisheve kur tabelat publicitare vendosen në Shqipëri apo në rastin e një fushate për shtyp kur media e shkruar shpërndahet kryesisht në Shqipëri apo dhe në kuadrin e një fushate audio-vizuale kur media transmeton duke pasur si destinacion publikun në Shqipëri.

Fakti që media mund të kapet përtej Shqipërisë nuk ndikon, në rastin kur publiku i synuar ndodhet efektivisht në Shqipëri.

b) Shërbimet e telekomunikacionit të furnizuara me anë të një linje konsiderohen se përdoren efektivisht në Shqipëri kur telefoni i klientit që emeton komunikacionin ndodhet në këtë vend. Në rastin e një telefoni celular, përdorimi apo shfrytëzimi efektiv prezumohen të jenë në Shqipëri kur karta SIM është shitur në këtë vend.

Vendi i përdorimit apo shfrytëzimit efektiv të shërbimeve të transmetimit radio-televizive, të cilat i mundësojnë klientit të shoh transmetimet televizive apo të dëgjojë radio është në Shqipëri, kur aparatet e marrësit që mundësojnë përfitimin e shërbimeve ndodhen në këtë vend, çka përkon në shumë raste me vendin e një pasurie të paluajtshme ku furnizohet akses në këto shërbime.

Bazuar në nenin 27 të ligjit vendi i furnizimit të shërbimeve të realizuara nga ndërmjetësit që veprojnë në emër dhe për llogari të një personi tjetër është në Shqipëri nëse vendi i shërbimit kryesor për të cilin ndërmjetëson ndërmjetësi është në Shqipëri. Vendi i furnizimit të shërbimit kryesor përcaktohet sipas rregullave të përcaktuara në nenet 23 deri 30 të ligjit.

Shembull: Një ndërmjetës nga Kosova vepron në emër dhe për llogari të zonjës me initiale A.B që banon në Maqedoni, tek një transportues person i tatueshëm në Shqipëri për realizimin e transportit të mallrave të apartamentit të zonjës A.B nga apartamenti i saj në Vlorë tek të afërmit e saj në Maqedoni. Vendi i furnizimit të shërbimit të transportit të mallrave që realizohet nga transportuesi, sipas nenit 28, pika a) është në Shqipëri në funksion të distancës së përshkuar. Shërbimi i ndërmjetësimit është gjithashtu i tatueshëm në Shqipëri në të njëjtin proporcion.

Nga ana tjetër, për përcaktimin e vendit të një aktiviteti ndërmjetësimi, nuk ka rëndësi fakti nëse operacioni kryesor është i tatueshëm me TVSH apo nëse është i pa-tatueshëm. Vendi i operacionit kryesor përcaktohet nga kriteret që merren në konsideratë për operacionet me të njëjtën natyrë që ndodhen në fushën e zbatimit të TVSH-së.

Në rastet kur furnizuesi dhe klienti i shërbimit komunikojnë në rrugë elektronike, kjo nuk do të thotë që shërbimi është furnizuar në rrugë elektronike

Shërbimet e furnizuara në rrugë elektronike konsiderohen ato shërbime të cilat nuk përkojnë as me furnizimin e mallrave të luajtshme të trupëzuara, as me furnizimin e shërbimeve “tradicionale”, as me shërbimet e telekomunikacionit.

Furnizimi i një malli të luajtshëm të trupëzuar, porosia e të cilit kryhet në rrugë elektronike dhe sjell si pasojë furnizimin material të mallit, në rrugë postare për shembull, i nënshtrohet të gjitha rregullave të territorialitetit për operacionet që lidhen me mallrat, veçanërisht atyre në lidhje me furnizimet, shitjet në distancë apo eksporteve dhe importeve. I tillë është rasti për shembull i një malli të porositur me internet dhe që i dorëzohet fizikisht klientit. Këtu përfshihen gjithashtu të gjitha mallrat e prodhuara në seri si gazeta, disketa, CD-ROM, kaseta audio/video, DVD, lojëra, etj.), të cilat mbërrijnë tek klienti në një suport material. Ato i nënshtrohen rregullave përkatëse të TVSH-së.

Me shërbime “tradicionale” kuptohen shërbimet e arritshme me mënyra të tjera komunikimi, për të cilat mënyra elektronike është veçse një vektor shpërndarje ashtu siç është një suport i shkruar, telefonik apo telematik. Këto shërbime i nënshtrohen regjimit përkatës të TVSH-së.

Neni 26

Vendi i furnizimit të shërbimeve që lidhen me një pasuri të paluajtshme

1. Bazuar në nenin 25 të ligjit, furnizimi i shërbimeve që lidhen me një pasuri të paluajtshme, përfshirë shërbimet e ekspertëve dhe agjentëve imobiliarë, furnizimi i strehimit në sektorin hotelier apo në sektorë që kanë funksion të ngjashëm me të si kampe pushimi ose zona të rregulluara për t’u përdorur si vende kampingu, dhënia e të drejtave të përdorimit të pasurive të paluajtshme dhe shërbimet për përgatitjen dhe bashkërendimin e punimeve të ndërtimit, të tilla si shërbimet e arkitektëve dhe ndërmarrjeve që mbikëqyrin zbatimin e punimeve, janë të tatueshme në Shqipëri, nëse pasuria e paluajtshme ndodhet në Shqipëri.

Përveç truallit, i cili konsiderohet si një pjesë e përcaktuar e sipërfaqes së tokës, përbëjnë “pasuri të paluajtshme” ndërtimet e trupëzuara në tokë, përfshirë dhe pjesët mbështetëse të tyre (si për shembull kanalizimet, tubacionet, kabllot), kur ato nuk mund të çmontohen dhe as të zhvendosen me lehtësi.

Kështu, edhe një mall që nuk është i trupëzuar në mënyrë të pandashme me tokën, mund të përmbajë një karakter të paluajtshëm.

Si shërbime të parashikuara shprehimisht nga ligji si të tatueshme në vendin ku ndodhet pasuria e paluajtshme përfshihen shërbimet e parashikuara në nenin 25 të ligjit.

Si shërbime të një natyre të tillë përmenden:

punimet e ndërtimit të çdo lloji,

shërbimet e ekspertëve dhe agentëve imobiliarë, si:

shërbimet e vlerësimit të pasurive të paluajtshme,

shërbimet e ndërmjetësimit në blerje, në shitje apo në qiradhënien e pasurive të paluajtshme nga agentët imobiliarë,

shërbimet për ndarjen apo kufizimin e pasurisë;

furnizimi i strehimit në sektorin hotelier apo në sektorë të ngjashëm me të;

dhënia e të drejtave të përdorimit të pasurive të paluajtshme ku përfshihen:

qiradhëniet e pasurisë së paluajtshme për përdorim banimi, industrial, tregtar apo bujqësor,

të drejtat e përdorimit të rrugëve të komunikacionit dhe veprave të artit,

transferimet apo koncesionet e të drejtave të gjuetisë apo të peshkimit në një pjesë të përcaktuar të territorit;

shërbimet e magazinimit, ruajtjes së përkohshme të mobilieve të zyrës e të tjera mjete; P.sh. *Një shoqëri në Shqipëri vë në dispozicion të një shoqërie me seli në Kosovë një ambient të rregulluar për përdorim zyrash në një ndërtesë të saj në Shqipëri, kundrejt një shpërblimi, ose një ambient për të vendosurmobiljet e saj dhe i lë ato në ruajtje. Ky është një furnizim shërbimi që është i lidhur me pasurinë e paluajtshme në Shqipëri. TVSH-ja duhet të faturohet nga furnizuesi në Shqipëri dhe vlera e tatueshme përbëhet nga të gjitha shumat e marra si kundërvlerë e vënies në dispozicion të ndërtesës.*

shërbimet për përgatitjen dhe bashkërendimin, supervizimin e punimeve të ndërtimit; projektimet, punimet e ndërtimit e të pajisjes, rikonstruksionit e mirëmbajtjes, supervizime, ekspertiza të lidhura me pasuritë e paluajtshme;

Bazuar në këtë dispozitë, lidhen me pasurinë e paluajtshme shërbimet e arkitektëve të cilat konsistojnë në konceptimin e projekteve të pasurive të paluajtshme që nga faza e tenderimit apo në zbatimin e tyre kur projekti është miratuar. Këtu përfshihen gjithashtu dhe shërbimet që vijnë si pasojë e ndërtimit, si shërbimet e gjeometrave, zyrave projektuese, mbikëqyrëse për pasuritë e paluajtshme, etj.

Përveç këtyre shërbimeve, konsiderohen si shërbime që kanë një lidhje mjaft të ngushtë me pasurinë e paluajtshme shërbimet e mëposhtme, lista e të cilave nuk është shteruese:

shërbimet e pastrimit të pasurisë së paluajtshme;
shërbimet e ruajtjes/mbikëqyrjes së pasurisë paluajtshme;
shërbimet e riparimit dhe të mirëmbajtjes të pasurisë paluajtshme;
shërbimet e ekspertëve në lidhje me vlerësimin e dëmeve dhe dëmshpërblimet e caktuara për riparimin e dëmeve të shkaktuara pasurisë së paluajtshme, etj.

Gjithashtu, përveç shërbimeve të parashikuara shprehimisht në nenin 25, pika a) të ligjit, si shërbime që lidhen me një pasuri të paluajtshme, bëjnë pjesë dhe shërbimet që paraqesin një lidhje mjaft të ngushtë me pasurinë e paluajtshme.

Kështu do të konsiderohen se kanë një lidhje mjaft të ngushtë me pasurinë e paluajtshme shërbimet për të cilat pasuria e paluajtshme përbën një element qendror dhe të domosdoshëm të furnizimit. Për këtë qëllim, shërbimet që kanë si qëllim të modifikojnë fizikisht apo juridikisht një pasuri të paluajtshme, paraqesin një lidhje mjaft të ngushtë me pasurinë e paluajtshme me të cilën lidhen.

Konsiderohen si shërbime që modifikojnë fizikisht një pasuri e paluajtshme, punimet e ndërtimit, të shkatërrimit, të riparimit, të rinovimit, të përmirësimit, të transformimit, të rregullimit që lidhen me një pasuri të paluajtshme të ndërtuar apo të pandërtuar (rregullimi i kopshteve, nivelimi i terrenit).

Konsiderohen si shërbime që modifikojnë juridikisht një pasuri e paluajtshme, përpilimi i akteve dhe marrëveshjeve me anë të të cilave pranohen të drejtat reale apo personale për një pasuri të paluajtshme (hartimi i akteve të pronësisë, i kontratave të qiradhënies).

Në të kundërt, konsiderohen si shërbime që nuk e modifikojnë juridikisht pasurinë e paluajtshme, shërbimet e konsulencës juridike para hartimit të një kontrate shitje të një pasurie të paluajtshme, e cila p.sh. ka si synim të përcaktojë regjimin tatimor që zbatohet në operacionin e parashikuar apo të vlerësojë kushtet në të cilat mund të realizohet transferimi i mallit të paluajtshëm.

Shembull 1: Shërbimi i konsulencës për zbatimin e një skeme për pagimin e tatimit dhe që ka si qëllim blerjen e një malli të paluajtshëm, nuk konsiderohet i lidhur me pasurinë e paluajtshme dhe për pasojë nuk është i tatueshëm në vendin ku ndodhet malli i paluajtshëm për të cilin është parashikuar blerja.

Shembull 2: Një person i tatueshëm në Shqipëri kryen një furnizim shërbimi vlerësim të një pasurie të paluajtshme që është e vendosur në Kosovë. Pasuria e paluajtshme nuk ndodhet në Shqipëri kështu që vendi i furnizimit të këtij shërbimi nuk është në Shqipëri. Personi i tatueshëm

nëShqipëri nuk do tëllogarisë TVSH-në në faturën e lëshuar për personin e tatueshëm në Kosovë për shërbimin e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme. Ky person që të justifikojë mosllogaritjen tatimit në çdo rast duhet të provojë dhe dokumentojë që shërbimi është kryer në Kosovë për një pasuri të vendosur atje.

Shembull 3: Një person i tatueshëm nëShqipëri kryen një projekt për ndërtimin e një ndërtese në lidhje me një pasuri të paluajtshme nëShqipëri. Shërbimi i është porositur nga një shoqëri e vendosur në Itali. Pavarësisht se ku është vendosur marrësi i shërbimit person i tatueshëm, në këtë rast vendi i furnizimit të shërbimit është nëShqipëri në vendin ku ndodhet pasuria e paluajtshme, kështu që furnizuesi i shërbimit do të lëshojë një faturë me TVSH 20 % marrësit të shërbimit person i tatueshëm në Itali. Furnizuesi i shërbimit duhet të paguajë TVSH në Shqipëri.

Shembull 4. Një person i tatueshëm në Maqedoni i kërkon një agjencie imobiliare në Kosovë të ndërmjetësojë për marrjen me qira të një ndërtese për qëllime të një panairi në Shqipëri. Agjencia imobiliare në Kosovë, i lëshon faturë shoqërisë në Maqedoni për shërbimin e ndërmjetësimit për qiramarrjen e ndërtesës nëShqipëri. Vendi i furnizimit tëshërbimit, përse ka të bëjë me qiradhënien e një ndërtese pasuri e paluajtshme nëShqipëri, është nëShqipëri kështu që Agjencia Imobiliare në Kosovë duhet tëcaktojë një përfaqësues tatimor nëShqipëri për të paguar TVSH-në për shërbimin nëShqipëri.

Shembull 5. Një shoqëri e vendosur në Greqi i kryen shërbimin e mirëmbajtjes së një pasurie të paluajtshme një personi të tatueshëm, shoqëri e vendosur nëShqipëri. Vendi i furnizimit të këtij shërbimi është nëShqipëri në vendin ku ndodhet pasuria e paluajtshme dhe vendi i tatimit është nëShqipëri. TVSH-ja do të paguhet nëShqipëri nëpërmjet auto-ngarkesës së TVSH-së, (reverse-charge) nga marrësi i shërbimit personi i tatueshëm në Shqipëri.

Shembull 6. Një person i tatueshëm A në Gjermani i kontraktuar nga një person i tatueshëm B i vendosur në Francë i kryen këtij të fundit një shërbim projektimi mbi ndërtimin e një qendre sportive nëShqipëri. Personi i tatueshëm B është kontraktuar për kryerjen e këtij shërbimi nga Federata Shqiptare e Lojërave me Dorë.

Personi i tatueshëm B në Francë pasi merr shërbimin prej shoqërisë gjermane A, ia faturon atë Federatës Shqiptare të Futbollit. Shërbimi i kryer është projektimi i qendrës sportive në Tiranë. Vendi i furnizimit të këtij shërbimi që ka lidhje me pasurinë e paluajtshme nëShqipëri është nëShqipëri. Kështu që shoqëria gjermane kërkohet të emërojë një përfaqësues tatimor nëShqipëri dhe të paguajë TVSH-në në Shqipëri. Shoqëria franceze gjithashtu emëron një përfaqësues tatimor nëShqipëri dhe paguan TVSH-në nëShqipëri për shërbimin që i furnizon Federatës Shqiptare. Në mungesë të emërimit të një përfaqësuesi tatimor përgjegjës për të paguar TVSH-në në Shqipëri është Federata Shqiptare e Lojërave me Dorë.

Neni 27

Përfaqësuesi tatimor

1. Pagesa e TVSH-së nëpërmjet përfaqësuesit tatimor

Sipas parimit të përgjithshëm të përcaktuar në nenin 86 të ligjit personi përgjegjës për të paguar TVSH-në në Shqipëri është personi i tatueshëm që furnizon shërbimin. Në rastin kur ky person nuk është i regjistruar për TVSH-në në Shqipëri dhe personi që e ka marrë shërbimin është një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në në Shqipëri, atëherë është marrësi i shërbimit personi përgjegjës për të paguar TVSH-në. Ky person e paguan TVSH-në duke aplikuar ngarkesën e kundërt (reverse-charge) siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 86 të ligjit.

Nëse marrësi i këtij shërbimi nuk është një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në në Shqipëri atëherë personi i tatueshëm që ka kryer shërbimin cakton një përfaqësues tatimor për të paguar TVSH-në në Shqipëri.

Kështu, bazuar në nenin 87 dhe 88 të ligjit, në rastin kur vendi i furnizimit të shërbimit është në Shqipëri, por furnizuesi i këtij shërbimi (person përgjegjës për pagesën e TVSH-së) është një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në Shqipëri, vend në të cilin duhet të paguhet TVSH-ja, ky person cakton një përfaqësues tatimor për të paguar TVSH-në, përveçse kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm në Shqipëri.

Për çdo shërbim të tatueshëm vendi i furnizimit të të cilit përcaktohet të jetë në Shqipëri referuar dispozitave të neneve 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit, kur furnizuesi i shërbimit është një person që nuk është i regjistruar në Shqipëri, ndërsa marrësi i shërbimit është ose një person i pa-tatueshëm në Shqipëri, ose një person që nuk është i regjistruar për TVSH-në në Shqipëri, ose një person i vendosur jashtë Shqipërisë, furnizuesi sipas nenit 87 dhe 88 të ligjit detyrohet të emërojë një përfaqësues tatimor për të paguar TVSH-në në Shqipëri.

Në të kundërt nëse TVSH-ja nuk paguhet prej përfaqësuesit tatimor për rastet e mësipërme, detyrohet ta paguajë TVSH-në në Shqipëri marrësi i shërbimit, i cili ka banesën e përhershme ose zakonisht banon në Shqipëri.

Shembull 1: Një shoqëri italiane i bën mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit të një shtëpie banimi në Shqipëri individit X që banon në Shqipëri. Shoqëria Italiane duhet të emërojë një përfaqësues tatimor për të paguar TVSH-në në Shqipëri për vlerën e shërbimit. Në mungesë të emërimit të një përfaqësuesi tatimor në momentin që konstatohet, TVSH-në e paguan individit X që banon në Shqipëri.

Shembull 2. Një grup artistik këngëtarësh rroku jep shfaqje në Shqipëri dhe të ardhurat nga biletat e hyrjes për të parë shfaqjen i përfiton menaxheri i grupit në emër të grupit të rrokut. Vendi i këtij koncerti është në Shqipëri, bazuar në nenin 28, pika b) të ligjit. Shërbimi i ofrohet personave të pa-tatueshëm, individëve që blejnë biletat për të parë shfaqjen. Për këtë shërbim vendi i të cilit është në Shqipëri atje ku shërbimi kryhet faktikisht, grupi i rrokut duhet të paguajë TVSH-në në Shqipëri. Paga e TVSH-së në këtë rast bëhet nëpërmjet një përfaqësuesi tatimor.

2. Modalitetet e përfaqësuesit tatimor

Personi që caktohet si përfaqësues tatimor, duhet të jetë një person i tatueshëm në Shqipëri. Për qëllime të përmbushjes së detyrimit si përfaqësues tatimor çdo person i tatueshëm që caktohet si i tillë duhet të regjistrohet më vete me një numër identifikimi tëri si përfaqësues tatimor. Ky person i emëruar si përfaqësues tatimor është personalisht përgjegjës, për të përmbushur të gjitha detyrimet, përfshirë çdo gjë a dënim, për të cilat detyrohet personi që përfaqëson dhe gëzon gjithashtu të gjitha të drejtat e personit që përfaqëson. Nëse personi që detyrohet, nuk emëron një përfaqësues tatimor, të gjitha detyrimet dhe penaltetet në ngarkim të tij do të paguhet nga përfituesi vendas i furnizimit.

Procedura për regjistrimin dhe çregjistrimin e përfaqësuesit tatimor zbatohet siç është përcaktuar në ligjin dhe udhëzimin për procedurat tatimore në RSH. Personat që regjistrohen si përfaqësues tatimor përmbushin detyrimet në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit (librave të shitjes dhe librave të blerjes), deklaratimit, faturimit, etj., siç do person tjetër i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në.

Në rastin kur personi i tatueshëm marrës i furnizimit është një tatimpagues që nuk është i regjistruar për TVSH-në, për shembull është një tatimpagues që i nënshtrohet regjimit të biznesit të vogël ose është një institucion ose organ publik që nuk është i regjistruar për TVSH-në, ose një individ, kërkohet emërimi i një përfaqësuesi tatimor për të paguar TVSH-në. Në mungesë të emërimit të një përfaqësuesi tatimor, atëherë përfituesi vendas i shërbimit është përgjegjës për të paguar TVSH-në.

Neni 28

Lindja e tatimit, Kërkueshmëria Momenti i lëshimit të faturës tatimore

Bazuar në nenin 31 të ligjit, TVSH-ja lind kur përmbushen kushtet ligjore të domosdoshme për të kërkuar tatimin mbi vlerën e shtuar. Autoriteti tatimor duke filluar nga momenti i përcaktuar me ligj sipas ngjarjes së ndodhur, moment në të cilin lind TVSH-ja ka të drejtë që t'ia kërkojë atë personit përgjegjës që ngarkohet nga ligji për ta paguar.

Kushtet ligjore për lindjen e TVSH-së.

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit, kushtet ligjore për lindjen e TVSH-se përmbushen kur:

Kryhet furnizimi i mallrave ose shërbimeve;

kryhen pagesa pjesore ose pagesa të njëpasnjëshme për furnizimet e mallrave ose të shërbimeve, por furnizimi i mallrave ose shërbimeve faktikisht nuk është kryer, këto furnizime mallrash ose shërbimesh konsiderohen të kryera në përfundim të çdo periudhe, së cilës i referohen pagesat. (P.sh. leasing).

Nga ky rregull bëjnë përjashtim rastet kur kryhen pagesa pjesore ose pagesa të njëpasnjëshme për furnizimet e mallrave që kanë si objekt qiradhënien e një malli për një periudhë të caktuar ose shitjen e mallrave, sipas pagesave me këste, siç përcaktohet në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji, furnizime mallrash për të cilët TVSH lind kur furnizimi i mallrave kryhet (për shembull, shitja e mallrave me kredi, ose pagesa me këste, shitja me rezervë).

Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të kryera në mënyrë të vazhdueshme, brenda një periudhe kohore, përfshirë operacionet e ndërtimit, konsiderohen të kryera në të njëjtin muaj, në të cilin lëshohet fatura në përputhje me pikën 5, të nenit 99, të ligjit.

Shembuj të furnizimit të mallrave dhe furnizimit të shërbimeve në mënyrë të vazhdueshme përmenden p.sh: shërbimet e vazhdueshme të telefonisë, furnizimi në mënyrë të vazhdueshme i energjisë elektrike, furnizimi në mënyrë të vazhdueshme me ujë nëpërmjet rrjetit etj., furnizime të një natyre të tillë që malli ose shërbimi lëvrohet ose kryhet në mënyrë të vazhdueshme (të pandërprerë), por sipas rregullave të ligjit, fatura për furnizimin e kryer, duhet të lëshohet periodikisht çdo periudhë tatimore. Periudhë tatimore për qëllime të ligjit është muaji.

Për çdo pagesë të kryer para se të kryhet furnizimi i mallit ose para përfundimit të furnizimit të shërbimit, TVSH-ja mbi pagesën lind dhe bëhet e kërkueshme në momentin e arkëtimit të shumës së paguar.

Si rregull bazuar në pikën 1, të nenit 99, të ligjit, fatura lëshohet në momentin e furnizimit të mallit ose shërbimit, por në rastin kur fatura tatimore është lëshuar përpara furnizimit, TVSH-ja bëhet e kërkueshme në momentin kur është lëshuar fatura.

Bazuar nënenin 99 të ligjit, personi i tatueshëm që kryen një furnizim mallrash ose shërbimesh, detyrohet të lëshojë një faturë për atë furnizim:

në momentin e furnizimit të mallit ose shërbimit;

kur mallrat janë lëvruar ose kur ato bëhen të disponueshme, në përputhje me dispozitat e parashikuara në seksionin 1, të kreut IV, të ligjit;

në momentin kur shërbimet janë kryer;

fatura mund të lëshohet në mënyrë periodike për disa furnizime mallrash ose shërbimesh, të cilat furnizohen në mënyrë të rregullt ose të vazhdueshme, të realizuara midis personit të tatueshëm dhe klientit të tij në të njëjtin muaj, në të cilin furnizimet janë kryer. Gjithashtu në ndërtim fatura tatimore duhet lëshuar çdo muaj;

për furnizimet e shërbimeve për të cilat TVSH-ja paguhet nga marrësi i furnizimit sipas pikës 2 të nenit 86 të ligjit, fatura duhet të lëshohet në të njëjtën periudhë tatimore në të cilën shërbimi është marre, por jo më vonë se data 14 e muajit pasardhës.

Neni 29

Vlera e tatueshme e furnizimit

1. Bazuar në nenin 37 të ligjit, vlera e tatueshme e furnizimit të mallrave ose furnizimit të shërbimeve, përbëhet nga të gjitha shumatat, vlerat, pagesat mallrat apo shërbimet e marra apo që do të merren nga furnizuesi i mallit/furnizuesi i shërbimit si kundërvlerë e këtyre furnizimeve, kundrejt blerësit, klientit apo një të treti, përfshirë dhe subvencionet që lidhen drejtpërdrejtë me çmimin e këtyre furnizimeve.

Nëse furnizimi këmbëhet në mallra/shërbime ose pjesërisht në para dhe pjesërisht në mallra/shërbime (natyrë), vlera e tatueshme e furnizimit duhet të jetë vlera e tregut e mallrave ose shërbimeve të pranuar, e llogaritur në datën, në të cilën tatimi bëhet i kërkueshëm. Nëse përveç mallit bëhet edhe pagesë shtesë në para për mallin e furnizuar atëherë vlerës së tregut të mallit/shërbimit të pranuar, i shtohet edhe vlera e arkëtuar.

Nuk është i rëndësishëm për qëllime të përcaktimit të vlerës së tatueshme Nëse pagesat në para apo në natyrë merren në të njëjtën kohë ose në momente të ndryshme. Të gjitha ato janë pjesë e vlerës së tatueshme, Ndërkohë që përshkallëzimi ose marrja e tyre në kohë të ndryshme për të aplikuar tatimin është e lidhur me lindjen, kërkueshmërinë e tatimit sipas nenit 27 të këtij udhëzimi.

Bëjnë pjesë gjithashtu në vlerën e tatueshme, dëmshpërblimet e derdhura që lidhen me një

furnizim kur përbëjnë kundërvlerën direkte apo indirekte të një furnizimi të tatueshëm. Për këtë është e rëndësishme të provohet lidhja e dëmshpërblimit me furnizimin, i cili mund të jepet për një furnizim të ri ose si pjesë e vlerës së shërbimit të kryer.

2.Përsa i përket rasteve të përcaktuara si furnizime kundrejt pagesës ose vetëfurnizime, vlera e tatueshme është përcaktuar për çdo rast siç parashikohet në nenin 38 të ligjit.

3.Subvencionet që lidhen drejtpërdrejtë me çmimin e një furnizimi malli ose shërbimi janë gjithashtu elemente të vlerës së tatueshme të furnizimit.

Kështu subvencioni është element i vlerës së tatueshme në rastin kur:

I jepet një personi të tatueshëm që furnizon mallin ose shërbimin me një çmim i cili nuk i mbulon kostot e furnizimit dhe për këtë përfitohet një subvencion që lidhet drejtpërdrejtë me çmimin e mallit ose të shërbimit, ose sepse personi i tatueshëm e shet mallin me një çmim më të ulët në treg për arsye tregtare dhe për këtë ai përfiton një subvencion si vlerë plotësuese e çmimit ose për shërbimin e kryer, etj;

Subvencioni përbën kundërvlerën e një furnizimi.

Që subvencioni të mos përfshihet në vlerën e tatueshme të një furnizimi duhet të verifikohet rast pas rasti që :

shumat e derdhura si subvencion nuk përbëjnë kundërvlerën e një furnizimi shërbimi (apo furnizim malli) që hyn në fushën e zbatimit të TVSH. Si provë mund të shërbejë ekzistenca ose konstatimi i një angazhimi nga marrësi i subvencionit, për furnizimin e një malli apo shërbimi të përcaktuar për dhënësin e subvencionit.

Kështu, duhet verifikuar në çdo situatë që subvencioni nuk është çmimi i një shërbimi të dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Raste të tilla të mungesës së shërbimit të drejtpërdrejtë sipas të cilave kemi të bëjmë me një subvencion që nuk përfshihet në vlerën e tatueshme përmenden :

subvencionet globale të derdhura nga një qytet ose dhomë tregtie në funksion të “perspektivave të përgjithshme të veprimt” për një organizëm, i cili duke pasur si qëllim favorizimin e ekspansionit ekonomik të një rajoni, kryen studime, informon dhe këshillon komunitet dhe ndërmarrjet e këtij rajoni.

financimi i një organizmi (i një shoqate) vetëm nga qëllimet e përgjithshme që ai ka apo nga angazhimi për t’i plotësuar ato, nuk përbën kundërvlerën e një furnizimi shërbimi. Kërkesa e dhënësit të subvencionit për një raport në lidhje me përdorimin e fondeve nuk tregon ekzistencën e një furnizimi shërbimi.

subvencionet e derdhura nga një ent publik për organizimin e një aktiviteti

përderisa marrësi nuk ka përcaktuar asnjë detyrim si kundërvlerë të këtyre subvencioneve.

Përmenden si subvencione që nuk përfshihen në vlerën e tatueshme:

kompensimet si ndihmë për punësimin që merren nga ndërmarrjet përderisa ato nuk përbëjnë kundërvlerën e një furnizimi shërbimi;

ndihma apo subvencioni i caktuar për të mbuluar sigurimet shoqërore;

ndihmat që përbëjnë thjesht një nxitje të pastër të punësimit (për shembull ndihma për krijimin e vendeve të punës me iniciativën lokale);

subvencionimi për ndihma, e caktuar për pagën e edukatorëve të punësuar nga ndërmarrjet ndërmjetëse ose qendrat e ndihmës për punën e kryer ndaj personave me aftësi të kufizuara;

ndihmat që derdhen nga shteti për të kompensuar kostot shtesë që rrjedhin nga punësimi i punëtorëve me kapacitet profesional të reduktuar; etj.

Neni 30

Elementet që përfshihen në vlerën e tatueshme

Vlera e tatueshme e një furnizimi përbëhet jo vetëm nga çmimi i mallit apo i shërbimit, por përfshihen gjithashtu edhe elemente të ndryshme që lidhen me të. Në vlerën e tatueshme të një furnizimi përfshihen elementet e mëposhtme:

tatimet, taksat, detyrimet, tarifat dhe pagesa të ngjashme, që lidhen me furnizimin, me përjashtim të TVSH-se, si dhe,

shpenzimet dytësore, të tilla si shpenzimet komisionere, të ambalazhimit, të transportit dhe të sigurimit që furnizuesi ia ngarkon blerësit ose klientit për furnizimin.

Shpenzimet dytësore nuk përfshihen në vlerën e tatueshme të një furnizimi nëse ato sipas rastit i faturohen veçmas klientit, (p.sh. transporti faturohet si furnizim më vete dhe veçohet nga shitja e mallit) ose nëse kryhen vetë nga klienti dhe shpenzimet përballohen vetë prej tij.

Vlera e tatueshme e ambalazheve

Bazuar në pikën 2 të nenit 39 të ligjit në vlerën e tatueshme të furnizimit përfshihet vlera e ambalazheve kur ato janë të pakthyeshme. Vlera e ambalazheve të kthyeshme nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të furnizimit, përveç kur ambalazhet e kthyeshme nuk janë kthyer nga blerësi. Ambalazhet mund të jenë të kthyeshme dhe të pakthyeshme. Në funksion të këtij dallimi ndryshon edhe mënyra e aplikimit të TVSH-së.

a) Ambalazhet e kthyeshme

Ambalazhet qarkulluese janë ambalazhe të tipit: kontenierë, qelqe, arka, bombola apo depozita gazi të lengshëm dhe të tjera të kësaj natyre. Ambalazhet qarkulluese si rregull furnizohen së bashku dhe në të njëjtën kohë me mallrat që ato përmbajnë.

Këto lloj ambalazhesh jepen nga shitësi (furnitori), së bashku me mallin në to në drejtim të blerësit (klientit); ato ruhen provizorisht nga blerësi dhe më pas kthehen nga ky i fundit përsëri në drejtim të shitësit. Blerja e ambalazheve nga shitësi i jep atij të drejtën e zbritjes së TVSH-së sipas rregullave të parashikuara në kapitullin X të ligjit. Vlera e ambalazheve që i jepen blerësit nga shitësi nuk përfshihen në vlerën e tatueshme të mallrave që ato shoqërojnë gjatë furnizimit. Ambalazhet që i janë dhënë blerësit, duhet të kthehen tek shitësi brenda një afati normal sipas fushës së aktivitetit të cilit ato i takojnë. Ky afat varion edhe sipas natyrës së produktit që ambalazhet përmbajnë dhe duhet të paraqitet në kontratën e lidhur mes palëve.

Për moslogaritjen e TVSH mbi vlerën e ambalazheve qarkulluese duhen plotësuar dy kushtet e mëposhtme:

Vlera e tyre të mos jetë përfshirë në vlerën e faturës nga shitësi.

Të ekzistojë një kontratë e lidhur midis palëve për dhënien dhe kthimin e ambalazheve. Në kontratë paraqitet edhe afati i kthimit të ambalazheve nga blerësi tek shitësi. Ambalazhet që blerësi nuk i kthen tek shitësi konsiderohen sikur të ishin shitur dhe i nënshtrohen TVSH-së mbi vlerën e tyre.

b) Ambalazhet e pakthyeshme

Janë ambalazhe të natyrës si: kartonë, shishe plastike, qese plastike, etj. Vlera e këtyre ambalazheve është element i vlerës së tatueshme të mallrave që ato përmbajnë. Blerja e ambalazheve nga shitësi, i jep atij të drejtën e zbritjes së TVSH-së sipas rregullave të parashikuara në kapitullin X të ligjit. Mbi vlerën e tatueshme të mallrave që përfshin edhe vlerën e ambalazheve, zbatohet TVSH në shitje.

Furnizime shërbimi të ndryshme, të kryera në funksion të realizimit të shitjeve ose blerjeve që kryen pas furnizimit

Bëhen pjesë e vlerës së tatueshme të një furnizimi dhe janë të tatueshme me TVSH, pagesat që i jepen ose përfitohen prej ri-shitësit, në formën e uljes së çmimit, apo që i derdhen periodikisht atij në funksion të shitjeve ose pjesë-pjesë gjatë zbatimit nga ana e ri-shitësit të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e shitjes ose edhe në formën e klauzolës së garancisë.

Në zbatim të kushteve të kontratave disa prodhues ose tregtarë të ndryshëm u sigurojnë (japin) personave që u japin ekskluzivitetin apo të drejtën të tregtojnë produkte të markës së tyre (rshitës të mallrave të markës së tyre) një pagesë të veçantë për shërbimet që kanë të bëjnë me

realizimin e shitjeve të mallrave ose kur kanë rënë dakord sipas kushteve të kontratës midis tyre në kuadrin e shërbimeve që duhet t'u kryejnë klientëve në zbatim të klauzolës së garancisë.

Shembull 1: Një shoqëri pijesh i jep ekskluzivitetin një shoqërie të tregtojë produktet e markës së saj dhe për këtë i jep një pagesë për realizimin e shitjeve të produktit mbi një sasi ose vlerë të caktuar. Shuma e përfituar nga rishitësi i produkteve është e tatueshme me TVSH, edhe nëse nuk përfitohet si pagesë, por në formën e zbritjes për furnizimin e radhës të kryer.

Shembull 2: Një shoqëri përfiton një pagesë bazuar në një klauzolë garancie të vendosur në kontratë, sipas së cilës i garanton furnizuesit të mallit së mallrat e tij do ti vendosë ose ekspozojë në një vend të dukshëm në super-market. Pagesa e përfituar në këtë rast nga ri-shitësi i këtyre mallrave është vlera e shërbimit të kryer për furnizuesin dhe si e tillë është e tatueshme me TVSH 20%. Nuk ka asnjë ndryshim nëse kjo vlerë përfitohet edhe në formën e një zbritje për furnizimin.

Shembull 3: Një shoqëri përfiton një pagesë bazuar në një klauzolë garancie të vendosur në kontratë, sipas së cilës përfiton një pagesë shtesë (në formën e një bonusi) nëse tregon brenda një periudhë të caktuar mallrat ose përfundon shërbimin në kushtet e kërkuara dhe sipas cilësisë së përcaktuar në kontratë. Pagesa e përfituar në këtë rast nga ri-shitësi i këtyre mallrave është vlera e shërbimit të kryer për furnizuesin dhe si e tillë është e tatueshme me TVSH 20%. Nuk ka asnjë ndryshim nëse kjo vlerë përfitohet edhe në formën e një zbritjeje për furnizimin.

Në këto situata ose të ngjashme me to nuk kemi të bëjmë me zbritje tëçmimit të aplikuar në kuptim të nenit 41 të ligjit.

Kështu vlerat e pa-arkëtuara faktikisht por të paraqitura në formën e zbritjes sëçmimit që i përfitojnë personat e tatueshëm ri-shitës së produkteve nuk mund të konsiderohen si zbritje çmimi sepse përbëjnë kundërvlerën e një shërbimi.

Pra, shumat e këtyre pagesave ose shumat e zbritur nuk zbritet nga vlera e tatueshme e furnizimit. Edhe personi i tatueshëm që kryen pagesën ose akordon zbritjen për personin ri-shitës nuk duhet të korrigjojë ose ulë vlerën e tatueshme të furnizimit të kryer, sepse nuk kemi të bëjmë me ulje të të ardhurave, por me një shërbim të pavarur.

Për personin e tatueshëm ri-shitës ose ai që përfiton të ardhurën (pagesën ose zbritjen), përderisa këto shumat ose zbritje përbëjnë kundërvlerën e shërbimeve që u kryhen prodhuesve ose furnizuesin kryesor të tyre, uljet e marra nga ri-shitësi përbëjnë të ardhura të tatueshme me shkallën 20 % të TVSH-së dhe duhet të shoqërohen me lëshimin e faturave tatimore. Nga ana tjetër personi i tatueshëm që kryen pagesën (prodhuesi) ka të drejtë të zbrësë TVSH-në e shënuar në faturë.

Pavarësisht nëse pagesa shtesë, ose zbritjet, bonuset përfitohen nga blerësi i mallit ose shërbimit, por edhe nëse përfitohen nga furnizuesi për kryerjen e një furnizimi si klauzolë garancie, ose në formën e një dëmshpërblimi sipas kushteve të kontratës, kemi të bëjmë me një furnizim të tatueshëm me TVSH.

4. TVSH e treguar ose jo nëfaturë

4.1 Nëse furnizimi i tatueshëm i një malli ose shërbimi është kryer pa një shumë të ndarë për TVSH-në, atëherë TVSH konsiderohet e përfshirë në vlerën totale të furnizimit. P.sh.nëse vlera totale e arkëtuar është 120 lekë, atëherë TVSH llogaritet $120 \text{ lekë} / 6 = 20 \text{ lekë}$, Vlera e tatueshme $120 - 20 = 100 \text{ lekë}$.

Kur klienti është vetë një person i tatueshëm për TVSH-në, furnizuesi i mallit/ i shërbimit duhet t'i lëshojë klientit të tij një faturë rregulluese në lidhje me rregullimin e TVSH-së.

Në rastin kur rasti është konstatuar nga autoriteti tatimor dhe palët vendosin mes tyre të rrisin çmimin fillestar të furnizimit me një shtesë çmimi që përkon me shumën e TVSH, kjo shtesë çmimi duhet t'i nënshtrohet TVSH, ashtu si dhe shuma themelore e çmimit. (vlera shtesë/6)

Shembull: Një furnizues shërbimi faturon 100 000 lekë një shërbim të tatueshëm pa treguar TVSH në faturë. Shuma e TVSH për këtë furnizim do të jetë $100\,000 \times 0,8333 \times 20\% = 16.667 \text{ lekë}$.

Furnizuesi duhet t'i lëshojë klientit të tij një faturë rregulluese që përmban vlerën e tatueshme prej 83333 lekë dhe TVSH 16667 lekë.

Nëse, në marrëveshje me klientin, furnizuesi i kërkon atij më pas një pagesë shtesë me një shumë që përkon me atë të TVSH-së, ai duhet ta tatojë gjithashtu këtë shtesë me shkallën që zbatohet për këtë furnizim. Fatura shtesë (apo rregulluese), e cila do t'i adresohet klientit, do të përmbajë shtesën e çmimit prej 16667 lekë të cilës i zbatohet 3333 lekë TVSH ($16667 \times 20\%$).

4.2 Nëse furnizimi i një malli ose shërbimi që nuk është i përjashtuar nga TVSH sipas dispozitave të ligjit, është faturuar si furnizim i përjashtuar nga TVSH dhe fatura është lëshuar për një furnizim të përjashtuar pa llogaritur TVSH, atëherë TVSH nuk konsiderohet e përfshirë në vlerën totale të furnizimit. TVSH do të llogaritet duke aplikuar shkallën tatimore përkatëse mbi vlerën e furnizimit.

Vlera e tatueshme edhe nëse në faturë është shënuar në një monedhë të ndryshme nga ajo kombëtare, është e detyrueshme që këto vlera të shprehen dhe shënohen në faturë në

monedhën kombëtare ekuivalente me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në momentin kur tatimi bëhet i kërkueshëm, i cili për qëllime të ligjit përkon me momentin kur lëshohet fatura.

Neni 31

Elementet që i zbriten vlerës së tatueshme

Bazuar në nenin 40 të ligjit në vlerën e tatueshme nuk përfshihen ulje ose reduktime tëçmimit që i bëhen blerësit ose klientit në kuadër dhe për qëllime të politikave tregtare të personit të tatueshëm që lidhen me një furnizim të tilla si:

Uljet/zbritjet e çmimit për pagesa të hershme të kryera për furnizimin;

Uljet/reduktimet e çmimit për blerësin ose klientin që përfitohen në momentin e furnizimit.

P.sh. Zbritje për çmimin e një furnizimi për shkak se pagesa bëhet menjëherë në dorë ose se një pjesë e saj është paguar më parë.

Një tjetër shembull mund të ishte skonto tregtare p.sh. klienti përfiton 10 % ulje nëse e kryen pagesën e furnizimit brenda 10 ditëve.

Këto ulje/ zbritje tëçmimit nuk përfshihen në vlerën e tatueshme të furnizimit. Uljet/ zbritjet e çmimit të kryera në kushtet e mësipërme duhet të shënohen dhe evidentohen në faturën tatimore të lëshuar siç përcaktohet në nenin 101 dhe 102 të ligjit për rastet kur nuk është e detyrueshme të lëshohet fatura tatimore, por lëshohet kuponi i kasës fiskale.

Në rastin kur zbritjet evidentohen në përputhje me këtë nen ato reduktojnë vlerën e tatueshme të furnizimit. Në të kundërt nëse zbritjet/uljet e çmimit në momentin e furnizimit ose në formën e skontove tregtare nuk janë evidentuar, llogaritur në faturën tatimore në momentin e furnizimit, nuk konsiderohen ulje për qëllime të nenit 40 të ligjit.

Neni 32

Saktësimi i vlerës së tatueshme

Për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, TVSH është e detyrueshme në datën e furnizimit apo të faturimit pavarësisht datës së pagesës së furnizimit.

Bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit janë parashikuar rastet kur lejohet të bëhet një saktësim i TVSH-së së faturuar prej furnizuesit të mallit/shërbimit, në rast anulimi apo tërheqje prej furnizimit ose një reduktim i çmimit pas momentit të kryerjes së furnizimit. Vlera e tatueshme saktësohet duke u reduktuar në përputhje me rregullat dhe procedurën e përcaktuar në këtë nen.

Për qëllime të kryerjes së saktësisimit furnizuesi do të lëshojë një faturë prej faturave që përdor, e cila është faturë korrigjuese dhe sipas rastit dhe qëllimit për të cilin është aplikuar duhet të përmbajë shënimin:

Faturë korrigjuese kur nuk kërkohet që midis palëve të rimbursohen vlerat (pagesa nuk është kryer në rast tërheqje prej furnizimit).

Faturë korrigjuese - Notë krediti nëse korrigjon në ulje vlerën e faturës fillestare;

Faturë korrigjuese- Notë debiti nëse korrigjon në rritje vlerën e faturës fillestare;

Notë krediti ose notë debiti lëshohet në ato raste kur prej blerësit pretendohet kthimi (rimbursimi) i shumës nga furnizuesi.

Me anulim apo tërheqje prej furnizimit në funksion të zbatimit të këtij neni kuptohet:

një furnizim do të konsiderohet i anuluar, në datën kur, pasi është bërë porosia dhe kryer parapagesa, blerësi, i cili nuk do ta vazhdojë këtë porosi, i kërkon shitësit ti kthejë (rimbursojë) shumën e parapagesave të bëra ;

furnizim do të konsiderohet i tërhequr, në datën kur palët rivendosen në situatën që ishin para realizimit të furnizimit. Pra mallrat i kthehen shitësit pasi furnizimi nuk është i njëjtë me atë që ka kërkuar blerësi ose mallrat janë të dëmtuara ose shërbimi nuk është kryer.

2. Zbritje në momentin e furnizimit

Kur ulja përfitohet në momentin e furnizimit ajo pasqyrohet në faturën e lëshuar nga furnizuesi për furnizimin, duke treguar edhe vlerat përkatëse fillestare dhe ato pas uljes. Furnizuesi dhe blerësi regjistrojnë faturën në librat përkatës duke marrë parasysh edhe uljen ose reduktimin e vlerës në momentin e furnizimit. Në këtë rast nuk duhet tëzbatohet faturë korrigjuese.

3. Zbritja e kushtëzuar në faturë

Në rastin kur ulja përfitohet më vonë, jo në momentin e furnizimit, por e kushtëzuar me datën kur do të kryhet pagesa apo çdo kusht tregtar tjetër, që të merret parasysh reduktimi i vlerës së tatueshme të furnizimit në momentin kur kushti plotësohet prej blerësit ose klientit duhet që ky fakt të jetë evidentuar (shkruar) në faturë në momentin e furnizimit prej furnizuesit.

Për të lejuar mospërfshirjen në vlerën e tatueshme të furnizimit është kusht që:

në faturë të cilësohen kushtet e skontos tregtare të aplikuar;

të shënohet data kur kërkohet të kryhet pagesa në mënyrë që të përfitohet skonto;

të përcaktohen edhe penalitetet nëse pagesa kryhet me vonë.

Kur ulja përfitohet në një moment të ndryshëm nga momenti i furnizimit, atëherë duhet të kryhet një saktësim i faturës së lëshuar.

Kështu fatura për furnizimin është lëshuar, regjistruar dhe deklaruar nga furnizuesi dhe blerësi sipas datës së lëshimit të faturës. Në momentin që përfitohet ulja, moment i cili mund të jetë në një periudhë tjetër tatimore furnizuesi lëshon një faturë tatimore me TVSH (notë krediti) për blerësin ose klientin duke evidentuar në të:

Dukshëm shënimin “faturë korrigjuese- notë krediti”;

Të dhënat e faturës që korrigjon si nr. fature, nr. serial, datë, etj.;

Vlerat saktësuese përkatëse përkatësisht në rastin e një ulje duhet të jenë me vlera negative;

Të shkruhet arsyeja e korrigjimit të vlerës së furnizimit.

Kjo faturë regjistrohet prej shitësit në kutitë përkatëse të librit të shitjes si shitje me TVSH.

Vlerat regjistrohen me shenjë negative dhe i zbriten vlerës së shitjeve dhe TVSH përkatësisht.

Blerësi nga ana e tij këtë faturë korrigjuese e regjistron si vlerë negative në kutitë përkatëse të blerjeve me TVSH dhe ia zbret vlerës së blerjeve dhe TVSH përkatëse.

Në rastin kur kemi të bëjmë me faturë korrigjuese, vlera e korrigjuar i shtohet përkatësisht vlerave të shitjes nga ana e shitësit dhe atyre të blerjes nga ana e blerësit.

Rregulla të përgjithshme për t’u zbatuar

Për të konsideruar të saktë procedurën e kryer kërkohet që :

Fatura e re që anulon, zëvendëson ose korrigjon të mëparshmen duhet të përmbajë referencën e saktë të faturës fillestare dhe shënimin e anulimit të kësaj të fundit. Përveç kësaj, ajo duhet të përmbajë tërësinë e informacioneve që përmban një faturë tatimore si dhe vlerat përkatëse tëkorrigjuara.

Në rastin kur lëshohet nota e kreditit, ajo duhet të përmbajë referencën e faturës fillestare dhe të tregojë shumën e uljes së miratuar, si dhe shumën e TVSH korresponduese.

Përveç kësaj, nota e kreditit duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të palëve, si dhe vlerën e furnizimit dhe TVSH e detyrueshme pas zbatimit të reduktimit të çmimit. Të evidentohet qartë edhe vlerat përkatëse të zbritjes. Në të njëjtën kohë, klienti blerës i tatueshëm me TVSH, nëse e ka kryer zbritjen e TVSH që figuron në faturën fillestare, është i detyruar të reduktojë (ulë) shumën e kësaj zbritje sipas shumës së tatimit që figuron në notën e kreditit.

Shembull:Firma Pr. në datën 30.07.2014 furnizon klientin e saj Bar “Tirana” me 500 litra pije freskuese me çmim për njësi 40 lekë. Ajo lëshon faturë tatimore kur kryen furnizimin. Pas

kryerjes së furnizimit në datën 1 gusht 2014 shitësi konstaton se mes pijeve të dërguara një sasi prej 100 litrash i përkasin një lloji pijesh freskuese që kanë një çmim 50l/litër. Atëherë në këtë rast firma Pr. duhet të lëshojë një faturë korrigjuese - notë debiti me qëllim rregullimin e detyrimit të TVSH. Pr. do të paguajë TVSH-në shtesë ndërsa Bar “Tirana” ka të drejtë të zbresë shumën e TVSH-së së korrigjuar me notë debiti.

Neni 33

Rimbursimi i shpenzimeve që nuk përfshihen në vlerën e tatueshme

Rregulla të përgjithshme

Në zbatim të pikës 1/c dhe 2 të nenit 40 të ligjit, nuk përfshihen në vlerën e tatueshme të një furnizimi, shumat që ka marrë një person i tatueshëm nga ana e blerësit apo klientit të tij si rimbursim për shpenzimet e bëra në emër dhe për llogari të këtyre të fundit dhe të regjistruara në kontabilitetin e personit të tatueshëm si llogari provizore.

Këto shumat e marra si rimbursim të shpenzimeve të dokumentuara për llogari të porositësve të tyre duke plotësuar kushtet e mëposhtme nuk përfshihen në vlerën e tatueshme të furnizimit.

Për zbatimin e kësaj dispozite, personi i tatueshëm duhet të paraqesë prova të shumës efektive të këtyre shpenzimeve të cilat janë të një natyre specifike. Ai nuk duhet të kryejë zbritje të TVSH-së që mund të jetë llogaritur mbi këto shuma.

Është kusht qënëse personi që i kryen shpenzimet i faturon personit në emër të të cilit ka vepruar, komision/tarifë për kryerjen e këtyre pagesave, ose shton vlerë mbi shpenzimet e bëra të dokumentuara, atëherë nuk jemi në kushtet e zbatimit të nenit 40, pika 1/c të ligjit.

Nëse shpenzimet futen në koston totale të shërbimit atëherë këto shpenzime përfshihen në vlerën e tatueshme të furnizimit.

Modalitetet dhe rregullat e zbatimit

Për zbatimin e këtij përcaktimi marrin pjesë tre palë:

I pari, i cili mund të jetë personi i tatueshëm ose jo;

I dyti, i cili është person i tatueshëm që është kontraktuar nga i pari për kryerjen e një shërbimi, për kryerjen e të cilit nevojiten të kryhen këto shpenzime për llogari dhe në emër të personit të parë;

I treti, i cili është personi të cilit i kryhen pagesat nga i dyti, autorizuar prej personit të parë për llogari të tij.

Për mospërfshirjen e këtyre vlerave në vlerën e tatueshme të furnizimit duhet të përmbushen kushtet e mëposhtme:

- 1- Të jetë nënshkruar një kontratë midis palëve ku të jenë përcaktuar veprimet që do të kryejnë palët. Të tregohet se veprimet që do të kryhen janë kryer prej personit të autorizuar (i dyti) me autorizim (urdhër) dhe në emër të tij (të parit). Për kryerjen e shërbimit për të cilin i dyti është ngarkuar, janë të nevojshme të kryhen pagesa shpenzimesh të cilat provohet dhe dokumentohet se janë kryer realisht në emër dhe për llogari të personit të parë. Për të justifikuar çdo shpenzim të kryer, duhet të jetë përpiluar një dokument ligjor ku personi i parë të këtë deleguar/autorizuar të drejtat për të vepruar në emër dhe për llogari të personit të parë. Nëse këto shpenzimeve nuk janë parashikuar në kontratë duhet të vërtetohen që janë kryer për këtë qëllim dhe për llogari të personit autorizues.
- 2- Duhet të ekzistojë një faturë ose dokument i qartë ku evidentohet shuma e saktë e paguar dhe të dhënat e personit për të cilin ka qenë e detyrueshme të kryhej pagesa, e cila ka lidhje me një furnizim shërbimi që i dyti do të kryejë për llogari të të parit. Shuma e paguar në emër dhe për llogari të klientit duhet të jetë e barabartë me shumën e arkëtuar nga klienti për këtë qëllim.
- 3- Këto shpenzime duhet të justifikohen me saktësisht dhe qartësisht për autoritetin tatimor duke iu bashkëngjitur dokumenti justifikues, dokumentet e pagesës, si dhe një kopje e dokumentit /autorizimit për të deleguar të drejtat për të vepruar në emrin e tij.
- 4- Shpenzime të tilla që kryhen për llogari të një personi tjetër, në kontabilitet duhet të jenë regjistruar në llogari provizore.

Është kusht që këto shpenzime janë të nevojshme të kryhen nga personi i tatueshëm për llogari të klientit të tij përgjatë kryerjes së një shërbimi për të cilin klienti e ka kontraktuar personin e tatueshëm. Këto shpenzime janë të nevojshme dhe evidentohen dhe faturohen më vete në faturën që personi i tatueshëm i lëshon klientit të tij.

Nëse kushtet e mësipërme nuk plotësohet atëherë konsiderohet shërbim i tatueshëm. Gjithashtu nëse shpenzime të tilla nuk provohen dhe dokumentohen sipas rregullave të këtij udhëzimi atëherë vlera e tyre e plotë ose vlera e paprovuar ose dokumentuar do të konsiderohet vlerë e tatueshme për të cilën zbatohet TVSH.

Shembull: Avokati një person i regjistruar kontraktohet nga një klient i tij A.X për të përfaqësuar interesat e tij në një proces gjyqësor në gjykatë mbi pronësinë e banesës së tij. Palët bien dakord sipas kontratës për çdo veprim që avokati, person i tatueshëm për TVSH-në do të kryejë për

llogari të klientit të tij, si dhe për vlerën e shërbimit të avokatisë në përfundim të procesit gjyqësor prej 120.000 lekë përfshirë TVSH-në. Ndërkohë për kryerjen e këtij procesi janë të detyrueshme dhe të nevojshme kryerja e disa shpenzimeve në emër dhe për llogari të klientit A.X, për të cilat klienti autorizon ti kryejë avokati i tij. Vlera e këtyre shpenzimeve nuk përfshihet në vlerën e shërbimit të avokatisë prej 120.000 lekë dhe në momentin e lidhjes së kontratës mund të jetë e njohur ose jo nga palët.

Kështu avokati kryen pagesën e tarifës së regjistrimit të kërkesë padisë së klientit në gjykatë prej 12.000 lekë, shpenzimet e noterit për noterizimin e autorizimit për kryerjen e këtyre shpenzimeve në emër të klientit të tij prej 3.000 lekë si dhe paguan 2.000 lekë për tërheqjen e një vërtetimi pranë zyrave të hipotekës në lidhje me pronësinë. Kërkohet që në dokumentet që justifikojnë kryerjen e këtyre shpenzimeve të evidentohet se shpenzimet janë kryer për llogari të klientit. Avokati i kryen vetë shpenzimet për llogari të klientit dhe më pas ia ngarkon atij.

Në një faturë tatimore avokati liston shpenzimet e kryera dhe vlerat përkatëse, të cilat duhet të jenë të barabarta dhe të përputhen me dokumentet që vërtetojnë shpenzimet (pagesat e kryera) në emër të klientit. P.sh.: tarifë për regjistrimin e padisë 12.000 lekë; shpenzime noterie 3.000 lekë; tarifë hipotekore 2.000 lekë. Total: 17.000 lekë.

Në kopjen e faturës tatimore që mban avokati i bashkëngjit detyrimisht dokumentet që vërtetojnë pagesat për shpenzimet e kryera. Në rast se mungon ndonjë dokument që vërteton pagesën ose vlera në faturë është më e madhe se vlera e pagesave të kryera dhe të vërtetuara me dokumente, atëherë çdo vlerë shtesë e padokumentuar përfshihet në vlerën e tatueshme të furnizimit dhe mbi tëzbatohet TVSH.

Në rastin kur avokati ia ngarkon këto shpenzime klientit në të njëjtin moment kur i lëshon faturën për shërbimin, atëherë në faturë ai evidenton:

Shërbim avokatie ...Vlera e tatueshme 100.000 lekë; TVSH 20.000 lekë;Vlera totale 120.000 lekë

Tarifë për regjistrimin e padisë 12.000 lekë; shpenzime noterie 3.000 lekë; tarifë hipotekore 2.000 lekë. Total: 17.000 lekë.

Vlera e shpenzimeve, të cilat në kontabilitet regjistrohen në llogari provizore dhe jo si shpenzime, nuk regjistrohen në librin e shitjes dhe as në deklaratën e TVSH-së. Përveç pagesës së shërbimit të tij, avokatit do t'i rimbursohen edhe shpenzimet që ka bërë për llogari të klientit të cilat i ka regjistruar në llogari provizore.

Neni 34

Kuptimi i vlerës së tregut për qëllime të përcaktimit të vlerës së tatueshme

Bazuar në nenin 36 të ligjit është përcaktuar kuptimi i “vlerës së tregut”.

Me “vlerë tregu” kuptohet shuma e plotë që blerësi, për të përfituar mallrat apo shërbimet në të njëjtën fazë të tregtimit në të cilën furnizimi kryhet, duhet t’i paguajë në kushtet e konkurrencës së barabartë furnizuesit të mallit ose shërbimit, i cili vepron si i pavarur në kushtet e tregut në territorin e Shqipërisë, në të cilin ky furnizim është subjekt i tatimit.

Në qoftë se nuk mund të sigurohen vlera të krahasueshme për furnizimet e mallrave ose shërbimeve, atëherë me termin “vlerë tregu” kuptohen shumat e mëposhtme:

për mallrat, një shumë jo më e vogël se çmimi i blerjes së mallit apo të mallrave të ngjashme ose, në mungesë të çmimit të blerjes, sa vlera e kostos e përcaktuar në kohën e furnizimit.

në rastin e shërbimeve, një shumë jo më e vogël se kostoja e plotë e kryerjes së shërbimit prej personit të tatueshëm.

Vlera e tatueshme e një furnizimi është vlera që është përcaktuar në nenin 37 të ligjit, e cila zbatohet në çdo rast me përjashtim të rregullave të veçanta të përcaktuara në nenin 38, pika 1, 2, 3 të ligjit ku përfshihen rastet që konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës.

Në raste kur vlera e tatueshme e një transaksioni nuk është e mundur të përcaktohet bazuar në nenin 37 të ligjit, atëherë autoriteti tatimor për çdo rast përfshirë edhe ato të përmendura me poshtë aplikon vlerën e tregut sipas përcaktimit në nenin 36 të ligjit.

Rastet për të cilat është parashikuar që tëzbatohet vlera e tregut janë:

- i) Neni 38, pika 3 për rastin e furnizimit të shërbimit sipas nenit 12, pika 2 shkronja c) të ligjit të kryera nga personi i tatueshëm për nevojat e biznesit.

Neni 38, pika 4 , për rastet kur furnizimi këmbëhet në mallra/shërbime ose pjesërisht të tilla dhe pjesërisht në para,vlera e tatueshme e furnizimit duhet të jetë vlera e tregut e mallrave ose shërbimeve të pranuar, e llogaritur në datën kur TVSH bëhet i kërkueshëm.

Si masa për të parandaluar shmangien dhe evazionin tatimor, nëse konstatohen raste të parashikuara në nenin 42 të ligjit të tilla si:

Për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, në rastet e mëposhtme, për blerës ose klientë, me të cilët furnizuesit kanë marrëdhënie familjare apo lidhje të tjera të ngushta personale, menaxhimi, pronësie, anëtarësie, financiare apo juridike, vlera e tatueshme është e barabartë me vlerën e tregut në qoftë se:

Vlera korresponduese është më e vogël se vlera e tregut dhe blerësi ose klienti nuk gëzon plotësisht të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sipas neneve 68, 69, 70, 71, 72, 73 e 74, të këtij ligji;

vlera korresponduese është më e vogël se vlera e tregut dhe furnizuesi nuk gëzon plotësisht të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi bazën e neneve 68, 69, 70, 71, 72, 73 e 74, të këtij ligji, dhe kur furnizimi është i përjashtuar mbi bazën e neneve 51, 53 dhe 54, të këtij ligji;

vlera korresponduese është më e madhe se vlera e tregut dhe furnizuesi nuk gëzon plotësisht të drejtën e zbritjes mbi bazën e neneve 68, 69, 70, 71, 72, 73 e 74, të këtij ligji.

Këto masa zbatohen gjithashtu për marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit ose familjes së punëmarrësit apo personave të tjerë të lidhur ngushtësisht me të.

Neni 35

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar

Furnizimi i arit të përpunuar

Në vlerën e tatueshme të arit të përpunuar, të importuar dhe arin e përpunuar, të furnizuar brenda vendit, nuk përfshihet vlera e arit të përdorur si lëndë e parë.

Njëkohësisht, në vlerën e tatueshme të një importi apo furnizimit brenda vendit, përfshihen përbërës materialë të tillë si: argjend, gurë të çmuar, lëndë plastike, vlera e punës së gjallë, firo të përpunimit, etj.

Lënda e parë ar e përdorur për prodhimin e bizhuterive, matet dhe konvertohet në ar me përmbajtjen më të lartë të arit të pastër në të 999,9%, ose ar 24 karat. Një lëndë e tillë me përmbajtje të arit kimikisht të pastër është e kuotuar në bursë, ku edhe përcaktohet çmimi i saj.

Në kushtet e përpunimit, lidhja ar i përdorur si lëndë e parë me metale të tjera krijon kategori të ndryshme ari që dallojnë nga njëra-tjetra nga përqindja e arit të pastër. Cilësitë standarde më të përdorshme të arit janë:

8 karat - 333/000

9 karat - 375/000

14 karat - 585/000

18 karat - 750/000

21 karat - 875/000

24 karat - 999,9/000.

Në çdo bizhuteri është e stampuar edhe shifra “për mijë” e arit të pastër në të. Kjo shifër detyrimisht paraqitet në faturën e importit dhe faturën tatimore për furnizimet brenda vendit.

Nëse numri i stampuar është 750, atëherë lidhja është klasifikuar 18 karat dhe përmban 7,50 gram ar të pastër në 10 gram të lidhjes gjithsej.

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar të importuar

Vlera e tatueshme për arin e përpunuar, të importuar, përcaktohet në përputhje me legjislacionin doganor e atë tatimor.

Vlerës së tatueshme të llogaritur sipas nenit 43 të ligjit, i zbritet vetëm vlera e arit të përdorur si lëndë e parë.

Dokument bazë justifikues është fatura e shitësit të huaj lëshuar në adresë të blerësit vendas. Nga vlera gjithsej mallit të importuar, në faturë detyrimisht duhet të paraqitet veçmas vlera e arit të konvertuar në ar të pastër, si dhe në valutë.

Mungesa e një ndarje të tillë të vlerës së një furnizimi, nuk i jep të drejtën importuesit për të mospërfshirë në vlerën e tatueshme të importit vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë. Nga vlera gjithsej që paraqitet në faturë zbritet vlera e arit të përdorur si lëndë e parë dhe shuma që del, është e barabartë me vlerën e tatueshme që merret për bazë edhe për llogaritjen e TVSH-së.

Autoriteti doganor për llogaritjen e bazës së tatueshme për arin e përpunuar të importuar përdor kursin e këmbimit të arit të publikuar.

Shembull : Në doganën shqiptare paraqitet importuesi A për të deklaruar e zhdoganuar bizhuteri me bazë ari.

Në faturën që ai disponon që ja ka lëshuar shitësi i huaj, shënohet:

Sasia - 3 000 gr. bizhuteri, - nr. stampuar - 585 (14 karat).

Llogaritja e vlerës së tatueshme bëhet si më poshtë:

Konvertimi i sasisë së bizhuterive të importuara në ar të pastër:

$3\,000 \times 0,585 = 1\,755$ gr. ar i pastër, sasi e cila në faturë paraqitet veçmas edhe e shprehur në valutë.

Kjo vlerë nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të importit dhe zbritet nga vlera gjithsej e arit të importuar. Mbi vlerën e mbetur, bëhet taksimi në doganë për efekt të TVSH-së, sipas procedurave të zakonshme të zhdoganimit.

TVSH e zbatuar mbi vlerën e mbetur deklarohet si e zbritshme nga A.

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar të furnizuar brenda vendit

Vlera e furnizimit brenda vendit është sa pagesa e plotë e atij furnizimi.

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar, të furnizuar brenda vendit, llogaritet, duke zbritur nga pagesa e plotë e furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Dokument bazë justifikues është fatura e furnizuesit, person i tatueshëm, e lëshuar në adresë të blerësit, e cila paraqet të ndarë veçmas vlerës totale të furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Mungesa e një ndarjeje të tillë të vlerës së një furnizimi brenda vendit, nuk i jep të drejtë furnizuesit që të mospërfshijë në vlerën e tatueshme të furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Pavarësisht natyrës së furnizimit, me shumicë apo me pakicë dhe pavarësisht vlerës së furnizimit, nga furnizuesi person i tatueshëm, lëshohet faturë tatimore siç përcaktohet në nenin 101 të ligjit.

Shembull : Personi i tatueshëm A ushtron veprimtarinë ekonomike në fushën e përpunimit dhe tregtimit me shumicë të bizhuterive.

Klienti i tij B është njëkohësisht person i tatueshëm që ushtron veprimtarinë në fushën e shitjes me pakicë të bizhuterive e artikujve të tjerë të luksit.

B porositi dhe blen tek A, disa artikuj bizhuterie me bazë ari, me sasi - 700 gr. dhe nr. stampuar - 750 (18 karat).

Konvertimi i sasisë së bizhuterive të furnizuara në ar të pastër: $700 \times 0,750 = 525$ gr. ar i pastër.

Kursi i publikuar nga Banka e Shqipërisë është:

1 gr.ar i pastër = 1850 lekë

Vlera e arit të përdorur si lëndë e parë.

$525 \times 1850 = 971\,250$ lekë

Kjo vlerë nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të furnizimit. Në faturën tatimore që A lëshon për B, paraqet veçmas këtë vlerë dhe sasinë respektive, të cilat, korrespondojnë me të dhënat e arit të furnizuar si lëndë e parë.

TVSH zbatohet mbi vlerën e mbetur të përpunimit dhe deklarohet si e mbledhshme nga furnizuesi dhe e zbritshme nga blerësi.

Neni 36

Zbatimi i shkallës së TVSH-së

Shkalla standarde e tatimit mbi vlerën e shtuar për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, është 20 për qind. Kjo shkallë zbatohet si një përqindje e vlerës së tatueshme. Shkalla e TVSH-së që zbatohet për furnizimet e tatueshme, është shkalla e TVSH-së në fuqi në momentin e lindjes së tatimit, i cili për qëllime të ligjit përkon me momentin e faturimit.

Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind.

Gjithashtu, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar aplikohet edhe për furnizime të tjera të mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me përcaktimet e nenit 49 të ligjit për TVSH-në, si për shembull, për furnizimin e reklamave nga media audiovizive, librave të çdo lloji... etj.

Shembull 1. Kompania X që ushtron aktivitetin në fushën e mediave audiovizive (television) furnizon (shet) shërbimin e reklamës për kompaninë Y. Në këtë rast, kompania X lëshon faturë tatimore shitjeje për kompaninë Y, me shkallë të reduktuar të TVSH-së në masën 6%.

Çdo veprimtari e kryer nga subjektet media audiovizive, veprimtari me natyrë tregtare, përveç reklamës, është e tatueshme me TVSH 20%. Pra, kur kompania X furnizon një program për një televizion tjetër, ose furnizon (shet) një kronike televizive, shet ose vë në dispozicion kohën televizive për transmetim etj., ajo kryen një shërbim të ndryshëm nga ai i shërbimit të reklamës dhe për pasojë nuk kryen furnizime shërbimi me shkallë të reduktuar të TVSH-së.

Ndërkohë, furnizimi i shërbimit të reklamave është furnizim i tatueshëm me shkallën standarde 20% kur furnizohet nga persona të tjerë të tatueshëm që nuk janë media audiovizive, përveç shërbimit të reklamave nga media e shkruar i cili është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja në zbatim të nenit 53, shkronja “j” të ligjit.”.

Shembull 2. Një person i tatueshëm X, furnizon (shet) libra të çdo lloji, në formën tradicionale të një libri. Në këtë rast, ai lëshon faturë tatimore shitje, duke aplikuar shkallën e reduktuar të TVSH-së prej 6 për qind. Çdo material i ofruar nga ky person, jo në formën tradicionale të librit, pavarësisht përmbajtjes së tij, që mund të lexohet nëpërmjet pajisjeve të tjera ndihmëse përfshirë ato elektronike, nuk është furnizim me shkallë të reduktuar të TVSH-së 6%.

Ndërkohë që, ky person i tatueshëm zbret normalisht TVSH-në në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe këtij udhëzimi, për të gjitha blerjet e mallrave dhe shërbimeve të realizuara në funksion të veprimtarisë së tij të tatueshme.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 16, datë 05.07.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 143, datë 10.07.2017).

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 5, datë 21.02.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 26.02.2019.)

Neni 37

Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm

Të përgjithshme mbi përjashtimin nga TVSH

Disa lloje transaksionesh që ndodhen në fushën e zbatimit të TVSH përjashtohen nga TVSH kur ligji përcakton përjashtimin. Përjashtimet përcaktohen në mënyrë të shprehur nga ligji dhe shtrirja e tyre për analogji nuk është e mundur.

Personat që kryejnë transaksione të përjashtuara nuk janë të përjashtuar nga detyrimet që u takojnë personave të tatueshëm (p.sh. lëshimi i faturave, plotësimi i deklaratave, etj), përveç se kur përcaktohet me ligj.

Përjashtimi nga TVSH e shtrin fushën e veprimit jo vetëm mbi furnizimet e përjashtuara, por kufizon gjithashtu edhe të drejtat mbi blerjet. Përjashtimi nga TVSH sjell humbjen e të drejtës së zbritjes së TVSH-së që ka rënduar mbi elementet e çmimit të transaksionit të realizuar.

Kategoritë e transaksioneve të përjashtuara nga TVSH pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së në blerjet e bëra për qëllime të këtyre transaksioneve, janë furnizimet e përjashtuara që përfshihen në nenet 51, 52, 53, 54,55,56 të ligjit, të cilat ndahen në kategori:

Përjashtim i veprimtarisë në interes të përgjithshëm sipas nenit 51 të ligjit,
Përjashtime të tjera sipas nenit 53 të ligjit,
Përjashtime në import sipas nenit 56 të ligjit.

Neni 38

Furnizimet e barnave dhe shërbimeve shëndetësore

I.Në furnizimet e përjashtuara nga TVSH për transaksionet me interes të përgjithshëm bazuar në nenin 51 pikat b),c), ç),d), dh) dhe ll) të ligjit përfshihen:

Furnizimi i barnave, pajisjeve mjekësore të implantueshme aktive dhe pajisjeve mjekësore të implantueshme është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja.

Në kuptim të kësaj pike, me barna kuptohen barnat për konsum njerëzor dhe barnat që përdoren për kafshët.

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore miraton listën e barnave të përjashtuara nga TVSH-ja dhe i vihen në destinacion autoritetit doganor dhe atij tatimor për zbatimin e përjashtimit sipas kësaj pike.

Pajisjet mjekësore të implantueshme dhe pajisjet mjekësore të implantueshme aktive të përjashtuara nga TVSH-ja, janë si më poshtë:

Përshkrimi	Kodet e NKM
Pacemakera kardiakë(ritëmbërës) të implantueshëm dhe aksesorët e tyre.	90215000100
Defibrillatore të implantueshem	90189084100
Stimulatorë nervorë të implantueshëm	90189075100
Stimulatorë fshikëze	90189075100
Stimulatorë diafragme	90189075100
Implantet kokleare	90214000100
Pajisje e implantueshme aktive për aplikimin e barit	90189084100
Pajisje e implantueshme monitorimi	90181910100
Stimulatorë të ndryshëm, të implantueshëm aktivë, me funksione sekondare (për shtyllën kurrizore, sistemin urinar etj.)	90189075100
Protezat e valvolave kardiake	90213990100
Proteza endovaskulare	90213990100

Filtra Vena cava	90213990100
Stenta vaskulare të implantueshme	90219090100
Graftet sintetike vaskulare	90213990100
Implantet dentare	90212900100
Suprastrukturat e implanteve dentare	90212900100
Kapëse intrakraniale vetëmbyllëse	90189084100
Shunt dhe komponent hidrocefalus të implantueshëm	90189084100
Implantet: protezat e zëvendësimit të gjymtyrëve: këmbë, shpatull, gju, hip, brryl, kuç.	90211090100
Implantet spinale: torako-lumbar, hapësinuesit intervertebralë, pajisjet për ruajtjen e lëvizshmërisë, implantet cervikale, stimuluesit spinal.	90211010100
Implantet ortobiologjike: zëvendësuesit e kockës, faktorët për rritjen e kockës, çimento kockore,	30064000100
Implantet e traumës: Vidat dhe pllakat e përdorura në ortopedi për fiksime të brendshme, implantet craniomaxillofaciale.	90211090100
Implantet (protezat) e gjirit	90213990100
Proteza intraokulare me injektor për implantim intraokular dhe solucion për implantimin intraokular	90213910100
Proteza e syrit	90213910100
Dispositiv intrauterin (DIU)	90189084100
Implante për osteosintezë	90211010100
Implant ezofageal dhe të rrugëve të frymëmarrjes	90192000100
Proteza artikulacionesh të implantueshme	90213100100

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/8, datë 05.06.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 94, datë 09.06.2015.)

Furnizimi i shërbimeve shëndetësore dhe veprimeve të lidhura ngushtë me to, që kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit të shtetasve, përfshirë parandalimin, diagnozën, trajtimin, kurimin e sëmundjes apo çrregullimeve shëndetësore dhe rehabilitimin, nga institucionet shëndetësore publike ose private, të njohura si të tilla nga autoriteti kompetent shëndetësor;

furnizimet e shërbimeve shëndetësore, të ofruara për qëllime të kujdesit për shëndetin, në kuadër të ushtrimit të profesionit mjekësor ose para-mjekësor, të njohur si të tillë dhe të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin;

furnizimi i organeve, gjakut dhe të qumështit njerëzor;

furnizimet e shërbimeve shëndetësore, të kryera në kuadrin e profesionit të tyre nga stomatologët dhe laborantët dentarë;

furnizimi i transportit të të sëmurëve apo të plagosurve me automjete të krijuara posaçërisht për këtë qëllim nga ana e organizmave të autorizuar posaçërisht.

Shtrirja e përjashtimit të TVSH-së

Bazuar në pikën c) të nenit 51 të ligjit përjashtohet nga TVSH-ja:

Furnizimi i shërbimeve shëndetësore ndaj pacientit ku përfshihen të gjitha shërbimet për parandalimin, diagnozën, trajtimin, kurimin e sëmundjes apo çrregullimeve shëndetësore dhe rehabilitimin, të ofruara nga institucionet shëndetësore publike ose private të njohura ose të licencuara nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

Në kuptim të kësaj dispozite “veprimet e lidhura me shërbimet shëndetësore” janë veprimet e domosdoshme që furnizohen (kryhen) nga vetëinstitucioni shëndetësor, për ofrimin e shërbimit shëndetësor dhe si pjesë e tij.

Është kusht që, këto shërbime dhe veprime të trajtohen si shërbime të përjashtuara nga TVSH, duhet të ofrohen (furnizohen) nga institucionet shëndetësore publike ose private, ose në kuadër të ushtrimit të profesionit mjekësor ose para-mjekësor, të njohur dhe licencuar si të tillë nga autoriteti kompetent shëndetësor.

Profesionistët që e ushtrojnë veprimtarinë mjekësore si të pavarur në kuadër të ushtrimit të profesionit mjekësor ose para-mjekësor, konsiderohen si profesionistë të pavarur, qoftë kur shfrytëzojnë institucione shëndetësore ose klinika private në të cilat ia kryejnë shërbimin drejtpërsëdrejti pacientit dhe e marrin drejtpërdrejtë shpërblimin për punën e tyre, qoftë kur e ushtrojnë veprimtarinë e tyre mjekësore në shërbim të pacientëve me qëllim kujdesin ndaj shëndetit nëpërmjet institucioneve shëndetësore private ose publike, ose në kuadrin e shoqërive civile profesionale.

Gjithashtu, furnizimi i organeve, gjakut dhe të qumështit njerëzor si pjesë e furnizimit të shërbimit shëndetësor ose jo, janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

Parimi i përjashtimit në rastin e shërbimeve shëndetësore është që shërbimi shëndetësor i cili është kryesori dhe shërbimi anësor(aksesor) bëhen nga i njëjti person i tatueshëm, në këtë rast, institucion shëndetësor.

“Shërbimet shëndetësore dhe veprimet e lidhura ngushtë me to” përfshijnë shërbimet për parandalimin, diagnozën, trajtimin, kurimin e sëmundjes apo çrregullimeve shëndetësore dhe rehabilitimin e pacientit, të furnizuara drejtpërdrejtë pacientit nga institucionet shëndetësore publike ose private të njohura si të tilla.

Hospitalizimi dhe trajtimi i të sëmurëve përjashtohen nga TVSH-ja. Si veprime të lidhura domosdoshmërisht me hospitalizimin përfshihen në fushën e zbatimit të përjashtimit nga TVSH-ja operacionet e mëposhtme, të cilat nuk janë shëruese, por e rëndësishme në çdo rast është që shërbimet e kësaj natyre janë të përjashtuara kur furnizohen (ofrohen) nga institucionet shëndetësore që kryejnë hospitalizimin.

Shpenzimet e qëndrimit dhe të kujdesit mjekësor për pacientët, me përjashtim të kërkesave të veçanta të pacientit;

Shpenzimet e sallës së operacionit apo të lindjes;

Shpenzimet e trajtimit mjekësor, kur këto mallra furnizohen nga institucioni gjatë qëndrimit në spital dhe në vazhden e drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme të kujdesit shëndetësor;

Ushqimi dhe dhomat e caktuara për personat që shoqërojnë të sëmurët, kur prania e një personi pranë të sëmurit vjen në vazhden e përshkrimit mjekësor dhe prania e tij vlerësohet e domosdoshme nga mjeku;

Shërbimi i strehimit të nënave për të porsalindurit dhe foshnjat 0-1 vjeç, fëmijët 1-14 vjeç kur qëndrimi i tyre pranë fëmijës është i domosdoshëm, sipas vlerësimit të mjekut kurues, përgjatë hospitalizimit të fëmijës është furnizim i lidhur drejtpërdrejtë me hospitalizimin.

Nuk përjashtohen nga TVSH-ja:

Qiradhënia e ambienteve për qëllime mjekësore ose jo, edhe kur ky shërbim u jepet mjekëve të tjerë, ose ofrimi i shërbimit të strehimit hotelier në spitale për të afërm të të sëmurëve dhe shërbime të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nëse furnizohen nga institucionet shëndetësore publike ose private. Ato trajtohen sipas rastit në varësi të natyrës së shërbimit ose furnizimit të mallit sipas dispozitave të ligjit;

Qiradhënia e pajisjeve të spitalit gjithashtu nuk është shërbim shëndetësor;

Veprimet që edhe pse furnizohen nga institucioni shëndetësor për pacientin, por nuk janë të lidhura me hospitalizimin dhe trajtimin mjekësor të pacientit, ose nuk janë të nevojshme për këtë qëllim si pjesë e hospitalizimit dhe trajtimit mjekësor, janë shërbime të tatueshme me TVSH. Bëhet fjalë veçanërisht për elementët, që u faturohen të sëmurëve dhe që përkojnë me kërkesat e veçanta të tyre, pastrim i ndërresave personale, shpenzime telefoni, televizorin. etj.;

Shitjet e mallrave, të cilat nuk janë pjesë e trajtimit mjekësor të pacientëve (librari, kancelari) kur të ardhurat i kalojnë institucionit shëndetësor. Edhe kur shitje të tilla tregtohen nga persona të tatueshëm tregtarë brenda ambienteve të spitalit, janë të tatueshme me TVSH;

Furnizimet për persona të ndryshëm nga pacientët, përveçkur shoqërojnë të sëmurët;

Shërbimet e vënies në dispozicion të ambienteve, lokaleve, personelit, materialeve, etj. Për mjekët dhe ndihmësit mjekësorë, që ushtrojnë në mënyrë të pavarur veprimtarinë e tyre profesionale, cilido qoftë cilësimi i llojit të shërbimit, apo cilado qoftë natyra e shërbimit të kryer; Qiradhëniet e ndryshme;

Vaktet e ushqimit:

Për personelin e punësuar: institucionet spitalore vendosen në të njëjtën situatë si punëdhënësit e tjerë, të cilët e ushqejnë falas personelin e tyre, apo që zotërojnë një mensë në ndërmarrje;

Për personat e tjerë, më përjashtim të rastit kur personat janë domosdoshmërisht për të shoqëruar të sëmurët.

Shembull: Një shoqëri, person i tatueshëm, ofron shërbimin e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit për pacientët e një spitali. Në këtë rast, janë dy situata:

Shërbimi ofrohet nga shoqëria drejtpërdrejtë për pacientët e spitalit.

Në këtë rast ky shërbim nuk është shërbim shëndetësor edhe pse i nevojshëm për shërbimin shëndetësor. Furnizimi i vakteve të të sëmurëve, kur ky shërbim nuk ofrohet si pjesë e shërbimit shëndetësor nga vetë institucioni shëndetësor, nuk është objekt i përjashtimit nga dispozitat e nenit 51 të ligjit dhe për pasojë është i tatueshëm me TVSH;

Shërbimi i ushqimit i ofrohet (furnizohet) spitalit nga shoqëria në fjalë. Ky shërbim nuk është shërbim shëndetësor. Të ardhurat prej shërbimit në këtë rast përfitoen nga një shoqëri, e cila nuk është institucion shëndetësor dhe nuk kryen shërbim shëndetësor.

Në rastin kur spitali ia ofron vetë vaktet (ushqimin) pacientit si shërbim i lidhur me shërbimin shëndetësor i ofruar (furnizuar) nga spitali, ky shërbim është i përjashtuar nga TVSH-ja, pavarësisht nëse shfaqet ose jo në faturë si një shërbim i cilësuar.

Furnizimet e shërbimeve shëndetësore, të kryera në kuadrin e profesionit të tyre nga stomatologët dhe laborantët dentarë janë të përjashtuar nga TVSH-ja.

Furnizimet e shërbimeve shëndetësore, të ofruara për qëllime të kujdesit për shëndetin, në kuadër të ushtrimit të profesionit mjekësor ose para-mjekësor, të njohur sit ë tillë dhe të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë dhe legjislacionin për licencimin si vijon:

- kujdesi shëndetësor parësor;
- kujdesi spitalor;
- shërbimi i urgjencës mjekësore;
- shëndeti publik;
- shëndeti stomatologjik;

kujdesi për të sëmuret terminal;
shërbimi shëndetësor në punë;
shërbimi optik;
mjekësia rehabilituese dhe sportive;
mjekësia alternative.

Furnizimi i shërbimit të transportit të të sëmurëve apo të plagosurve me automjete të krijuara posaçërisht për këtë qëllim si p.sh. shërbimi i autoambulancës private ose publike, kur ky shërbim ofrohet nga ana e organizmave të autorizuar posaçërisht për këtë qëllim, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja.

E drejta e zbritjes së TVSH-së

Institucionet shëndetësore që ofrojnë shërbim shëndetësor të përjashtuar nga TVSH janë përjashtuar gjithashtu nga e drejta për të zbritur TVSH- në e paguar në blerjen e çdo malli ose shërbimi të marrë për qëllime të veprimtarisë së tyre të përjashtuar, sipas parimit të së drejtës së zbritjes dhe rregullave të përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim.

Neni 38/1

Përjashtimi nga TVSH-ja për furnizimin e shërbimeve veterinare

Bazuar në shkronjën “o” të nenit 51 të ligjit, furnizimi i shërbimeve veterinare me përjashtim të shërbimeve veterinare për kafshët shtëpiake, përjashtohet nga TVSH. Për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, kafshët shtëpiake konsiderohen kafshët e shoqërimit sipas përcaktimit të legjislacionit të fushës për shërbimin veterinar.

(Shtuar me Udhëzim nr. 5, datë 21.02.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 26.02.2019.)

Neni 39

Përjashtimi nga TVSH për furnizimin e shërbimeve arsimore

1.Bazuar në pikën g) të nenit 51 të ligjit përjashtimi zbatohet për furnizimet e mirëfillta të mësimdhënies shkollore, universitare, formimit profesional dhe rikualifikimit, përfshirë furnizimin e shërbimeve ose të mallrave të lidhura ngushtë me këtë mësimdhënie.

Është kusht që të jenë të përjashtuara, përveç se duhet të jenë shërbime të edukimit dhe mësimdhënies në të gjitha nivelet, shërbimet duhet të jenë të furnizuara nga institucione arsimore të njohura si të tilla, pavarësisht nëse janë shërbime arsimore ose shërbime dhe mallra të lidhura ngushtësisht me to.

Në kuptim të kësaj dispozite përsa i përket shërbimeve të mirëfillta të edukimit, mësimdhënies shkollore, universitare, formimit profesional dhe rikualifikimit, nuk përfshihen shërbimet e ofruara nga institucione që ofrojnë kurse trajnimi, kualifikimi, kurse të tjera speciale ose profesionale, nëpërmjet të cilave nuk merret një formim i vazhdueshëm për pjesëmarrësit, i cili në përfundim të tij të shoqërohet me një diplomë të vlefshme për t'u njohur si profesion (zanat, specializim), por janë shërbime (kurse, etj.) nëpërmjet të cilave pjesëmarrësi merr ose zhvillon më tej njohuritë e tij në një fushë të caktuar të profesionit ose të ndryshme.

Edhe nëse këto kurse kryhen nga institucione të njohura si të tilla nga autoritetet kompetente, shërbimet që ato ofrojnë nuk janë shërbime në objektin e përjashtimit të nenit 51, pika g) e ligjit.

Për zbatimin e përjashtimit, konsiderohen furnizim i shërbimeve të edukimit të fëmijëve dhe të rinjve, të mësimdhënies shkollore apo universitare, formimit profesional dhe rikualifikimit, furnizimet e mëposhtme:

Furnizimi i shërbimit të mësimdhënies për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, nga institucione të arsimit të lartë, universitar dhe pasuniversitar të njohura si të tilla nga autoriteti kompetent shtetëror.

Furnizimi i shërbimeve arsimore të mësimdhënies për realizimin e planeve dhe programeve mësimore në nivele të ndryshme shkollore e parashkollore (arsimi bazë; arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe arsimi profesional, arsimi special, kopshtet).

Furnizimi i shërbimeve arsimore të mësimdhënies për realizimin e programeve të arsimit profesional dhe rikualifikimit.

Furnizimi i shërbimeve arsimore që kryhen nga institucionet arsimore plotësuese jo-publike, ku punohet në drejtim të arsimit të edukimit në lëndë e specialitete të veçanta që kanë të bëjnë me marrjen e njohurive në lëndë të përfshira në programin mësimor (p.sh. kurse të gjuhës së huaj, matematikë, fizikë, kantoje etj), të miratuara nga autoriteti kompetent shtetëror.

Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të lidhura ngushtë me mësimdhënien

Në rastin kur përbëjnë një element plotësues të domosdoshëm dhe të pandashëm të mësimdhënies, furnizimi (shitja) e materialeve mësimore për nxënësit dhe studentët (fotokopje, etj.) përjashtohen nga TVSH-ja.

Po kështu, shërbimi i printimit ose fotokopjes nga universitetet për printim esesh dhe tezash diplome përjashtohen nga TVSH-ja me kusht që:

këto printime t'iu shërbejnë studentëve të këtyre institucioneve për nevojat e studimeve të tyre;

të bëhen në një numër të kufizuar kopjesh pa qenë nevoja e përdorimit të metodave komerciale të menaxhimit, të cilat mund t'u japin karakter konkurrues.

Shembull: Një universitet i cili ofron për studentet e tij shërbimin arsimor dhe në të njëjtën kohë edhe shërbimin e mensës ose fjetjen, (konviktin) kryen shërbim të përjashtuar nga TVSH.

Një shkollë e cila në të njëjtën kohë kryen me mjetet e veta transportin e nxënësve nga shkolla në shtëpi. Kur shkolla e kryen vetë këtë shërbim dhe ia faturon atë nxënësit së bashku me shërbimin arsimor kryen një shërbim të përjashtuar nga TVSH-ja.

Nëse këtë shërbim shkolla e kryen me të tretë, p.sh. një shoqëri transporti, atëherë shërbimi i transportit të nxënësve në këtë rast i faturuar prej shoqërisë së transportit qoftë nxënësve, qoftë shkollës, është furnizim i tatueshëm për TVSH. Shkolla e merr këtë shërbim me TVSH si kosto të shërbimit arsimor që ajo furnizon, dhe shërbimin arsimor (pa evidentuar veçmas transportin) për nxënësit e faturon të përjashtuar nga TVSH-ja. Shkolla nuk duhet të faturejë transportin për nxënësit nëse nuk e kryen vetë atë. Nëse e faturon ajo sillet si ri-shitës i shërbimit të transportit dhe këtë shërbim do t'ia faturejë me TVSH.

KUJDES! Qendrat e trajtimit të studentëve që subvencionohen me fonde shtetërore, të cilat funksionojnë posaçërisht për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të studentëve konviktet ose mensat, shërbimi i fjetjes dhe i mensës kur i ofrohet studentëve ose nxënësve është i përjashtuar nga TVSH-ja, si shërbim i lidhur dhe i domosdoshëm për shërbimin arsimor. Këto qendra duhet të vërtetojnë në çdo rast që shërbimi që ato ofrojnë i është ofruar studentëve dhe jo të tretëve, me rekomandim të universitetit publik. Përndryshe shërbimi i kryer prej tyre është i tatueshëm me TVSH.

Furnizimi i objekteve të krijuara nga nxënësit në kuadrin e vënies në jetë të mësimdhënies së ofruar, përfitojnë nga përjashtimi për aq kohë sa këto operacione nuk shndërrohen në operacione që hyjnë në konkurrencë me operacionet e ndërmarrjeve apo profesioneve, të cilat i nënshtrohen TVSH-së si dhe për sa kohë që nuk përdorin metoda komerciale menaxhimi. Këto parime zbatohen kryesisht për punët kërkimore të realizuara nga studentët.

Bazuar në pikën gj) të nenit 51, janë të përjashtuara nga TVSH-ja kurset apo leksionet e veçanta të ofruara privatisht nga mësuesit kur ofrojnë shërbime që kanë të bëjnë me mësimdhënien shkollë apo universitare, për lëndë që bëjnë pjesë në këto programe mësimore dhe që ndiqen nga nxënës e studentë. (p.sh. kurse matematike, gjuhë e huaj, fizikë, etj).

Megjithatë bazuar në nenin 39 të ligjit, në çdo rast përse i përket përjashtimeve të përcaktuara në pikën g) të nenit 51 të ligjit janë parashikuar kufizime në të drejtën e përjashtimit.

Nëse shërbimet ose mallrat që furnizohen nga këto institucione arsimore nuk janë të domosdoshme për kryerjen e furnizimeve të përjashtuara të parashikuara në pikën g) ato nuk përjashtohen nga TVSH; ose

Nëse nëpërmjet furnizimit të këtyre mallrave ose shërbimeve realizohen të ardhura shtesë duke konkurruar drejtpërdrejtë me transaksionet e kryera nga sipërmarrjet tregtare, subjekte të TVSH-së, ato nuk përjashtohen nga TVSH.

Neni 40

Përjashtimi nga TVSH i furnizimeve të sigurimit dhe ri-sigurimit

Bazuar në nenin 53, shkronja a), të ligjit janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, furnizimi i shërbimeve të sigurimit dhe të ri-sigurimit përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime dhe ri-sigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimit.

Dispozita ligjore e shtrin përjashtimin për shërbimet e sigurimit dhe ri-sigurimit si dhe shërbimin ndërmjetësimit në sigurime dhe ri-sigurime pavarësisht se këto shërbime furnizohen nga shoqëritë e sigurimit apo furnizohen nga agjentët dhe brokerat e sigurimit të njohur si të tillë nga autoriteti kompetent financiar.

Neni 41

Përjashtimi nga TVSH-ja i shërbimeve financiare

1. Bazuar në nenin 53, shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja transaksionet financiare të parashikuara dhe të shprehura në mënyrë të qartë dhe shteruese në këto dispozita, pavarësisht nëse këto transaksione kryhen nga një institucion financiar, ose jo.

Çdo transaksion tjetër që nuk është i shprehur në nenin 53 të ligjit, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, nuk përjashtohet nga TVSH-ja. Përjashtimi nga TVSH-ja zbatohet kur transaksioni i kryer është njëri nga shërbimet e parashikuara në këtë dispozitë. Aplikimi i përjashtimit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me natyrën e shërbimit dhe jo me entitetin ose subjektin që ofron shërbimin dhe as personin që merr shërbimin. Identiteti i palëve është i parëndësishëm. Mënyra e ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike, manuale apo automatike, gjithashtu, është e parëndësishme në aplikimin ose jo të përjashtimit.

Shembull 1.

Një klient paraqitet pranë një banke për të marrë një kredi. Dhënia dhe negocimi i kredisë edhe menaxhimi i saj janë operacione të përjashtuara nga TVSH-ja, kur furnizohen nga kredidhënësi.

Klienti paraqet njëdosje jo shumë të mirë dhe banka refuzon kredinë ose i jep një kredi jo të favorshme. Një person i tatueshëm, i cili kryen veprimtari si negociues, merr përsipër të kryejë këtë shërbim për klientin pranë bankës. Ky person mund të jetë individ ose agjenci. Shërbimi i kryer nga negociuesi për klientin nuk është shërbim i përjashtuar nga TVSH-ja, por i tatueshëm me TVSH. Shërbimi i negocimit përjashtohet nga TVSH-ja kur kryhet (furnizohet) nga kredidhënësi, që në këtë rast është banka. Edhe në rastin kur komisioni i ndërmjetësismit i faturohet bankës prej personit të tatueshëm ai është i tatueshëm me TVSH.

Shembull 2.

Një bankë jep me qira bankomatin për përdorim një banke tjetër. Ky operacion nuk është i përjashtuar nga TVSH-ja edhe pse kryhet nga banka, pasi nuk është në listën e furnizimeve të përjashtuara në këtë dispozitë.

Mirëmbajtja e bankomatit, gjithashtu, apo e sistemit të IT të bankës nuk janë shërbime të përjashtuara nga TVSH, përse nuk janë shërbime financiare të listuara nënenin 53 të ligjit. Këto shërbime kryhen nga persona të tatueshëm të TVSH-së dhe unënshtrohen rregullave të përgjithshme për aplikimin e TVSH-së sipas vendit të furnizimit.

Shembull 3.

Një kompani e njohur e programeve kompjuterike prodhon një program specifik bankar sipas porosisë së një banke. Sistemi do të përdoret për sistemin e pagesave të bankës. Në këtë rast kemi të bëjmë me një furnizim shërbimi siç është shitja e

software-it për bankën nga shoqëria e programeve kompjuterike. Ky shërbim është i tatueshëm me TVSH, përse furnizimi i software-ve të çdo lloji nuk është një furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit. Përjashtimi nga TVSH-ja parim përcaktohet për furnizimin e shërbimit dhe jo për klientin që e përfiton shërbimin.

Janë të përjashtuara nga TVSH-ja shërbimet financiare të mëposhtme:

-Dhënia, negocimi, menaxhimi i kredive nga ana e vetë kredidhënësit

.

Shembull. Vlerësimi i pasurisë si garanci për kredinë, i kryer nga njëvlerësues pasurie është shërbim i tatueshëm me TVSH.

-Negocimi ose marrëveshje të ngjashme për garantimin e kredive, ose çdo garanci që ka lidhje me paratë, ose menaxhimi i garancive të kredive, kur kryhen nga kredidhënësi;

Shembull. Me qëllim menaxhimit të garancisë së kredisë, një bankë i kërkon informacion institucioneve që merren me regjistrimin e pronave për të verifikuar disa prona të luajtshme ose të paluajtshme nëse kanë ose jo barrë hipotekore ose barrë siguroese, për disa klientë që kanë aplikuar për kredi në bankë. E njëjta gjë kur banka u kërkon të vendosin barrë mbi pronën për kredinë. Këto institucione, persona të tatueshëm, i furnizojnë bankës një shërbim për verifikimin dhe informacionin e dhënë të kërkuar nga banka ose për shërbimin e vendosjes së barrës apo hipotekës. Këto shërbime nuk janë shërbime financiare në kuptim të nenit 53 të ligjit, pavarësisht nëse kryhen për një institucion financiar, Banka nga ana e saj kur i faturon shërbimin klientit në përfundim të negocimit për kredinë (përfshin në shërbimin për klientin gjithë vlerën e shërbimeve që lidhen me kredinë) ia faturon si shërbim të përjashtuar nga TVSH-ja sipas nenit

53,pika “c”,të ligjit. -Transaksionet përfshirë negocimin lidhur me veprimet e këmbimit, depozitat, llogaritë rrjedhëse,furnizimin e likuiditeteve nëpërmjet pagesave, transfertave, huadhënia, çeqet dhe instrumentet e tjera të negociueshme;

-Transaksionet përfshirë negocimin lidhur me valutën, kartëmonedhat apo monedhat e përdorura si mjete ligjore pagese;

-Transaksionet përfshirë negocimin në aksione, kuota, pjesë në shoqëri apo shoqata, në obligacione e tituj të tjerë, përveç titujve për mallrat dhe të drejtat ose titujt mbi pasurinë e paluajtshme që përcaktohen në nenin 8, të ligjit;

Shembull. Shoqëria “Invest”merr përsipër sipas një kontrate shërbimi ti sigurojë dhe ofrojë klientit të saj i cili menaxhon një fond investimi të dhënat e kërkuara në lidhje me fondin e investimit.

Gjithashtu,ajo proceson, verifikon formularët e investitorëve potencialë,duke siguruarqë ato të jenë përpiluar, deklaruar dhe paguar korrekt. Këto shërbime shoqëria i kryen kundrejt pagesës. Aduhet tëkonsiderohet shërbimi i ofruar nga shoqëria “Invest”si një transaksion i lidhur me transferimin ose negocimin e titujve/letrave me vlerë?

Këto shërbime janë shërbime me natyrë administrativembështetëse dhe si të tilla, shërbimet administrative mbështetëse që nuk shkaktojnë një ndryshim të pozicionit financiar dhe ligjor të palëve, nuk janë shërbime të përjashtuara.

Gjithashtu, shërbimet për “menaxhimin dhe ruajtjen e titujve ”përjashtohen shprehimisht nga aplikimi i përjashtimit të TVSH -së sipas pikës “dh”të nenit 53 të ligjit.

-Përjashtohet, gjithashtu, bazuar në nenin 152 të ligjit furnizimi dhe importimi i arit për investim.

2.Bazuar në nenin 53 të ligjit, përjashtimi nga TVSH-ja nuk aplikohet për transaksionet e mëposhtme:

-Shërbimi i mbledhjes së borxhit

Shembull. Një bankë ka dhënë kredi e cila nuk është shlyer. Banka kryen veprime për mbledhjen e borxhit të saj duke bllokuar në llogarinë e klientit shumën e kredisë së pashlyer dhe një komision shtesë (e ngjashme me veprimtarinë përmbaruese).

Komisioni që banka përfiton nga llogaria e klientit në këtë rast është pagesë për mbledhjen e borxhit e cila është e tatueshme me TVSH.

-Transaksionet përfshirë negocimin për monedhat dhe kartëmonedhat për koleksion, që do të thotë monedha ari, argjendi apo monedha të tjera metali ose kartëmonedha që nuk përdoren normalisht si mjet ligjor pagese ose monedha që paraqesin interes numizmatik;

-Transaksionet për menaxhimin apo ruajtjen e aksioneve, kuotave, pjesë në shoqëri apo shoqata, në obligacione dhe tituj të tjerë, si dhe titujt mbi mallrat dhe të drejtat apo titujt mbi pasurinë e paluajtshme që përcaktohen në nenin 8 të ligjit;

-Qiradhënia e kasafortave edhe nëse ky shërbim kryhet nga një bankë është i tatueshëm për TVSH-në. Shërbimet e renditura në këtë pikë nuk janë shteruese. Çdo shërbim tjetër, i cili nuk bën pjesë në shërbimet e përjashtuara të përcaktuara në nenin 53 të ligjit, të renditura në pikën 2 të këtij neni, janë furnizime shërbimi të tatueshëm me TVSH.

3. Bazuar në pikën “e”, të nenit 53 të ligjit përjashtohet nga TVSH-ja, menaxhimi i fondeve të investimeve, në kuptim të ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 13, datë 17.05.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 91, datë 30.05.2016).

Neni 42

Shërbimet postare dhe pullat

Bazuar në nenin 51 shkronja a) dhe nenin 53 shkronja ë) përjashtohen nga TVSH:

furnizimi i shërbimit postar i kryer nga shërbimi publik postar në Shqipëri në përputhje me shërbimin universal postar;

furnizimi me vlerën e parashtypur i pullave postare për përdorim për shërbime postare në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pullave të tjera të ngjashme;

Përjashtohen nga TVSH-ja furnizimet, në vlerën e tyre zyrtare, të pullave postare për shërbime postare në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pullave të tjera të ngjashme. Ky përjashtim përfshin vetëm “furnizimet”, domethënë shitjet e pullave. Nuk përfitojnë nga përjashtimi shtypja e pullave ose transporti i tyre, etj.

Përjashtimi përfshin pullat e çdo natyre, të cilat kanë vlerë përdorimi në Republikën e Shqipërisë, p.sh. pulla takse, regjistrimi, lejimi, etj., dhe që tregtohen nga autoritetet shtetërore.

Shitjet e pullave të koleksionit nga koleksionistët për qëllime tregtare i nënshtrohen TVSH-së.

Neni 43

Përjashtime të tjera

1. Furnizimi i basteve, lotarive dhe lojërave të tjera të fatit, në kuptim të ligjit për lojërat e fatit përjashtohen nga TVSH-ja. Përjashtohen ato furnizime të lojërave të përcaktuara në ligjin specifik “Për lojërat e fatit” dhe të cilat tatohen sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Nuk janë objekt i përjashtimit nga TVSH sipas kësaj dispozite çdo furnizim malli ose shërbimi që kryhet përgjatë organizimit të lojërave ose kryhen nga shoqëritë e licencuara për organizimin e këtyre lojërave. Nuk janë furnizime të përjashtuara nga TVSH gjithashtu komisionet për shërbimet e ndërmjetësimit ose komisionet e agjentëve për shitjen e biletave të lojërave apo lotarive të ndryshme, përse ligji nuk i përcakton këto përjashtime, si dhe përse këto shërbime nuk janë objekt i tatimit të ligjit të lojërave të fatit.

Shembull: Një shoqëri bastesh me kuaj i jep me qira 10 kuaj për organizimin e një shfaqje sportive një klubi sportive. Në këtë rast shoqëria e basteve ka kryer një furnizim të tatueshëm për

TVSH-në. Ky shërbim i vënies në dispozicion të kuajve nuk është objekt i tatimit të ligjit “Për lojërat e fatit”, si dhe nuk përjashtohet nga TVSH-ja sipas pikës f) të nenit 53 të ligjit.

Neni 44

Furnizimi i tokës, ndërtesës dhe dhënia me qira e pasurive të paluajtshme

Bazuar në pikën g) dhe gj) të nenit 53 të ligjit është furnizim i përjashtuar nga TVSH: furnizimi i ndërtesave apo i pjesëve të një ndërtese si dhe furnizimi i tokës, në të cilën qëndron ndërtesa, përveç furnizimit të procesit të ndërtimit; furnizimi i tokës

Me “ndërtesë” kuptohet çdo lloj strukture e fiksuar në tokë;

Me “tokë” kuptohet çdo zonë e papunuar, e papërpunuar, e pazhvilluar dhe e pandërtuar e tokës.

Në kuptim të dispozitës së mësipërme nuk përbën dallim përse i përket përjashtimit nga TVSH Nëse kemi të bëjmë me ndërtesa për banim apo për qëllime të tjera.

Gjithashtu bazuar në shkronjën h) të ligjit është furnizim i përjashtuar nga TVSH dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, përveç:

dhënies me qira të ndërtesave për një periudhë deri në dy muaj;

strehimit në hotele ose vende pushimi, të kryera në sektorin e hotelerisë ose në sektorë që kanë funksione të njëjta, përfshirë qiradhënien e kampeve të pushimit apo të terreneve të pajisura për kampingje;

dhënien me qira të zonave të destinuara për parkimin dhe magazinimin e automjeteve dhe mjeteve të tjera lëvizëse;

dhënien me qira të pajisjeve dhe makinerive të fiksuara në mënyrë të qëndrueshme;

dhënien me qira të kasafortave.

Sipas kësaj dispozite përjashtohet nga TVSH dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme, tokë ose ndërtesë.

Megjithatë sipas nenit 53, pika h) të ligjit parashikohet të zbatohen disa përjashtime nga përjashtimi i TVSH-së, duke i përcaktuar si furnizime të tatueshme furnizimet që përfshihen përkatësisht në nënpikat: i),ii),iii),iv),v, të pikës h), të nenit 53 të ligjit.

Bazuar në shkronjën h), të nenit 53 të ligjit janë furnizime të tatueshëm me shkallën e TVSH-së 20%:

dhënia me qira e ndërtesave për një periudhë me pak se 2 muaj. Për qëllime tatimore është i rëndësishëm shfrytëzimi i ndërtesave për qira dhe jo vetëm lidhja e kontratës.

Shembull 1: Nëse një person i tatueshëm ka lidhur një kontratë me një tjetër person të tatueshëm për dhënien me qira të ndërtesës për një periudhë 6 muaj (mbi 2 muaj). Personi që merr me qira ndërtesën parapaguan në momentin e lidhjes së kontratës shumën e qirasë për 6 muaj, kundrejt faturës së lëshuar nga personi i tatueshëm që kryen shërbimin e qiradhënies. Në faturën e lëshuar nuk shënohet vlera e TVSH-së si një furnizim i përjashtuar nga TVSH. Personi i tatueshëm e shfrytëzon ndërtesën me qira vetëm për 2 muaj dhe largohet duke prishur kontratën me qiradhënësin. Në momentin e prishjes së kontratës qiradhënësi pavarësisht parashikimeve dhe detyrimeve që kanë rënë dakord në kontratë për kthimin ose jo të shumës së parapaguar të qirasë, për qëllime të TVSH-së do të duhet të bëjë një rregullim të TVSH-së. Kështu në momentin që kontrata priset ai do të lëshojë një faturë tatimore me TVSH për vlerën e qirasë që do të mbajë qiramarrësit duke llogaritur TVSH. Në këtë faturë duhet të jetë shënuar që kjo faturë lëshohet për saktësim të faturës së lëshuar nr serial..... Datë..... për personin e tatueshëm..... me Nipt dhe vlerë Në librin e shitjeve të muajit do të regjistrojë me të kuqe veprimin e anuluar për faturën e përjashtuar nga TVSH të lëshuar më parë dhe do të regjistrojë si shitje me TVSH faturën e saktësimit. Veprimet e saktësimit do të bëhen në përputhje me përcaktimet në këtë udhëzim.

Gjithashtu janë furnizime të tatueshëm me shkallën 20 % të TVSH-së :

Strehimi në hotele ose vende pushimi, të kryera në sektorin e hotelerisë ose në sektorë që kanë funksione të njëjta, përfshirë qiradhënien e kampeve të pushimit apo të terreneve të pajisura për kampingje; hoteleria dhe qiradhënia e këtyre pasurive konsiderohen dhe trajtohen në të njëjtën mënyrë si hotelet edhe dhomat apo ambientet e dhëna me qira për pushime, në vende pushimi; Dhënien me qira të zonave të destinuara për parkimin dhe magazinimin e automjeteve dhe mjeteve të tjera lëvizëse. Ky rregull vlen si për vende ose zona për parkim të hapura të rrethuara dhe për zona parkimi të mbyllura si pjesë e ndërtesave,

Dhënien me qira të pajisjeve dhe makinerive të fiksuara në mënyrë të qëndrueshme:

P.sh. një spital jep me qira një universiteti skanerin e instaluar dhe të vendosur në një ambient të caktuar, të nevojshëm për zhvillimin e praktikës mësimore të studentëve. Në këtë rast qiradhënia e pajisjes së fiksuar në mënyrë të qëndrueshme për shkak edhe të instalimeve të nevojshme që duhen për përdorimin e tij, është e tatueshme me TVSH.

Për qëllime të këtij neni përfshihen në qiradhënien e pajisjeve dhe makinerive të fiksuara në mënyrë të qëndrueshme dhe si të tilla janë të tatueshme me TVSH, qiradhënia e pasurive të paluajtshme që përfshijnë një tërësi të aseteve (një fond tregtar) dhe që janë të përshtatshme për kryerjen e veprimtarive ekonomike. Për shembull dhënia me qira e një pike që furnizon me

karburant, e cila përveç ndërtesës (Nëse ekziston një e tillë) përfshin në tërësinë e saj që e bën të mundur për t'u shfrytëzuar pajisje të tjera dhe makineri, p.sh. përfshin depozitat e karburantit, pompat e karburantit, si dhe infrastrukturën e nevojshme, etj.

Dhënien me qira të kasafortave.

Për qëllime të TVSH-së nuk është i rëndësishëm statusi apo cilësia e personit të tatueshëm që jep me qira kasafortat, qoftë kjo një bankë ose institucion financiar ose një hotel, qiradhënia e kasafortave është furnizim i tatueshëm.

Neni 45

Ushtrimi i së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimet e përjashtuara

Pavarësisht nga trajtimi si furnizim i përjashtuar nga TVSH i qiradhënies së ndërtesave mbi 2 muaj, i parashikuara në nenin 53, pika h) të ligjit, personi i tatueshëm që kryen veprimtari të qiradhënies së ndërtesës gëzon të drejtën e zgjedhjes për ta trajtuar qiradhënien e ndërtesave si furnizim të tatueshëm me TVSH 20%.

Kjo e drejtë është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet për qiradhënien e ndërtesave për banim. Kjo e drejtë do të ushtrohet në përputhje me modalitetet dhe rregullat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, pavarësisht nga trajtimi si furnizim i përjashtuar nga TVSH i furnizimit (shitjes) të ndërtesës ose i pjesëve të një ndërtese, i parashikuar në nenin 53, pika g) të ligjit, personi i tatueshëm që furnizon ndërtesën ose pjesë të një ndërtese, gëzon të drejtën e zgjedhjes për ta trajtuar këtë furnizim si furnizim të tatueshëm me TVSH 20%.

E drejta për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimin e ndërtesës ose i pjesëve të një ndërtese është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm që furnizojnë apartamente, ndërtesa apo ambiente për banim ose kur blerësi është një individ .

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 15, datë 18.05.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 26.05.2017).

Neni 46

Përjashtimi i gazetave, revistave dhe reklamës nga media e shkruar

Bazuar në shkronjën “j” të nenit 53 të ligjit, furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetatat, furnizimi i gazetave, i revistave, si dhe furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Kështu, përjashtimi shtrihet për:

Shërbimin e shtypshkrimit të gazetave. Në këtë rast personi i tatueshëm që kryen shërbimin e shtypshkrimit të gazetës në faturën tatimore të lëshuar për botuesin e gazetës, vlerës së tatueshme nuk i ngarkon TVSH. Furnizime të tjera të shtypshkrimit nuk përfitojnë nga përjashtimi.

Shitja e gazetave dhe e revistave. Çdo material i ofruar jo në formën tradicionale të një gazete, reviste, pavarësisht përmbajtjes së tyre, që mund të lexohet nëpërmjet pajisjeve të tjera ndihmëse përfshirë ato elektronike, nuk është i përjashtuar në kuptim të këtij neni. Furnizim i përjashtuar është edhe shitja e Fletores Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, botuar nga Qendra e Publikimeve Zyrtare.

Furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar është furnizim i përjashtuar. Vlera e tatueshme në faturat tatimore që mediat e shkruara lëshojnë për porositësit e reklamave, nuk ngarkohet me TVSH.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 5, datë 21.02.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 26.02.2019.)

Neni 47

Përjashtime të tjera

Bazuar në pikën i), të nenit 53 të ligjit përjashtohen nga TVSH furnizimi i kartave të identitetit për shtetasit. Furnizimi i pasaportave për shtetasit nuk është furnizim i përjashtuar nga TVSH.

Bazuar në nenin 54 të ligjit trajtohen si furnizime të përjashtuara nga TVSH :

Furnizimet e mallrave të luajtshme të përdorura për një veprimtari të përjashtuar, sipas neneve 51 dhe 53, të ligjit, në rastin kur këto mallra nuk kanë qenë objekt i së drejtës së zbritjes së TVSH-së

Shembull: Një shkollë shet aparaturat e laboratorit të fizikës pasi i ka përdorur për qëllime të mësimdhënies. Në momentin kur i ka blerë këto pajisje shkolla i ka blerë me TVSH, por nuk ka zbritur TVSH-në pasi veprimtaria e saj është e përjashtuar nga TVSH. Pas 2 vjetësh ajo i shet , ose një pjesë të tyre. Shitja e këtyre pajisjeve sipas nenit 54 është e përjashtuar nga TVSH.

Furnizimet e mallrave, për të cilat TVSH-ja nuk ishte e zbritshme në blerjen ose përdorimin e tyre, në përputhje me nenin 74, të ligjit.

Shembull: Shoqëria shet një autoveturë të cilën e ka blerë me TVSH, por nuk e ka zbritur TVSH-në në momentin e blerjes për shkak të kufizimeve të përcaktuara në ligj. Ky furnizim është i përjashtuar nga TVSH sipas nenit 54 të ligjit.

Neni 48

Eksportet

1.Bazuar në nenin 57 të ligjit trajtohen si furnizime me shkallë zero të TVSH-së:

Furnizimi i mallrave të dërguara ose të transportuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Eksportet e mallrave duhet të vërtetohen dhe dokumentohen me dokumentacionin doganor të eksportit siç është parashikuar në legjislacionin përkatës. Për eksportin e mallrave shkalla zero e TVSH-së zbatohet në momentin e kryerjes së procedurave të eksportit.

Nuk përfitojnë nga trajtimi me shkallën zero të TVSH-së mallrat e transportuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, prej personave të tatueshëm, për t'u përdorur për pajisjen apo furnizimin e anijeve turistike, mjeteve fluturuese private apo të çdo lloj mjeti tjetër transporti të përdorur për përdorim privat. këto mallra nuk i nënshtrohen procedurave të eksportit.

Furnizimi i shërbimit të përpunimit të mallrave jo-shqiptare të kryera nga eksportuesi, të klasifikuara nën regjimin e përpunimit aktiv (punët fason) shërbime, të cilat i shtojnë vlerën mallit të përpunuar të destinuara për t'u ri-eksportuar janë furnizime me shkallë zero% të TVSH-së.

Sigurohet trajtimi me shkallën e TVSH-së 0 % për shërbimin e përpunimit të mallrave jo-shqiptare në regjim përpunimi aktiv në faturën e lëshuar nga operatori eksportues, faturë e cila i bashkëngjitet deklaratës doganore të ri-eksportit të këtyre mallrave.

Në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 57 të ligjit, në rastin kur furnizimi i shërbimit të përpunimit të mallrave joshqiptarë të destinuara për t'u riekportuar, kryhet nga një nënkontraktor, i cili e kryen këtë shërbim për llogari të shoqërisë së përpunimit aktiv që e ka kontraktuar (shoqëria eksportuese) e cila i nënshtrohet regjimit të përpunimit aktiv, ky furnizim shërbimi përpunimi është i tatueshëm me shkallën e TVSH-së 0%.

Nënkontraktori është një person i tatueshëm i pajisur me autorizimin përkatës prej autoritetit doganor.

Për kryerjen korrekte të procedurës për dokumentimin e shërbimit të përpunimit për këto mallra, si dhe për dokumentimin e lëvizjes së mallrave jo-shqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv, për qëllime tatimore duhet të zbatohet procedura e mëposhtme:

Furnizimi i shërbimit për përpunimin e mallrave joshqiptare, të destinuara për t'u riekportuar të kryer nga nënkontraktorët e pajisur me autorizimin përkatës prej autoritetit doganor, për llogari të shoqërive të përpunimit aktiv, është furnizim shërbimi i tatueshëm me TVSH 0%.

-Aktivitetet e klasifikuara nën regjimin e përpunimit aktiv, konsiderohen tërësisht të destinuara për ri-eksport.

-Kushtet e ekzistencës së kësaj natyre operacionesh janë:

Përpunuesi (nënkontraktori) asnjëherë nuk duhet të bëhet pronar i materialeve të sjella nga porositësi (shoqëria e përpunimit aktiv)

Materialet e sjella nga porositi si tek përpunuesi, duhet të trupëzohen tërësisht në produktin e fabrikuar.

Materialet e sjella nga porositi në formën e lëndës së parë duhet t'i kthehen atij fizikisht nga përpunuesi në formën e gjysmëproduktit ose produktit të gatshëm, me përjashtim të mbetjeve teknologjike gjatë procesit të prodhimit dhe në përputhje me kartat teknologjike të prodhimit. Kjo kërkon si domosdoshmëri, që këto materiale të jenë të identifikuara me dokumentacionin përkatës tek përpunuesi për gjatë gjithë kohës së përpunimit.

Nëse rezulton që sasia e gjysmëproduktit ose produktit të gatshëm është më e vogël nga sa duhej të ishte kundrejt materialeve të përdorura në përpunim, diferenca konsiderohet si shitje e kryer nga përpunuesi dhe është furnizim i tatueshëm me TVSH 20%. Për këtë qëllim shkëmbehet informacion për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Detyrime të veçanta

Midis porositisit (kontraktori kryesor i vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv) dhe përpunuesit (nënkontraktori) të jetë lidhur një kontratë në përputhje me Kodin Civil.

Përpunuesit duhet të mbajnë një regjistër të veçantë, ku përshkruhet realizimi i punimeve për llogari të porositisit. Në këtë regjistër duhet të shënohet identiteti i porositisit, pra emri tregtar, NIPT, emri/mbiemri i administratorit, statusi juridik i tij, adresa e selisë. Për çdo operacion hyrje dhe dalje, shënohet:

Lloji dhe sasia e materialeve objekt i përpunimit dhe data e hyrjes. Lëvizja e mallit do të dokumentohet me faturë shoqërimi.

Lloji dhe sasia e gjysmë produktit ose produktit të fabrikuar, si dhe data e daljes.

Në regjistër duhet të evidentohet edhe malli gjendje tek përpunuesi. Për këtë hartohet inventari mujor.

Lëvizja e çdo sasi gjysmëprodukti ose produkti të gatshëm nga përpunuesi (nënkontraktori) tek porositi (kontraktori), shoqërohet me faturë tatimore me TVSH 0% për vlerën e shërbimit të kryer.

Për zbatimin e këtyre rregullave çdo person i tatueshëm nënkontraktor, menjëherë me marrjen e autorizimit të autoritetit doganor, paraqet një kërkesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore përkatëse. Kërkesës i bashkëngjitet një kopje e autorizimit të lëshuar nga autoriteti doganor, i cili e njeh nënkontraktorin si të tillë, si dhe një kopje të kontratës së lidhur me kontraktorin (shoqërinë e përpunimit aktiv).

Drejtoria Rajonale Tatimore lëshon për nënkontraktorin, autorizimin, “Për përfshirjen në operacione të përpunimit aktiv”, jo më vonë se 30 ditë nga data e lëshimit të autorizimit nga ana e autoritetit doganor. Vlefshmëria e këtij autorizimi është e njëjtë me atë të lëshuar nga autoriteti doganor. Për çdo ndryshim nënkontraktori është i detyruar të njoftojë autoritetin tatimor përkatës.

Të gjitha autorizimet e lëshuara evidentohen nga Drejtoria Rajonale Tatimore në një regjistër të veçantë ku shënohet emri i personit të tatueshëm (nënkontraktorit), NIPT, adresa, lloji i veprimtarisë, kontraktori për të cilin punon, data e lëshimit të autorizimit dhe afati i vlefshmërisë. [Furnizimet e shërbimit në kuadër të regjimit të përpunimit aktiv nuk kryhen nga nënkontraktorë të paautorizuar nga autoritetet doganore dhe tatimore përkatëse..](#)

Në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe të këtij udhëzimi për të drejtën e zbritjes së TVSH-së, nënkontraktori person i tatueshëm ka të drejtë të zbresë TVSH-në për shpenzime të ndryshme të bëra me TVSH të lejuara në kushte të regjimit që aplikon, të cilat i shërbejnë furnizimit të shërbimeve të tatueshme të përpunimit të këtyre mallrave për llogari të shoqërisë së përpunimit aktiv. [Shoqëria e përpunimit aktiv që rieksporton këto mallra nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e ngarkuar në faturën e marrë prej saj, për furnizimin e shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare, të kryera në kuadër të regjimit prej 1 janar 2019, pasi furnizimi është i tatueshëm me 0 % dhe jo më 20%](#)

Gjithashtu trajtohen si furnizime shërbimi me shkallë zero të TVSH-së furnizimi i shërbimeve të lidhura drejtpërdrejtë me importimin e mallrave në Shqipëri, vlera e të cilave bazuar në nenin

të ligjit përfshihet në vlerën e tatueshme të mallrave të importuara dhe si të tilla tatohen në momentin e importit. Të tilla janë shpenzimet dytësore, të tilla si shpenzimet e ambalazhimit, të transportit që ndodhin deri në momentin e hyrjes së mallit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, cilado qoftë mënyra e transportit të përdorur.

Nuk përfshihen në këto shërbime, kur bëhen pjesë e vlerës së tatueshme në import, shërbimet e përjashtuara nga TVSH sipas neneve 51 dhe 53 të ligjit.

Vlera e çdo furnizimi të shërbimeve të lidhura me importimin e mallrave, e cila nuk është përfshirë në vlerën e tatueshme të importit tatohen me TVSH në shkallën standarde në të njëjtën mënyrë si çdo shërbim i kryer në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3.Gjithashtu bazuar në nenin 57, pika c) të ligjit eksporti i mallrave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, prej organizatave jofitimprurëse si pjesë e veprimtarisë së tyre humanitare, bamirëse jashtë Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve të posaçme është furnizim me shkallën zero të TVSH-së. TVSH e paguar në blerje për këto mallra, të destinuara për eksport për përmbushjen e qëllimit bamirës të tyre, e dokumentuar me faturën përkatëse tatimore të blerjes është e rimbursueshme. Organizatat që i nënshtrohen procedurës së mëposhtme nuk duhet të kryejnë veprimtari ekonomike qoftë edhe dytësore. Ato duhet të jenë qartësisht me qëllim mirëbërës dhe humanitar dhe shpërndajnë falas pa pagesë mallrat që blejnë.

Për të realizuar procedurën e rimbursimit të këtyre organizatave ato i nënshtrohen procedurës së mëposhtme:

Në momentin e eksportit këto organizata duhet të paraqesin pranë autoritetit tatimor, që kryhen procedurat e eksportit, faturat origjinale të blerjes së tyre. Lloji, sasia dhe vlera e mallrave të eksportuara duhet të përputhet me llojin, sasinë dhe vlerën e mallrave të blera sipas faturave tatimore origjinale të blerjes së këtyre mallrave në Shqipëri.

Blerësi i mallrave në faturë duhet të jetë organizata jofitimprurëse (Emër, Nipt) që kryen eksportin.

Faturat e blerjes së mallrave duhet të kenë lidhje direkte me mallrat që eksportohen dhe të mos jenë përdorur në Republikën e Shqipërisë.

Në momentin e kryerjes së procedurave të eksportit pranë autoritetit doganor, organizata jofitimprurëse plotëson formularin bashkangjitur këtij udhëzimi në të cilin deklarohen në mënyrë analitike të gjitha faturat e blerjes së mallrave që eksportohen me emrin e personit të tatueshëm shitës, nr serial, datë, vlera e tatueshme, TVSH dhe vlera totale sipas faturave. Në përfundim të procedurës ky dokument vulozet nga autoriteti doganor dhe një kopje i vihet në dispozicion organizatës.

Pasi është kryer eksporti i mallrave për rimbursimi në TVSH-së organizata jofitimprurëse paraqet pranë [Drejtore se Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve](#) ku është e regjistruar kërkesën për rimbursim të TVSH-së dhe bashkangjitur dokumentacionin si vijon:

Fotokopje të noterizuar të certifikatës së Nipt-it;

Fotokopje të noterizuar të faturave origjinale të blerjes;

Deklaratën e eksportit në të cilën organizatat që kërkon rimbursimin duhet të jetë eksportuesi i mallit;

Një kopje e noterizuar e marrëveshjes së posaçme me organizatën për të cilën mallrat janë destinuar, e cila duhet të jetë e vendosur jashtë Shqipërisë. Pritësi (destinuesi) i mallit në deklaratën e eksportit dhe organizata, e cila është palë në marrëveshjen e posaçme, duhet të përputhen;

Një kopje e noterizuar e formularit të plotësuar dhe vulosur nga autoriteti doganor sipas procedurës së mësipërme. Shuma e TVSH-së sipas faturave për të cilat kërkohet të rimbursohet TVSH duhet të jetë e njëjtë me shumën e TVSH-së që rezulton në formularin e plotësuar nga autoriteti doganor në momentin e eksportit të justifikuar me deklaratën doganore të eksportit;

Një deklaratë ku jep informacion për nr. e llogarisë në të cilën do të rimbursohet TVSH. Pas marrjes së këtij dokumentacioni [Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve](#) kryen nga zyra verifikimet e dosjes së paraqitur. Nëse e gjejnë të nevojshme mund të shkëmbejnë informacion edhe me autoritetin doganor. Verifikon shlyerjen e detyrimeve të tjera tatimore që kjo organizatë mund të ketë dhe pas këtij procesi procedon me

miratimin e shumës së TVSH-së së rimbursueshme duke vijuar procedurat e rimbursimit nëpërmjet thesarit.

Në rast refuzimi të rimbursimit për pasaktësi ose mosrakordim të shumave, [Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve](#) shprehet me shkrim duke dhënë edhe arsyet e refuzimit të rimbursimit të kërkuar. [Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve](#) mban në një regjistër të veçantë ku regjistron të gjitha procedurat e rimbursimit të ndjekura sipas kësaj procedure.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/4, datë 04.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 07.09.2015)

Neni 49

Procedura e rimbursimit për mallrat në bagazhin personal të udhëtarit

Për zbatimin e dispozitës së nenit 58 të ligjit, për rimbursimin e TVSH-së së paguar në Shqipëri për blerje mallrash të destinuara për tu transportuar në bagazhin personal të udhëtarëve, përcaktohet procedura e mëposhtme:

Trajtimi me shkallën zero të TVSH-së realizohet nëpërmjet procedurës së rimbursimit të TVSH-së së paguar në blerjen e këtyre mallrave.

Për qëllime të ushtrimit të së drejtës për rimbursim të TVSH-së për qëllime të këtij neni konsiderohen si eksporte mallrat e eksportuara në bagazhin personal të udhëtarit, vlera totale e të cilave përfshirë TVSH-në nuk është më e vogël se 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë.

Një person konsiderohet udhëtar jo i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse vërtetohet se banesa e përhershme apo rezidenca e tij e zakonshme nuk ndodhet brenda këtij territori.

Për të vërtetuar banesën e përhershme ose rezidencën e zakonshme individit duhet ti ketë këto të treguara në pasaportën, kartën e identitetit ose në një dokument të posaçëm të lëshuar nga autoritetet e shtetit ku ka rezidencën.

Individi udhëtar, i cili në territorin e Shqipërisë ka blerë mallra me një vlerë totale jo më pak se 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë dhe është në gjendje të vërtetojë se këto mallra janë të destinuara për tu transportuar në bagazhin e tyre personal dhe eksportohen për tu përdorur jashtë territorit të Shqipërisë, nga udhëtari i cili adresëne përhershme ose rezidencën e ka jashtë Shqipërisë, atëherë ky furnizim konsiderohet si eksport dhe trajtohet me shkallën zero të TVSH-së.

Për të konsideruar furnizimin e këtyre mallrave si eksport për të ushtruar të drejtën për rimbursim të TVSH-së udhëtari duhet të plotësojë njëkohësisht tre kushte:

a) udhëtari duhet të vërtetojë se nuk është i vendosur brenda Republikës së Shqipërisë dhe për këtë duhet të tregojë se banesa e tij e përhershme ose rezidenca e zakonshme është jashtë Shqipërisë;

mallrat e blera në territorin shqiptar transferohen jashtë Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 3 muaj që ndjekin datën e kryerjes së furnizimit sipas datës së shënuar në faturën origjinale të blerjes së mallit;

vlera totale e furnizimit e shprehur në lekë ose kundërvlerën e saj në lekë, përfshirë TVSH-në, të mos jetë më e vogël se vlera 120 000 (njëqind e njëzet mijë)lekë.

Mallrat e lejuara në bagazhin personal të udhëtarëve që lënë territorin shqiptar janë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit doganor shqiptar.

Udhëtari i cili përmbush kushtet e parashikuara në këtë dispozite, ka të drejtë të aplikojë për rimbursimin e TVSH-së.

Për qëllime të zbatimit të kësaj dispozite udhëtari duhet të kryejë procedurën që vijon:

Në momentin që udhëton jashtë Shqipërisë ai paraqitet pranë autoritetit doganor në pikën e kalimit të kufirit përkatës dhe deklaron se kërkon të kryejë procedurë për rimbursim të TVSH-së sipas nenit 58 të ligjit “Për TVSH-në”.

Në këtë moment duhet ti paraqesë autoritetit tatimor faturën origjinale tatimore të shitjes në të cilën udhëtari është edhe individ i blerës. Në faturë përveç emrit duhet të jenë shënuar edhe të dhënat e identifikimit të dokumentit identifikues të udhëtarit, pasaportë ose kartë identiteti. Është kusht që fatura të këtë bashkangjitur edhe kuponin tatimor që vërteton pagesën. Gjithashtu në këtë moment ai plotëson formularin sipas modelit bashkangjitur këtij udhëzimi që i vihet në dispozicion nga autoriteti doganor.

Ndër të dhënat që përmban ky formular janë të dhënat identifikuese të udhëtarit, adresë saktë të banimit, numër telefoni, numri i llogarisë bankare, përshkrim i hollësishëm të mallit duke përfshirë këtu llojin, tipin, sasinë, çmimin, vlera e paguar për mallrat e blera në territorin e Republikës së Shqipërisë, vlera e TVSH-së. Gjithashtu udhëtari paraqet biletën e udhëtimit, kur ka një të tillë.

Ky formular së bashku me faturën origjinale të blerjes së mallrave, bashkangjitur me kuponin tatimor që vërteton kryerjen e pagesës, vulosen nga autoriteti doganor shqiptar.

Aplikimi për rimbursim të TVSH-së nga udhëtari bëhet kur udhëtari është jashtë Shqipërisë brenda një periudhe prej 30 ditësh nga momenti i largimit nga territori shqiptar. Aplikimi për rimbursim përmban:

Formularin e plotësuar dhe të vulosur nga autoriteti doganor në pikën e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë;

Faturën origjinale të blerjes, bashkangjitur së cilës duhet të jetë kuponi tatimor, të vulosur prej autoritetit doganor;

Fotokopje të dokumentit të identifikimit të udhëtarit;

Këto dokumente dërgohen me postë në adresëne autoritetit tatimor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, (adresa e autoritetit tatimor i bëhet e ditur udhëtarit në formularin e aplikimit për rimbursim që do të dërgohet me poste prej tij)

Autoriteti tatimor nëpërmjet [Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve](#) brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit verifikon aplikimin për rimbursim nëse janë plotësuar të gjitha kushtet, procedurat dhe dokumentacioni i kërkuar sipas këtij neni dhe nëse po urdhëron rimbursimin e shumës së TVSH-së në llogarinë bankare të udhëtarit të shënuar në formularin e dërguar.

Nëse pas verifikimit rezulton se nuk janë plotësuar korrekt, afatet, procedurat, kushtet dhe dokumentacioni i kërkuar, autoriteti tatimor refuzon kërkesën për rimbursim të udhëtarit, duke i kthyer përgjigje zyrtare në adresëne shënuar në formularin për aplikim.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/4, datë 04.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 07.09.2015)

Neni 50

Transporti ndërkombëtar dhe shërbimet e lidhura me të

Janë furnizime me shkallë zero të TVSH-së transaksionet e mëposhtme të transportit ndërkombëtar:

furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme, për lundrimin në det të hapur të:

- i. anijeve për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve me pagesë ose,
- ii. anijeve për ushtrimin e veprimtarive tregtare, industriale e të peshkimit,
- iii. anijeve për kryerjen e veprimeve të shpëtimit dhe ndihmës në det
- iv. anijeve për peshkimin bregdetar, përveç furnizimit me rezerva të tjera të

nevojshme;

furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme të anijeve luftarake të përfshira në kodin e Nomenklaturës së Kombinar (NC) 8906 10 00, të cilat lënë territorin e Republikës së Shqipërisë me destinacion ose për t'u ankoruar në një port jashtë saj;

furnizimi i shërbimeve të tilla si: riparimi, transformimi, mirëmbajtja dhe dhënia me qira e tyre, të kryera për anijet për lundrim në det të hapur për qëllime të:

- transportit ndërkombëtar të pasagjerëve me pagesë;
- për ushtrimin e veprimtarive tregtare, industriale e të peshkimit;
- për kryerjen e veprimeve të shpëtimit dhe të ndihmës në det;

furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme të mjeteve fluturuese që përdoren nga kompanitë e transportit ajror për transport ndërkombëtar me pagesë;

dh) furnizimi i shërbimeve të tilla si: riparimi, transformimi, mirëmbajtja dhe dhënia me qira e tyre, të kryera për mjetet fluturuese që përdoren nga kompanitë e transportit ajror për transport ndërkombëtar me pagesë.

Shërbime të lidhura drejtpërdrejtë me mjetet për transport ndërkombëtar detar dhe ajror

A.Për mjetet detare

Trajtohen si furnizime me zero % Nëse shërbimet kryhen për anijet që janë të licencuara për aktivitetin e tyre ndërkombëtar sipas legjislacionit shqiptar apo të huaj të fushës kur kryejnë aktivitet në ujëra ndërkombëtare si më poshtë:

Anijet e përdorura për një veprimtari industriale në det të hapur dhe për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve me pagesë. Këtu përfshihen vetëm anijet e përdorura në hapësirën detare që ndodhet përtej kufirit të jashtëm të detit territorial të Republikës së Shqipërisë, të licencuara sipas legjislacionit shqiptar apo të huaj.

Anijet e posaçme të licencuara për peshkimin profesional, vetëm kur peshkojnë në ujëra ndërkombëtare;

Anijet e shpëtimit dhe të asistencës në det, përfshirë anijet e pilotimit dhe ormexhimit.

Personi i tatueshëm që kryen furnizimet sa më sipër duhet të dokumentojë dhe të zotërojë të gjithë dokumentacionin e duhur sipas legjislacionit të fushës që të vërtetojë kryerjen e furnizimit për mjetet si më sipër. Për këtë ai duhet të pajiset edhe me një vërtetim /deklaratë noteriale të lëshuar nga blerësi (zotëruesi i anijes) për çdo shërbim të kryer që dëshmon se anija që furnizohet kryen aktivitetin ndërkombëtar sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen të ligjit. Gjithashtu personi i tatueshëm duhet të mbajë në një regjistër të veçantë transaksionet për të cilin aplikon nenin 59 si dhe detaje të blerësit, të dhënat mbi anijen, etj.

Nuk përfshihen në trajtimin sipas nenit 59 anijet që nuk janë pjesë e kategorive veçanërisht të përcaktuara më sipër. I tillë është veçanërisht rasti i:

- anijeve të përdorura për një veprimtari industriale brenda ujërave territoriale;
- anijeve të kultivuesve të midhjeve, kultivuesve të stridheve, kultivuesve të butakëve -anijeve për qëllime sportive ose për argëtim -anijeve të Flotës Kombëtare.

Shërbimet e kryera për këto mjete nuk konsiderohen si shërbime në funksion të transportit ndërkombëtar dhe janë të tatueshme me shkallën tatimore 20%.

B.Shërbime të kryera për mjetet detare dhe ngarkesën e tyre

Bazuar në nenin 59 pika ç) dhe e) të ligjit konsiderohen si shërbime të kryera për nevoja të drejtpërdrejta të këtyre anijeve apo ngarkesës së tyre shërbimet e mëposhtme të cilat duhet të kryhen brenda hapësirës portuale.

Shërbimi për përdorimin e kanalit të portit, nga mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

Shërbimi për qëndrimin në kalatat e portit të mjeteve lundruese që operojnë në transport ndërkombëtar.

Shërbimi për qëndrimin në kalatë pas veprimeve tregtare të mjeteve lundruese që operojnë për transport ndërkombëtar.

Shërbimi i përdorimit të kalatës nga mjetet lundruese që operojnë për transport ndërkombëtar;

Shërbimi i rimorkimit dhe pilotimit të anijes për transport ndërkombëtar;

Shërbimet shëndetësore dhe sanitare që kryhen në mjetet lundruese të destinuara për transportin ndërkombëtar.

Shërbimi për ngarkimin e mallrave, si dhe shërbimet ndihmëse (përpunimi i tyre, manipulimi në sheshe, magazinimi), për eksportin e kryer me mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

Shërbimi për shkarkimin e mallrave deri në kalatë dhe për tranzit ndërkombëtar, si dhe shërbimet ndihmëse për këto të fundit (përpunimi i tyre, manipulimi në sheshe, magazinimi) të kryera nga mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

Shërbimet për ngarkimin e kontenierëve, si dhe shërbimet ndihmëse (magazinimi, përpunimi i kontenierëve, pastrimi, shërbimet mbështetëse), për eksportin e kryer me mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

Shërbimet për shkarkimin e kontenierëve deri në kalatë dhe për tranzit ndërkombëtar, si dhe shërbimet ndihmëse për këto të fundit (magazinimi, përpunimi i kontenierëve, pastrimi, shërbimet mbështetëse) të kryera nga mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

Shërbimet për çdo prekje të trageteve që operojnë në transportin ndërkombëtar;

Shërbimi për imbarkimin e pasagjerëve dhe mallrave të tyre për tragetet që operojnë në transportin ndërkombëtar.

Shërbimi për çimbarkimin e pasagjerëve dhe mallrave të tyre për tragetet që operojnë në transportin ndërkombëtar.

Shërbimet e pastrimit, riparimit apo mirëmbajtjes të mjeteve lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

Shërbimi për mbrojtjen kundër zjarrit për mjete lundruese dhe ngarkesën e tyre, që operojnë në transportin ndërkombëtar.

Furnizimi me karburant dhe me ushqime për t'u konsumuar në bord.

C.Për mjetet ajrore

Shërbime të kryera për mjete detare dhe ngarkesën e tyre

Konsiderohen si shërbime të kryera për nevoja të drejtpërdrejta të mjeteve fluturuese ose ngarkesës së tyre dhe trajtohen me shkallë zero të TVSH-së furnizimet e shërbimeve të mjeteve fluturuese që përdoren nga kompanitë e transportit ajror për transport ndërkombëtar me pagesë.

Personi i tatueshëm që kryen furnizimet sa më sipër duhet të dokumentojë dhe të zotërojë të gjithë dokumentacionin e duhur sipas legjislacionit të fushës që të vërtetojë kryerjen e furnizimit për mjetet fluturuese për transport ndërkombëtar dhe për nevoja të tyre. Për këtë ai duhet të pajiset edhe me një vërtetim /deklaratë noteriale të lëshuar nga blerësi (zotëruesi i mjetit) për çdo shërbim të kryer që dëshmon se mjeti fluturues për të cilin është kryer shërbimi kryen transport ndërkombëtar sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen të ligjit. Gjithashtu personi i tatueshëm duhet të mbajë në një regjistër të veçantë transaksionet për të cilin aplikon nenin 59 si dhe detaje të blerësit, të dhënat mbi mjetin fluturues etj.

Nuk janë furnizime shërbimi me 0% shërbimet e kryera për:

mjetet fluturuese të përdorura për kompanitë ajrore, të cilat nuk i plotësojnë kushtet e transportit ndërkombëtar, referuar legjislacionit të fushës;
avionët, mjetet fluturuese për turizëm apo për përdorim privat.

Ç.Furnizimet e shërbimeve të kryera për nevojat e drejtpërdrejta të mjeteve fluturuese dhe ngarkesës së tyre

Furnizimet e shërbimeve të mëposhtme duhet të jenë kryer brenda hapësirës së aeroporteve:

Shërbimet për uljen e ngritjen e avionëve për transport ndërkombëtar.

Shërbimi i ndriçimit të pistës së ulje- ngritjes së avionëve për transport ndërkombëtar.

Shërbimi për drejtimin dhe parkimin e avionëve në pistë për transport ndërkombëtar.

Shërbime të lidhura me mbërritjen, parkimin dhe nisjen e mjeteve fluturuese.

Shërbimet e pastrimit, ngarkimit dhe shkarkimit të avionit për transport ndërkombëtar të pasagjerëve.

Shërbimet për mirëmbajtjen dhe riparimin e avionëve për transport ndërkombëtar.

Shërbimi i ruajtjes dhe shërbimi për parandalimin dhe luftën kundër rënies së zjarrit;

Shërbimet për përdorimin e pajisjeve të aeroportit të destinuara për avionë për transport ndërkombëtar.

Shërbimet që kryhen për sigurinë, ruajtjen dhe kontrollin e pasagjerëve dhe mallrave në aeroporte, të destinuara për transport ndërkombëtar.

Shërbimet e imbarkimit dhe zbarkimi i pasagjerëve dhe bagazheve të tyre.

Ngarkimi dhe shkarkimi i mjeteve fluturuese.

Manovrimi i mallrave si operacion mbështetës i ngarkimit dhe shkarkimit të mjeteve fluturuese.

Operacionet e asistencës për pasagjerët (veçanërisht transporti i pasagjerëve nga terminali në mjetin fluturues), operacione të lidhura me regjistrimin e pasagjerëve dhe atë të bagazheve të tyre.

Shërbimet e avaro-shpëtimit.

Furnizimi i materialeve të nevojshme në avion, karburant për avionët dhe shërbimi catering në bord.

2. Transporti ndërkombëtar i pasagjerëve

Bazuar në nenin 59 të ligjit, transporti ndërkombëtar i pasagjerëve nga Republika e Shqipërisë me destinacion jashtë Republikës së Shqipërisë është furnizim shërbimi me shkallë zero të TVSH-së.

Vendi i furnizimit të transportit të pasagjerëve të cilët nisen nga Shqipëria me destinacion jashtë saj pa ndalesë është në Shqipëri në proporcion me distancën e përshkruar dhe si i tillë vendi i tatimit është në Shqipëri. Ky shërbim në Shqipëri është i tatueshëm me shkallën e TVSH-së 0 % bazuar në nenin 59 pika ë) të ligjit.

Transporti ndërkombëtar i pasagjerëve përfshin:

Transportin ajror ose detar të pasagjerëve që kanë si destinacion një vend jashtë Shqipërisë;

Transportin rrugor të pasagjerëve që kanë si destinacion një vend jashtë Shqipërisë.

Ndërmjetësit e biletave (agjencitë) e transportit ndërkombëtar dhe shërbime për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve

Në cilësinë e ndërmjetësve transparent (agjencitë e biletave të transportit ndërkombëtar të pasagjerëve) që veprojnë në emër dhe për llogari të një personi tjetër bazuar në nenin 62 të ligjit, furnizimi i shërbimit të kryer prej tyre si agjent për biletat e udhëtimit për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve, është furnizim shërbimi i tatueshëm me shkallën 0 % të TVSH-së.

Gjithashtu furnizimi i shërbimit në rolin e agjentit të mbledhjes dhe pagesës së tarifës për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë si shërbim i lidhur me transportin ndërkombëtar të pasagjerëve është i tatueshëm me 0%

3. Transporti ndërkombëtar i mallrave

Për të përcaktuar tatueshmërinë e shërbimit të transportit ndërkombëtar të mallrave është e nevojshme të analizojmë sipas konceptit të vendit të furnizimit të shërbimit.

Vendi i furnizimit të shërbimit të transportit të mallrave nga një person i tatueshëm për një person të tatueshëm, përsa ligji nuk përcakton ndryshe është në vendin e marrësit të shërbimit.

Në rastin kur marrësi i shërbimit të transportit ndërkombëtar të mallrave është një person tatueshëm në Shqipëri, vendi i furnizimit të shërbimit të transportit është në Shqipëri. Ky shërbim është i tatueshëm me TVSH në Shqipëri, pavarësisht destinacionit të mallrave.

Nëse personi i tatueshëm marrës i shërbimit të transportit të mallrave me destinacion jashtë Shqipërisë është një person i tatueshëm jashtë Shqipërisë atëherë vendi i tatimit është në vendin e marrësit, sipas rregullit të përgjithshëm të përcaktuar në ligj mbi vendin

furnizimit të shërbimit. Ky furnizim shërbimi nuk është i tatueshëm në Shqipëri kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm jashtë Shqipërisë.

Personi i tatueshëm që kryen transportin duhet në çdo rast të vërtetojë që transporti ndërkombëtar i mallrave është bërë për një person të tatueshëm jashtë Shqipërisë si dhe të faktojë me dokumente udhëtimin e kryer jashtë, karakteristikat e mallit të transportuar si dhe të vërtetojë eksportin e mallit.

Në zbatim të nenit 57 pika d) të ligjit, në rastin kur transporti ndërkombëtar i mallrave është një proces i vazhdueshëm përfshirë eksportin e mallrave që transportohen deri në dorëzimin e tyre në destinacionin që ndodhet jashtë territorit shqiptar, atëherë pavarësisht vendit ku fillon transporti i mallrave, ky shërbim transporti konsiderohet shërbim i lidhur drejtpërdrejtë eksportin e mallrave dhe zbatohet shkalla e TVSH-së 0%.

Për këtë transportuesi duhet të vërtetojë që ka kryer shërbimin e transportit ndërkombëtar deri në destinacionin jashtë Shqipërisë, të mallrave për të cilat vërteton se është kryer procedura e eksportit, nëpërmjet deklaratës së eksportit.

Gjithashtu transportuesi duhet të regjistrojë dhe të paraqesë:

- një vërtetim të lëshuar nga pronari i mallit, me anë të të cilit ai vërteton se transporti është kryer për mallrat e destinuara për eksport. Vërtetimi duhet të lëshohet jo më vonë se momenti i faturimit të transportit dhe në të duhet të jenë shkruar përveç destinacionit të produkteve dhe emrit të klientit, karakteristikat e mallrave të transportuara.

- të regjistrojë për çdo transport në kontabilitetin e tij ose në librin e veçantë të transportit, transportet e kryera jashtë Shqipërisë, duke treguar datën e regjistrimit, emrin dhe adresën e klientit të huaj;

-t'i bashkëngjisë kontabilitetit vërtetimet që i janë dorëzuar nga klientët e huaj dhe kopjet e faturave që këta të fundit duhet t'i dërgojnë, duke shënuar me korrektësi referencat (numrat, datat, pikat e hyrjes doganore) në deklaratat e eksportit të mallrave të transportuara.

Transportuesit i duhet të provojë dhe të posedojë të gjitha vërtetimet që tregojnë se mallrat e transportuara e kanë kaluar efektivisht kufirin, autorizimin e transportit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet përkatëse.

Prova për dërgesën e mallrave me destinacion një vend tjetër mbështetet nga kopjet e faturave dhe sipas rastit, nga vërtetimet e dorëzimit të mallit apo nga fotokopjet e tyre kur këto dokumente të fundit, jo të detyrueshme, janë plotësuar nga dërguesi apo nën përgjegjësinë e tij. Nga ana tjetër, këto dokumente përbëjnë provën e dërgesës së mallrave drejt një vendi apo territori eksportues për transportet që nuk kanë nevojë për autorizim të veçantë të transportit ndërkombëtar.

Ne rastin kur malli i transportuar nuk ka shkuar në destinacion jashtë Shqipërisë, shërbimi i transportit është i tatueshëm me 20%

Për arsye të thjeshtimit të procedurës, ndërmarrjet që kryejnë transport ndërkombëtar, por që për arsye procedure nuk mund të sigurojnë dokumentacionin e kërkuar për të provuar transportin ndërkombëtar, aplikojnë TVSH 20% për shërbimin dhe klienti ka të drejtë të aplikojë zbritjen e TVSH-së në përputhje me aktivitetin që kryen.

Nuk përfiton nga trajtimi me 0%, furnizimi i shërbimit të transportit ndërkombëtar i kryer për një person të pa-tatueshëm. P.sh. transporti i pajisjeve të banimit jashtë Shqipërisë të një individi.

Dërgesat postare për eksport

Dërgesat me anë të shoqërive postare të vendosura në Shqipëri të cilat marrin pjesë në trafikun ndërkombëtar të pakove, zarfeve, kolive përbën një furnizim transporti i lidhur me dërgesa (mallra) që eksportohen. Shërbimi që sigurojnë këto shoqëri, duke dërguar jashtë territorit të Shqipërisë, pako, zarfe apo koli postare, për të cilat vërtetohet eksporti është furnizim drejtpërdrejtë i lidhur me eksportin, i tatueshëm me 0% të TVSH-së.

Mallrat e vendosura në regjim doganor

Trajtohen si furnizime me shkallë zero furnizimet e mallrave të vendosura nën regjimet doganore të përcaktuara në nenin 64 të ligjit. Autoriteti doganor ka përgjegjësinë për dokumentimin dhe kryerjen e procedurave për mallrat e vendosura në regjime doganore në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin doganor në fuqi.

Për mallrat që i nënshtrohen regjimeve doganore të përcaktuara në nenin 64 të ligjit, TVSH pezullohet deri në momentin e daljes nga regjimi. Në momentin e daljes nga regjimi për t'iu nënshtruar procedurave të importit llogaritet TVSH-ja për mallrat.

Bazuar në nenin 65 të ligjit trajtohen si furnizime me shkallë zero veprimet e mëposhtme:

furnizimet e mallrave që janë të destinuara për t'u pranuar në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të trupëzohen në platformat e shpimit ose të shfrytëzimit, në funksion të ndërtimit, riparimit, mirëmbajtjes, shndërrimit ose pajisjes së këtyre platformave ose për lidhjen e tyre me tokën;

furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme i platformave të shpimit ose të shfrytëzimit, të vendosura në detin territorial të Republikës së Shqipërisë.

Procedura për dokumentimin, verifikimin dhe lejimin e këtyre transaksioneve në momentin kur këto mallra largohen për në ujërat territoriale të Shqipërisë, për t'u siguruar që janë përdorur në destinacionin e përcaktuar nga ligji do të kryhet nga autoriteti doganor.

Neni 51

Importi dhe rregullat për TVSH-së

1.Kur mallrat me origjinë nga territore të tjera çlirohen për qarkullim të lirë në territorin doganor shqiptar, i cili përfshin territorin tokësor, ujërat territoriale, ujërat e brendshme dhe hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit doganor në fuqi, atëherë kemi të bëjmë me “importim të mallrave” dhe vendi i importimit të këtyre mallrave është në Shqipëri, në vendin ku këto mallra çlirohen për qarkullim të lirë.

Gjithashtu për mallrat, të cilat në momentin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë nuk janë në qarkullim të lirë, por i nënshtrohen ndonjërit prej regjimeve të parashikuara në nenet 64 dhe 65, të ligjit për TVSH-ne, ose nën regjime të përkohshme importimi, me përjashtim total nga taksat doganore, ose regjimit të tranzitit, vendi i importimit të këtyre mallrave është në Shqipëri, nëse këto mallra çlirohen nga regjimet ose situatat e përmendura në territorin doganor shqiptar.

2.Në zbatim të nenit 2 të ligjit për TVSH-në, të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen tatimit mbi vlerën e shtuar, përveç kur përjashtohen nga TVSH-ja në import sipas ligjit. Furnizimet e shërbimeve të përfshirë në vlerën e tatueshme në importin e mallrave, janë pjesë e importit të mallrave. Vlera e tatueshme në këtë rast është vlera e përcaktuar në momentin e importit nga autoriteti doganor dhe e pasqyruar në deklaratën doganore të importit.

3.TVSH-ja në importet e mallrave lind dhe bëhet e kërkueshme atëherë kur është kryer importimi i mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë. Momenti i regjistrimit të importit

në librin e blerjeve të personit të tatueshëm importues (kur importi quhet i kryer) është “Data e Çlirimit të mallrave“, datë kur mallrat çlirohen nga dogana. Ajo paraqitet në “Urdhrin e Lëshimit“, dokument i lëshuar nga organi doganor dhe i bashkëngjitet deklaratës doganore të importit.

4.Në import TVSH-ja paguhet nga personi ose personat përgjegjës për pagesën e detyrimeve doganore në import, siç përcaktohet në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.

TVSH-ja paguhet nga personi, i cili çliron mallrat për qarkullim të lirë nga regjimet e përcaktuara e pezullimit doganor të përcaktuar në nenet 64 dhe 65 të ligjit.

5.Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përbëhet prej vlerës së përcaktuar në import nga autoriteti doganor, mbi bazën e legjislacionit doganor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në Kodin Doganor, baza kryesore për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave është vlera e transaksionit, që është çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke marrë në konsideratë edhe rregullimet, kur është e nevojshme. Çmimi realisht i paguar apo që duhet paguar është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi të shitësi ose nga blerësi të një palë e tretë në përfitim të shitësit për mallrat e importuara dhe përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë si kusht për shitjen e mallrave të importuara.

Bazuar në nenin 44 të ligjit, vlera e tatueshme e mallrave të importuara përfshin, gjithashtu, nëse nuk janë përfshirë elementet e mëposhtme:

taksat, tatimet, detyrimet, tarifat dhe pagesa të tjera të detyrueshme për t’u paguar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, si edhe ato të detyrueshme, si rezultat i importimit, me përjashtim të TVSH-së.

shpenzimet dytësore, të tilla si shpenzimet komisionere, të ambalazhimit, të transportit dhe të sigurimit që ndodhin deri në momentin e hyrjes së mallit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në nenin 45 të ligjit në vlerën e tatueshme të mallrave të importuara nuk përfshihen uljet e çmimit për rastet e zbritjes për pagesa të hershme, të kryera për furnizimin apo uljet dhe reduktimet e çmimit që i bëhen blerësit apo klientit dhe të përfituara nga ai në momentin, në të cilin kryhet importimi.

6.Për mallrat që janë eksportuar përkohësisht jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që në vijim importohen përsëri në Republikën e Shqipërisë pasi i janë nënshtruar ndërkohë riparimit, transformimit, përshtatjes, punimit ose ripunimit jashtë Republikës së

Shqipërisë, vlera e tatueshme është e njëjtë me atë që do të ishte aplikuar nëse riparimi, përpunimi, përshtatja, punimi ose ripunimi do të kishin ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

7.Shkalla e TVSH-së qëzbatohet për importimet e mallrave është e njëjta shkallë e TVSH-së qëzbatohet për shitjen e të njëjtit mall brenda territorit të vendit.

Parimi i tatueshmërisë së njëjtë të furnizimit të mallrave si brenda vendit ashtu dhe në import zbatohet dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Kështu përjashtohen nga TVSH në import të gjitha ato mallra furnizimi i të cilave brenda vendit është i përjashtuar sipas dispozitave të ligjit.

Por bazuar në nenin 56 të ligjit aplikohen edhe përjashtime të tjera nga TVSH-ja në import. Këto përjashtime parashikohen nga ky ligj dhe në momentin e importit kryhen sipas rregullave të përcaktuara në përputhje edhe me legjislacionin doganor për përjashtimin nga taksat doganore.

8.Bazuar në nenin 75 të ligjit për të gëzuar të drejtën e zbritjes së TVSH-së, lidhur me importimet e mallrave, personi i tatueshëm duhet të zotërojë një dokument që provon importimin, të lëshuar në momentin e çlirimit për qarkullim të lirë të mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin ai cilësohet si marrësi ose importuesi i mallit dhe ku të shkruhet shuma e TVSH-së së paguar dhe mënyra e llogaritjes së saj;

9.Kreditimi në rastet e importeve

Pas kryerjes së procedurave të importit, autoriteti doganor mund të kryejë rivlerësime të vlerës doganore të mallrave të importuara. Dallohen rastet :

Rivlerësim në rritje i vlerës doganore të importit: personi i tatueshëm është debitor ndaj doganës. Vetëm pasi ai shlyen detyrimin ndaj doganës i njihet vlera e rritur e TVSH-sësë zbritshme nga importi në Deklaratën e TVSH-së të muajit në të cilin është bërë pagesa.

Në rast se nuk është paguar TVSH, personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të zbrësë TVSH-në.

Nëse pagesa për detyrimin e TVSH-së të vlerësuar nga autoriteti doganor në import është kryer përtej 12 periudhave tatimore nga momenti kur personit të tatueshëm i është kryer rivlerësimi duke u deklaruar debitor nga autoriteti doganor, atëherë TVSH e paguar më vonë se 12 periudha tatimore nuk njihet si e zbritshme.

Shembull : Në 12 janar 2015 personi i tatueshëm ka bërë një import një aktiv investimi me vlerë të tatueshme prej 1.000 000 lekë. Në deklaratën e periudhës tatimore 201501 ai deklaroi vlerën 1.000.000 lekë në kutinë Importe mallra investimi dhe TVSH përkatëse prej 200 000 lekë.

Në 25 shkurt 2015 dogana e rivlerëson në rritje vlerën e tatueshme nga 1.000.000 lekë në shumën 2.000.000 lekë dhe i kërkon personit të tatueshëm të paguajë detyrimin shtesë. Pagesa

për shtesën e TVSH-së prej 200.000 lekë bëhet në 5 prill 2015, . Kjo vlerë shtesë e dokumentuar me dokumentin përkatës doganor do të regjistrohet në librine blerjessë muajit prill dhe do të deklarohet në deklaratën e kësaj periudhe.

*Import rivlerësim në ulje i vlerës doganore:*personi i tatueshëm ka paguar TVSH në import më shumë nga sa i takonte dhe nga ana tjetër në autoritetin tatimor ka deklaruar TVSH të zbritshme, aq sa TVSH-ja e paguar në import.

Në rast se autoriteti doganor i bën një rivlerësim në ulje të vlerës doganore edhe TVSH-së përkatëse, njofton në të njëjtën kohë edhe autoritetin tatimor. Personi i tatueshëm detyrohet të ndryshojë deklarin e TVSH-së në përputhje me vlerat e saktësuara nga ana e autoritetit tatimor, për të reflektuar një situatë reale dhe në përputhje me deklaratat doganore. Nëse personi i tatueshëm nuk e bën me vullnetin e tij këtë saktësim, autoriteti tatimor kryen veprimet për saktësimin e TVSH-së së zbritshme.

Kafshët për majmëri, importimi i të cilave është i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, në bazë të nenit 56, pika 40 e ligjit, janë kafshët e gjalla për majmëri, të klasifikuara sipas kodeve të mëposhtëm të NK-së:

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/2, dt. 19.3.2015. Botuar në Fl. Z nr. 45, dt. 26.3.2015).

Në momentin e importimit të kafshëve të gjalla për majmëri, importuesi paraqet pranë organit doganor ku kryhen procedurat e zhdoganimit:

Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se, ushtron aktivitet në fushën e bujqësisë dhe peshkimit;

Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë se, importuesi ka stabiliment të rritjes për majmëri të kafshëve të gjalla.

Për importin e larvave të peshkut, bëhet verifikimi nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë pranë degëve doganore kufitare. Inspektorët e Drejtorive Rajonale të Bujqësisë plotësojnë formularin tip i cili verifikon që produkti i importuar është larvë sipas kodeve tarifore të përcaktuara në këtë pike.

Në datën 5 të çdo muaji, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i dërgon zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve listën e importuesve të kafshëve të gjalla, sasisë dhe vlerën, të kafshëve të gjalla për majmëri të importuara.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/1, datë 17.3.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 40, datë 19.3.2015)

Neni 52

Zbritshmëria e TVSH-së

Objekti dhe rëndësia e të drejtës së zbritjes së TVSH- së

Parime të përgjithshme

Ushtrimi i së drejtës së zbritjes së TVSH-së që ka rënduar mbi elementet e çmimit të transaksioneve të tyre të tatueshme përbën një nga mekanizmat thelbësorë të TVSH-së.

Lejimi i personit të tatueshëm që të bëjë zbritjen apo të marrë rimbursimin e TVSH-së, e cila është derdhur në buxhetin e shtetit nga personi i tatueshëm në fazën paraardhëse çon në faktin që çmimi i mallrave dhe shërbimeve në stadin e konsumit final të përballojë vetëm një herë tatimin.

Por, detyrimi i neutralitetit bën që të përcaktohen dispozita të destinuara për të shmangur që moszbatimi i të drejtës së zbritjes të shkaktojë shtrembërime në lidhje me neutralitetin fiskal.

Kështu nenet 68 deri 84 të ligjit parashikojnë kushtet, kufizimet, dhe rregullimet e parashikuara për ushtrimin e të drejtës së zbritjes.

Në përputhje me këto parime, një person i tatueshëm lejohet të zbresë TVSH-në që ka rënduar çmimin e një malli apo të një shërbimi përderisa ky mall apo shërbim është përdorur për realizimin e një transaksioni të tatueshëm me të drejtë zbritje, me rezervën që nuk është objekt i ndonjë kufizimi apo përjashtimi të veçantë shprehimisht i përcaktuar në ligj. Ashtu sikurse një person i tatueshëm nuk lejohet të zbresë TVSH-në që ka rënduar çmimin e një malli apo shërbimi përderisa ky mall ose shërbim është përdorur për kryerjen e transaksioneve të përjashtuara nga TVSH-ja sipas ligjit.

Në lidhje me TVSH-në, kur një sipërmarrje realizon në të njëjtën kohë transaksione brenda fushës së zbatimit të TVSH (të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara) ose jashtë saj, ajo duhet të dallojë mallrat dhe shërbimet e blera, të cilat do të përdoren përkatësisht për secilën nga kategoritë e transaksioneve me qëllim aplikimin e së drejtës së zbritjes së TVSH-së.

Neni 53

Transaksione që mundësojnë zbritjen e TVSH-së

1. Rregulla të përgjithshme për transaksionet që japin të drejtën e zbritjes së TVSH-së

Transaksionet, kryerja e të cilave i mundëson personit të tatueshëm zbritjen e TVSH-së për mallrat dhe shërbimet e marra të nevojshme për realizimin e këtyre transaksioneve janë, furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës nga ky person i tatueshëm.

Cilat janë transaksionet, kryerja e të cilave i jep personit të tatueshëm të drejtën e zbritjes?

Fillimisht duhet të bëhet dallimi mes :

Transaksioneve të cilat bazuar në nenin 2 të ligjit dhe kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim ndodhen në fushën e zbatimit të TVSH-së. Këto transaksione cilësohen si transaksione të tatueshme;

Transaksioneve që ndodhen jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së dhe si pasojë nuk janë të tatueshme.

Në grupin e parë, (1) të transaksioneve të tatueshme përfshihen :

Furnizime të tatueshme për nga natyra dhe sipas ligjit, që i nënshtrohen TVSH-së, pavarësisht shkallës;

Furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, kur ligji i përcakton të tilla në mënyrë të specifikuar.

Transaksionet që japin të drejtën e zbritjes përfshijnë transaksionet brenda fushës që i nënshtrohen efektivisht tatimit dhe transaksionet të cilat ndonëse nuk i nënshtrohen efektivisht TVSH-së, ngjasojnë me transaksione të tatueshme me të drejtë të zbritjes së TVSH-së. (p.sh: furnizimet ndërkombëtare, eksportet e të ngjashme).

Efektivisht në këtë kategori pra 1/a) përfshihen :

I.furnizimet e tatueshme me shkallën e TVSH-së në fuqi,

II.furnizimet me shkallën zero të TVSH-së ose të ngjashme me eksportet sipas pikës b) të nenit 70 të ligjit ;

III.furnizimet e kryera jashtë territorit të Shqipërisë nga një person i tatueshëm, në kuadër të veprimtarisë së tij ekonomike, të cilat nëse po të kryheshin brenda vendit do të ishin furnizime të tatueshme me shkallën e TVSH-së dhe i japin të drejtën e zbritjes së TVSH-së personit të tatueshëm, sipas pikës a) të nenit 70 të ligjit.

Transaksionet e përjashtuara sipas ligjit që përfshihen në 1/b) edhe pse janë transaksione në fushën e zbatimit të TVSH-së, janë transaksione të përjashtuara pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së. Kryerja e furnizimeve të përjashtuara prej personit të tatueshëm nuk i jep atij të drejtën e zbritjes së TVSH-së për furnizimet e marra.

Ndërkohë është e qartë qënëse mallrat ose shërbimet nuk përdoren për nevojat e veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm, por për realizimin e transaksioneve apo veprimtarive jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së, në zbatim të dispozitave të ligjit dhe këtij udhëzimi, nuk lind asnjë e drejtë zbritje e TVSH-së.

Për Shembull : Një shoqëri holding përfiton të ardhura nga dividendi, këto të ardhura nuk janë përfituar si rezultat i një furnizimi malli ose shërbimi dhe si të tilla, nuk janë në fushën e zbatimit të TVSH-së. Kjo shoqëri nuk gëzon të drejtën të zbresë TVSH-në për furnizimet apo shpenzimet e kryera, përse këto blerje i shërbejnë veprimtarisë së saj jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së.

2. Lindja e së drejtës së zbritjes së TVSH-së

Bazuar në nenin 68 të ligjit, e drejta e zbritjes lind atëherë kur TVSH i zbritshëm bëhet i kërkueshëm sipas nenit 32 të ligjit.

Neni 32 përcakton lindjen dhe kërkueshmërinë e TVSH-së prej furnizuesit. Në këtë kuptim, atëherë kur TVSH bëhet e kërkueshme për furnizuesin dhe ai duhet ta paguajë atë, në të njëjtin moment lind e drejta e zbritjes së kësaj TVSH-je, për personin që ushtron të drejtën e zbritjes.

Bazuar në këto dispozita rrjedh se nëse një person i tatueshëm që vepron si i tillë përdor mallrat ose shërbimet për nevojat e transaksioneve të tij të tatueshme me të drejtë zbritje të TVSH-së, ai ka të drejtë të zbresë TVSH-në që detyrohet të paguajë apo që ka paguar për këto mallra ose shërbime.

Sipas dispozitave të nenit 68 të ligjit, e drejta e zbritjes, lind kur TVSH-ja bëhet i kërkueshëm për personin e tatueshëm në bazë të dispozitave të nenit 32 të ligjit.

TVSH e zbritshme është pikërisht:

TVSH-ja që shkruhet në faturën e lëshuar nga furnizuesi, dhe

TVSH-ja e paguar në import.

3. Zbritja e TVSH-së

Bazuar në nenin 69 të ligjit, personi i tatueshëm që kryen furnizime të tatueshme gëzon të drejtën që të zbresë nga TVSH e llogaritur, TVSH-në për furnizimet e marra, në masën që këto furnizime përdoren nga personi i tatueshëm në funksion të transaksioneve të tatueshme që ai kryen.

E drejta e zbritjes prej një personi të tatueshëm ushtrohet për:

TVSH-në e paguar apo për t'u paguar për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që i janë furnizuar ose do t'i furnizohen;

TVSH-ja e paguar në import për mallrat e importuara;

TVSH-në për t'u paguar për furnizimet kundrejt pagesës të bëra për nevojat e veprimtarisë ekonomike në masën që ato i shërbejnë veprimtarisë të tatueshme

(vetëfurnizimet);

TVSH-në mbi furnizimet e marra që lidhen me një pasuri të paluajtshme të personit të tatueshëm në proporcion me përdorimin e kësaj pasurie për qëllime të veprimtarisë së tij të tatueshme;

TVSH-ja mbi furnizime të tjera të marra, si p.sh. mallra të luajtshëm, blerje për qëllime administrative, etj., në proporcion me përdorimin e saj për veprimtari të tatueshme.

Gjithashtu bazuar në nenin 70 të ligjit, personi i tatueshëm ka të drejtë të zbresë gjithashtu:

TVSH-në për furnizimet e marra në masën që këto furnizime janë përdorur për qëllime të furnizimeve të tatueshme të personit të tatueshëm të kryera jashtë territorit të Shqipërisë, furnizime të cilat nëse do të kryheshin në vend do ti jepnin atij të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Këtu përfshihen transaksionet në fushën e zbatimit të TVSH-së, por që nuk janë të përjashtuara nga TVSH-ja sipas ligjit.

Furnizimet e përcaktuara në ligj si furnizime me shkallë zero të TVSH-së, ose të ngjashme me eksportet.

Nëse personi i tatueshëm i ka përdorur ose do t'i përdor blerjet e mallrave ose shërbimeve ose importet e mallrave për kryerjen e furnizimeve të përjashtuara sipas ligjit personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të zbres TVSH-në e paguar ose për t'u paguar, për blerjet e mallrave dhe shërbimeve si dhe TVSH-në e paguar në import. Personi i tatueshëm furnizimet e të cilit janë të përjashtuara nga TVSH sipas ligjit, është i përjashtuar gjithashtu edhe nga e drejta për të zbritur TVSH-në e paguar ose për t'u paguar për furnizimet e marra.

Kur furnizimet që merr një person i tatueshëm, brenda vendit ose nëpërmjet importimit, nuk përdoren për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, sipas nenit 4 të ligjit, ai nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e paguar ose për t'u paguar për blerjet e mallrave dhe shërbimeve si dhe TVSH-në e paguar në import.

Neni 54

Kriteret formale për ushtrimin e së drejtës së zbritjes së TVSH-së

Parimisht, e drejta e zbritjes së TVSH-së e përfshirë në çmimin e blerjes së një malli/shërbimi ushtrohet prej blerësit, kur TVSH-ja bëhet e kërkueshme tek furnizuesi siç përcaktohet në nenin të ligjit.

Dokumentimi

TVSH-ja e zbritshme është TVSH e shënuar në faturën tatimore të lëshuar nga furnizuesi,

si dhe TVSH e paguar në import e shënuar në dokumentin doganor të importit (deklaratë doganore).

Që të mund të ushtrojë të drejtën e zbritjes së TVSH-së në deklaratën e TVSH-së, personi i tatueshëm duhet të zotërojë faturën e blerjes me TVSH për blerje të kryera në vend që e tregon atë si blerës, ose çdo lloj dokumenti tjetër si deklarata e importit që e tregon atë si marrësin e mallrave të importuara.

Kështu zbritja e TVSH-së në blerje kërkohet mbi bazën e faturës tatimore origjinale të lëshuar prej furnizuesit dhe të plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj.

Për qëllime të zbritjes së TVSH-së, konsiderohet e vlefshme edhe kopja e noterizuar e faturës së blerjes (në rast se fatura origjinale humbet), me kusht që shitësi të zotërojë kopjen e tij të faturës dhe ta ketë deklaruar atë. Pa këtë faturë nuk ushtrohet e drejta për të zbritur TVSH-në e paguar, ose për t'u paguar në blerje.

Për të ushtruar të drejtën e zbritjes së TVSH-së së paguar në import, personi i tatueshëm duhet të zotërojë deklaratën doganore origjinale të importit, në të cilën të tregohet TVSH e paguar në import. Nuk mund të kërkohet të zbritet një TVSH nëse ajo nuk është llogaritur më parë në një faturë ose dokument tjetër siç përcaktohet në ligj.

Bazuar në nenin 75 të ligjit, personi i tatueshëm për të ushtruar të drejtën e zbritjes së TVSH-së duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

Për zbritjen, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 69, të ligjit, lidhur me shitjet e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve, të zotërojë një faturë të hartuar në përputhje me nenet nga 96 deri në 105 të ligjit; Fatura që nuk është hartuar në përputhje me përcaktimet ligjore të kërkuara rast pas rasti, është element kufizues i së drejtës së zbritjes së TVSH-së.

Për zbritjen, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 69 të ligjit, lidhur me furnizimet kundrejt pagesës, kur kemi të bëjmë me vetëfurnizim dhe janë përmbushur kriteret e përcaktuara sipas këtij udhëzimi; Furnizimi duhet të jetë dokumentuar me faturë.

Për zbritjen e TVSH-së, sipas përcaktimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 69, të këtij ligji, lidhur me importimet e mallrave, personi i tatueshëm duhet të zotërojë një deklaratë që provon importimin, të lëshuar në momentin e çlirimit për qarkullim të lirë të mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin ai cilësohet si marrësi ose importuesi i mallit dhe ku të shkruhet shuma e TVSH-së së paguar dhe mënyra e llogaritjes së saj;

Kur blerësi detyrohet të paguajë TVSH-në, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 86 të ligjit, pra zbaton skemën e auto-ngarkesës së TVSH-së, gëzon të drejtën e zbritjes së TVSH-së në blerje sipas faturës së lëshuar siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 99 të ligjit.

3. Momenti në të cilin ushtrohet e drejta e zbritjes

Kur lind kërkueshmëria e tatimit, e për rrjedhojë lind e drejta e zbritjes për personin e tatueshëm dhe personi i tatueshëm zotëron një faturë tatimore ose një deklaratë të importit sipas kërkesave të ligjit, element shumë i rëndësishëm që lidhet me të drejtën e zbritjes gjithashtu, është momenti në të cilën personi i tatueshëm e ushtron të drejtën e zbritjes dhe deklaratë e TVSH-së në të cilën ai e deklaron këtë TVSH.

drejta e zbritjes ushtrohet në deklaratën e periudhës në të cilën furnizimi ose importi është kryer. Kjo është edhe periudha në të cilën ka lindur kërkueshmëria e TVSH-së.

Deklarata e TVSH-së në të cilën ushtrohet e drejta e zbritjes i përket periudhës që përkon me datën lëshimit të faturës tatimore nga furnizuesi sipas përcaktimeve në nenin 99 të ligjit ose data e shënuar në deklaratën doganore, e cila njihet si data e çlirimit të mallrave.

Nëse personi i tatueshëm nuk kryen zbritjen e TVSH-së në periudhën tatimore në të cilën i lind e drejta e zbritjes ai mund ta zbresë këtë shumë të TVSH-së së zbritshme pas kësaj periudhe, por jo më vonë se 12 periudha tatimore përfshirë periudhën në fjalë. Pas 12 periudhave kjo faturë regjistrohet si “ blerje me TVSH jo të zbritshme”. TVSH-ja nuk zbritet përpara periudhës në të cilën ka lindur e drejta e zbritjes.

Zbritja e TVSH-së që deklarohet nga personi i tatueshëm në deklaratën e TVSH-së që i përket një periudhe tatimore, është totali i TVSH-së për të cilën ushtrohet e drejta e zbritjes në përputhje me ligjin dhe me këtë udhëzim.

4. Deklarimi

Bazuar në nenin 76 të ligjit, personi i tatueshëm nga shuma e TVSH-së së llogaritur mbi vlerën totale të tatueshme të të gjitha furnizimeve të tatueshme të kryera gjatë një periudhe tatimore zbrit shumën e TVSH-së, për të cilën ka lindur e drejta e zbritjes, gjatë së njëjtës periudhe tatimore.

Në qoftë se për një periudhë tatimore shuma e TVSH-së së zbritshme është me e madhe se TVSH-ja e llogaritur për t’u paguar, atëherë për këtë periudhë tatimore personi i tatueshëm rezulton me tepriçë të TVSH-së së zbritshme, TVSH e cila i rimbursohet personit të tatueshëm pasi plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 77 të ligjit dhe dispozitave përkatëse të këtij udhëzimi.

5. Kufizime të zbritjes së TVSH-së për situata të parregullta, ose në raste shkeljeje

Pavarësisht se personi i tatueshëm është në kushtet e zbatimit të nenit 69 dhe 70, nuk do të lejohet zbritja e TVSH-së për rastet kur ai disponon faturë të lëshuar nga persona të tretë jo në përputhje apo në shkelje të dispozitave të ligjit siç përcaktohet në nenin 76 pikat 5, 6, 7 të ligjit, si në rastet më poshtë:

Nëse personi i tatueshëm pranon një faturë që tregon TVSH-në, nga personi i cili nuk ka të drejtë të llogarisë TVSH-në sipas këtij ligji, personi, i cili pranon faturën, pavarësisht se e ka paguar, nuk duhet të zbresë TVSH-në e paraqitur në faturë, ndërkohë që personi që e ka llogaritur padrejtësisht duhet t'ia paguajë TVSH-në administratës tatimore.

Personi i tatueshëm, i cili ka pranuar një faturë, sipas kushteve të pikës 4, të nenit 86, të këtij ligji, nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e shënuar në faturë.

Nëse një person i tatueshëm pranon një faturë që tregon një shumë të TVSH-së, e cila e tejkalon shumën e TVSH-së që duhej të ngarkohej sipas këtij ligji, personi i tatueshëm që pranon faturën, pavarësisht nëse e ka paguar, nuk duhet të zbresë shumën e TVSH-së të llogaritur më tepër.

Personi i tatueshëm, për të cilin është kryer një furnizim malli ose shërbimi në kushtet e pikës 7, të nenit 86, të këtij ligji, nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e shënuar në faturë.

Në pikën 7 të nenit 86 të ligjit përcaktohet se personi i tatueshëm për të cilin është kryer një furnizim malli ose shërbimi dhe që ka dijeni ose nuk mund të mohojë faktin që TVSH-ja për tu paguar ose pjesë e kësaj TVSH-je mbi këtë furnizim ose mbi të gjitha furnizimet e mëparshme të mallrave a shërbimeve, nuk është paguar për shkak të mashtrimit, është përgjegjës bashkë me furnizuesin për pagesën e TVSH-së.

Në parim, një blerës i tatueshëm nuk mund të konsiderohet përgjegjës për mosrespektimin e mundshëm nga furnizuesi të detyrimeve që rrjedhin për të, mbi kërkueshmërinë e TVSH-së për transaksionin e realizuar.

Sipas përcaktimit të mësipërm vënia në dyshim e të drejtës së zbritjes së TVSH-së ndodh në rast se blerësi kishte dijeni apo nuk mund të injoronte faktin që me blerjen e tij, ai merrte pjesë në një mashtrim që synon të mos derdhë TVSH-në e detyrueshëm për këtë furnizim. Në këtë rast TVSH-ja për furnizimin në fjalë nuk mund të jetë objekt zbritje.

Shembull 1: Rasti i drejtpërdrejtë

Shoqëria (B) kryen furnizim të tatueshëm me TVSH mallrash për shoqërinë (C). Shoqëria B kryen mashtrim duke mosderdhur TVSH-në e mbledhur nga shoqëria (C)

Në këtë situatë, shoqërisë (C) mund t'i vihet në dyshim e drejta e zbritjes për mallrat e furnizuara nga shoqëria (B), nëse ajo ishte në dijeni apo nuk mund të injoronte faktin se me blerjen e saj, ajo merrte pjesë në një mashtrim të kryer nga (B) që konsiston në mosderdhjen e tatimit të

detyrueshëm për këtë furnizim.

Shembull 2: Rast jo i drejtpërdrejtë

Shoqëria (B) kryen furnizim mallrash të tatueshme me TVSH për shoqërinë (D), e cila nga ana e saj furnizon mallrat tek shoqëria (C). Shoqëria B kryen mashtrim duke mosderdhur TVSH-në e mbledhur nga shoqëria (D).

Në këtë situatë, shoqërisë (C) nuk mund t'i vihet në dyshim e drejta e zbritjes për mallrat e furnizuara nga shoqëria (D) për shkakun se ajo ishte në dijeni apo nuk mund të injoronte faktin që shoqëria (B) nuk do ta derdhte TVSH-në mbledhur për furnizimet e kryera për shoqërinë (D). Përkundrazi, e drejta e zbritjes e shoqërisë (D) mund të vihet në dyshim përderisa shoqëria (B) është furnizuesi i saj i drejtpërdrejtë.

Vënia në dyshim e të drejtës së zbritjes varet nga fakti që të vërtetohet se është kryer një mashtrim në fillim nga furnizuesi i drejtpërdrejtë, si dhe nga fakti që blerësi ishte në dijeni, ose nuk mund të injoronte faktin që me blerjen e tij, ai mernte pjesë në një mashtrim.

Për t'u siguruar për ekzistencën e një mashtrimi të realizuar nga furnizuesi i drejtpërdrejtë, kryhen një sërë verifikimesh :

Së pari, duhet të përcaktohet që furnizuesi i një malli nuk e ka shlyer në mënyrë të parregullt TVSH e detyrueshme për furnizimin e mallit për klientin e tij. Për furnizuesin, mashtrimi konsiston në mosderdhjen për llogari të autoritetit tatimor të TVSH- së faturuar klientit të tij, ndërkohë që është zbritur nga ky i fundit në kuadrin e një skeme mashtruese.

Nga ana tjetër, nuk është e nevojshme dhe as e rëndësishme të provohet nëse blerësi ka nxjerrë ose jo fitim nga mashtrimi.

Blerësi “ishte në dijeni, ose nuk mund të injoronte” faktin se pjesëmarrja në një mashtrim konsiston në mosderdhjen e TVSH-së.

Në praktikë, duhet të gjenden dhe vlerësohen të gjithë elementët që të tregojnë se:

blerësi “ishte në dijeni”, duhet të ekzistojnë elemente objektive të pakundërshtueshëm se blerësi kishte dijeni për mashtrimin e bërë nga furnizuesi i tij,

ose blerësi “nuk mund të injoronte”. Nëse nuk mund të tregojë në mënyrë objektive dhe të pakundërshtueshme se blerësi kishte dijeni për mashtrimin, duhet të gjenden elemente që të mund të vërtetohej se “ai nuk mund ta injoronte atë”, që do të thotë se elementet, faktet janë të tillë që blerësi nuk mund të pretendojë që e ka injoruar ekzistencën e mashtrimit.

Për këtë mund të verifikohet dhe tregohet se blerësi i mallit nuk mund të injoronte faktin se furnizuesi nuk e kishte shlyer në mënyrë të parregullt TVSH-në e detyrueshme për furnizimin, duke u mbështetur në treguesit e mëposhtëm :

i) ekzistenca e lidhjeve juridike, ekonomike dhe personale mes operatorëve që marrin pjesë në transaksion (skemë);

çmimi i paguar është më i ulët se çmimi më i ulët që mund të presë blerësi për të paguar në mënyrë të arsyeshme këto mallra në treg apo më i ulët se çmimi i kërkuar për çdo furnizim të mëparshëm të mallrave të njëjta ;

blerje për periudha afatshkurtra dhe për shuma të rëndësishme tek furnizuesit e mëpasshëm të cilët shfaqen si inekzistentë ;

një adresë banimi të furnizuesit, mungesa e stafit dhe mjeteve të shfrytëzimit në përputhje me vëllimin e transaksioneve të kryera ;

mungesa e dokumenteve në lidhje me furnizimin e mallrave;

një aktivitet ekonomik i furnizuesit pa lidhje me furnizimet e mallrave që janë kryer ;

një mënyrë pagese për blerjet që nuk përkon me mënyrën tregtare të pagesës së vendosur (pagesa të shpejta, me çek bankar, etj.).

Kur bëhet fjalë për një sërë treguesish, mund të përdoret çdo element, natyra e të cilit do të ndihmonte blerësin të njohte pjesëmarrjen e tij në një skemë mashtruese. Përveç se duhet të tregojë lidhjet mes operatorëve në fjalë për të vërtetuar njohjen e mashtrimit, saktësia e treguesve që merren në konsideratë duhet të bëhet për çdo rast të shfaqur rast pas rasti.

Mund të ndodh që vetë personi i tatueshëm është tatimpagues i TVSH- së, për të cilën ushtron të drejtën e zbritjes.

I tillë është rasti i :

TVSH-së së paguar në import. TVSH në import paguhet për llogari të autoritetit doganor;

Furnizimeve të mallrave/shërbimeve të kryera nga një person i tatueshëm i vendosur jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të pikës 2 neni 86;

mbi vetëfurnizimetsipas nenit 15 të ligjit;

Në këto situata, personi i tatueshëm mund të ushtrojë të drejtën e zbritjes së TVSH-së, për të cilin ai është vetë tatimpagues i këtyre transaksioneve, vetëm kur ky tatim është bërë i kërkueshëm.

Neni 55

Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime

Sipas pikës 1 të nenit 74 të ligjit, përjashtohen nga e drejta e zbritjes së TVSH-së shpenzimet për blerjen, importin e mallrave, shpenzimet për shërbimet e përcaktuara shprehimisht në këtë dispozite.

Në zbatim të nenit 74 pika 1 shkronja a/ii, përcaktohen normativat e zbritjes së TVSH-së së gazoilit të përdorur sipas veprimtarive.

Përjashtohen nga e drejta e zbritjes së TVSH-së shpenzimet për blerjen e gazoilit sipas normativave të mëposhtme, përveç rastit kur gazoili i blerë përveç se për t'u shitur, përdoret si lëndë e parë kryesore përbërëse e produktit të prodhuar.

Me kushtin që gazoili i blerë të përdoret vetëm për nevoja të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, e drejta për të zbritur TVSH-në ushtrohet deri në normativat e përcaktuara më poshtë sipas veprimtarive. Shpenzimet faktike për gazoilin për çdo veprimtari ekonomike duhet të justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjeti/et, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proces të kryer, etj. Në çdo rast, këto shpenzime duhet të jenë të kryera realisht dhe të justifikuara sipas veprimeve të realizuara për nevoja të veprimtarisë ekonomike, të provuara me dokumentacionin përkatës, por jo më shumë se normativat e përcaktuara në këtë udhëzim.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 15, datë 18.05.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 26.05.2017).

Normativat aplikohen mbi bazën e treguesit të përcaktuar sipas peshës specifike, që blerjet për gazoil zënë në raport me qarkullimin e tatueshëm, të kryer në kuadër të veprimtarisë ekonomike. Normativat e përdorimit të gazoilit sipas veprimtarive përcaktohen si më poshtë:

I. NDËRTIM

a) Prodhim materiale inerte	deri më	33%
b) Ndërtim shtrim rrugësh	deri më	32%
c) Ndërtim banesash dhe objektsh të ndryshme	deri më	8%
ç) Prodhim betoni	deri më	14%
d) Gjermime / shpime	deri më	25%
dh) prodhim tullash dhe tjegullash	deri me	33%

II. TRANSPORT

- | | |
|--|---------------|
| a)Transport udhëtarësh | deri më 100 % |
| b)Transport mallrash | deri më 38 % |
| c) Transport mallrash me mjete teknologjike deri me 78 % | |

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 32, datë 25.08.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 154 datë 26.08.2020)

III. SHËRBIME

- | | |
|-----------------------------|-------------|
| a) Autoshkolla | deri më 25% |
| b) Shërbime pastrimi qyteti | deri më 30% |
| c) Peshkimi | deri më 80% |

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/5, datë 05.10.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 09.10.2015)

IV. TREGTI	deri më 3%
------------	------------

V. TË TJERA (veprimtari të tjera jo të listuara)	deri më 2%
--	------------

Llogaritjet përse i përket aplikimit të normativave bëhen dhe regjistrohen në librin e blerjes. Kufizimet e tjera të së drejtës së zbritjes së TVSH-së aplikohen sipas nenit 74 të ligjit.

Shembull: Një shoqëri që tregon karburant i njihet si e zbritshme dhe nuk aplikohen kufizime, për TVSH-në në blerje të sasisë së karburantit të blerë për t'u tregtuar. Ndërkohë nëse në ndërmarrje furnizohen me karburant edhe makinat që ndërmarrja ka në dispozicion për qëllime të veprimtarisë së saj ajo në këtë rast kryen një furnizim. Në rastin kur karburanti përdoret për furnizimin e autovegurave të shoqërisë sipas nenit 9 të ligjit ky është një furnizim kundrejt pagesës dhe shoqëria do të paguajë TVSH dhe ndërkohë për këtë furnizim nuk mund të zbresë TVSH në blerje pasi i kufizohet e drejta për të zbritur TVSH-në për shpenzimet e karburantit për autovegurë, bazuar në nenin 74, pika 1/b të ligjit.

Në rastin kur shoqëria furnizon me karburant automjetet e veta të ndërmarrjes, jo autovegura (p.sh. makina transporti të karburantit), në këtë rast shoqëria kryen një vetëfurnizim për të cilin sillet si shitës dhe si blerës. Faturën në shitje do ta regjistrojë me vlerat përkatëse Ndërkohë që në blerje e drejta e zbritjes është pjesore, pasi i kufizohet bazuar në nenin 74. Pika 1/a/ii, sipas së cilës e drejta e zbritjes së TVSH-së së vetëfurnizimit të karburantit i lind atë sa normativa e përcaktuar për veprimtarinë që kryen, në raport me qarkullimin e kryer. Meqenëse veprimtaria e

shoqërisë kategorizohet si tregti atëherë normativa e zbritjes së TVSH-së së karburantit është 3% e qarkullimit. Deri në këtë vlerë i lejohet zbritja e TVSH-së.

Neni 56

Rregulla praktike mbi zbritjen e TVSH-së

1. Analiza e të drejtës së zbritjes së TVSH-së së një furnizimi

Ushtrimi i të drejtës së zbritjes së TVSH-së për shpenzimet e përballuara nga një person i tatueshëm varet nga respektimi i njëkohshëm i kushteve që rrjedhin nga dispozitat e ligjit, sipas të cilave furnizimet /shpenzimet duhet :

- a- të përdoren për nevojat e një furnizimi të kryer kundrejt pagesës me të drejtë zbritje, dhe të mos përfshihen shprehimisht në furnizimet specifike për të cilat kufizohet të drejta e zbritjes sipas nenit 74 të ligjit ;
- b- të justifikohen nga një faturë që përmban tërësinë e informacioneve të parashikuara sipas ligjit dhe në këtë udhëzim.

Nga ana tjetër, ligji përcakton rregullat dhe kushtet sipas të cilave personat e tatueshëm që nuk realizojnë vetëm transaksione brenda fushës dhe me të drejtë zbritje, pra personat pjesërisht të tatueshëm mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të zbritjes së TVSH-së.

Në praktikë masa e zbritjes së TVSH-së që lidhet me një mall apo shërbim mund të ndryshojë nga një mall/shërbim në tjetrin, në funksion të përdorimit të mallit ose shërbimit.

Në funksion të përdorimit të mallit/ shërbimit përcaktohen:

koeficienti i tatueshmërisë: proporcioni i përdorimit të mallit apo shërbimit për një veprimtari për të cilën personi konsiderohet si person i tatueshëm në kuptim të nenit 3 të ligjit, dhe përdorimit të mallit/shërbimit nga i njëjti person për qëllime që nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij ekonomike, sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 69 të ligjit.

koeficienti i zbritjes së TVSH-së: pjesa e përdorimit të mallit apo shërbimit për furnizime në fushën e zbatimit të TVSH-së, për furnizime që japin të drejtën e zbritjes, sipas nenit 71 të ligjit,

koeficienti i kufizimit: furnizimi i mallit apo shërbimit është shprehimisht objekt i kufizimeve të nenit 74 të ligjit.

Kështu zbritja e TVSH-së së mallit apo shërbimit është e barabartë me produktin e elementeve të mësipërm.

2. Koeficienti i Tatueshmërisë (Kt)

Koeficienti i tatueshmërisë përcaktohet për rastet në pikën 2 dhe 3 të nenit 69.

Për çdo mall apo shërbim, ai është i barabartë, me proporcionin e përdorimit të këtij malli/shërbimi për veprimtari ekonomike. Kështu, një person i tatueshëm duhet që menjëherë pas blerjes së një malli apo shërbimi, të vendosë për përdorimin e tij në mënyrë që të përcaktojë vlerën e koeficientit të tatueshmërisë.

Nga ky përkufizim rrjedh se :

koeficienti i tatueshmërisë së një malli/shërbimi i përdorur vetëm për realizimin e operacioneve jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së është i barabartë me zero ;

koeficienti i tatueshmërisë së një malli/shërbimi i përdorur vetëm për realizimin e operacioneve brenda fushës së zbatimit të TVSH-së është i barabartë me 1, pavarësisht se këto operacione janë të tatueshme apo të përjashtuara ligjërisht.

Proporcioni i përdorimit për realizimin e operacioneve të tatueshme përcaktohet nga personi i tatueshëm nën përgjegjësinë e tij. Ai duhet të shprehë në mënyrë korrekte përdorimin real të çdo malli/shërbimi.

Shembull: Një organizatë jofitimprurëse zhvillon aktivitetin e saj bazuar në pagesa të përfituara nga kuotizacionet, e anëtarësisë si dhe fonde, grante, donacione të përfituara për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, aktivitet ky që referuar nenit 3 të ligjit nuk e bën person të tatueshëm, pra është jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së. Përkrah aktivitetit jofitimprurës OJF vendos të kryejë veprimtari ekonomike (shërbime konsulence juridike kundrejt pagesës për anëtarët e tij , përtej vlerës së kuotizacioneve) për të cilën plotëson kushtet për tu regjistruar si person i tatueshëm për TVSH-në sipas ligjit.

Pesha specifike e të ardhurave të secilit aktivitet është përkatësisht 10% ose 0.1 dhe 90 % ose 0.9 të totalit të të ardhurave të saj.

Gjatë periudhës tatimore ka paguar TVSH si më poshtë:

20.000 lekë TVSH e paguar për shpenzime, telefonike energjie, etj.. të zyrës

100.000 lekë TVSH e paguar për qira zyrash me TVSH

10.000 TVSH për shërbime honorar të një avokati, shërbim ky që i shërben direkt furnizimeve të tatueshëm kundrejt pagesës që kryen.

Sa do të jetë TVSH e zbritshme:

Zgjidhja

Furnizimet që i shërbejnë si veprimtarisë ekonomike për të cilën OJF konsiderohet person i tatueshëm edhe për veprimtarinë jofitimprurës do të zbriten proporcionalisht pra vetëm 10% të tyre, ndërsa furnizimet që i shërbejnë direkt aktivitetit të tatueshëm do të zbriten tërësisht. Kështu:

TVSH e zbritshme = 10.000 lekë + (20.000 + 100.000) x 10% = 22.000 lekë.

TVSH për t'u zbritur për periudhën tatimore në fjalë do të jetë 22.000 lekë.

3. Koeficienti i Zbritjes së TVSH - së

Bazuar në nenin 71 të ligjit nëse furnizimet e mallrave dhe shërbimeve përdoren nga një person i tatueshëm, si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi bazën e neneve 69 dhe 70, të këtij ligji, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë (transaksione të përjashtuara nga TVSH, neni 51,52,53,54,55), atëherë vetëm pjesa e TVSH-së që lidhet përdorimin e furnizimeve për kategorinë e transaksioneve të tatueshme është e zbritshme.

Llogaritja e zbritjes së pjesshme të TVSH-së bëhet në bazë të koeficientit të zbritjes së TVSH-së, i cili llogaritet siç përcaktohet në nenin 72 të ligjit.

Llogaritja e Koeficientit të zbritjes së pjesshme të TVSH-së

Koeficienti i zbritjes së TVSH-së (Kz) sipas nenit 72 të ligjit llogaritet në përqindje nga raporti i mëposhtëm:

$$Kz = \frac{\text{furnizime të tatueshme (neni 69,70)}}{\text{furnizime të tatueshme + furnizime të përjashtuara}} \times 100$$

Në llogaritjen e koeficientit më sipër, bazuar në nenin 72, pika 2 të ligjit nuk merren parasysh vlerat e qarkullimit të realizuara nga furnizimet e mallrave kapitale, të përdorura nga personi i tatueshëm për nevoja të biznesit si tij si dhe qarkullimi i realizuar gjatë vitit nga transaksione financiare dhe të pasurive të paluajtshme, si dhe nga transaksione të përcaktuara nga shkronja “b” deri në “e”, të nenit 53, të këtij ligji, nëse këto transaksione janë rastësore.

Koeficienti i zbritjes së TVSH-së, i aplikueshëm provizorisht për një vit, është koeficienti fillestar i zbritjes dhe ky koeficient llogaritet mbi bazën e transaksioneve të vitit të mëparshëm kalendarik në kushtet e nenit 71, të këtij ligji.

Në mungesë të këtyre transaksioneve në vitin e mëparshëm(viti i parë i veprimtarisë, ose aplikim për herë të parë i zbritjes së pjesshme), ose kur shumat e tyre është e papërfillshme, koeficienti fillestar i zbritjes së TVSH-së vlerësohet provizorisht prej vetë personit të tatueshëm, në bazë të parashikimeve të tij dhe nën mbikëqyrjen e administratës tatimore.

Zbritja e TVSH-së, e kryer mbi bazën e koeficientit fillestar të zbritjes, duhet të rregullohet në periudhën e parë tatimore të vitit pasardhës, sipas koeficientit përfundimtar të zbritjes së TVSH-së.

Pra jo më vonë se data 31 janar e vitit pasardhës kalendarik, personi i tatueshëm duhet të rillogarisë koeficientin përfundimtar të zbritjes së TVSH-së që i takon furnizimeve të tatueshme, sipas qarkullimit të realizuar në fakt gjatë vitit, dhe bën rregullimin vjetor në Zbritjen e TVSH-së për diferencën midis koeficientit fillestar me atë përfundimtar.

Personi i tatueshëm nuk është i detyruar të korrigjojë zbritjen e TVSH-së sipas koeficientit përfundimtar nëse ndryshimi në TVSH-në e zbritshme është më i vogël se 20.000 (njëzet mijë) lekë.

Veprimet për llogaritjen e koeficientit të zbritjes së TVSH-së dhe rregullimi vjetor sipas nenit 73 të ligjit, pasqyrohen në kutinë përkatëse me emërtimin “Rregullime të TVSH-së së zbritshme “ të librit të blerjeve të periudhës kur bëhen llogaritjet (Janar), si dhe deklarohen në kutinë më të njëjtin emërtim në Deklaratën e TVSH-së të kësaj periudhe.

Shembull

Personi i tatueshëm kryen veprimtari ekonomike si konsulente tregtar, si dhe organizon kurse profesionale të licencuara nga Ministria e Arsimit, dhe në vitet 2013 dhe 2014 ka këto tregues lidhur me furnizimet e kryera.

Viti	Furnizime të tatueshme me TVSH	Furnizime të perjashtuara	qarkullimi total	koeficienti i zbritjes
2013	3,000,000	2,000,000	5,000,000	60%
2014	2,500,000	2,000,000	4,500,000	56%

Personi i tatueshëm në korrik 2014 merr nga një person i tatueshëm furnizime shërbimi punime rikonstruksionin të zyrave ku kryen veprimtarinë e tij ekonomike, në vlerën 1.500.000 lekë, TVSH e paguar 300.000 lekë.

Gjithashtu në muajin korrik 2014 ka kryer edhe shpenzime të përgjithshme administrimi me vlerë 500.000 lekë, TVSH e paguar 100.000 lekë.

Sa TVSH do të zbresë personi i tatueshëm për periudhën tatimore korrik 2014, dhe rregullimi vjetor në zbritjen e TVSH-së në periudhën janar 2015?

Sipas të dhënave në tabelën më sipër :

Në vitin 2013 në periudhën e parë në të cilën personi i tatueshëm kryen edhe furnizime të përjashtuara përveç atyre të tatueshme aplikon një koeficient fillestar të zbritjes me vlerësimin e tij të përafërt. P.sh 40%. Në janar 2014 llogarit koeficientin përfundimtar mbi treguesit faktik të realizuar dhe bën rregullimin me koeficientin 60% për TVSH-në e blerjeve të realizuara në 2013 Nëse ndryshimi i TVSH-së së zbritshme është mbi 20.000 Lekë.

Nëse që në momentin që fillon veprimtarinë personi i tatueshëm ka dijeni që do ti kryejë të dy veprimtaritë atëherë koeficientin mund ta aplikojë që në fillim pa pritur periudhën e parë kur kryen edhe transaksione të tatueshme.

Ndërkohë në periudhën tatimore korrik 2014, personi i tatueshëm do të zbresë TVSH-së sipas koeficientit fillestar të zbritjes (koeficienti faktik vitit 2013) pra:

TVSH e zbritur provizorisht= $(300.000\text{lekë}+100.000\text{lekë})\times 60\%= 240.000\text{lekë}$.

Në janar 2015 personi i tatueshëm llogarit zbritjen e TVSH-së sipas koeficientit përfundimtar të Zbritjes.

TVSH e zbritshme faktikisht = $(300.000\text{lekë}+100.000\text{lekë})\times 50\%= 200.000\text{lekë}$.

Në periudhën tatimore janar 2015 personi i tatueshëm do të bëjë rregullimin si më poshtë:

<i>Zbritja e TVSH sipas Koeficientit përfundimtar të TVSH</i>	<i>200.000 lekë;</i>
<i>(-) zbritja e TVSH sipas Koeficientit fillestar të TVSH</i>	<i>240.000 lekë;</i>
<i>(=) Rregullimi i Zbritjes së TVSH</i>	<i>-40.000 lekë.</i>

Veprimet për rregullimin përfundimtar të zbritjes së TVSH-së pasqyrohen në kutinë “rregullime të TVSH-së së zbritshme” përkatësisht vlerë e tatueshme -200.000 lekë dhe TVSH -40.000 lekë (jo në vlerë absolute) të librit të blerjeve në janar 2015 dhe deklarohen në kutitë me të njëjtin

emërtim të deklaratës së TVSH-së të këtij muaji - për të njëjtat vlera. Në deklaratën e muajit janar 2015 TVSH e zbritshme pakësohet me 40.000 lekë.

Procedura e Njoftimit

Personi i tatueshëm, që gjendet në kushtet e zbatimit të nenit 71, brenda afateve të përcaktuara në pikën 4 të nenit 73 të ligjit duhet të njoftojë Drejtorinë Rajonale Tatimore, se zbaton zbritjen e pjesshme të TVSH-së si dhe vlerën e koeficientit fillestar të zbritjes së TVSH-së.

Neni 57

Rregullimet e zbritjes së TVSH-së

Parime të përgjithshme mbi rregullimin e TVSH së zbritur

Bazuar në nenin 82 të ligjit përcaktohen rregullat sipas së cilave do të kryhen rregullimet e TVSH-së së zbritur.

Nëse zbritja e TVSH-se është kryer siç duhet dhe/ose nuk lidhet me mallra të përjashtuara nga e drejta e zbritjes, atëherë zbritja e ushtruar në kushtet e parashikuara në përputhje me ligjin dhe udhëzimin nuk është në kushtet e një rregullimi të TVSH-së së zbritur.

Megjithatë, bazuar në nenin 78 të ligjit, zbritja e TVSH-së e kryer më parë rregullohet kur është më e lartë apo më e ulët se ajo vlerë për të cilën personi i tatueshëm ka gëzuar të drejtën e zbritjes.

Kështu ligji parashikon se duhet të kryhet një rregullim kur koeficienti i zbritjes së pjesshme të mallit apo shërbimit duhet të modifikohet për shkak të ndryshimit/ zgjerimit të përdorimit të mallit apo kur ndodhin ngjarje, të cilat detyrojnë ndryshimin e përdorimit të mallit ose shërbimit.

Rregullimet mund të kryhen brenda një afati dhjetë-vjeçar për mallrat kapitale të paluajtshme, pesë-vjeçar për mallrat kapitale të luajtshme duke filluar nga data në të cilën mallrat janë blerë ose prodhuar, me kusht që çmimi i blerjes ose kosto e prodhimit të tyre të jetë mbi 500.000 (pesëqind mijë) lekë pa përfshirë TVSH- në.

Rregullimet e kryera mund të rezultojnë ose me derdhjen e një pjese të TVSH- së së zbritur ose me një zbritje shtesë. Në të dyja rastet ato deklarohen në librin e blerjes dhe në rubrikën përkatëse të Deklaratës së TVSH-së, sipas efektit plus (+) ose (-) në zbritje të TVSH-së.

Megjithatë, asnjë rregullim nuk mund të kryhet për mallrat me koeficient tatueshmërie të barabartë me zero, pra mallra të cilat që në fillim nuk janë përdorur nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë për realizimin e transaksioneve brenda fushës së zbatimit të TVSH.

Rregullimet e zbritjes për mallrat kapitale

Zbritja fillestare e TVSH-së korrigjohet atëherë kur shfrytëzimi i mallrave kapitale pëson ndryshim që ndikon në të drejtën e personit të tatueshëm për zbritjen e shumës së TVSH-së, që mund të jetë më e vogël apo më e lartë.

Korrigjimi vjetor bëhet vetëm për pjesën e së dhjetës (p.sh 1/10) e TVSH-së së pasurisë të paluajtshme dhe për pjesën e të pestës (p.sh. 1/5) të TVSH-së të mallrave të tjera kapitale, mbi TVSH-në e mallrave kapitale.

Korrigjimi duhet të bëhet mbi bazat e ndryshimeve të së drejtës së zbritjes për vitet pasuese që ndërlihen me vitin kur mallrat kapitale janë pranuar(blerë ose prodhuar). Viti kalendarik i papërfunduar do të merret si vit i plotë. Veprimet e rregullimit të zbritjes duhet të pasqyrohen në librin e blerjeve dhe ne kutinë përkatëse të Deklaratës së TVSH-së.

Personi i tatueshëm nuk është i detyruar të korrigjojë zbritjen nëse diferenca e TVSH-së së zbritshme për t'u korrigjuar është më e vogël se 20.000 (njëzet mijë) lekë.

Afati i rregullimit të zbritjes për mallrat kapitale sipas pikës 3 dhe 4 nenit 80 fillon nga momenti kur malli kapital është blerë, është prodhuar dhe është bërë i gatshëm për t'u përdorur.

Bazuar në nenin 157, pika 1 të ligjit rregullimi i TVSH-së së zbritshme sipas afateve të përcaktuara në nenin 80 të ligjit, përkatësisht për mallrat kapitale të luajtshme 5 vjet dhe për mallrat kapitale të paluajtshme 10 vjet, do të zbatohet për ato mallra kapitale të blera ose prodhuara pas datës 1 janar 2015 dhe me çmim blerje ose kosto prodhimi mbi 500.000 (pesëqind mijë) lekë pa përfshirë TVSH-në.

Ndërkohë për mallrat kapitale të luajtshme ose të paluajtshme të blera ose prodhuara para datës 1 janar 2015, afati i rregullimit të zbritjes së TVSH-së për ndryshimin e së drejtës së zbritjes sipas përdorimit të aktivitetit nga një veprimtari e tatueshme për një veprimtari të përjashtuar nga TVSH do të vazhdojë të jetë 5 vjet për të gjitha mallrat kapitale dhe rregullimi për mallrat kapitale të paluajtshme do të kryhet për aktive mbi 1 milion lekë.

Nëse mallrat kapitale furnizohen gjatë periudhës së korrigjimit duhet të veprohet si në vijim: në qoftë se furnizimi është i tatueshëm me TVSH, mallrat kapitale duhet të konsiderohen se shfrytëzohen plotësisht për qëllime tatimore për periudhën e mbetur të korrigjimit.

Në qoftë se tatimpaguesi nuk ka pasur të drejtë të bëjë zbritjen e plotë të TVSH-së së zbritshme, korrigjimi mund të kryhet për periudhën e mbetur korrigjuese të periudhës tatimore kur mallrat kapitale janë furnizuar.

në qoftë se furnizimi nuk është i tatueshëm me TVSH, mallrat kapitale duhet të konsiderohen se shfrytëzohen për qëllime që nuk janë të tatueshme për periudhën e mbetur korrigjuese. Në qoftë se tatimpaguesi ka pasur të drejtën për zbritje të plotë apo të pjesshme të TVSH-së së zbritshme, korrigjimi duhet kryhet për periudhën e mbetur të korrigjimit të periudhës tatimore kur janë furnizuar mallrat kapitale;

në qoftë se është zbatuar neni 16 i ligjit për transferimin e veprimtarisë ekonomike, transferim i cili nuk është i tatueshëm, korrigjimi i TVSH-se së zbritshme të mallrave kapitale në fjalë i transferohet pranuesit të transferimit, i cili duhet të zbatohet edhe procedurën e përcaktuar në këtë udhëzim.

Në qoftë se një ndërtesë ose pajisje bëhet e pashfrytëzueshme për arsye të vërtetuara prej personit të tatueshëm, përpara se t'i skadojë afati periudhës së korrigjimit të TVSH-së së zbritshme, atëherë arsyet për korrigjim të TVSH-së së zbritshme duhet të ndërpriten.

Në qoftë investimet pasuese nuk e ndryshojnë në thelb jetëgjatësinë e shfrytëzimit të ndërtesës ose pajisjes, atëherë korrigjimi i TVSH-së së zbritshme për atë investim duhet të kryhet në vijim të periudhës së korrigjimit të TVSH-së së zbritshme për mallrat kapitale në fjalë. Pra nuk ndryshon ose zgjatet periudha, por vetëm vlerat.

Nëse bëhet një investim pasues i cili në thelb e ndryshon jetëgjatësinë e shfrytëzimit ose paraqet një njësi të ndarë siç mund të jetë p.sh. një pjesë e shtuar të një ndërtese ekzistuese, për investimin e ri fillon një periudhë e re për të cilën rregullimi i zbritjes së TVSH-së do të llogaritet më vete.

Rregullimi i të drejtës së zbritjes të ushtruar për mallrat kapitale bëhet për kohën e mbetur të rregullimit të zbritjes, në rastet kur ndodhin ngjarjet si më poshtë:

në kushtet e zbatimit të nenit 81 të ligjit;

sipas nenit 80 të ligjit për ndryshimet e së drejtës së zbritjes sipas përdorimit për qëllime të veprimtarisë;

për rastet që mund të përcaktohen në zbatim të nenit 79, pika 3 të ligjit;

për rastet kur përfundon veprimtaria sipas parashikimeve të bëra në nenin 9 të ligjit dhe në dispozitat përkatëse të këtij udhëzimi.

Shembull 1: Kompania A kryen furnizime të tatueshme me TVSH dhe furnizime të përjashtuara nga TVSH. Pas çdo fund viti Kompania llogarit qarkullimin e furnizimeve të tatueshme dhe furnizimet e përjashtuara si më poshtë :

Viti	Furnizim e te tatueshm e m e T VSH I (ne ooo/leke)	Furnizim e te perjashtuara	T otali i furnizim ev e	E drejta e zbritjes
		(ne ooo/leke)	(ne ooo/leke)	
2015	150,000	100,000	250,000	60%
2016	17 0,000	90,000	260,000	65%
2017	200,000	150,000	350,000	57 %
2018	-	90,000	90,000	0%
2019	120,000	140,000	260,000	46%
2020	17 5,000	150,000	325,000	54%
2021	300,000	50,000	350,000	86%
2022	160,000	100,000	260,000	62%
2023	300,000	150,000	450,000	67 %
2024	250,000	-	250,000	100%
2025	-	100,000	100,000	0%

E drejta rrumbullakoset me një numër të plotë në përputhje me pikën 1 të nenit 73 të ligjit.

Kompania A ka rikonstruktuar magazinat, rikonstrukcion i cili përfundon në gusht 2016. Vlera e TVSH-së është 1.500.000 lekë. Kompania A ka zbritur faturat për rikonstrukcionin 1.500.000 lekëpërgjatë vitit 2016 dhe fillon shfrytëzimin në shtator 2016. Kompania e shfrytëzon këtë magazinë për kryerjen e të dyja furnizimeve, të tatueshme dhe të përjashtuara. Sa mund të zbres Kompania A për këtë investim gjatë vitit 2016?

Llogarit shumën që mund ta zbresë Kompania A si dhe korrigjimet vjetore të zbritjes së TVSH-së zbritshme që do të kryhen nga Kompania ndër vite.

Gjatë vitit 2016 në lidhje me investimin Kompania A zbret në total 900.000 lekë TVSH. Arsyeja për këtë është se sipas pikës 2 të nenit 73 zbritja fillestare mund të zbatohet provizorisht për vitin 2016 sipas koeficientit të zbritjes përfundimtar të vitit 2015 që është 60%.

Në deklaratën e TVSH-së së janarit 2017 që duhet të dorëzohet deri në 14 shkurt 2017, kompania duhet të korrigjojë zbritjen e kryer paraprakisht sipas koeficientit përfundimtar të zbritjes të llogaritur për vitin 2016, i cili referuar të dhënave të tabelës llogaritet 65 %. Prandaj, kompania duhet të rrisë zbritjen e TVSH-së së zbritshme me 75.000 lekë që është diferenca ndërmjet vlerës paraprake të zbritur dhe vlerës përfundimtare që i takon sipas koeficientit përfundimtar të vitit 2016.

Në vijim janë renditur korrigjimet e bëra për secilin vit.

Viti	E drejta e zbritjes	Zbritje e m undshm e per vit	Zbritja e kryer paraprakisht	E drejta perfundim ta re e zbritjes	Diferenca e zbritjes se TVSH-se	Korrigjim i vjetor
2016	65%	150,000	97,500	97,500	-	-
2017	57 %	150,000	97,500	85,714	(11,786)	-
2018	0%	150,000	97,500	-	(97,500)	(97,500)
2019	46%	150,000	97,500	69,231	(28,269)	(28,269)
2020	54%	150,000	97,500	80,769	(16,731)	-
2021	86%	150,000	97,500	128,571	31,071	31,071
2022	62%	150,000	97,500	92,308	(5,192)	-
2023	67 %	150,000	97,500	100,000	2,500	-
2024	100%	150,000	97,500	150,000	52,500	52,500
2025	0%	150,000	97,500	-	(97,500)	(97,500)

Kompania do të kryejë rregullime vjetore për rastet kur vlera absolute e ndryshimit midis vlerës së TVSH të zbritur paraprakisht me TVSH që ka të drejtë të zbresë është mbi 20.000 lekë, pra korrigjimi do të kryhet sipas vlerave përkatëse vetëm për vitet 2018, 2019, 2024 dhe 2025.

Kështu në janar 2019 do të bëhet rregullimi për vitin 2018 përkatësisht duke u ulur TVSH e zbritshme në vlerën 97.500 lekë. Kjo vlerë do të deklarohet përkatësisht në kutinë me emërtimin “Rregullime të TVSH-së së zbritshme” të librit të blerjes dhe në deklaratën e TVSH-së. Përkatësisht në kutinë 38 të deklaratës regjistrohet vlera negative - 487.500 lekë dhe në kutinë 39 regjistrohet vlera negative - 97.500 lekë.

Në janar 2022 do të bëhet rregullimi për vitin 2021 përkatësisht duke rritur TVSH-në e zbritshme në vlerën 31.071 lekë. Kjo vlerë do të deklarohet përkatësisht në kutinë me emërtimin “Rregullime të TVSH-së së zbritshme” të librit të blerjes dhe në deklaratën e TVSH-së. Përkatësisht në kutinë 38 të deklaratës regjistrohet vlera pozitive 155.355 lekë dhe në kutinë 39 regjistrohet vlera pozitive 31.071 lekë.

Shembull 2: Një shoqëri e cila kryen aktivitet tërësisht të tatueshëm blen brenda vendit në korrik 2015 një mall kapital të luajtshëm me një vlerë të tatueshme 2 milionë lekë. Zbritja e TVSH-së në momentin e blerjes është 400 mijë lekë (2 milionë x 20% shkalla tatimore) dhe paraqitet në librin e blerjeve të muajit korrik 2015 nga shoqëria. Njëkohësisht kjo shumë paraqitet në kutinë përkatëse të Deklaratës së TVSH në përputhje me modalitetet e përcaktuara për deklarimin.

Në maj 2017, veprimtaria ekonomike e personit të tatueshëm si pasojë e një ndryshimi ligjor bëhet tërësisht e përjashtuar. Sa do të jetë vlera e rregullimit të TVSH-së?

Malli kapital i blerë në korrik 2015 do të përdoret për furnizime të përjashtuara, dhe është objekt i rregullimit të TVSH-së për pjesën e mbetur të afatit 5- vjeçar, referuar kohës së periudhës së afatit të rregullimit për mallrat kapital të luajtshme, meqenëse më parë shoqëria kishte deklaruar të plotë TVSH e zbritshme të tij.

Rregullimi i zbritjes do të bëhet duke mbajtur parasysh nga 5 vitet e afatit të rregullimit sipas nenit 80 pika 3, 2 vjetët e mbetur në të cilat ky aktiv i qëndrueshëm nuk do të përdoret për veprimtari ekonomike.

Shuma e TVSH së zbritshme që duhet të kthejë shoqëria është $400.000 \times 2/5 = 160$ mijë lekë.

Rregullimi bëhet në librin e blerjeve të shoqërisë në periudhën tatimore në të cilën ka ndodhur ngjarja që bën të detyrueshëm rregullimin e zbritjes, si dhe deklarohet në rubrikat përkatëse të Deklaratës së TVSH-së.

Në rastin konkret, në librin e blerjeve të muajit maj 2017, në kutinë përkatëse të rregullimeve paraqitet me vlerë negative (-) shuma e TVSH së zbritshme prej 160 mijë lekë që do të kthehet nga shoqëria duke pakësuar totalin e TVSH së zbritshme të atij muaji.

Neni 58

Rregullat dhe procedura për daljet jashtë përdorimit të mallrave

1. Shkatërrimi i mallrave të dala jashtë përdorimit

Në kuptim të pikave 2 dhe 3 të nenit 79 të ligjit, nuk kryhet rregullimi i zbritjes së TVSH-së për daljet jashtë përdorimit të mallrave për shkak se janë të papërdorshme, ose u ka kaluar afati i përdorimit të tyre, të provuara apo të konfirmuara, sipas procedurave përkatëse ligjore e nënligjore.

Nëse mallrat për të cilat nuk zbatohet rregullimi i TVSH-së së zbritshme sipas këtij neni personi i tatueshëm përfiton dëmshpërblim për arsye të sigurimit të mallit, atëherë për vlerën e përfituar, personi i tatueshëm llogarit TVSH. Vlera e tatueshme në këtë rast është vlera e përfituar minus TVSH-në përkatëse.

Barra e provës i takon personit të tatueshëm, i cili duhet gjithashtu të zbatojë procedurat përkatëse sipas ligjit, si dhe procedurat përcaktuara në legjislacionin e sektorit ku operon.

Nëse personi i tatueshëm nuk dokumenton mungesën e mallrave sipas procedurës së parashikuar më poshtë, atëherë mallra të tilla do të konsiderohen si mallra të shitura.

Procedura për daljet jashtë përdorimit të mallrave

Personi i tatueshëm duhet të mbajë një regjistër për mallrat ku të shënojë llojet e mallrave të skaduar, datën e blerjes së mallit të nxjerrë jashtë përdorimit, datën e skadencës së mallit, sasinë përkatëse, arsyen për nxjerrjen e mallrave jashtë përdorimit, si dhe personat e pranishëm në kryerjen e procesit të daljes jashtë përdorimit. Personi i tatueshëm është i detyruar të provojë arsyen e mosshitjes së mallit dhe daljen jashtë përdorimit të tij.

Personi i tatueshëm i cili do të kryejë nxjerrjen jashtë përdorimit të mallrave duhet të bëjë një njoftim me shkrim drejtuar autoritetit tatimor, përkatësisht Drejtorisë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar.

Nëpërmjet njoftimit, autoriteti tatimor informohet në lidhje me:

Listën e mallrave që do të nxjerrë jashtë përdorimit,
arsyet e nxjerrjes jashtë përdorimit për secilin artikull dhe
numrin e njësisë/sasinë mallrave,
çmimin e blerjes së secilit prej mallrave;
vlerën e mallrave;
datën kur do të kryhet ky proces.

Njoftimi duhet të dërgohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore jo më vonë se 5 ditë kalendarike, para datës së nxjerrjes jashtë përdorimit të mallit.

Drejtorja Rajonale Tatimore cakton për të marrë pjesë në këtë proces dy inspektor, të cilët mbajnë një procesverbal për këtë qëllim, të konfirmuar edhe nga përfaqësuesi i personit të tatueshëm dhe personat e tjerë të pranishëm gjatë këtij procesi.

Nëse inspektorët nuk paraqiten brenda afatit të përcaktuar, personi i tatueshëm ka të drejtë të vazhdojë normalisht me nxjerrjen jashtë përdorimit të mallit. Në këtë rast janë të nevojshme dokumentet e institucioneve përkatëse të cilat kanë verifikuar shkatërrimin e mallrave, kur kërkohet prania e tyre.

Një kopje e gjithë dokumentacionit të mbajtur përgjatë procesit të daljes jashtë përdorimit i dërgohet Drejtorisë Rajonale Tatimore.

Ky proces nuk shoqërohet me faturë tatimore.

Nëse procedura e mësipërme nuk ndiqet ose inspektorët tatimor kundërshtojnë kërkesën e personit të tatueshëm ose në rast kontrolli konstatojnë se personi ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore tatimore apo me ligjet specifike të sektorit ku vepron, atëherë ai është i detyruar të kryejë rregullimin e TVSH-së së zbritur për mallin në përputhje me ligjin.

3. Raste të tjera të dëmeve apo shkatërrimit të pasurisë

Shkatërrimi i pasurisë së personit të tatueshëm për shkaqe natyrore të tilla si tërmete, përmbytje, djegie, etj., në raste emergjencash civile sipas legjislacionit të fushës, ose për shkak të aksidenteve, të cilat janë të verifikueshme dhe të dokumentuara nga institucioni publik përkatës, nuk është objekt i rregullimit të TVSH-së së zbritur.

Kur mallrat janë dëmtuar apo shkatërruar nga fatkeqësia nuk kryhet rregullimi i TVSH-së së zbritshme që lidhet me mallrat e dëmtuara, të shkatërruara nëse personi i tatueshëm dokumenton:

një përshkrim të mallrave të dëmtuara, shkatërruara përfshirë numrin e njësive/ sasinë e secilit lloj të mallit;

dokumente ose një evidence të blerjes së mallrave dhe çmimin me të cilin mallrat janë blerë;

raportin përkatës nga organi kompetent që vërteton se mallrat janë dëmtuar, shkatërruar si dhe mënyrën (ngjarjen) me të cilën mallrat janë dëmtuar apo shkatërruar;

datën në të cilën mallrat janë dëmtuar, shkatërruar;

Nëse mallrat për të cilat nuk zbatohet rregullimi i TVSH-së së zbritshme sipas këtij neni personi i tatueshëm përfiton dëmshpërblim për dëmin ose për arsye të sigurimit të mallit, ose vlerë të rikuperueshme për mallin e dëmtuar, atëherë për vlerën e përfituar, personi i tatueshëm llogarit TVSH. Vlera e tatueshme në këtë rast është vlera e përfituar minus TVSH-në përkatëse.

Do të kryhet rregullimi i TVSH-së së zbritshme, për çdo mall të dëmtuar apo shkatërrim i cili është shkaktuar nga një akt i qëllimshëm i personit të tatueshëm apo dikush që vepron në interes të tij, të tilla si për shembull kur një tatimpagues me qëllim i vë zjarrin mallrave të tij, ose kur shkatërrimi ndodh për shkak të veprimeve të kryera nga personi i tatueshëm në shkelje të dispozitave ligjore përkatëse.

Neni 59

Vjedhja ose humbja e pasurisë

Në zbatim të pikës 3 të nenit 79 të ligjit për rastet e një humbjeje të pasurisë për shkak të vjedhjes, kryhet rregullimi i zbritjes së TVSH-së për vlerën e zbritur të TVSH-së së mallit të vjedhur.

Rregullimi i TVSH-së regjistrohet në librin e blerjes në kolonën përkatëse, si dhe në deklaratën e TVSH-së të periudhës tatimore kur ka ndodhur vjedhja ose humbja.

Në kushtet e paragrafit më sipër, kur malli i vjedhur ka qenë i siguruar pranë një shoqërie sigurimi apo ri-sigurimi dhe personi i tatueshëm përfiton një dëmshpërblim të dëmit të pësuar të pasurisë së tij, atëherë për vlerën e dëmshpërblimit në këtë rast nuk zbatohet TVSH.

Neni 60

Trajtimi fiskal i firove /humbjeve gjatë procesit të prodhimit, magazinimit, transportit

1.Në zbatim të pikës 2 tënenit 79 të ligjit për mallrat që pësojnë firo/humbje gjatë procesit të prodhimit, magazinimit, transportit, për të cilat nuk ka përcaktime në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë normativat e firove, përlllogaritjet do të bazohen në kartën teknologjike. Kështu për sasinë e humbjeve të lejuara sipas kartës teknologjike nuk do të kërkohet të kryhet rregullimi i zbritjes së TVSH-së, [siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale.](#)

Për qëllime të këtij paragrafi personi i tatueshëm, me fillimin e aktivitetit prodhues është i detyruar të dorëzojë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore kartën teknologjike.

Në rast të mosdorëzimit të kartës teknologjike, ose kur autoriteti tatimor konstaton shkelje zbatohet TVSH për sasinë e firove/humbjeve përkatëse për proceset e mësipërme.

2.Trajtimi i humbjeve në rrjet të energjisë elektrike gjatë procesit të shpërndarjes

Në rastin e furnizimit të energjisë elektrike, “humbje gjatë shpërndarjes së energjisë elektrike” do të konsiderohet përqindja e humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje, [siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale”.](#)

Për qëllime të këtij udhëzimi, niveli i humbjeve në rrjet të energjisë elektrike është vjetor dhe niveli maksimal i humbjeve është përqindja sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave të sipërpërmendur.

Në rast se përqindja faktike vjetore e humbjeve tejkalon përqindjen sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale”, për qëllime të TVSH-së konsiderohet përqindja e përcaktuar sipas VKM-së.

Në rast se përqindja faktike vjetore e humbjeve është më e ulët se përqindja vjetore e përcaktuar me VKM, për qëllime të TVSH-së konsiderohet përqindja faktike e humbjeve.

Brenda tre muajve të vitit pasardhës, personi i tatueshëm që operon në sektorin e shpërndarjes së energjisë në bashkëpunim me administratën tatimore kryejnë rakordimet dhe rregullimet përkatëse.

Neni 61

Kushtet e njohjes së borxhit të keq

1. Kushtet e njohjes së borxhit të keq

Bazuar në nenin 84 të ligjit, kur një pagesë nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht për një furnizim të tatueshëm prej furnizuesit dhe është shpallur si e pambledhshme, konsiderohet si borxh i keq dhe për shumën e paarkëtuar të borxhit të keq, lejohet korrigjimi në zbritje i TVSH-së përkatëse të zbatuar mbi furnizimin.

Për njohjen e një borxhi si borxh të keq me pasojë reduktimin e TVSH-së së pagueshme, duhet të vërtetohet që furnizuesi i mallit/shërbimit ka ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore ose gjyqësore për të mbledhur borxhin dhe pas kësaj ai është shpallur përfundimisht i pambledhshëm (borxhi i keq), për arsye se personi i tatueshëm blerës ka falimentuar.

Gjithashtu, është kusht të vërtetohet se për arkëtimin e tij janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme ligjore, janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore për arkëtimin e borxhit, janë zbatuar sanksionet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dhe nuk është bërë i mundur arkëtimi i tij, dokumentuar me vendim të organeve gjyqësore, ose organeve të tjera kompetente shtetërore të njohura me ligj.

Autoriteti tatimor nuk mund të pranojnë në asnjë rast borxhin e keq si të tillë, nëse furnizuesi nuk vërteton me vendim gjykate se blerësi i tij është debitor dhe ka falimentuar e për pasojë borxhi nuk mund të arkëtohet.

Mosmbledhja ose mospagesa e këtij borxhi në afat ose për një periudhë të caktuar nuk i jep borxhit karakterin e një borxhi të pambledhshëm, cilido qoftë shkaku i mungesës së pagesës (pamundësi pagese, kundërshtim, mospranim, etj).

E drejta për të lëshuar një faturë të borxhit të keq, nëse janë plotësuar dhe vërtetuar se borxhi është borxh i keq, lind vetëm nëse kanë kaluar minimumi 6 muaj nga periudha tatimore në të cilën TVSH është zbatuar.

2. Modalitetet e lëshimit të faturës

Në rastin e shpalljes së një borxhi të keq, shitësi duhet të lëshojë një faturë tatimore me TVSH . Ajo duhet të tregojë fjalët "borxh i keq", vlerat përkatëse që do të korrigjohen, numrin rendor, nr. serial, datën e faturës së furnizimit me të cilën lidhet ky borxh dhe të tregojë në faturë që zbritja e TVSH-së së blerësit duhet të zvogëlohet. Kjo faturë përdoret nga shitësi për të zvogëluar detyrimin për TVSH, ndërsa nga blerësi për të zvogëluar TVSH- ne e zbritshme.

Kur vetëm një pjesë e vlerës së transaksionit nuk është arkëtuar, atëherë fatura duhet të tregojë shumën e pa arkëtuar të transaksionit dhe TVSH që i përket kësaj shume. Për Shembull:

Në faturën e parë:

Shuma për t'u arkëtuar, përfshirë TVSH është

90 lek:

- TVSH për t'u arkëtuar	10 lek
- Shuma e arkëtuar	54 lek
- TVSH e arkëtuar	6 lek
<u>Nëfaturën e borxhit të keq:</u>	
Shuma e paarkëtuar	36 lek
- TVSH e zbritshme për t'u saktësuar (10-6)	4 lek

3. Regjistrimi dhe deklarimi i veprimeve me borxhin e keq

Saktësimet mbi bazën e faturës të borxhit të keq regjistrohen nga shitësi në librin e shitjeve në kutinë përkatëse me emërtimin “ borxh i keq” dhe në deklaraten e TVSH-së si pakësim detyrimi për TVSH në kutitë përkatëse me të njëjtin emërtim, përkatësisht vlera e tatueshme në vlerë negative (-) në kutitë me emërtimin “Borxhi i keq” dhe vlera e TVSH përkatëse vlerë negative (-) në kutitë e deklaratës. Ndërsa nga blerësi në librin e blerjeve si pakësim i zbritjes së TVSH- së, dhe në kutitë përkatëse me emërtimin “Borxhi i keq” të deklaratës së TVSH-së.

Shitësi ka detyrimin të njoftojë autoritetin tatimor që ka kryer procedurën e mësipërme të borxhit të keq, e cila nga ana e saj do të sigurohet që edhe blerësi do të kryejë veprimet korrigjuese në ulje të TVSH-së së zbritshme bazuar në faturën e borxhit të keq të lëshuar. Në të kundërt fatura e borxhit të keq nuk do të njihet për qëllime të reduktimit të TVSH-së, prej shitësit.

Kur një borxh i keq lejohet dhe i gjithë ose një pjesë e këtij borxhi arkëtohet më vonë, shitësi duhet të lëshojë një faturë të re për vlerën e borxhit të arkëtuar. Për lëshimin e kësaj fature zbatohen të njëjtat rregulla dhe fatura e re duhet të tregojë fjalët "borxh i keq i paguar" dhe numrin rendor dhe serial të "faturës të borxhit të keq" me të cilën lidhet.

Neni 62

Rimbursimi i TVSH-së Rregullat dhe procedura e rimbursimit

Sikurse përcaktohet në nenin 1 të ligjit nr. 90/2015, datë 23.7.2015, "Për një ndryshim në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH", procedura e rimbursimit të TVSH-së kryhet siç përcaktohet në ligjin për procedurat tatimore dhe udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, "Për procedurat tatimore në RSH", të ndryshuar"

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/4, datë 04.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 07.09.2015)

Neni 63

Rimbursimi për marrëveshjet financiare

Në rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 77 të ligjit, nëse kërkesa për rimbursim është bërë në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar u rimbursohet financuesve të huaj nëpërmjet sistemit të thesarit brenda 30 ditëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim. Rimbursimi i kryer për këto raste nuk i nënshtrohet analizës së riskut dhe kontrolli tatimor për rimbursimin e kryer nuk është i detyrueshëm përpara rimbursimit.

Çdo procedurë për rimbursimin apo për financimin e TVSH-së për rastet e mëposhtme, pavarësisht nëse kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo financohen sipas procedurave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 12.8.1996, nga përfituesi vendës, do të përfundojë brenda 30 ditëve, përfshirë edhe rimbursimin e shumave nga strukturat përgjegjëse të Thesarit.

Kur pavarësisht përjashtimit, TVSH-ja përballohet (paguhet) direkt nga

donatori: a) Kur projekti realizohet (zbatohet) nga vetë njësia zbatuese

Njësia zbatuese e projektit për qëllime të rimbursimit të TVSH-së duhet të pajiset me NIPT (certifikatë regjistrimi) në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse dhe të dorëzojë deklaratën e TVSH-së në përputhje me ligjin. Njësia zbatuese e projektit çregjistrohet në përfundim të afatit të projektit. TVSH-ja mbulohet (përballohet) direkt nga njësia zbatuese e donatorit apo e projektit në Shqipëri si për blerjet brenda vendit, ashtu dhe për importet, njësia paraqet në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, dokumentacionin e mëposhtëm:

Kërkesën për rimbursim, ku theksohet shuma e rimbursimit që kërkohet, veprimtaria e kryer, arsyet për rimbursim etj.

Kopjen në shqip të noterizuar të marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të marrëveshjes së miratuar nga qeveria. Kontrata e projektit, e hartuar në kuadër të marrëveshjes, duhet të përmbajë emërtimin e projektit apo të projekteve, shumën totale për secilin prej tyre, afatin kohor të fillimit e të përfundimit të projektit. Kopja e kontratës shoqërohet edhe me listën (emrin dhe mbiemrin) e përfaqësuesve zyrtarë të çdo projekti.

Deklaratat e TVSH-së, teprica kreditore e mbartur e të cilave duhet të jetë e barabartë me shumën e TVSH-së që kërkohet të rimbursohet.

Faturat origjinale të blerjes (në rastin e blerjeve brenda vendit) dhe deklaratat origjinale doganore (për rastet e importeve). Si faturat, ashtu dhe deklaratat doganore të importit, duhet të

përmbajnë në mënyrë shumë të dukshme shënimin "Blerja/importi bëhet në kuadrin e marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të miratuar nga Këshilli i Ministrave, me nr. __, datë __. __. 20__ dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje". Ky shënim do të bëhet nga përfaqësuesi zyrtar i njësisë së zbatimit të projektit, i njohur nga drejtoria rajonale e tatimeve, në bazë të listës së mësipërme, i cili veç kësaj duhet të shënojë në faturë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

Kur projekti realizohet nga sipërmarrës të kontraktuar nga njësia zbatuese

Në këtë rast, në kuadër të zbatimit të projektit, është shoqëria sipërmarrëse e punimeve, e cila për zbatimin e projektit sipas kontratës zbaton TVSH-në mbi vlerën e punimeve, shërbimeve apo furnizimit të mallrave të kryer. Shoqëria sipërmarrëse nga TVSH-ja e faturuar zbret TVSH-në e paguar në blerjet që ka bërë për këtë qëllim, të përballuar nga vetë ajo dhe diferenca përfaqëson TVSH-në e pagueshme nga kjo shoqëri, TVSH-ja, e cila deklarohet dhe paguhet sipas ligjit. Faturën origjinale të shitjes, së bashku me situacionin e punimeve, shoqëria sipërmarrëse e punimeve ia paraqet njësisë zbatuese të projektit.

Njësia zbatuese e projektit, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, duhet të pajiset me NIPT (certifikatë regjistrimi) në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse dhe të dorëzojë deklaratën e TVSH-së në përputhje me ligjin. Njësia zbatuese e projektit çregjistrohet në përfundim të afatit të projektit. Njësia zbatuese e projektit paraqet në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në DPT dokumentacionin e mëposhtëm:

Kërkesën për rimbursim, ku theksohet shuma e rimbursimit që kërkohet, veprimtaria e kryer, arsyet për rimbursim etj.

Kopjen në shqip të noterizuar të marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të marrëveshjes së miratuar nga qeveria. Kontrata e projektit, e hartuar në kuadër të marrëveshjes, duhet të përmbajë emërtimin e projektit apo të projekteve, shumën totale për secilin prej tyre, afatin kohor të fillimit e të përfundimit të projektit. Kopja e kontratës shoqërohet edhe me listën (emrin dhe mbiemrin) e përfaqësuesve zyrtarë të çdo projekti.

Deklaratat e TVSH-së, teprica kreditore e mbartur e të cilave duhet të jetë e barabartë me shumën e TVSH-së që kërkohet të rimbursohet.

Faturat origjinale të blerjes (në rastin e blerjeve brenda vendit) dhe deklaratat origjinale doganore (për rastet e importeve). Si faturat, ashtu dhe deklaratat doganore të importit, duhet të përmbajnë në mënyrë shumë të dukshme shënimin "Blerja/importi bëhet në kuadrin e marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të miratuar nga Këshilli i Ministrave me nr. __, datë

___. __. 20__ dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje". Ky shënim do të bëhet nga përfaqësuesi zyrtar i njësies së zbatimit të projektit, i njohur nga drejtoria rajonale e tatimeve, në bazë të listës së mësipërme, i cili veç kësaj duhet të shënojë në faturë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

TVSH-ja përballohet nga përfituesi vendës i projektit si kosto lokale

Kryerja e punimeve, furnizimi i mallrave apo i shërbimeve për zbatimin e projekteve do të ngarkohet kurdoherë me TVSH-në, e cila në çdo rast do të paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e kontraktuar për zbatimin e projektit. Por kjo TVSH do t'i jepet atij përkundrejt paraqitjes së faturës (situacionit) me TVSH-në nga burime të brendshme të financuara nga kosto lokale sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 12.8.1996. Kështu, kur donatori nuk merr përsipër të përballojë pagesën e TVSH-së, do të veprohet në përputhje me VKM-në nr. 509, datë 12.8.1996. Në bazë të këtij vendimi, TVSH-ja financohet nga përfituesi apo investitori vendës i projektit dhe paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e punimeve për zbatimin e projektit.

Tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin e materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet anëtare të Aleancës së NATO-s apo partnerët, paguhet si kosto lokale nga Ministria e Mbrojtjes.

Në rastin e zbatimit të Marrëveshjeve kuadër "Mbi bashkëpunim dhe zhvillim", midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, financimet në kuadër të këtyre marrëveshjeve janë të përjashtuara nga TVSH-ja. TVSH-ja do të financohet nga përfituesi vendës në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe faturohet e paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e furnizimeve për zbatimin e projektit. Skema e zbatimit të TVSH-së do të bëhet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 12.8.1996 "Për mënyrën e përballimit të TVSH-së që lidhet me zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë e organizma të ndryshëm ndërkombëtarë".

Në zbatim të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, kur i kontraktuari/përfituesi i grantit (lider/koordinator, bashkaplikant/bashkëpërfitues apo nënpërfitues granti) të donatorit të përcaktuar në këto marrëveshje, është një organizatë jofitimprurëse (OJF) sipas kuptimit të ligjit për organizatat jofitimprurëse, si dhe përcaktimit të nenit 3, të ligjit për TVSH-në, që ka lidhur një kontratë të financuar me fonde të donatorit, pavarësisht statusit të saj në kontratë, OJF-ja gëzon të drejtën e rimbursimit të TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në kuadër të kësaj kontrate, sipas procedurës së përcaktuar në këtë udhëzim.

Për çdo kontratë granti mund të ketë vetëm një numër identifikimi për efekt rimbursimi, por disa OJF aplikante për t'u pajisur me certifikatë për rimbursim TVSH-je në varësi të statusit të tyre në

kontratë. Nëse aplikanti është një OJF, palë në kontratë me statusin lider/koordinator, certifikata e saj për rimbursim është e vlefshme edhe për TVSH-në e paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në Shqipëri në kuadër të kësaj kontrate nga OJF-të e tjera vendase, palë në kontratë me statusin bashkëpërfituese apo nënëpërfituese të grantit. Në rast se OJF-ja, palë në kontratë me statusin lider/koordinator është organizatë e huaj që ushtron veprimtarinë jashtë territorit të Shqipërisë apo që ushtron një a disa veprimtari të caktuara në territorin shqiptar, e paregjistruar sipas të drejtës shqiptare me një degë a OJF të re, të drejtën e aplikimit e gëzon OJF-ja/të vendase, palë në kontratë me statusin bashkëpërfituese, për pjesën e TVSH-së së paguar prej saj/tyre dhe prej nënëpërfituesve të grantit (OJF-të vendase, nëse ka) në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në Shqipëri në kuadër të kësaj kontrate.

Edhe në rastin kur lideri/koordinatori nuk e gëzon statusin e OJF-së sipas kuptimit të ligjit për organizatat jofitimprurëse, të drejtën e aplikimit e gëzon OJF-ja/të vendase palë në kontratë me statusin bashkëpërfituese, për pjesën e TVSH-së së paguar prej saj/tyre dhe prej nënëpërfituesve të grantit (OJF-të vendase, nëse ka) në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në Shqipëri në kuadër të kësaj kontrate.

Aplikanti i parë merr gjithnjë certifikatën me numrin bazë të regjistrimit për kontratën, ndërkohë që aplikantët e tjerë pajisen me certifikata me numër identifikues me fraksion të certifikatës së parë. Pavarësisht mënyrës së aplikimit, individualisht apo nëpërmjet një OJF-je tjetër (palë në të njëjtën kontratë), OJF-të që përfitojnë rimbursimin e TVSH -së sipas këtij udhëzimi, janë individualisht përgjegjëse para organit tatimor për pjesën e tyre të deklarimit për efekt të TVSH-së së rimbursueshme.

OJF-ja (lider/koordinator apo bashkëpërfituese) pjesë e kontratës së grantit me donatorin apo institucionin/entitetin e autorizuar/deleguar zyrtarisht prej tij, brenda 90 ditëve kalendarike nga data përfundimtare e pranueshmërisë së shpenzimeve, aplikon pranë drejtorisë rajonale tatimore (DRT) përkatëse, për regjistrim për efekt rimbursimi TVSH-je, në kuadër të zbatimit të kontratës, sipas formularit 6A dhe shpjegimeve përkatëse, pjesë integrale e këtij udhëzimi.

Formulari 6A shkarkohet elektronikisht në <https://www.tatime.gov.al/c/6/71/tatimi-mbi-vleren-e-shtuar>, <https://www.tatime.gov.al/c/6/257/262/tatimi-mbi-vleren-e-shtuar>

ose <https://www.tatime.gov.al/d/8/129/209/185/tatimi-mbi-vleren-e-shtuar> dhe pas plotësimit me të gjitha të dhënat e nevojshme, i adresohet zyrtarisht DRT-së përkatëse, duke i bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

kopje të noterizuar të kontratës (marrëveshjes së partneritetit) midis OJF-së dhe donatorit apo institucionit/entitetit të autorizuar zyrtarisht prej tij për lidhjen e kontratës së financuar/bashkëfinancuar me grant, në gjuhën në të cilën është lidhur kjo kontratë, së bashku me kopje të përkthyer në shqip dhe noterizuar;

kopje të noterizuar të kontratës në gjuhën në të cilën është lidhur kontrata/marrëveshja mes liderit/koordinatorit dhe bashkëpërfituesit dhe/ose nënëpërfituesit të grantit (nëse është e aplikueshme), së bashku me kopje të përkthyer në shqip dhe noterizuar;

ekstrakti i OJF-së nga Gjykata (dokumentacionin që provon statusin jofitimprurës së bashku me ndryshimet që mund të ketë pësuar OJF-ja).

DRT-ja përkatëse regjistron në një regjistër të veçantë të tilla OJF për efekt të rimbursimit të TVSH-së së paguar në kuadër të kontratës së grantit dhe brenda 10 ditëve pune lëshon për OJF-në certifikatën e regjistrimit të kontratës për efekt të rimbursimit të TVSH-së, sipas formularit 6C pjesë e këtij udhëzimi ose njofton refuzimin e saj duke sqaruar edhe arsyet e këtij refuzimi.

Afati i vlefshmërisë së certifikatës është nga data e lëshimit të saj nga DRT-ja përkatëse deri në 24 muaj kalendarik pas datës përfundimtare të pranueshmërisë së shpenzimeve. OJF-ja mund të bëjë kërkesë për rimbursim të TVSH -së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në çdo moment brenda afatit të vlefshmërisë së certifikatës, por në çdo rast vetëm për furnizimet e marra brenda afateve të përcaktuara në kontratë për pranueshmërinë e shpenzimeve.

Për të përfituar rimbursimin e TVSH-së në kuadër të zbatimit të kontratës së grantit, OJF-ja mbajtëse e certifikatës së regjistrimit të kontratës për efekt të rimbursimit të TVSH-së, i paraqet Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar në kuadër të zbatimit të kontratës së grantit, sipas formatit 6R bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë e tij, së bashku me dokumentet e mëposhtme:

kopje të certifikatës së regjistrimit për efekt të rimbursimit të TVSH-së;

kopje të noterizuar ose origjinalin e të gjitha faturave të blerjes të mallrave dhe shërbimeve në kuadër të zbatimit të projektit në Shqipëri dhe listën e blerjeve me TVSH të bëra nga OJF-ja në kuadër të implementimit të kontratës së grantit (pjesë e formatit 6R);

vërtetim nga banka me të dhënat e sakta për çdo llogari bankare të përfshirë në kërkesën për rimbursim;

ç) vërtetimin/konfirmimin e lëshuar nga donatori ose institucioni/entiteti i autorizuar/ deleguar zyrtarisht prej tij, së bashku me raportin financiar përmbledhës, listën e detajuar të shpenzimeve, raportin e verifikimit të shpenzimeve dhe raportin e auditit (nëse është e aplikueshme), për të gjitha shpenzimet për të cilat kërkohet rimbursimi i TVSH-së.

Brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT kryen verifikimin e dokumentacionit të paraqitur dhe procedon me rimbursimin e TVSH-së në llogarinë bankare të çdo OJF-je, të vënë në dispozicion në kërkesën për rimbursim.

Në rastin kur OJF-ja nënshkruan një kontratë me një njësi shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme që vepron si autoritet kontraktues në kuadër të zbatimit të projekteve të ndihmës IPA nën regjimin e menaxhimit indirekt apo të një marrëveshjeje tjetër specifike me donatorin që parashikon mospërdorimin e burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, TVSH-ja i rimbursohet OJF-së, palë në kontratë nga autoriteti kontraktues. Në këtë rast OJF-ja nuk aplikon pranë administratës tatimore, pasi rimbursimi mbulohet nga fondi i parashikuar si kosto lokale në buxhetin e institucionit buxhetor, fusha e përgjegjësisë të të cilit mbulon sektorin e financuar apo bashkëfinancuar nga donatori.

Me lidhjen e kontratës me delegacionin e KE-së në Tiranë, OJF-të duhet të bëjnë një kërkesë pranë drejtorisë rajonale tatimore ku janë të regjistruar si OJF, për regjistrim për efekt rimbursimi TVSH-je në kuadër të zbatimit të projektit IPA, duke i bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

Një kopje të kontratës së noterizuar midis OJF-ve dhe delegacionit të KE-së në Tiranë, në gjuhën shqipe dhe angleze;

Emrin e projektit në gjuhën shqipe dhe angleze;

Shumën e grantit për projektin përkatës dhe periudha e kohëzgjatjes;

Emrin e organizatës jofitimprurëse përgjegjëse për projektin;

Dokumentacion që provon statusin jofitimprurës të organizatës.

Drejtorja rajonale tatimore regjistron në një regjistër të veçantë të tilla OJF për efekt të rimbursimit të TVSH-së së paguar në kuadër të këtyre projekteve dhe lëshon për OJF-të një certifikatë të regjistrimit të projektit për efekt të rimbursimit të TVSH-së sipas formatit nr. 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Një kopje e kësaj certifikate i përcillet delegacionit të KE-së në Tiranë dhe Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në DPT.

Organizata jofitimprurëse i paraqet Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar për zbatimin e kësaj kontrate, duke i bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

Certifikatën e regjistrimit për efekt të rimbursimit të TVSH-së;

Kopje të faturave origjinale të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve në kuadër të zbatimit të projektit;

Vërtetimin e lëshuar nga Komisioni Evropian së bashku me listën e konfirmuar të të gjitha faturave të detajuara për shpenzimet e kryera nga OJF-të në kuadër të projektit të financuar nga IPA.

Brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës dhe verifikimit të shumës së pretenduar, Drejtoria e rimbursimit të TVSH-së, në DPT procedon me rimbursimin e TVSH-së.

Në rastet e zbatimit të marrëveshjeve kuadër për bashkëpunim dhe zhvillim, në bazë të të cilave përfitues janë institucionet buxhetore, të cilave, në momentin e importimit, nuk u janë livruar nga Drejtoria e Thesarit fondet buxhetore për pagimin e TVSH-së për importimin e mallrave të përfituara në kuadër të këtyre projekteve, administrata doganore procedon me shtyrje të pagesës së TVSH-së në momentin e importit, për një periudhë deri në tre muaj, me kusht që institucioni buxhetor përfitues të paraqesë:

pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave: kopje të kontratës së lidhur midis institucionit buxhetor përfitues dhe donatorit;

pranë degës doganore që do të akordojë shtyrjen e TVSH-së: urdhrin e pagesës të vulosur nga dega e thesarit përkatës.

Në qoftë se nuk kryhet pagesa brenda periudhës 3-mujore, njoftohet Ministria e Financave. (Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/4, datë 04.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 07.09.2015)

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 34, datë 05.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 169, datë 11.12.2019)

Neni 63/1

Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e donacionit/grantit

~~Në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit, për qëllime të TVSH së, trajtohet si furnizim i ngjashëm me eksportet, furnizimi i mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime në Shqipëri.~~

~~Për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore të TVSH-së zero për qind, zbatuesi ose përfituesi i projektit (kur nuk ka zbatues), duhet të regjistrohet për qëllime të TVSH-së dhe të ndjekë procedurën e mëposhtme:~~

~~2.1 Regjistrimi në organin tatimor për efekt të TVSH-së i zbatuesit/përfituesit (kur nuk ka zbatues)/kontraktorit të projektit~~

~~Në mënyrë që skema e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit të funksionojë, duhet që zbatuesit/përfituesit (kur nuk ka zbatues)/kontraktorët, të jenë të regjistruar për TVSH-në. Regjistrimi për qëllime të TVSH-së mundëson lëshimin e faturave tatimore me TVSH zero për qind për furnizime brenda vendit nga kontraktorët, si dhe pranimin e këtyre faturave nga zbatuesit/përfituesit e projektit. Regjistrimi për TVSH-në mund të bëhet edhe nëpërmjet përfaqësuesit tatimor, sipas dispozitave të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.~~

~~2.2 Regjistrimi i zbatuesit/përfituesit të projektit në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)~~

~~a) Zbatuesi i projektit ose përfituesi i projektit (kur nuk ka zbatues), regjistrojnë projektin në SASPAC, duke paraqitur:~~

~~i. kërkesë me shkrim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet nga marrëveshja e donacionit/grantit të miratuar, e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, në të cilën është përcaktuar qartësisht kushti që donacionet/grantet e parashikuara në marrëveshje, nuk do të përdoren për të paguar tatime;~~

~~— kopje të aktit me të cilin është miratuar projekti;~~

~~— çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga SASPAC.~~

~~SASPAC vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga zbatuesi/përfituesi i projektit dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Projektit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, SASPAC njofton menjëherë zbatuesin/përfituesin e projektit për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-ditor (dhjetëditor).~~

~~Certifikata përmban elementet, si: emërtimi i projektit, data e fillimit dhe data e përfundimit të projektit, vlera fillestare e financimit të projektit, të dhënat e zbatuesit dhe përfituesit të projektit, si dhe Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të lëshuar nga SASPAC për këtë qëllim.~~

~~SASPAC, një kopje të certifikatës së regjistrimit të projektit, së bashku me kopje të dokumentacionit të parashikuar në shkronjën “a” më sipër, i’a dërgon menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD).~~

~~Në rast të ndryshimit të kushteve të marrëveshjes dhe/ose projektit, zbatuesi/përfituesi i projektit duhet të njoftojë SASPAC, brenda një afati 5 (pesë) ditor. Në këtë rast, SASPAC reflekton ndryshimet në certifikatën e lëshuar dhe ia dërgon menjëherë DPT së dhe DPD së.~~

~~2.3 Regjistrimi i kontratës/ave në Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT) përkatëse:~~

~~DPT, certifikatën e lëshuar nga SASPAC, së bashku me dokumentacionin e dërguar sipas shkronjës “d”, të pikës 2.2, më sipër, ia përcjell ditën e nesërme të punës, DRT së ku është i regjistruar për TVSH në i kontraktuari i zbatuesit të projektit ose zbatuesi/përfituesi i projektit.~~

~~Kontraktori/ët dorëzon/jnë pranë DRT së ku është/janë i/të regjistruar një kopje të noterizuar të kontratës/ave të dakordësuar/a dhe nënshkruar/a me zbatuesin ose me përfituesin e projektit, për rastet kur ky i fundit nuk e delegon projektin tek ndonjë zbatues projektit.~~

~~DRT-ja përkatëse regjistron në një regjistër të veçantë kontraktorin/ët dhe/ose zbatuesin/përfituesin e projektit, si dhe brenda 5 (pesë) ditëve pune, lëshon certifikatën për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, sipas formularit 7A, pjesë integrale e këtij udhëzimi. Kjo certifikatë është e vlefshme deri në përfundimin e projektit, sipas kriterëve të parashikuara në marrëveshje.~~

~~Kodi Unik i Identifikimit të Projektit, i përcaktuar në certifikatën e lëshuar nga SASPAC, do të evidentohet në çdo faturë të lëshuar me TVSH zero për qind nga kontraktori për zbatuesin/përfituesin e projektit, si dhe në çdo faturë që furnizuesit e mallrave/shërbimeve (qofshin këto furnizime të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara nga TVSH-ja) lëshojnë për kontraktorin e miratuar.~~

~~Në faturat që lëshon, kontraktori duhet të pasqyrojë dispozitën e ligjit, konkretisht, shkronja “e”, pika 1, neni 60, sipas së cilës ky furnizim do të trajtohet si furnizim i përngjashëm me eksportet, me shkallë tatimore të TVSH së zero për qind, si dhe numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja. Ndërsa, furnizuesit e mallrave/shërbimeve për kontraktorin, qofshin këto furnizime të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara nga TVSH-ja, do të pasqyrojnë në faturë numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja.~~

~~Faturimi i furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.~~

~~3. Aplikimi i TVSH së gjatë zbatimit të projektit nga kontraktori~~

~~Kontraktori, subjekt i regjistruar për TVSH në, në zbatim të kontratës së nënshkruar me zbatuesin e projektit, realizon furnizime mallrash/shërbimesh, të cilat sipas shkronjës “e”, pika 1, neni 60, të ligjit, trajtohen si furnizime të përngjashme me eksportet, pra me shkallë tatimore të TVSH së zero për qind.~~

~~Deklarimi i transaksioneve për qëllime të TVSH-së nga kontraktori/ët dhe rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve~~

~~Kontraktori/ët, furnizimin e mallrave/shërbimeve të realizuara në zbatim të shkronjës “e”, pika 1, neni 60, të ligjit e deklarojnë në librin e shitjeve dhe më pas në formularin e deklarimit të TVSH-së në rubrikën “Shitje të përngjashme me eksportet”, ndërsa blerjet e realizuara për qëllim të kësaj skeme, në rubrikën “Blerje të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me donacione/grante”.~~

~~Për blerjet e kryera në funksion të realizimit të projektit, qofshin këto blerje me normë standarde apo të reduktuar të TVSH-së, kontraktori gëzon të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sipas përcaktimeve në nenet 68-84, të kreut IX, të ligjit. Në rast se kontraktori rezulton me tepriceë kreditore, i lind e drejta e rimbursimit, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.~~

~~Përfjashtimi nga TVSH-ja në import~~

~~Në zbatim të pikës 45, të nenit 56, të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja në import, importimi i mallrave të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime.~~

~~Për qëllime të zbatimit të përjashtimit në import, zbatuesi/përfituesi (kur nuk ka zbatues)/kontraktuesi i projektit, të cilët mund të kryejnë importe mallrash në kuadër të kësaj skeme, do të pajisen me autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Për marrjen e këtij autorizimi, zbatuesi/përfituesi/kontraktuesi i projektit duhet të paraqesë me shkrim pranë DPD-së:~~

~~-kërkesën për përjashtim nga TVSH-ja në importin e mallrave të destinuara për projektin;~~
~~-kopje të Certifikatës së Regjistrimit të Projektit, përfshirë Kodin Unik të Identifikimit të Projektit;~~

~~-kopje të certifikatës së lëshuar nga DRT-ja;~~
~~-kopje të noterizuar të kontratës/ave ndërmjet zbatuesit/përfituesit me kontraktorin/ët;~~
~~-dokumentin që vërteton përgjegjësinë tatimore të regjistrimit për qëllime të TVSH-së. DPD-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të kërkesës, shqyrton aplikimin për përjashtim dhe lëshon autorizimin nëse dokumentacioni është i saktë. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, DPD njofton menjëherë subjektin aplikues për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor. Me plotësimin e dokumentacionit, DPD-ja lëshon autorizimin për përjashtimin nga TVSH-ja në import. Ky autorizim regjistrohet në sistemin informatik të DPD-së.~~

~~Monitorimi dhe kontrolli i furnizimeve për llogari të projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj~~

~~Administrata tatimore monitoron, analizon dhe verifikon furnizimet dhe importet e kryera në kuadër të skemës së parashikuar në shkronjën “e”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nga:~~

Kontraktorët, të cilët aplikojnë TVSH zero për qind për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve për zbatuesit/përfituesit e projekteve.

~~Zbatuesit/përfituesit e projekteve, të cilët furnizohen me mallra dhe shërbime me TVSH zero për qind nga kontraktorët e tyre.~~

~~Administrata tatimore ka detyrimin e kontrollit, verifikimit, kryqëzimit të të dhënave të deklaruar nga kontraktorët/zbatuesit/përfituesit e projekteve në librat e tyre të shitjeve dhe blerjeve, si dhe në deklaraten e TVSH-së, me qëllim garantimin e trajtimit me TVSH zero për qind vetëm për furnizimet e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit.~~

~~Procedurat e detajuara të verifikimit të transaksioneve, kontrollit të tyre dhe rimbursimit të kontraktorëve për rastet kur plotësohen kriteret ligjore, detajohen nga DPT në pjesën e Manualit të Kontrollit të dedikuar për këto transaksione dhe subjekte.~~

(Shtuar me Udhëzim Nr. 11 datë 13.04.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 66, datë 19.04.2023)

Neni 63/1

Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e donacionit/grantit me donatorët, përveç granteve nga Bashkimi Evropian

1. Në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit, për qëllime të TVSH-së, trajtohet si furnizim i ngjashëm me eksportet, furnizimi i mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime në Shqipëri.

2. Për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore të TVSH-së zero për qind, zbatuesi ose përfituesi i projektit (kur nuk ka zbatues), duhet të regjistrohet për qëllime të TVSH-së dhe të ndjekë procedurën e mëposhtme:

2.1 Regjistrimi në organin tatimor për efekt të TVSH-së i zbatuesit/përfituesit (kur nuk ka zbatues)/kontraktorit të projektit

Në mënyrë që skema e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit të funksionojë, duhet që zbatuesit/përfituesit (kur nuk ka zbatues)/kontraktorët, të jenë të regjistruar për TVSH-në. Regjistrimi për qëllime të TVSH-së mundëson lëshimin e faturave tatimore me TVSH zero për qind për furnizime brenda vendit nga kontraktorët, si dhe pranimin e këtyre faturave nga zbatuesit/përfituesit e projektit. Regjistrimi për TVSH-në mund të bëhet edhe nëpërmjet përfaqësuesit tatimor, sipas dispozitave të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

2.2 Në zbatim të pikës 1, regjistrimi i zbatuesit/përfituesit të projektit në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC) bëhet:

a) Në rastin e marrëveshjeve/protokolleve të bashkëpunimit të firmosura nga titullari i SASPAC, drejtorja përgjegjëse për bashkërendimin e ndihmës së huaj i drejton SASPAC kërkesën për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës për çdo projekt/program të parashikuar në përmbajtjen e tyre;

b) Në rastin e marrëveshjeve të përcjella nëpërmjet kanaleve diplomatike pranë SASPAC, drejtorja përgjegjëse për bashkërendimin e ndihmës së huaj i drejton SASPAC kërkesën për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës për çdo projekt/program të parashikuar në përmbajtjen e tyre;

c) Midis institucionit shqiptar përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj, ose zbatuesi i projektit ose përfituesi i projektit (kur nuk ka zbatues), regjistrojnë projektin në SASPAC, duke paraqitur:

i. Kërkesë me shkrim ku bashkëlidhur të jetë marrëveshja qeveritare kuadër e lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të shteteve të huaja për sigurimin e bashkëpunimit financiar apo bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet dy vendeve shoqëruar me protokollin e bashkëpunimit ose dokumentin strategjik të donatorit për mbështetjen e Shqipërisë (nëse ka një të tillë);

ii. Të dhëna referencë për aktin me të cilin është miratuar marrëveshja/protokolli/dokumenti strategjik (nëse ka një të tillë);

d) SASPAC vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga zbatuesi/përfituesi i projektit dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Projektit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, SASPAC njofton menjëherë zbatuesin/përfituesin e projektit për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-ditor (dhjetëditor);

e) Certifikata përmban elementet, si: emërtimi i projektit, data e fillimit dhe data e përfundimit të projektit, vlera fillestare e financimit të projektit, të dhënat e zbatuesit dhe përfituesit të projektit, si dhe Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të lëshuar nga SASPAC për këtë qëllim;

f) SASPAC, një kopje të certifikatës së regjistrimit të projektit, së bashku me kopje të dokumentacionit të parashikuar në shkronjën “a” më sipër, ia dërgon menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD);

g) Në rast të ndryshimit të kushteve të marrëveshjes dhe/ose projektit, zbatuesi/përfituesi i projektit duhet të njoftojë SASPAC, brenda një afati 5-(pesë)-ditor. Në këtë rast, SASPAC reflekton ndryshimet në certifikatën e lëshuar dhe ia dërgon menjëherë DPT-së dhe DPD-së;

h) Në rast të ndryshimit të vlerës së financimit dhe/ose projektit, zbatuesi/përfituesi i projektit duhet të njoftojë SASPAC, brenda një afati 5-(pesë)-ditor. Në këtë rast, SASPAC reflekton ndryshimet në certifikatën e lëshuar dhe ia dërgon menjëherë DPT-së dhe DPD-së;

i) DPT-ja dhe DPD-ja raportojnë në fundin e muajit pasues të çdo tremujori në SASPAC, të dhëna të detajuara për çdo transaksion që kanë kryer me TVSH-në e përjashtuar (të dhëna për zbatuesin/përfituesin e projektit, NIPT-i, kodi unik i certifikatës, vlera, monedha).

2.3 Regjistrimi i kontratës/ave në Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT) përkatëse:

a) DPT-ja, certifikatën e lëshuar nga SASPAC, së bashku me dokumentacionin e dërguar sipas shkronjës “d”, të pikës 2.2, më sipër, ia përcjell ditën e nesërme të punës, DRT-së ku është i regjistruar për TVSH-në i kontraktuari i zbatuesit të projektit ose zbatuesi/përfituesi i projektit;

b) Kontraktori/ët dorëzon/jnë pranë DRT-së ku është/janë i/të regjistruar një kopje të noterizuar të kontratës/ave të dakordësuar/a dhe nënshkruar/a me zbatuesin ose me përfituesin e projektit, për rastet kur ky i fundit nuk e delegon projektin tek ndonjë zbatues projekti.

DRT-ja përkatëse regjistron në një regjistër të veçantë kontraktorin/ët dhe/ose zbatuesin/përfituesin e projektit, si dhe brenda 5 (pesë) ditëve pune, lëshon certifikatën për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, sipas formularit 7A, pjesë integrale e këtij udhëzimi. Kjo certifikatë është e vlefshme deri në përfundimin e projektit, sipas kritereve të parashikuara në marrëveshje;

c) Kodi Unik i Identifikimit të Projektit, i përcaktuar në certifikatën e lëshuar nga SASPAC, do të evidentohet në çdo faturë të lëshuar me TVSH zero për qind nga kontraktori për zbatuesin/përfituesin e projektit, si dhe në çdo faturë që furnizuesit e mallrave/shërbimeve (qofshin këto furnizime të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara nga TVSH-ja) lëshojnë për kontraktorin e miratuar;

d) Në faturat që lëshon, kontraktori duhet të pasqyrojë dispozitën e ligjit, konkretisht, shkronja “c”, pika 1, neni 60, sipas së cilës ky furnizim do të trajtohet si furnizim i përngjashëm me eksportet, me shkallë tatimore të TVSH-së zero për qind, si dhe numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja. Ndërsa, furnizuesit e mallrave/shërbimeve për kontraktorin, qofshin këto furnizime të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara nga TVSH-ja, do të pasqyrojnë në faturë numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja;

e) Faturimi i furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

3. Aplikimi i TVSH-së gjatë zbatimit të projektit nga kontraktori

Kontraktori, subjekt i regjistruar për TVSH-në, në zbatim të kontratës së nënshkruar me zbatuesin e projektit, realizon furnizime mallrash/shërbimesh, të cilat sipas shkronjës “c”, pika 1, neni 60, të ligjit, trajtohen si furnizime të përngjashme me eksportet, pra me shkallë tatimore të TVSH-së zero për qind.

4. Deklarimi i transaksioneve për qëllime të TVSH-së nga kontraktori/ët dhe rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve

Kontraktori/ët, furnizimin e mallrave/shërbimeve të realizuara në zbatim të shkronjës “c”, pika 1, neni 60, të ligjit e deklarojnë në librin e shitjeve dhe më pas në formularin e deklarimit të TVSH-së në rubrikën “Shitje të përngjashme me eksportet”, ndërsa blerjet e realizuara për qëllim të kësaj skeme, në rubrikën “Blerje të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me donacione/grante”.

Për blerjet e kryera në funksion të realizimit të projektit, qofshin këto blerje me normë standarde apo të reduktuar të TVSH-së, kontraktori gëzon të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sipas përcaktimeve në nenet 68–84, të kreut IX, të ligjit. Në rast se kontraktori rezulton me tepriçë kreditore, i lind e drejta e rimbursimit, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përjashtimi nga TVSH-ja në import

Në zbatim të pikës 45, të nenit 56, të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja në import, importimi i mallrave të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime.

Për qëllime të zbatimit të përjashtimit në import, zbatuesi/përfituesi (kur nuk ka zbatues)/kontraktuesi i projektit, të cilët mund të kryejnë importe mallrash në kuadër të kësaj skeme, do të pajisen me autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Për marrjen e këtij autorizimi, zbatuesi/përfituesi/kontraktuesi i projektit duhet të paraqesë me shkrim pranë DPD-së:

a) Kërkesën për përjashtim nga TVSH-ja në importin e mallrave të destinuara për projektin;

b) Kopje të Certifikatës së Regjistrimit të Projektit, përfshirë Kodin Unik të Identifikimit të Projektit;

c) Kopje të certifikatës së lëshuar nga DRT-ja;

d) Kopje të noterizuar të kontratës/ave ndërmjet zbatuesit/përfituesit me kontraktorin/ët;

e) Dokumentin që vërteton përgjegjësinë tatimore të regjistrimit për qëllime të TVSH-së.

DPD-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të kërkesës, shqyrton aplikimin për përjashtim dhe lëshon autorizimin nëse dokumentacioni është i saktë. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, DPD-ja njofton menjëherë subjektin aplikues për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor. Me plotësimin e dokumentacionit, DPD-ja lëshon autorizimin për përjashtimin nga TVSH-ja në import. Ky autorizim regjistrohet në sistemin informatik të DPD-së.

6. Monitorimi dhe kontrolli i furnizimeve për llogari të projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj

Administrata tatimore monitoron, analizon dhe verifikon furnizimet dhe importet e kryera në kuadër të skemës së parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nga:

a) Kontraktorët, të cilët aplikojnë TVSH zero për qind për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve për zbatuesit/përfituesit e projekteve;

b) Zbatuesit/përfituesit e projekteve, të cilët furnizohen me mallra dhe shërbime me TVSH zero për qind nga kontraktorët e tyre.

Administrata tatimore ka detyrimin e kontrollit, verifikimit, kryqëzimit të të dhënave të deklaruara nga kontraktorët/zbatuesit/përfituesit e projekteve në librat e tyre të shitjeve dhe blerjeve, si dhe në deklaratën e TVSH-së, me qëllim garantimin e trajtimit me TVSH zero për qind vetëm për furnizimet e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit.

Procedurat e detajuara të verifikimit të transaksioneve, kontrollit të tyre dhe rimbursimit të kontraktorëve për rastet kur plotësohen kriteret ligjore, detajohen nga DPT-ja në pjesën e Manualit të Kontrollit të dedikuar për këto transaksione dhe subjekte.

(Riformuluar me Udhëzimin nr. 27, datë 13.9.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.137, datë 20.09.2023)

Neni 63/2

Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e grantit për programet/projektet e financuara nga asistenca financiare e Bashkimit Evropian

1. Në rastin e programeve vjetore të financuara nga IPA Kombëtare, pas finalizimit të procedurave të brendshme për miratimin e Marrëveshjes së Financimit të Programit dhe hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, drejtoria përgjegjëse për administrimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian pranë SASPAC, në rolin e Zyrës Mbështetëse të Koordinatorit Kombëtar IPA, i drejton SASPAC kërkesën për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës për të gjithë dokumentet e veprimit që janë pjesë e programit të miratuar, duke i vënë në dispozicion:

a) Kopje të aktit të miratimit të Marrëveshjes Financiare të Programit;

b) Kopje të dokumentit/eve të veprimit për të cilat do të lëshohet certifikata.

Pas lëshimit të certifikatës, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, SASPAC ia përcjellë autoriteteve kontraktuese, respektivisht:

a) Për dokumentet e veprimit që do të zbatohen me menaxhim direkt, i përcillet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri;

b) Për dokumentet e veprimit që do të zbatohen me menaxhim indirekt me strukturat kombëtare, i përcillet Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU);

c) Për dokumentet e veprimit që do të zbatohen me menaxhim indirekt me një palë të besuar nga Komisioni, i përcillen organizatës/institucionit të cilit i është besuar zbatimi i dokumentit të veprimit.

Autoriteti kontraktues certifikatën e lëshuar nga SASPAC ia përcjellë zbatuesit/përfituesit të projektit.

2. Në rastin e Programeve Operacionale, pas përfundimit të procedurave të brendshme për miratimin e Marrëveshjes Financiare të Programit dhe hyrjes në fuqi të saj, drejtoria përgjegjëse për administrimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian pranë SASPAC, në rolin e Zyrës

Mbështetëse të Koordinatorit Kombëtar IPA, i drejton SASPAC kërkesën për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës për këtë program, duke i vënë në dispozicion:

- a) Kopje të aktit të miratimit të Marrëveshjes Financiare të Programit;
- b) Kopje të programit të miratuar për të cilin do të lëshohet certifikata.

Pas lëshimit të certifikatës, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, SASPAC ia përcjellë Autoritetit Menaxhues dhe Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar (ONMF)/Autoritetit Kontraktues të Programit.

Autoriteti Menaxhues dhe Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar (ONMF)/Autoriteti Kontraktues i Programit certifikatën e lëshuar nga SASPAC ia përcjellë zbatuesit/përfituesit të programit.

3. Në rastin e programeve rajonale të cilat zbatohen direkt nga Komisioni Evropian apo nga një palë të cilës i është besuar nga Komisioni Evropian zbatimi i programit, Komisioni Evropian/Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri regjistrojnë projektin në SASPAC duke paraqitur:

- a) Kërkesën me shkrim;
- b) Njoftimin zyrtar mbi pranueshmërinë e Shqipërisë për të qenë pjesë e programit, bazuar në kriteret e pranueshmërisë;
- c) Dokumentin identifikues të programit në përmbajtje të të cilit janë të dhënat bazë mbi programin, duke përfshirë përshkrimin e programit, informacionin mbi zbatuesin, afatet kohore;
- d) Kopje të aktit me të cilin është miratuar projekti, pjesë e programit;
- e) Çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga SASPAC.

SASPAC vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Programit/Projektit, në drejtim të Komisionit Evropian/Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, SASPAC njofton menjëherë Komisionin Evropian/Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-(dhjetë)-ditor.

Komisioni Evropian/Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri certifikatën e lëshuar nga SASPAC, ia përcjellë zbatuesit/përfituesit të projektit.

4. Në rastin e programeve të Bashkimit Evropian, pas përfundimit të procedurave të miratimit të projekteve për secilën thirrje të programit, institucioni i cili është në rolin e Koordinatorit Kombëtar të programit regjistron projektin në SASPAC, duke paraqitur:

- a) Kërkesën me shkrim;
- b) Referencën ligjore për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Shqipërisë në një program të caktuar;
- c) Listën e projekteve të miratuara në të cilat janë përfitues edhe palë nga Shqipëria (institucioni, organizata, entiteti);
- d) Kopje të aktit me të cilin është miratuar projekti;
- e) Kopje të Marrëveshjes së Partneritetit midis palës shqiptare dhe palëve të tjera përgjegjëse për zbatimin e projektit;
- f) Çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga SASPAC.

SASPAC vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga institucioni koordinues i programit dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Programit/Projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, SASPAC njofton menjëherë institucionin koordinues të programit për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-(dhjetë)-ditor.

Institucioni koordinues i programit certifikatën e lëshuar nga SASPAC ia përcjell zbatuesit/përfituesit të projektit.

5. Në rastin e programeve IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar, pas përfundimit të procedurave të miratimit të projekteve për secilën thirrje të programit, Autoriteti Menaxhues/Autoriteti Kontraktues i programit regjistrojnë projektin në SASPAC, duke paraqitur:

- a) Kërkesë me shkrim;
- b) Kopje të kontratës/marrëveshjes, të nënshkruar nga Autoriteti Menaxhues/Autoriteti Kontraktues dhe përfituesi i projektit, ku përmenden të gjithë partnerët shqiptarë në këtë projekt;
- c) Kopje të Marrëveshjes së Partneritetit midis palës shqiptare dhe palëve të tjera përgjegjëse për zbatimin e projektit;
- d) Çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga SASPAC.

SASPAC vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Autoriteti Menaxhues/Autoriteti Kontraktues i Programit dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Programit/Projektit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, SASPAC njofton menjëherë Autoritetin Menaxhues/Autoritetin Kontraktues i Programit për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10--(dhjetë-)ditor.

Autoriteti Menaxhues/Autoriteti Kontraktues i Programit certifikatën e lëshuar nga SASPAC ia përcjellë zbatuesit/përfituesit të projektit.

6. Për të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, certifikata përmban elementet, si: emërtimi i programit/projektit, data e fillimit dhe data e përfundimit të programit/projektit, vlera fillestare e financimit të programit/projektit, të dhënat e zbatuesit dhe përfituesit të programit/projektit, si dhe Kodin Unik të Identifikimit të Programit/Projektit, të lëshuar nga SASPAC për këtë qëllim.

SASPAC, një kopje të certifikatës së regjistrimit të programit/projektit, së bashku me kopje të dokumentacionit të parashikuar në secilin rast më sipër, ia dërgon menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD).

Në rast të ndryshimit të kushteve të marrëveshjes dhe/ose programit/projektit, autoriteti apo institucioni që ka bërë kërkesën duhet të njoftojë SASPAC, brenda një afati 10-(dhjetë-)ditor. Në këtë rast, SASPAC reflekton ndryshimet në certifikatën e lëshuar dhe ia dërgon menjëherë DPT-së dhe DPD-së. Procedurat e detajuara të verifikimit të transaksioneve, kontrollit të tyre dhe rimbursimit të kontraktorëve për rastet kur plotësohen kriteret ligjore, detajohen nga DPT-ja në pjesën e Manualit të Kontrollit të dedikuar për këto transaksione dhe subjekte.

(Shtuar me Udhëzimin nr. 27, datë 13.9.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.137, datë 20.09.2023)

Neni 64

Procedura e rimbursimit dhe përjashtimit për diplomatët, organizatat ndërkombëtare, NATO

Bazuar në nenin 60 të ligjit për qëllime të TVSH-së trajtohen si furnizime të ngjashme me eksportet furnizimet e mëposhtme:

furnizimet e mallrave dhe shërbimet e kryera në kuadrin e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore;

furnizimet e mallrave dhe shërbimeve ndaj organizatave ndërkombëtare, si dhe anëtarëve të këtyre organizatave, të njohura si të tilla nga ana e autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë ose nga anëtarët e këtyre organizatave, brenda limiteve dhe sipas kushteve të marrëveshjeve ndër-kombëtare, në bazë të të cilave janë themeluar;

Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, të destinuara për forcat e armatosura të shteteve të tjera anëtare të NATO-s, për t'u përdorur nga këto forca apo personeli civil që i shoqëron ato, si dhe për të furnizuar mensat përkatëse për qëllimin e përbashkët të mbrojtjes.

jithashtu, bazuar në pikën 33 dhe 34, të nenit 56 të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja në import, përkatësisht:

Importimet e mallrave të kryera në kuadrin e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore, të cilat përfitojnë përjashtim nga taksat doganore, mbi bazën e reciprocitetit, si dhe importimet e mallrave të kryera nga organizatat ndërkombëtare, të njohura si të tilla prej autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë, si dhe nga anëtarët e këtyre organizatave, brenda limiteve dhe sipas kushteve të marrëveshjeve ndërkombëtare, në bazë të të cilave janë themeluar.

Importimet e mallrave nga forcat e armatosura të shteteve të tjera anëtare të NATO-s, për t'u përdorur nga këto forca apo personeli civil që i shoqëron ato, si dhe për të furnizuar mensat përkatëse për qëllimin e përbashkët të mbrojtjes.

Për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore të TVSH-së 0 për qind për furnizimet e mësipërme të kryera brenda vendit, të cilat trajtohen si të ngjashme me eksportet, përcaktohet procedura e mëposhtme e rimbursimit të TVSH-së.

Misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe NATO-ja regjistrohen për TVSH-në dhe të pajisen me Certifikatën e Numrit të Identifikimit pranë autoritetit tatimor.

Për blerjet brenda vendit, misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe personeli i tyre, paguajnë TVSH-në në momentin e blerjes, TVSH- në për të cilën do të rimbursohen, (me kusht që çdo faturë blerjeje të jetë më e madhe se 10.000 lekë) Kjo fjali SHFUQIOZOHET ME UMF. NR. 15, date 18.05.2017. Botuar ne FLZ. Nr. 123, date 26 maj 2017..E drejta e rimbursimit për ambasadat do të jepet në bazë të parimit të reciprocitetit. Me procedurat e rimbursimit të TVSH-së së paguar merret Drejtoria e Protokollit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila është përgjegjëse edhe për zbatimin e parimit të reciprocitetit. Kjo drejtori do t'i pajisë misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare, e personelin e tyre me formularin "Kërkesë për rimbursim", sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Çdo mision diplomatik, organizatë ndërkombëtare për blerjet e bëra nga vetë ato ose nga personeli i tyre, do të dërgojë në drejtorinë

e mësipërme dy kopje të formularit "Kërkesë për rimbursim" (të firmosur e të vulosur nga titullari i ambasadës apo i organizatës ndërkombëtare), si edhe faturat origjinale të blerjes.

Drejtoria e Protokollit në Ministrinë e Jashtme, kopjen origjinale të formularit "Kërkesë për rimbursim" dhe faturat origjinale të blerjes, i dërgon pranë autoritetit tatimor kompetent të ngarkuar për të kryer rimbursimin, i cili është i detyruar që brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të mësipërm nga ana e Drejtorisë së Protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të bëjë rimbursimin e TVSH-së së paguar sipas faturave përkatëse.

Brenda këtij afati, autoriteti tatimor verifikon faturën e lëshuar nga shitësi për misionin diplomatik apo për organizatën ndërkombëtare, regjistrimin e saj në librin e shitjeve, pasqyrimin e të dhënave në deklaratën e TVSH-së për muajin përkatës dhe pagesën e TVSH-së në llogari të autoritetit tatimor.

Pas miratimit të kërkesës për rimbursim, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT i dërgon zyrtarisht Ministrisë së Punëve të Jashtme formularin nr. 3, "Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së", një kopje e të cilit dërgohet zyrtarisht dhe në thesar.

Ministria e Punëve të Jashtme përpilon urdhërpagesën për rimbursim (në katër kopje), për çdo trup diplomatik, në bazë të formularit nr. 4 dhe e dërgon pranë degës së thesarit, ku kjo e fundit bën pagesat sipas legjislacionit në fuqi. Dega e thesarit, pasi kontrollon përputhshmërinë e listës përmbledhëse, bashkëlidhur urdhërpagesave me atë të formularit nr. 4, kryen pagesat me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë. Në fund të çdo muaji, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT dhe dega e thesarit bëjnë rakordimet për pagesat e kryera gjatë periudhës mujore.

3. Për sa u përket blerjeve që personeli i NATO-s dhe bazat e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë bëjnë brenda vendit, ato nuk do të paguajnë TVSH në pikën e blerjes. Për këtë, në pikën e blerjes, përfaqësuesi i NATO-s është i detyruar t'i dorëzojë shitësit një certifikatë livrimi, sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi, mbi bazën e së cilës shitësi harton faturën tatimore me TVSH 0%. Në fund të faturës, shitësi bën shënimin: "Ky përjashtim nga TVSH bazohet në certifikatën e livrimit nr , datë " Zyra e autorizuar për lëshimin e certifikatës së livrimit, pranë Komandës së NATO-s, në Republikën e Shqipërisë, brenda datës 10 të çdo muaji, dërgon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, një listë përmbledhëse së bashku me kopjet e certifikatave të livrimit të lëshuara për blerjet e realizuara në muajin paraardhës, që do të shërbejë për kryqëzimin dhe verifikimin e faturave tatimore të lëshuara me TVSH 0% prej personave të tatueshëm që kanë kryer furnizimet.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/4, datë 04.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 07.09.2015)

Neni 65
Furnizimi i arit për Bankën e Shqipërisë

Trajtohet si furnizim me shkallën e TVSH-së 0 për qind furnizimi i arit ndaj Bankës së Shqipërisë.

Kur Banka e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin sipas të cilit kryen veprimtarinë e saj furnizohet me ar prej bankave të nivelit të dytë në vend, ajo paguan TVSH në blerje sipas faturave të lëshuara prej këtyre bankave, dhe për të siguruar trajtimin e TVSH-së me zero %, TVSH-ja e paguar i rimbursohet Bankës së Shqipërisë prej autoritetit tatimor, pas kërkesës së paraqitur për këtë qëllim. Bashkangjitur kërkesës për rimbursim Banka e Shqipërisë paraqit një kopje të faturave tatimore përkatëse. Drejtoria Rajonale Tatimore pasi verifikon që faturat e shitjes dhe TVSH-në përkatëse është deklaruar nga furnizuesit , p.sh. bankat e nivelit të dytë, kryen rimbursimin e TVSH-së për Bankën e Shqipërisë.

Importimi i arit prej Bankës së Shqipërisë është furnizim i përjashtuar nga TVSH.Nuk përjashtohet nga TVSH në import importimi i arit nga bankat e nivelit të dytë.

Neni 66

Faturimi

1.Të përgjithshme

Për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar, çdo furnizim malli apo shërbimi dokumentohet në përputhje me përcaktimet e ligjit për TVSH-në. Dokumenti bazë që përdoret është fatura tatimore. Ajo përcakton detyrimin e TVSH-së për furnizuesin dhe shumën e TVSH-së të zbritshëm që do ti lejohet të kërkojë blerësi i regjistruar për TVSH-në. Bazuar në nenin 97 fatura tatimore është e detyrueshme të lëshohet:

-Për çdo furnizim malli ose shërbimi të kryer kundrejt një personi të tatueshëm ose një personi juridik të pa-tatueshëm;

-Për çdo pagesë të arkëtuar përpara se të kryhet furnizimi i mallit ose përpara përfundimit të furnizimit të shërbimit.

Në raste të caktuara, për të dokumentuar furnizimin e mallit apo shërbimit përdorën dokumente tatimore të thjeshtuara si p.sh. kuponi tatimor, i cili në mënyrë të detyruar përmban të paktën elementet sipas nenit 102 të ligjit. Kuponi tatimor është i detyrueshëm të lëshohet në çdo rast që transaksioni nuk është i detyruar të shoqërohet me faturë tatimore me TVSH-në për transaksione me vlera deri në 40.000 lekë të kryera për individë, përveç kur blerësi individ kërkon faturën tatimore sipas nenit 101 të ligjit. Për çdo furnizim të tillë të bërë për individët konsumatorë jo-tregtarë, në faturën e lëshuar nga shitësi paraqitet detyrimisht emri, mbiemri dhe adresa e blerësit.

2.Përmbajtja e faturës tatimore

Bazuar në nenin 101 të ligjit, fatura tatimore duhet të përmbajë të gjithë informacionin e përcaktuar sipas kërkesave të ligjit për TVSH-në dhe konkretisht:

datën e lëshimit të faturës;

një numër serial që e identifikon faturën në mënyrë unike;

numrin e identifikimit të TVSH-së të personit të tatueshëm që kryen furnizimin e mallrave dhe shërbimeve;

numrin e identifikimit të TVSH-së të blerësit, kur ai është person i tatueshëm për furnizime brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

emrin dhe adresën e plotë të shitësit dhe të blerësit;
emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targën e mjetit dhe orën e furnizimit;
sasinë dhe përshkrimin e mallrave të shitura dhe përshkrimin e shërbimeve të kryera;

datën, në të cilën furnizimi i mallrave ose shërbimeve është kryer ose datën, në të cilën pagesa është kryer, në qoftë se kjo datë është e ndryshme nga data e lëshimit të faturës;

çmimin për njësi, pa TVSH-në, për çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar, si dhe çdo ulje të çmimit ose zbritje që nuk është përfshirë në çmimin për njësi;
vlerën e tatueshme, sipas shkallës tatimore të zbatuar ose të përjashtuar;
shkallën e zbatuar të TVSH-së, të shprehur në përqindje;
vlerën e TVSH-së së pagueshme, përveç rasteve kur zbatohet një regjim i veçantë, sipas të cilit, në përputhje me ligjin, kjo vlerë nuk duhet të tregohet në faturë;
vlerën totale me TVSH.

Përveç sa më sipër, për rastet sipas pikave: f), k), l), ll), m), n) dhe nj) të nenit 101 të ligjit, fatura duhet të përmbajë edhe informacionin si më poshtë:

-kur fatura është lëshuar për pagesë të kryer në avancë dhe TVSH-ja bëhet e kërkueshme në momentin e marrjes së pagesës, si dhe e drejta e zbritjes lind në këtë moment, në faturë duhet të shkruhet “Pagesë në avancë”;

-kur fatura lëshohet nga blerësi për furnizimin e marrë nga furnizuesi në faturën e lëshuar duhet të shkruhet “Vetëfaturim”;

-në rast se personi i tatueshëm furnizon mallra ose shërbime të përjashtuara nga TVSH-ja, fatura duhet të tregojë dispozitën e këtij ligji, sipas së cilës përjashtohet;

-në rast se personi i tatueshëm në cilësinë e blerësit apo klientit është përgjegjës për pagesën e TVSH-së, në faturë duhet të shkruhet “auto-ngarkesë e TVSH-së”(reverse-charge);

-në rast të zbatimit të regjimit të veçantë për agjencitë e udhëtimit, në faturë duhet të shkruhet “TVSH-ja është zbatuar mbi marzhin, regjimi i agjencive të udhëtimit”;

-në rast të zbatimit të njërit prej regjimeve të veçanta për mallrat e përdorura dhe për objektet e artit, koleksioneve ose antikitetit, në faturë duhet të shkruhet respektivisht “TVSH-ja është zbatuar mbi marzhin, regjimi i mallrave të përdorura”; “TVSH-ja është zbatuar mbi marzhin, objektet e artit”; “TVSH-ja është zbatuar mbi marzhin, objektet e koleksioneve dhe antikitetit”;

në rast se personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së është një përfaqësues tatimor, për qëllime të nenit 87, të ligjit, duhet të tregohet në faturë numri i identifikimit të TVSH-së të përfaqësuesit tatimor, sipas neneve 91 dhe 92, të ligjit, së bashku me emrin dhe adresën e tij të plotë.

3.Të tjera për përmbajtjen e faturës

Personi që kryen furnizime të tatueshme, detyrohet të njoftojë në mënyrë të dukshme nëpërmjet shpalljes, kontratës apo reklamës nëse çmimi i mallrave ose shërbimeve të furnizuara ose çmimi që duhet të paguhet për furnizimin përfshin ose jo TVSH-në. Personi i tatueshëm detyrohet të evidentojë në mënyrë të dukshme në faturën sipas nenit 101 ose 102 të ligjit, zbritjen apo skonton tregtare, duke evidentuar gjithashtu dhe kushtet e saj.

Për qëllime të TVSH-së është kusht që vlera e tatueshme dhe vlera e TVSH-së për t'u paguar sipas faturës tatimore, të jenë shprehur në monedhën kombëtare shqiptare (Lek). Nëse fatura është hartuar në një monedhë të huaj ajo duhet të konvertohet në Lek me kursin e këmbimit në ditën që është kryer furnizimi (është lëshuar fatura) dhe kursi i këmbimit duhet të shënohet në faturë.

Fatura lëshohet në origjinal dhe jo më pak se dy kopje, origjinali i faturës është për blerësin ndërsa kopjet janë për shitësin dhe transportuesin. Nëse lind e nevojshme fatura tatimore mund të lëshohet edhe në më shumë se dy kopje. Vetëm origjinali i faturës i jep të drejtë blerësit për të zbritur TVSH-në e paguar në blerje. Për qëllime të zbritjes së TVSH-së të shënuar në faturë, në rastet kur kopja e parë origjinale humbet, do të konsiderohet e vlefshme për blerësin kopja e noterizuar e faturës së blerjes, me kusht që shitësi të zotërojë origjinalin dhe ta ketë deklaruar atë. Nëqoftëse fatura nuk përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara më lart, blerësi nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e paguar në blerje, kurse shitësi nga ana e tij do të paguajë TVSH-në e detyrueshme për t'u paguar. Faturat që mund të justifikojnë zbritjen janë vetëm ato që janë lëshuar në mënyrë të rregullt nga furnizuesit e të mallrave/shërbimeve.

Për ushtrimin e të drejtës së zbritjes, fatura përbën një dokument themelor sepse mundëson të justifikojë formalisht ekzistencën e një TVSH-je të zbritshme. Për këtë qëllim fatura tatimore duhet të jetë e saktë dhe të përmbajë të gjithë informacionin e kërkuar në zbatim të kërkesave të ligjit për TVSH-në. Zbritja e tatimit mund të vihet në dyshim kur rëndësia apo natyra e mungesave dhe pasaktësive të konstatuara nuk mundësojnë që dokumenti të konsiderohet si faturë. Ndërkohë që vetëm një mungesë apo pasaktësi e informacioneve të detyrueshme nuk sjell domosdoshmërisht vënien në dyshim të vlefshmërisë së një fature për ushtrimin e të drejtës së zbritjes së tatimit përderisa operacioni justifikohet në realitet dhe përmbush kushtet e tjera të vendosura për ushtrimin e të drejtës së zbritjes. Në çdo rast, fatura duhet të mundësojë justifikimin e lindjes dhe ushtrimit të së drejtës së zbritjes nga klienti.

4.Formati i faturës tatimore dhe procedurat e administrimit të tyre

Formati i faturës tatimore me TVSH është sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ajo shpërndahet nga autoritetet tatimore, siç përcaktohet në ligjin “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Faturat tatimore me TVSH përdoren vetëm nga personat e tatueshëm të regjistruar për TVSH-në. Personi i tatueshëm i cili sipas ligjit për TVSH-në duhet të pajiset me fatura tatimore me TVSH, i drejtohet me një kërkesë Drejtorisë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar, duke i bashkëngjitur kërkesës fotokopjen e NIPT-it, kopjen e kartës së identitetit, si dhe një autorizim për personin që do të tërheqë bllokun e faturave tatimore. Drejtoria Rajonale Tatimore pajis personin e tatueshëm me bllok faturash tatimore, pasi ka verifikuar faktin që personi i tatueshëm është aktiv dhe subjekt deklarues në përmbushje të përgjegjësisë për të cilat është regjistruar. Blloku i faturave përdoret nga personi i tatueshëm duke ruajtur rendin kronologjik të faturave pjesë e këtij blloku. Drejtoria Rajonale Tatimore nga ana e saj i regjistron në një regjistër të gjitha faturat tatimore me TVSH të tërhequra nga çdo person i tatueshëm duke evidentuar emrin e personit të tatueshëm, Nipt-in, intervalin e Numrave serial të faturave të tërhequra, si dhe emrin e personit i cili u paraqit për të tërhequr faturat.

Edhe në rastin kur personi i tatueshëm nuk ka paraqitur një kërkesë me shkrim për të tërhequr faturat tatimore me numër serial, Drejtoria Rajonale Tatimore procedon në të njëjtën mënyrë si më sipër.

Në rastin kur personi i tatueshëm që përdor blloqe të faturave tatimore të emetuara nga Drejtoria

Përgjithshme e Tatimeve, kalon në pasiv ai detyrohet të deklarojë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore numrat serial të blloqeve të përdorur deri në momentin e kalimit në pasiv.

Në rastin kur personi i tatueshëm mbyll veprimtarinë ekonomike, ai detyrohet të dorëzojë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore blloqet e faturave me numra serial të përdorur. Drejtoria Rajonale Tatimore mban një akt për këtë qëllim duke i shpallur numrat serial të pavlefshëm dhe njëkohësisht kryen procedurën e asgjësimit të këtyre blloqeve duke mbajtur procesverbalin përkatës .

Nëse një person i tatueshëm shet një sasi të konsiderueshme artikujsh në të njëjtën kohë e për të njëjtin klient, ai mund të lëshojë faturë kompjuterike për qëllime të evidentimit në mënyrë analitike të artikujve ose karakteristikave të veçanta të tyre. Në këtë rast, faturën kompjuterike me të njëjtin numër duhet të ia bashkëngjisë faturës tatimore me numër serial të parashtypur. Në këtë mënyrë, për çdo klient lëshohet detyrimisht fatura tatimore e emtuar nga autoriteti tatimor, e cila plotësohet normalisht me të gjitha të dhënat e kërkuara, të dhënat e shitësit dhe blerësit, ndërsa vlera e transaksionit të kryer me klientin do të paraqitet në vlera totale, duke evidentuar përkatësisht vlerën e tatueshme, TVSH dhe vlerën totale. **Personi i tatueshëm lejohet të përdorë fatura tatimore me numër serial unik dhe të papërsëritshëm, të printuara nga sistemi i tij i regjistrimeve, sipas kushteve dhe procedurës të përcaktuara për këtë qëllim në ligjin dhe udhëzimin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.**

PIKA 5. (Procedura e lejimit të mospërdorimit të faturës tatimore me numër serial të parashtypur)

Kjo fjali hiqet me UMF. NR. 15, date 18.05.2017. Botuar ne FLZ. Nr. 123, date 26 maj 2017.

5.Nota e Kreditit dhe Nota e Debitit

Në rastet kur një person ka kryer furnizim të tatueshëm dhe ka lëshuar faturë tatimore, por ka nevojë të bëjë një saktësim për pagesën, pasi është lëshuar fatura, lëshon një notë krediti, dokument i lëshuar nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve duke e kredituar atë për furnizim e tatueshëm të kryer.

Ndërkohë duhet të lëshojë një notë debiti, dokument i lëshuar nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve duke e debituar atë për furnizimin e tatueshëm.

Bazuar në nenin 102 të ligjit nota e debitit dhe nota e kreditit janë faturat tatimore që personi i tatueshëm përdor, por kur ato përdoren për qëllime të korrigjimit të një fature fillestare duhet të përmbajnë shënimin “notë debiti”, notë –kredit”, referencat e faturës që korrigjojnë dhe të tjera detaje që lidhen me korrigjimin. Përdorimi i këtyre dokumenteve bëhet sipas ligjit dhe përcaktimeve të këtij udhëzimi.

Neni 67 **Deklarata e TVSH-së**

Bazuar në nenin 106 të ligjit, çdo person i tatueshëm që detyrohet, duhet të dorëzojë një deklaratë të TVSH-së, sipas formës dhe përmbajtjes në modelin bashkëngjitur këtij udhëzimi. Një deklaratë të tillë duhet të dorëzojë edhe përfaqësuesi tatimor sipas kuptimit të nenit 87 të ligjit për TVSH-në.

Me përjashtim të rastit kur sipas përcaktimit në nenin 86, pika 2 të ligjit, për shërbime të marra jashtë Shqipërisë, TVSH-ja paguhet (auto-ngarkohet) dhe deklarohet nga marrësi i shërbimit person i tatueshëm i regjistruar në Shqipëri, në rastin kur personi që detyrohet të auto-ngarkojë TVSH-në është një person juridik i pa-tatueshëm atëherë ai vetëm për qëllime të pagesës së TVSH-së detyrohet të deklarojë dhe paguajë TVSH-në. Personi juridik i pa-tatueshëm nuk i lind e drejta të zbrësë TVSH-në e auto-ngarkuar, pasi nuk kryen transaksione të tatueshme. Në këtë rast ai është pagues i TVSH-së.

Dorëzimi i deklaratës së TVSH-së vetëm për qëllime të pagesës së TVSH-së, bëhet sipas përcaktimit në nenin 65 të ligjit “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në nenin 107 të ligjit, deklarata e TVSH-së duhet të dorëzohet jo më vonë se 14 ditë pas përfundimit të periudhës tatimore që deklarohet. Për qëllime të deklarimit të TVSH-së, periudha tatimore është muaji kalendarik.

Nëse personi i tatueshëm regjistrohet për herë të parë, atëherë periudha tatimore fillon ditën kur regjistrimi i tij hyn në fuqi dhe mbaron në ditën e fundit të atij muaji.

Nëse personi i tatueshëm çregjistrohet, atëherë periudha tatimore fillon në ditën e parë të muajit përkatës dhe përfundon në ditën, në të cilën personi është çregjistruar.

Të gjithë personat, të cilët në zbatim të kërkesave të ligjit për TVSH-në kanë detyrimin për të dorëzuar deklaratën e TVSH-së, duhet ta shoqërojnë atë me regjistrat përmbledhës mujorë si për furnizime të kryera, dhe për furnizime të marra dhe saktësime të tyre, të emërtuar përkatësisht Libër shitje dhe Libër blerje.

Neni 68

Libri i shitjeve dhe libri i blerjeve

Libri i blerjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm dhe të dorëzohet elektronikisht për çdo periudhë tatimore. Forma dhe përmbajtja e tij është sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ai duhet të tregojë numrin e identifikimit, emrin e personit të tatueshëm, periudhën për të cilën deklarohet dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar. Në të regjistrohen për çdo transaksion furnizuesi, të dhënat e faturës që paraqet transaksionin, data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, numri serial i faturës, të dhënat e deklaratës së importit, emri i shitësit dhe numri i identifikimit të tij dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar në përmbajtjen e tij sipas modelit.

Blerjet regjistrohen në vlerë totale, e cila përfshin edhe TVSH (nëqoftëse ka) si dhe të ndara në blerje me TVSH dhe në blerje me TVSH jo të zbritshme ose pa TVSH. Blerjet me TVSH regjistrohen të ndara në importe dhe blerje brenda vendit. Për çdo blerje me TVSH personi regjistron vlerën e tatueshme dhe TVSH që i korrespondon kësaj blerje.

Blerjet me TVSH ndahen në blerje të aktiveve afatgjata dhe blerje e mallrave të tjerë. E njëjta edhe për importet. Në blerjet të aktiveve afatgjata paraqiten çdo blerje e kryer në funksion të veprimtarisë ekonomike që është për qëllime investimi.

Për çdo blerje nga fermerët sipas skemës së veçantë, regjimi i kompensimit të prodhuesve bujqësorë, personi i tatueshëm blerës faturën e blerjes për mallin e blerë nga fermerët e regjistron në kutitë përkatëse të librit të blerjes me përcaktimin “Vlera e tatueshme/nga fermerë vendas” dhe në një kuti të veçantë, regjistrohet vlera që i korrespondon normës së kompensimit, si produkt i vlerës së tatueshme të mallit me përqindjen e kompensimit.

Gjithashtu në librin e blerjes në kuti të ndara më vete do të regjistrohet edhe korrigjimi i TVSH-së së zbritshme në rastet kur kemi të bëjmë me rregullime të zbritjes së TVSH-së, si edhe borxhi i keq kur është plotësuar procedura e kërkuar.

Libri i shitjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm. Forma dhe përmbajtja e tij është sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ai duhet të tregojë numrin e identifikimit dhe emrin e personit të tatueshëm, si dhe periudhën tatimore për të cilën bëhet deklarimi. Në të regjistrohen për çdo transaksion, klienti dhe të

dhënat e faturës që paraqet transaksionin. Në librin e shitjeve regjistrohen data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, numri serial i fatures dhe numri i deklaratës doganore kur mallrat eksportohen, emri i klientit dhe numri i identifikimit të tij.

Në të regjistrohet vlera totale e transaksionit përfshirë TVSH (nëqoftëse ka). Shitjet regjistrohen të ndara në: shitje të përjashtuara (shitjet të cilat ligji i kategorizon sitëpërjashtuara nga TVSH, shitje pa TVSH (shitje të cilat janë shitje të tatueshme për nga natyra, por vendi i furnizimit të tyre nuk është në Shqipëri dhe të tjera të përcaktuara në udhëzim), shitje me TVSH zero%, eksporte, dhe shitje të tatueshme me TVSH 20%.

Për çdo shitje të tatueshme regjistrohen vlera e tatueshme dhe TVSH. Gjithashtu në librin e shitjes do të deklarohet vlera e tatueshme dhe TVSH-në përkatëse për të gjitha transaksionet e kryera nga personat e tatueshëm që aplikojnë TVSH-në mbi marzhin, si agentët e udhëtimit, ri-shitësit e mallrave të përdorura, etj. Në librin e shitjes do të regjistrohet edhe çdo faturë e borxhit të keq për korrigjimin e borxhit dhe për arkëtimin e tij (Nëse kryhet).

Libri i shitjeve dhe libri i blerjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm dhe duhet të dorëzohen elektronikisht për çdo periudhë tatimore përpara dorezimit të deklaratës së TVSH-së të periudhës dhe jo më vonë se data 10 e muajit që pason periudhën tatimore që deklarohet.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/2, dt. 19.3.2015. Botuar në Fl. Z nr. 45, dt. 26.3.2015).

Neni 69

Raste të posaçme kur fatura lëshohet nga blerësi

Rregullat për zbatim

Bazuar në nenin 100 të ligjit, në këtë nen të udhëzimit përcaktohen rastet kur është e mundur të zbatohet kjo procedurë.

Sipas kësaj skeme parashikohet që fatura mund të lëshohet nga blerësi ose klienti i një malli apo shërbimi për furnizimet e mallrave ose shërbimeve të marra prej tij nga një person i tatueshëm, nëse ka një marrëveshje paraprake midis dy palëve dhe me kushtin që të ekzistojë një procedurë për pranimin nga furnizuesi i mallit ose shërbimit të çdo fature të lëshuar për llogari dhe në emër të tij.

Për zbatimin e kësaj skeme, në mënyrë që blerësi i shërbimit ose mallit person i tatueshëm, të lëshojë faturën tatimore të TVSH-së për llogari dhe në emër të furnizuesit të tij kërkohet që:

Furnizuesi i mallit ose shërbimit të jetë një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në. Një person i tatueshëm që i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla nuk mund të hyjë në marrëveshje për të aplikuar këtë skemë.

Furnizimi i kryer të jetë furnizim i tatueshëm me TVSH me shkallën tatimore të TVSH-së. Nuk zbatohet kjo procedurë për furnizime të përjashtuara.

Të ketë një marrëveshje me shkrim paraprake midis furnizuesit dhe blerësit, në të cilën të jetë parashikuar detyrimisht e shprehur një procedurë për pranimin nga furnizuesi të faturës së lëshuar nga blerësi. Procedura e pranimin të faturës së lëshuar nga blerësi për llogari të furnizuesit duhet të kryhet për çdo faturë, si kusht që vërteton kryerjen dhe pranimin e furnizimit të kryer.

Çdo faturë e lëshuar nga blerësi në emër dhe për llogari të personit të tatueshëm duhet të jetë e miratuar prej këtij të fundit. Është përgjegjësi e blerësit që të garantojë në çdo kohë autoritetin tatimor që furnizuesi është një person i tatueshëm që ka një vend biznesi.

Personi i tatueshëm blerës i cili pranon të kryejë këtë procedurë është i detyruar që më parë të njoftojë me shkrim autoritetin tatimor. Njoftimit i bashkëngjitet lista e personave të tatueshëm furnizues me të cilët ky blerës ka nënshkruar marrëveshje, si dhe në të përshkruhet procedura e pranimin të faturave për të cilët palët kanë rënë dakord.

Personi i tatueshëm blerës nëpërmjet faturës së lëshuar për llogari dhe në emër të furnizuesit ka marrë përsipër edhe detyrimin për të deklaruar dhe paguar TVSH-në në emër dhe për llogari të furnizuesit.

Në faturën e lëshuar prej blerësit, në të dhënat e shitësit shënohen identitetet (Emër, Nipt, adresë, etj.) të furnizuesit dhe bazuar në nenin 101, pika k) në të duhet të shënohet “vetëfaturim”

Personat e tatueshëm të cilët mund të aplikojnë këtë skemë janë personat e tatueshëm, organizatorë të lojërave të fatit me bileta, me çmim të parashtypur, të cilët i paguajnë komision ndërmjetësve transparent për shërbimin e shitjes së biletave të lotarisë.

Organizatori për vlerën e komisionit të paguar për çdo muaj, nga faturat tatimore që përdor lëshon një faturë tatimore me TVSH 20%, ku si shitës është personi i tatueshëm që përfiton komisionin, furnizuesi dhe si blerës ai vetë. Në faturë duhet të evidentohen qartë vlera e tatueshme dhe TVSH-në përkatëse. Furnizuesit i paguhet nëpërmjet llogarisë bankare, vlera e komisionit duke zbritur TVSH-në. Faturën origjinale e mban blerësi vetë dhe furnizuesit i jep kopjon e dytë të faturës.

Blerësi i mban furnizuesit vlerën e TVSH-së së shënuar në faturë, TVSH të cilën e deklaron dhe paguan blerësi për llogari të furnizuesit, pranë administratës tatimore. Pra nga vlera totale e komisionit të faturuar blerësi i mban 20% të vlerës furnizuesit dhe i lëvtron atij në llogarinë bankare vlerën e komisionit pa TVSH.

Të gjitha këto fatura të lëshuara regjistrohen prej (blerësit) si blerje pa TVSH në kutinë përkatëse të deklaratës së TVSH-së. Veçanërisht faturat që lëshohen në kuadër të kësaj skeme regjistrohen në këtë rubrikë jo me vlerën totale të tyre por me vlerën e tatueshme, pa përfshirë TVSH-në. Nga ana tjetër furnizuesi vlerën e tatueshme sipas faturës (vlera pa TVSH) e regjistron sipas faturave në rubrikën shitje pa TVSH të librit të shitjeve dhe në të njëjtën rubrikë të deklaratës së TVSH-së.

Blerësi i cili sipas kësaj skeme ngarkohet të paguajë TVSH për vlerën e komisionit në emër dhe për llogari të furnizuesit vetëm për qëllime të pagesës së TVSH-së vlerat i deklaron në kutitë Shitje me TVSH të deklaratës, përkatësisht vlera e tatueshme dhe

TVSH. Në Librat e shitjes në këto rubrika shitësi nuk duhet të regjistrojë asnjë vlerë. Vlera e TVSH-së që do të paguhet në këtë rast nga blerësi për llogari të shitësit përputhet me 20 % të vlerës së tatueshme (pa TVSH) të regjistruar në kutinë blerje pa TVSH të librit të blerjes prej blerësit. Blerësi është përgjegjës për pagesën e TVSH-së për llogari të furnizuesit pasi i mban TVSH-në furnizuesit me qëllim për ta paguar për llogari të tij.

Vlera e TVSH-së deklarohet dhe paguhet nga blerësi për çdo periudhë tatimore në deklaratën e tij të TVSH-së.

Bazuar në nenin 53 të ligjit, lojërat e fatit janë të përjashtuara nga TVSH-ja pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së së paguar në blerjet e bëra për qëllim të kësaj veprimtarie.

Shembull: Një shoqëri e lojërave të fatit në televizion i shet biletat e lojërave nëpërmjet ndërmjetësve të saj me të cilët ka lidhur një marrëveshje. Është rënë dakord që ndërmjetësi të përfitojë 10 % komision (përfshirë TVSH-në) të vlerës totale të biletave të shitura. Ndërmjetësi është personi i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në. Në fund të muajit ndërmjetësi ka realizuar shitje të biletave në vlerë 100.000 lekë.

Komisioni që duhet të përfitojë ndërmjetësi është $10\% \times 100.000 = 10.000$ lekë (përfshirë TVSH-në). Shoqëria e lojërave lëshon një faturë ku si shitës është ndërmjetësi dhe blerësi është vetë ajo. Në faturë llogarit përkatësisht:

Vlera e tatueshme $10.000/1.2 = 8.333$ lekë $\times 20\% = 1667$ lekë TVSH për tu paguar.

Shoqëria i paguan ndërmjetësit në llogari bankare vetëm vlerën 8.333 lekë dhe i mban vlerën 1.667 lekë për ta paguar me deklaratën e TVSH-së për llogari dhe në emër të ndërmjetësit.

II. Skema për mbetjet industriale

Rregullat për zbatim

Furnizimet e mbetjeve industriale dhe materialet e rikuperueshme (hekuri për skrap, plastika, etj), të cilat konsiderohen mallra të papërdorshme në gjendjen në të cilën janë,

përgjithësisht ripërdoren si lëndë e parë dhe si të tilla i nënshtrohen TVSH-së sipas rregullave të përcaktuara në ligj.

Bazuar në nenin 100 dhe 86 të ligjit, personat juridikë ose fizikë që kanë cilësinë e personit të tatueshëm të regjistruar për TVSH-në të cilët kryejnë veprimtarinë e grumbullimit të mbetjeve industriale me qëllim furnizimin e tyre të mëtejshëm për përpunim në industrinë përpunuese, të riciklimit, etj., për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen rregullave të përcaktuara më poshtë në këtë nen të udhëzimit.

Personi i tatueshëm i cili grumbullon këto mallra, në momentin e furnizimit (shitjes) së tyre lëshon një faturë tatimore pa llogaritur TVSH mbi vlerën e tatueshme të mallit të shitur për blerësin e këtyre produkteve i cili mund të jetë vetë përpunuesi, person i tatueshëm për TVSH-në ose një person tjetër i tatueshëm, i cili pasi grumbullon sasi të konsiderueshme ia shet ato përpunuesit të këtyre mallrave.

Përpunuesi në momentin që blen këto mallra për vlerën e mallit të blerë të dokumentuar me faturat përkatëse do të lëshojë vetë për vete një faturë tatimore ku mbi vlerën e furnizimit do të llogarisë TVSH 20%. Në këtë mënyrë përpunuesi është përgjegjës për pagesën e TVSH-së. Ai do të sillet si pagues i TVSH-së në momentin e blerjes ndaj furnizuesit të tij, TVSH të cilën nuk ia paguan furnizuesit por e deklaron si TVSH të mbledhshme për llogari të autoritetit tatimor dhe nga ana tjetër ai sillet si blerës ku ka të drejtë sipas ligjit të konsiderojë të zbritshme TVSH-në e deklaruar si të mbledhshme.

Kështu ai do të deklarojë si shitje me TVSH të pagueshme furnizimin e marrë dhe nga ana tjetër e deklaron si blerje me TVSH të zbritshme.

Shembull: Një grumbullues i mbetjeve të hekurit person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në grumbullon hekurishte prej individëve persona të paregjistruar në vlerë prej 20.000 lekë dhe më pas sipas marrëveshjes që ka me një përpunues të hekurit ia shet sasinë e grumbulluar përpunuesit i cili është një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në në vlerën prej 23.000 lekë.

Grumbulluesi person i regjistruar në momentin kur i blen mbetjet prej individëve lëshon faturë tatimore në emrin e individit nga faturat që ai përdor në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 53 të ligjit nr. 9920, datë 13.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, ku individë evidentohet si shitës dhe grumbulluesi si blerës, duke evidentuar veç të dhënave që kërkon fatura edhe sasinë dhe vlerën përkatëse të furnizimit prej 20.000 lekë, e cila është vlera e paguar individëve. Grumbulluesi nga ana e tij kur kryen furnizimin i lëshon një faturë tatimore përpunuesit të plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara duke evidentuar sasinë e shitur dhe vlerën e tatueshme të furnizimit prej 23.000 lekë pa llogaritur TVSH. Kjo është vlera që

përpunuesi i detyrohet grumbulluesit. Përpunuesi nga ana e tij për furnizimin e marrë prej grumbulluesit lëshon një faturë tatimore si shitës dhe blerës i furnizimit dhe në të evidenton dukshëm të dhënat e faturës përkatëse me të cilën është furnizuar prej grumbulluesit si dhe vlerat përkatësisht vlerë e tatueshme 23.000 lekë TVSH (20%) 4.600 lekë, vlerë totale 27.600 lekë. Në çdo rast kjo faturë do të shoqërohet me faturën e furnizimit të marrë prej grumbulluesit. Nga ana e përpunuesit fatura me TVSH do të deklarohet si shitje me TVSH të llogaritur dhe si blerje me TVSH të zbritshme.

REGJIMI I BIZNESEVE TË VOGLA

Neni 70

Objekti i regjimit të bizneseve të vogla

Sipas nenit 117 të ligjit, personat e tatueshëm, qarkullimi vjetor i të cilëve është nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në i përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, janë objekt i regjimit specifik për bizneset e vogla, duke përfutur përjashtimin nga detyrimi për të llogaritur TVSH-në në shitje për të gjitha furnizimet e mallrave apo shërbimeve që ai kryen në kuadër të veprimtarisë së tij ekonomike, për gjithë periudhën në të cilën vazhdon të plotësojë kriteret për aplikimin e këtij regjimi.

Kështu përfitojnë të drejtën të zbatojnë këtë regjim të TVSH-së:

personat e tatueshëm, të cilët regjistrohen për të kryer veprimtari ekonomike për herë të parë dhe në fillim të veprimtarisë së tyre ekonomike parashikojnë të realizojnë qarkullim vjetor të pritshëm sipas kuptimit të nenit 119 të ligjit nën kufirin minimal të regjistrimit. Nëse këta persona regjistrohen për të kryer veprimtari ekonomike gjatë vitit kalendarik, qarkullimi i pritshëm për të përcaktuar kufirin llogaritet proporcionalisht për periudhën e mbetur deri në fund të vitit.

Personat e tatueshëm, qarkullimi vjetor i të cilëve bie nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në. Këta persona kërkojnë të çregjistrohen nga regjimi normal i TVSH-së, me kërkesë të tyre, në rast se qarkullimi vjetor bie nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në. Çregjistrimi nga regjimi normal i TVSH-se bëhet pas miratimit nga autoriteti tatimor kompetent në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 122 të ligjit dhe dispozitave të këtij udhëzimi.

Sipas pikës 3 të nenit 117 të ligjit përjashtohen nga e drejta për t'iu nënshtruar regjimit të bizneseve të vogla, edhe nëse qarkullimi i tyre është nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, personat e tatueshëm që janë konstatuar se kryejnë veprimtari ekonomike si persona të paregjistruar, që kanë kryer evazion tatimor në kuptim të nenit 116 të ligjit

“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Këta persona kur regjistrohen i nënshtrohen regjimit normal të TVSH-së, pasi nuk mund të gëzojnë të drejtën për t’u përjashtuar nga detyrimi i pagesës së TVSH-së sipas këtij regjimi, pavarësisht qarkullimit të tyre.

Neni 71

E Drejta e Zgjedhjes

Bazuar në nenin 120 të ligjit, personat e tatueshëm që i nënshtrohen regjimit të bizneseve të vogla duke përfutur nga përjashtimi për të llogaritur TVSH, kanë të drejtë të zgjedhin ti nënshtrohen regjimit normal të TVSH-së duke u regjistruar me përgjegjësi tatimore për TVSH-në.

Kjo e drejtë mund të ushtrohet në rastet e mëposhtme:

Personat e tatueshëm, të cilët regjistrohen për të kryer veprimtari ekonomike për herë të parë, edhe pse qarkullimi që parashikojnë të realizojnë është nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, kërkojnë vullnetarisht pranë autoriteteve kompetente ku paraqiten për të regjistruar veprimtarinë e tyre, që të regjistrohen si persona të tatueshëm për TVSH-në në përputhje me nenin 91 të ligjit. Zbatimi i regjimit normal të TVSH-së mbi furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të kryera prej tyre fillon nga data e regjistrimit të tyre për TVSH-në.

Personat e tatueshëm të regjistruar, të cilët në përputhje me nenin 117 të ligjit kryejnë veprimtari ekonomike në kushtet e regjimit për bizneseve të vogla dhe kërkojnë në mënyrë vullnetare ti nënshtrohen regjimit normal të TVSH-së duke ushtuar në këtë mënyrë të drejtën e zgjedhjes sipas nenit 120 të ligjit.

Personi që zgjedh ti nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së, sipas pikës 1 të këtij neni, detyrohet të qëndrojë dhe t’i nënshtrohet këtij regjimi jo më pak se 2 vjet kalendarikë, përveç se kur personi i tatueshëm nuk kryen më veprimtari ekonomike dhe çregjistrohet sipas procedurës së përcaktuar në ligjin “Për

Procedurat Tatimore në RSH”. Ky person ka të drejtë të kërkojë t’i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla, jo më parë se 2 vjet kalendarikë nga data e regjistrimit të tij me zgjedhje për TVSH-në.

Personi i tatueshëm paraqet një kërkesë për çregjistrim nga regjimi normal i TVSH-së pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar. Drejtoria Rajonale Tatimore përgjatë një periudhe 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës verifikon qarkullimin e realizuar prej personit të tatueshëm si dhe qarkullimin e pritshëm të tij. Në rast se kushtet plotësohen, pra personi i tatueshëm realizon një qarkullim faktik dhe të pritshëm nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, Drejtoria Rajonale Tatimore merr masa që të kryejë çregjistrimin e tij nga TVSH jo më vonë se 6 muaj nga data e kërkesës. Periudha

6-mujore nga data e kërkesës do të shërbejë si periudhë për të mbikëqyrur qarkullimin faktik që realizon personi i tatueshëm.

Personi i tatueshëm vazhdon të nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga ligji, gjatë periudhës që fillon nga data e kërkesës dhe deri në hyrjen në fuqi tëçregjistrimit (6 muaj pas datës së kërkesës).

Në rast se gjatë periudhës ose në përfundim të saj, përgjatë së cilës personi i tatueshëm ka ushtruar të drejtën zgjedhjes, konstatohet se qarkullimi i tij tejkalon kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, atëherë ky person humbet të drejtën që të trajtohet sipas nenit 120 të ligjit, përse personi i tatueshëm referuar kushteve të nenit 122 është i detyruar të jetë person i tatueshëm i regjistruar në regjimin normal të TVSH-së dhe në këtë mënyrë i nënshtrohet të gjitha detyrimeve sipas regjimit normal të TVSH-së.

Neni 72

Transaksione dhe aktivitete për të cilat nuk zbatohet ky regjim

Bazuar në nenin 118 tëligjit parashikohen disa transaksione, të cilat kryhen nga persona të tatueshëm të cilët zbatojnë këtë regjim, por që nuk merren parasysh për qëllime të këtij regjimi apo dhe disa aktivitete specifike për të cilat ky regjim nuk mund të zbatohet për arsyet si më poshtë:

furnizimi në mënyrë rastësore i një pasurie të paluajtshme, e cila bën pjesë në pasurinë e tij, nga ana e personit të tatueshëm i cili zbaton këtë regjim, nuk është një furnizim i cili përfshihet në qarkullimin e tatueshëm të tij në kuptim të neneve 119 dhe 122 të ligjit. Pra kemi të bëjmë një furnizim të pasurisë së paluajtshme, i cili konsiderohet rastësor atëherë kur kryerja e furnizimeve të pasurisë së paluajtshme apo të furnizimeve të tjera lidhura me to, nuk është veprimtari ekonomike kryesore e këtij personi të tatueshëm.

aktivitetet e përfshira në skemën e prodhuesve bujqësorë nuk përfshihen në këtë regjim pasi për furnizimet që ata kryejnë zbatohet TVSH nga blerësit e furnizimeve të tyre, dhe ata e përfitojnë atë si një kompensim, siç parashikohet në dispozitat përkatëse për regjimin e prodhuesve bujqësor sipas seksionit Nr. 4 të kapitullit të XI të ligjit.

furnizimet e shërbimeve të kryera nga një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, vend në të cilin lind detyrimi për TVSH-në, pavarësisht vlerës së furnizimit të tyre nuk mund të përfitojnë nga përjashtimi për të paguar TVSH siç parashikohet në këtë regjim, përse në nenin 86 pika 2 dhe nenin 87 të ligjit përcaktohet për secilin rast edhe personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së, i cili në këtë rast është

marrësi i shërbimit edhe nëse ky është një person i tatueshëm, i cili i nënshtrohet këtij regjimi.

Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në i përcaktuar me VKM-në nuk zbatohet për personat që nuk kanë selinë ose një vendndodhje të qëndrueshme në Shqipëri, por kryejnë furnizime shërbimi, vendi i furnizimit të të cilave është në Shqipëri, pavarësisht vlerës sëfurnizimit, të cilët sipas dispozitave të ligjit detyrohet të emërojnë një përfaqësues tatimor.

Në rastin kur zbatohet procedura e auto-ngarkesës së TVSH-së (reverse- charge) për furnizime shërbimi vendi i furnizimit të të cilave është në vendin e marrësit të shërbimit në Shqipëri, marrësi i cili është person që i nënshtrohet regjimit tëbizneseve të vogla, është i detyruar të paguajë TVSH-në në Shqipëri.

Neni 73

Qarkullimi

Bazuar në nenin 117 të ligjit kriteri kryesor që një person i tatueshëm të zbatojë këtë regjim është që qarkullimi vjetor që realizon të jetë nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në.

Për qëllim të këtij regjimi, bazuar në nenin 119 të ligjit, qarkullimi i personit të tatueshëm përfshin qarkullimin e realizuar nga të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve që ai kryen në kuadër të veprimtarisë ekonomike të tij, dhe llogaritet në bazë tëçmimit gjithsej që paguan blerësi, pa përfshirë TVSH-në.

Në qarkullimin sipas paragrafit më sipër përfshihen edhe furnizimet e kryera sipas neneve 57, 59, 60, 61 dhe 62, nga i njëjti person i tatueshëm të cilat sipas ligjit janë furnizime me shkallë zero të TVSH-së.

Bëjnë pjesë në qarkullimin vjetor për qëllime të pikës 1, të këtij neni, furnizimet e pasurisë së paluajtshme dhe shërbimet financiare, pavarësisht se janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, sipas nenit 53, të këtij ligji, kur krijohen si rezultat i veprimtarisë ekonomike kryesore.

Sipas pikës 2 të nenit 119 të ligjit, në llogaritjen e vlerës së qarkullimit për qëllime të këtij regjimi nuk përfshihen në të, vlerat e transaksioneve të mëposhtme:

furnizimet e aktiveve materiale dhe jo-materiale të personit të tatueshëm, që konsiderohen si aktive të investimit dhe nuk mbahen me qëllim për t'u shitur.

Shembull: Një person i tatueshëm që kryen veprimtari në dhënien e shërbimeve të reklamave, shet automjetin (aktiv investimi) që përdor për qëllime të aktivitetit të tij. Në këtë rast vlera e përfituar nga shitja e automjetit i cili për personin e tatueshëm është aktiv investimi, nuk përlllogaritet në qarkullimin sipas këtij regjimi.

Vlerat e përfituara nga veprimet financiare të parashikuara në nenin 53, shkronjat “b” deri në “e”, të këtij ligji, të cilat nuk krijohen si rezultat i kryerjes së veprimtarisë ekonomike, por janë veprime aksesore.

Shembull: Vlera e interesave bankare të përfituara në llogarinë rrjedhëse të personit të tatueshëm, të cilat paguhen nga banka mbi gjendjen e likuiditeteve që disponon në llogarinë e tij rrjedhëse ky person i tatueshëm, veprimtaria ekonomike kryesore e të cilit nuk është në fushën e shërbimeve financiare.

vlerat e përfituara nga veprimet mbi pasuri të paluajtshme, të cilat nuk krijohen si rezultat i veprimtarisë ekonomike kryesore, për të cilën personi i tatueshëm është regjistruar.

Shembull: Një person i tatueshëm është regjistruar në QKR për të kryer veprimtari ekonomike si tregtar mallrash industriale. Personi i tatueshëm në fillim të aktivitetit të tij 1 janar 20xx, ka deklaruar qarkullimit të pritshëm në vlerën 4.000.000 lekë. Kështu subjekti sipas nenit 117 të ligjit është në kushtet e zbatimit të regjimit të bizneseve të vogla. Gjatë vitit kalendarik në fjalë personi ka realizuar transaksionet si më poshtë:

<i>Furnizime mallrash industriale në vlerë totale</i>	<i>3.800.000 lekë</i>
<i>Shitje automjet (aktiv investimi)</i>	<i>1.300.000 lekë</i>
<i>Të ardhura interesa bankare nga llog. Rrjedhëse</i>	<i>50.000 lekë</i>
<i>Totali</i>	<i>5.150.000 lekë</i>

Sipas nenit 121 të ligjit, vetëm për qëllime të TVSH-së, referuar treguesve të mësipërm, qarkullimi që do të merret parasysht si kriter krahasimi me kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në (p.sh. 5.000.000 lekë), për këtë person të tatueshëm është 3.800.000 lekë, dhe jo vlera 5.150.000 e cila është e ardhura faktike e shoqërisë për vitin kalendarik në fjalë. Kështu përsa personi i tatueshëm ka një qarkullim më të ulët se kufiri minimal i regjistrimit në TVSH, ai do të vazhdojë të zbatojë regjimin e bizneseve të vogla për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që kryen.

Regjistrimi për herë të parë si person i tatueshëm

Për qëllime të këtij neni, për një person të tatueshëm, i cili regjistrohet për herë të parë për të kryer një veprimtari ekonomike, kufiri minimal i regjistrimit llogaritet në mënyrë proporcionale me periudhën nga data e krijimit (regjistrimit) deri në fund të vitit fiskal.

Nëse regjistrimi bëhet para datës 15 të muajit, për qëllime të llogaritjes së kufirit minimal të regjistrimit në mënyrë proporcionale, periudha që do të merret në konsideratë do të llogaritet duke numëruar muajt nga data 1 (një) e të njëjtit muaj.

Nëse regjistrimi bëhet pas datës 15 të muajit, për qëllime të llogaritjes së kufirit minimal të regjistrimit në mënyrë proporcionale, perioda që do të merret në konsideratë do të llogaritet duke numëruar muajt nga data 1 (një) e muajit pasardhës.

Shembull 1: Një person do të regjistrohet për herë të parë për të realizuar veprimtari ekonomike duke filluar nga data 7 tetor 20XX. Në mënyrë që personi të gëzojë të drejtën për të zbatuar regjimin e bizneseve të vogla duhet që qarkullimi i tij i parashikuar për periudhën nga data 7 tetor deri me 31 dhjetor të jetë më i vogël se 1.250.000 lekë (pra 5.000.000 lekë x 3 muaj/12muaj).

Shembull 2: Një person do të regjistrohet për herë të parë për të realizuar veprimtari ekonomike duke filluar nga data 17 tetor 20XX. Në mënyrë që personi të gëzojë të drejtën për të zbatuar regjimin e bizneseve të vogla duhet që qarkullimi i tij i parashikuar për periudhën nga data 7 tetor deri me 31 dhjetor të jetë më i vogël se 833.333 lekë (pra 5.000.000 lekë x 2 muaj/12muaj).

Neni 74

Dokumentimi e të tjera

Personat e tatueshëm nën këtë regjim nuk kanë të drejtë të llogaritin TVSH- në në faturë, për këtë arsye ata nuk duhet të përdorin fatura tatimore me TVSH.

Dokumentimi nga ana e tyre i furnizimeve të mallrave apo shërbimeve të kryera do të bëhet me faturë të thjeshtë tatimore, siç përcaktohet nëligjin për procedurat tatimore në fuqi.

Gjithashtu personi i tatueshëm që i nënshtrohet këtij regjimi, për qëllime të përcaktimit të qarkullimit të tij sipas nenit 121 dhe nenit 122 të ligjit është i detyruar të mbajë regjistrime për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të kryera siç përcaktohet në ligjin

“Për Procedurat Tatimore”. Regjistrimet duhet të mbahen në mënyrë kronologjike, mujore dhe me vlera kumulative, në mënyrë që të identifikohet qarkullimi i realizuar gjatë vitit kalendarik dhe momenti kur qarkullimi kalon kufirin minimal të regjistrimit.

Personat e tatueshëm nën këtë regjim, të cilët në kundërshtim me neni 121 pika 2, llogarisin TVSH-në në faturat e lëshuara për furnizimet e mallrave apo shërbimeve që kryejnë janë të detyruar që të paguajnë TVSH-në e mbledhur dhe për shkeljen i nënshtrohen dënimit siç përcaktohet në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Ndërkohë personi i tatueshëm që ka marrë furnizimin në fjalë nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e faturuar nga furnizuesi në shkelje të ligjit.

Personi i tatueshëm i cili zbaton regjimin e biznesve të vogla, i lejohet që të kryej importe pa qenë i regjistruar për TVSH-në, vetëm nëse importon mallra kapitale, por nuk lejohet të kryej importim të mallrave me qëllimin për tu rishitur.

Ai duhet të kërkojë të regjistrohet në regjimin normal të TVSH-së përpara se të kryej importin e mallrave me qëllim rishitje. Nëse autoriteti tatimor konstaton se personi i tatueshëm ka kryer importe të mallrave me qëllim rishitje, pra jo importe të mallrave kapitale, atëherë e regjistron personin e tatueshëm në regjimin normal të TVSH-së, sipas së cilit detyrohet të llogarisë TVSH-në në shitjen e këtyre mallrave, por ndërkohë nuk i lejohet të zbresë TVSH-në e paguar në momentin e importit, përse nuk e ka ushtruar të drejtën për tu regjistruar përpara momentit të importimit të këtyre mallrave.

Neni 75

Kalimi në regjimin normal të TVSH-së

Për qëllime të zbatimit të nenit 122 të ligjit si dhe bazuar në nenin 117, pika 1 të ligjit qarkullimi mbi të cilin zbatohen këto dispozita është qarkullimi vjetor e për pasojë periudhë 12- mujore e njëpasnjëshme do të konsiderohet viti kalendarik.

Kështu personi i tatueshëm që vepron në regjimin e bizneseve të vogla, i cili referuar të dhënave të regjistruara për qarkullimin gjatë periudhës janar 20xx – dhjetor 20xx, rezulton se ka kryer një qarkullim kumulativ vjetor të llogaritur në përputhje me nenin 121 të ligjit, që kalon kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, është i detyruar të kërkojë të regjistrohet për TVSH-në brenda datës 15 janar të vitit kalendarik pasardhës.

Në rast se kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në, bazuar në qarkullimin kumulativ, tejkalohet më parë se 12 muaj të vitit, personi i tatueshëm është i detyruar të kërkojë të regjistrohet për TVSH-në, menjëherë brenda 15 ditëve nga data e kalimit të kufirit dhe të llogarisë TVSH për shumën për të cilën është tejkaluar kufiri.

Shembull: Nëse për periudhën janar 20xx – shtator 20xx personi i tatueshëm ka realizuar një qarkullim prej 4.800.000 lekë dhe në fillim të muajit tetor ai kryen shitje duke e shtuar qarkullimin e tij në 5.100.000, fakt të cilin e konstaton në datën 5 tetor, ndërkohë që kufirin e ka kaluar me shitjen e kryer në datën 2 tetor. Ky person është i detyruar të regjistrohet menjëherë për TVSH-në brenda 15 ditësh duke filluar nga data 2 tetor, datë në të cilën ka kaluar kufirin e regjistrimit, ndërkohë që TVSH do të llogarisë dhe paguajë për çdo shitje të kryer mbi vlerën 5.000.000 lekë. Pra detyrohet të llogarisë dhe paguajë TVSH për vlerën 100.000 lekë dhe çdo shitje e mëpasshme dokumentohet dhe i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së. Kërkesa për regjistrim bëhet në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar.

Çdo person i tatueshëm i regjistruar në regjimin normal të TVSH- së sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kërkojë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore që të çregjistrohet nga regjimi normal i TVSH-se dhe ka të drejtë të kërkojë t'i nënshtrohet regjimit të bizneseve të

vogla në rast se qarkullimi i tij kumulativ për të paktën 1 vit të plotë kalendarik të mëparshëm (1 janar-31dhjetor), bie nën kufirin minimal të regjistrimit të TVSH-së. Kur regjistrimi bëhet para datës 16 të muajit janar, janari do të konsiderohet muaj i plotë për qëllime të llogaritjes së vitit të plotë kalendarik sipas këtij paragrafi.

Bazuar në piken 2 të nenit 122, administrata tatimore brenda 12 muaj duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës të personit të tatueshëm, shprehet duke miratuar ose jo kërkesën e personit të tatueshëm për t'iu nënshtruar regjimit të biznesëve të vogla. Përgjatë këtyre 12 muajve që pasojnë nga dita e kërkesës për çregjistrim, autoriteti tatimor mbikëqyr veprimtarinë e personit të tatueshëm. Nëse furnizimet e personit të tatueshëm do të jenë mbi kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, ky person i tatueshëm do të njoftohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore se nuk i është miratuar kërkesa për çregjistrim nga TVSH-ja. Nëse brenda 12 muajve nga dita e kërkesës për çregjistrim, furnizimet e personit të tatueshëm do të jenë nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në ky person i tatueshëm do të njoftohet se i është miratuar kërkesa për çregjistrim nga TVSH. Përgjatë kësaj periudhe prej 12 muaj personi i tatueshëm është i detyruar të vazhdojë të nënshtrohet të gjitha detyrimeve dhe të drejtave për TVSH-në sipas regjimit normal të TVSH-së.

Shembull: Personi i tatueshëm i regjistruar në regjimin normal të TVSH-së në tetor 2014, ka të drejtë të kërkojë të çregjistrohet nga regjimi normal i TVSH-së nëse qarkullimi i tij vjetor për vitin 2015 (vit i plotë) bie nën kufirin minimal të regjistrimit të TVSH-së. Në këtë rast ka të drejtë që duke filluar nga data 1 janar 2016, të kërkojë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore çregjistrimin nga TVSH. Drejtoria Rajonale Tatimore duke filluar nga data 1 janar 2016 deri në dhjetor 2016 duhet të mbikëqyrë qarkullimin e personit të tatueshëm në vitin në vijim, për tu shprehur për miratimin ose jo të çregjistrimit nga regjimi normal jo më vonë se 31 'dhjetor 2016.

Nëse autoriteti tatimor konstaton se personi i tatueshëm i cili zbaton regjimin e biznesëve të vogla ka qenë i detyruar të regjistrohej në një datë të mëparshme në regjimin normal të TVSH-së, ajo procedon me regjistrimin e detyruar në regjimin e TVSH-së, dhe personi i tatueshëm detyrohet të paguajë TVSH-në për furnizimet që ai i ka bërë nga data që e ka kaluar qarkullimin dhe nuk është regjistruar. Detyrimet tatimore i ngarkohen në periudhën tatimore në të cilën regjistrohet.

Neni 76

E Drejta e Zbritjes së TVSH-së

Bazuar në nenin 121 pika 1 të ligjit, personat e tatueshëm, të cilët përfitojnë nga përfshirja në këtë regjim, nuk gëzojnë të drejtën e zbritjes së TVSH-së në përputhje me kreun X, të ligjit. Kështu TVSH e paguar nga personi i tatueshëm në furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të blera nuk është e zbritshme, përse ai duke iu nënshtruar këtij regjimi përfiton nga përjashtimi për të llogaritur TVSH-në.

Bazuar në nenin 83 të ligjit, personi i tatueshëm i cili kalon kufirin minimal të regjistrimit të TVSH-së dhe për pasojë i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së, si dhe personi i cili regjistrohet vullnetarisht në këtë regjim ka të drejtë që në periudhën e parë tatimore kur bëhet person i tatueshëm i regjistruar, të njohë TVSH-në e zbritshme për mallrat e inventarit gjendje në datën e regjistrimit në këtë regjim, mallra këto me qëllim për t'u shitur, për të cilat do të llogarisë TVSH në shitje.

Kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar këtë të drejtë janë si më poshtë:

mallrat do të shërbejnë për kryerjen e furnizimeve të tatueshme që kanë të drejtën e zbritjes. Nëse e drejta e zbritjes së TVSH-së është ushtruar ndërkohë që mallrat stok i shërbejnë furnizimeve të përjashtuara, atëherë duhet të bëhet rregullimi i TVSH-së së zbritur sipas përcaktimeve të ligjit.

personi i tatueshëm duhet të disponojë listën e mallrave stok të specifikuar në sasi dhe në vlerë, ku të evidentohet data e regjistrimit të stoqeve. Ky inventar duhet të dorëzohet në organin tatimor në momentin e regjistrimit në regjimin normal të TVSH-së dhe të jetë i evidentuar në regjistrat dhe kontabilitetin e personit të tatueshëm.

Çdo mall i përfshirë në inventar duhet të jetë i justifikuar me faturë tatimore të blerjes me TVSH, i blerë jo më parë se 12 periudha tatimore përfshirë periudhën në fjalë, në përputhje me ligjin.

Bazuar në nenin 83 të ligjit, nëse personi i tatueshëm ka rezultuar me tepriçë të TVSH-së së zbritshme për 3 muaj radhazi si rezultat i TVSH-së së zbritshme të mallrave stok në momentin kur bëhet person i tatueshëm, atëherë ky person nuk ka të drejtë që të bëjë kërkesë për rimbursim të kësaj TVSH-je.

Neni 77

REGJIMI PËR AGJENCITË E UDHËTIMIT

Përkufizime dhe Koncepte

Në kuptim të pikës 1 të nenit 123 të Ligjit:

Agjencia e Udhëtimit nënkupton "çdo person të tatueshëm i cili në emër të tij apo si agent, ndërmjetëson, siguron informacion apo merr përsipër ti mundësojë/sigurojë

udhëtarit (klientit) të udhëtojë i vetëm apo në grup, përfshirë fjetjen, struktura akomoduese, transportin, udhëtime të organizuara dhe shërbime të tjera turistike, të cilat kryhen nga persona të tatueshëm të tretë.

Agjenci udhëtimi konsiderohen edhe organizatorët e udhëtimeve turistike.

Agjentët e udhëtimit në përputhje me përcaktimet e ligjit duhet të zbatojnë këtë regjim për veprimet që agjencia kryen në emrin e saj për klientin, për realizimin e të cilave përdor furnizimet e mallrave dhe të shërbimeve të ofruara nga persona të tjerë të tatueshëm.

Këto veprime konsiderohen si një shërbim i vetëm i furnizuar nga agjencia e udhëtimit për klientin e saj.

“Klienti” nënkupton përfituesin e shërbimeve të udhëtimit i cili është:

Udhëtari - Individ , ose

person i tatueshëm që nuk kryen aktivitet si agjenci udhëtimi, por merr shërbimin e vetëm të agjencisë së udhëtimit jo me qëllim për ta rishitur atë.

Paketa e turistike e udhëtimit konsiderohet një kombinim i paracaktuar ku përfshihen detyrimisht të paktën dy prej tri grupeve të shërbimeve, të cilat sigurohen gjatë një periudhë kohore minimale 24 orë, apo ku përfshihet kalimi i një nate, si me poshtë:

Transporti;

fjetja (akomodimi);

Të tjera shërbime të ndryshme nga shërbimet e transportit dhe fjetjes apo shërbimet dytësore të lidhura me to, të cilat përbëjnë pjesë të rëndësishme të paketës së shërbimit të udhëtimit: si p.sh. shërbimi ushqimit, pjesëmarrje në ngjarje shkencore, kulturore, sportive, argëtuese, vizita në muze e të tjera të ngjashme.

Pjesë e paketës është gjithmonë edhe shërbimi këshillimor apo lehtësia që u ofrohet udhëtarëve dhe turistëve nga agjencitë e udhëtimit.

Shërbimi i vetëm i agjencisë së udhëtimit

Veprimet që agjencia e udhëtimit kryen në emrin e saj, në përfitim të klientit për të cilat përdor furnizime të mallrave dhe të shërbimeve të furnizuara nga persona të tjerë të tatueshëm, nëkuptim të pikës 1 të nenit 124 të ligjit për TVSH- në, konsiderohen si furnizim i një shërbimi të vetëm tërësor.

Vetëm veprimet e kryera nga agjencitë e udhëtimit apo organizatorët turistik që veprojnë në emër të tyre, pra sillen si ndërmjetës të fshehur mund të aplikojnë këtë regjim.

Në rastin kur agjencitë e udhëtimit veprojnë në emër dhe për llogari të një klienti apo të një furnizuesi shërbimesh, pra sillen si ndërmjetës transparent, furnizimet e tyre do të tatohen sipas rregullave të regjimit normal të TVSH-së.

Ky regjim nuk zbatohet nëse p.sh. agjencia ofron shërbimin në hotelin që e ka në pronësi apo kryen transportin me autobusin që ka në pronësi, pasi duhet plotësuar kushti që agjencia të lidhet me të tretë.

3. Vendi i Furnizimit të Shërbimit të Agjencisë së udhëtimit

Siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 124 të ligjit për TVSH-në vendi i furnizimit të këtij shërbimi të vetëm është në Shqipëri nëse agjencia e udhëtimit e ka të vendosur në Republikën e Shqipërisë vendin kryesor të aktivitetit të saj ose një njësi fikse, dhe furnizimi i shërbimit kryhet nëpërmjet saj.

Në kuptim të paragrafit më sipër, agjencitë e udhëtimit të cilat nuk kanë vendin kryesor të aktivitetit të tyre apo një njësi fikse në Shqipëri, dhe nga selia e tyre e vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë organizojnë udhëtime turistike apo qëndrime të klientëve të saj në Shqipëri, atëherë shërbimi i tyre i vetëm si agjenci udhëtimi nuk është objekt i aplikimit të TVSH-së sipas këtij ligji.

Bazuar në nenin 127 të ligjit, nëse veprimet, për të cilat agjencia e udhëtimit u është drejtuar personave të tjerë të tatueshëm, janë kryer nga këta persona jashtë Republikës së Shqipërisë, shërbimi kryer nga agjencia e udhëtimit është i ngjashëm me veprimtarinë e ndërmjetësit transparent dhe ky shërbim sipas nenit 62 të ligjit është shërbim ndërmjetësimi me shkallë 0 % të TVSH-së.

Nëse veprimet, sipas pikës c), të këtij neni, janë kryer brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, marzhi zbatohet vetëm për shërbimin e agjencisë së udhëtimit të kryer brenda vendit. Pjesa e shërbimit të agjencisë së udhëtimit, që u përket veprimeve jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 62 të ligjit është shërbim ndërmjetësimi me shkallë 0 % të TVSH-së.

Vlera e Tatueshme e shërbimit të vetëm të agjencisë së udhëtimit

Në kuptim të pikës 1 të nenit 125 të ligjit, vlera e tatueshme e furnizimit të shërbimit të vetëm të agjencisë së udhëtimit është marzhi i agjencisë së udhëtimit ku përfshihet edhe TVSH që lidhet me këtë marzh.

Marzhi i agjencisë së udhëtimit llogaritet si diferenca ndërmjet çmimit total të paguar nga klienti dhe vlerës reale të paguar nga agjencia e udhëtimit për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të faturuara nga persona të tjerë të tatueshëm me kusht që çdonjëri nga furnizimet e mallrave dhe shërbimeve nga të tretë përfitohet nëmënyrë të drejtpërdrejtë nga klienti.

Marzhi llogaritet mbi bazën e faturave të lëshuara dhe faturave të mbledhura për një udhëtim turistik.

Transaksionet, ndërmjet klientit dhe agjencisë dhe personave të tjerë të tatueshëm nëpërmjet të cilëve është bërë i mundur të kryhet shërbimi duhet të kryhen nëpërmjet llogarive bankare.

Si rregull, marzhi i agentit të udhëtimit përfshin edhe TVSH-në dhe llogaritja e vlerës së tatueshme dhe të TVSH-së së mbledhshme sipas këtij regjimi bëhet si më poshtë:

$$\text{Vlera e tatueshme} = \text{Marzhi i agentit të udhëtimit} - \text{TVSH-në e mbledhshme}$$

$$\text{TVSH e mbledhshme} = \text{Vlera e tatueshme} \times \text{shkalla tatimore e TVSH-së (20\%)}$$

TVSH bëhet e kërkueshme në periudhën tatimore në të cilën të gjithë elementet e nevojshëm për llogaritjen e vlerës së tatueshme mund të përcaktohen me siguri. Nëse kjo nuk është e mundur më parë marzhi zbatohet dhe tatimi kërkohet në momentin kur kryhet shërbimi i vetëm i agjencisë së udhëtimit.

5. Rregullat e faturimit dhe e TVSH-së

Vlera e TVSH-së së mbledhshme sipas këtij regjimi nuk shënohet dhe nuk identifikohet veçmas në faturën që agjencia e udhëtimit lëshon për klientin.

Në rast të zbatimit të regjimit të veçantë siç përcaktohet në shkronjën m) të nenit 101 të ligjit, agjencia e udhëtimit, në faturë duhet të shkruajë detyrimisht “TVSH- ja është zbatuar mbi marzhin, regjimi i agjencive të udhëtimit”. Në rast se ky shënim mungon në faturë, fatura konsiderohet e parregullt dhe aplikohen sanksione sipas ligjit “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

Agjencia e udhëtimit nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e faturuar nga persona të tretë të tatueshëm, për mallrat dhe shërbimet të cilat përdoren në përfitim të drejtpërdrejtë të klientit, pra konsumohen direkt nga klienti gjatë udhëtimit dhe janë pjesë e shërbimit të vetëm të agjencisë së udhëtimit. Këto fatura regjistrohen në regjistrin e posaçëm për qëllime të llogaritjes së marzhit dhe deklarohen në librin e blerjes siç përcaktohet në këtë udhëzim.

Agjencia e udhëtimit ka të drejtë të zbresë TVSH-në për shpenzimet e përgjithshme administrative të agjencisë së udhëtimit, furnizime këto që nuk përdoren dhe nuk bëjnë pjesë në furnizimin e shërbimit të vetëm të agjencisë së udhëtimit.

Agjencia e udhëtimit është e detyruar të mbajë regjistra kontabël të veçantë ku të regjistrohen transaksionet (faturat e marra dhe të lëshuara) dhe mënyra e llogaritjes së marzhit të agjencisë, vlerës së tatueshme dhe TVSH e mbledhshme për çdo shërbim udhëtimi që u është faturuar klientëve për të cilën zbaton regjimin e marzhit të udhëtimit.

Agjencia e Udhëtimit lejohet të kryejë saktësime të vlerës së llogaritur të marzhit dhe TVSH-së përkatëse nëse vlera e furnizimeve të marra ndryshon duke ndikuar në vlerën e tatueshme nën regjimin e marzhit.

Llogaritja e qarkullimit të agjencive për qëllime të përcaktimit të kufirit minimal të regjistrimit për TVSH-në është vlera totale e paguar prej klientit për çdo shërbim, pavarësisht nëse ai shërbim i nënshtrohet ose jo regjimit të marzhit, është i tatueshëm me 0% si shërbim i kryer për jashtë, apo i tatueshëm me 20%.

1. Rregulla praktike dhe shembuj

Supozojmë se agjencia shet një paketë me shërbime për kryerjen e një udhëtimi turistik i cili kryhet pjesërisht brenda territorit të RSH-së dhe pjesërisht jashtë territorit të RSH-së. Për këtë qëllim agjencia do të blejë nga persona të tretë furnizime me TVSH apo pa TVSH.

Agjencia është e detyruar që të shesë dhe të faturojë shërbimet e udhëtimit të përfshira në paketën e udhëtimit si një shërbim i vetëm (pavarësisht nëse furnizimet e blera nga të tretë janë me apo pa TVSH). Në faturën e lëshuar nga agjencia nuk llogaritet TVSH, por agjencia pasi përcakton marzhin e llogarit TVSH-në në regjistrat përkatës siç parashikohet në pikën 5 të këtij neni të udhëzimit, e deklaron atë në Librin e shitjes dhe deklaratën e TVSH-së në kutinë përkatëse me emërtimin “Shitje në Regjimin e marzhit të agjencive të udhëtimit”. Faturat e blerjes të cilat janë pjesë e llogaritjes së marzhit deklarohen në librin e blerjes nga agjencia e udhëtimit, në kutinë “Blerje pa TVSH”.

Kështu në momentin e faturimit kur është përcaktuar çmimi që do të paguajë klienti për paketën e shërbimeve të udhëtimit, agjencia ka mundësinë të përcaktojë kostot e shërbimeve që përfshihen në paketë.

Pesha specifike që zënë furnizimet e blera nga agjencia në përfitim të klientit përkatësisht për pjesën e udhëtimit brenda territorit të RSH-së dhe për pjesën e udhëtimit jashtë territorit të RSH-së mbi totalin e tyre, do të përdoret si bazë për të përcaktuar pjesën që zënë nëçmimin total të faturuar, çmimi i paguar për shërbimet e paketës të ofruara brenda territorit të Shqipërisë dhe çmimi i paguar nga klienti për shërbimet e ofruara jashtë territorit të RSH-së.

Vlera e tatueshme dhe TVSH sipas marzhit, korrigjohet nëse është e nevojshme pasi subjekti të këtë marrë edhe faturat e blerjes përkatëse dhe rezultojnë diferenca në marzhin e llogaritur në momentin e lëshimit të faturës.

Shembull 1: Agjencia ofron një udhëtim turistik me itinerar Tiranë-Korçë -Selanik- Tiranë i cili zgjat 2 net dhe çmimi i përcaktuar për çdo udhëtar është 25.000 lekë.

	<i>Korçë</i> <i>vlera me TVSH</i>	<i>Selanik</i> <i>vlera</i>	<i>Totali</i>
<i>Shërbim fjetje +ushqim /person</i>	<i>4000 lekë</i>	<i>8000 lekë</i>	<i>12000 lekë</i>
<i>Shërbim transporti /person</i>	<i>1500 lekë</i>	<i>5000 lekë</i>	<i>6500 lekë</i>
<i>Totali</i>	<i>5500 lekë</i>	<i>13000lekë</i>	<i>18500 lekë</i>
<i>Pesha specifike</i>	<i>29.7%</i>	<i>70.3%</i>	
<i>Pjesa e çmimit që i takon udhëtimit brenda vendit (25000*29.7%)</i>		<i>7425 lekë</i>	
<i>(-)totali i shpenzimeve/person brenda vendit</i>		<i>5500 lekë</i>	
<i>=Marzhi i agjencisë</i>		<i>1925 lekë</i>	
<i>TVSH e mbledhshme =</i>	<i>1925*20/120=</i>	<i>321 lekë</i>	

Në faturën tatimore të shitjes që agjencia i bën klientit shënon vetëm vlerën totale të paguar prej 25.000 lekë dhe nuk llogarit TVSH.

Ndërkohë deklarimi në libra i faturës me vlerë 25.000 lekë bëhet si më poshtë:

Në kutinë përkatëse "Shitje në regjimin e marzhit" të librit të shitjes dhe Deklaratën e TVSH-së në Vlerën e tatueshme shënohet 1604 lekë, TVSH 321lekë, për Marzhin total 1925 lekë, dhe "Furnizime me 0%" në vlerën 17.575 lekë(25.000 x 70.3% = 17.575 lekë).

Faturat e blerjeve brenda vendit të cilat i shërbejnë furnizimeve të cilat i nënshtrohen llogaritjes së TVSH-së mbi marzhin regjistrohen në librin e blerjeve në kutinë "Blerje me TVSH jo të zbritshme dhe pa TVSH" dhe ruhen për të dokumentuar dhe provuar llogaritjen e saktë të marzhit dhe TVSH-së përkatëse. Ato regjistrohen edhe në regjistrat e posaçëm të mbajtur për llogaritjen e TVSH sipas marzhit.

Shembull 2: Agjencia ofron një udhëtim turistik nëpër jugun e Shqipërisë i cili zgjat 2 netë dhe çmimi i përcaktuar për çdo udhëtar është 15.000 lekë.

Faturat e pranuar nga agjencia janë:

	<i>Vlera pa TVSH</i>	<i>TVSH</i>	<i>Vlerë me TVSH</i>
<i>Shërbim fjetje hoteli 2 net/person</i>	<i>3000</i>	<i>600</i>	<i>3600 lekë</i>
<i>Shërbim transporti vajtje ardhje/person</i>	<i>1000</i>	<i>200</i>	<i>1200 lekë</i>
<i>Shërbim katering /person</i>	<i>2000</i>	<i>400</i>	<i>2400 lekë</i>
<i>Totali</i>			<i>7200 lekë</i>

Çmimi i paguar nga udhëtari 15000 lekë
(-)totali i shpenzimeve/person 7200 lekë
=Marzhi i agjencisë 7800 lekë
TVSH e mbledhshme = $7800 \cdot 20 / 120 = 1300$ lekë

Në faturën e shitjes që agjencia i bën klientit shënon vetëm vlerën totale të paguar prej 15.000 lekë pa llogaritur dhe pa shfaqur TVSH në faturë. Fatura e shitjes duhet të ketë shënimin “TVSH- ja është zbatuar mbi marzhin, regjimi i agjencive të udhëtimit”, dhe deklarohet në librin shitjes dhe nëdeklaratën e muajit në të cilën lëshohet, e detajuar si më poshtë:

Vlera 7200 lekë në kutinë “Shitje pa TVSH”

Vlera e tatueshme 6500lekë si dhe 1300 lekë TVSH në kutitë përkatëse “Shitje Regjimi agjentëve të udhëtimit”.

Faturat e blerjes për shërbimin e fjetjes në hotel, transport, shërbim catering deklarohen në kutinë “Blerje me TVSH jotë zbritshme/pa TVSH” të librit të blerjes dhe deklaratën përkatëse të muajit kur ato furnizohen nga të tretët.

Shembull 3: *Agjencia ofron një udhëtim turistik në Athinë, i cili zgjat 2 net dhe çmimi i përcaktuar për çdo udhëtar është 20.000 lekë.*

Faturat e pranuar nga agjencia janë:

	<i>Vlera e furnizuar</i>
<i>Shërbim fjetje+ushqim (ne Athine) 2 netë/person</i>	<i>10000 lekë</i>
<i>Shërbim transport ndërkombëtar/person</i>	<i>3000 lekë</i>

Total : 13.000 lekë

Çmimi i paguar nga udhëtari 20.000 lekë.

Në këtë rast nuk kryejmë llogaritje të marzhit për këtë udhëzim pasi shërbimi është kryer jashtë Shqipërisë dhe shërbimi i ofruar nga agjencia është i tatueshëm me 0% sipas regjimit normal të

TVSH-dhe faturohet si “Furnizim me 0% dhe deklarohet në kutinë “Furnizime me TVSH 0%” tëLibrit të shitjes dhe deklaratës së TVSH-së.

Neni 78

Rregulla të Zbatimit të Regjimit të Marzhit të Fitimit

1. Koncepti i Regjimit të marzhit

Për qëllime të TVSH-se në seksionin 3 të kapitullit XI tëligjit parashikohen një sërë rregullash të veçanta për transaksionet brenda vendit të shitjes së mallrave të përdorur, veprave të artit, objekteve të koleksionit dhe antikitetit.

Regjimi i veçantë përcakton tatimin e këtyre transaksioneve për qëllime të TVSH-së sipas marzhit.

Ky regjim bën të mundur tatimin me TVSH mbi vlerën e marzhit të transaksioneve të shitjes të kryera nga:

“personi i tatueshëm rishitës” në kushtet e zbatimit të regjimit të marzhit të fitimit sipas nënseksionit 1 të seksionit 3 të kapitullit XI të ligjit; dhe

“Organizatori i shitjeve në ankand” në kushtet e zbatimit të regjimit të marzhit të fitimit sipas nënseksionit 1 të seksionit 3 të kapitullit XI të ligji.

Mallrat për të cilat zbatohet regjimi

Koncepti i mallrave të përdorura

Në kuptim të nenit 129 të ligjit, “mallra të përdorura”, janë mallra të prekshme të luajtshme të cilat janë të përshtatshme për përdorim të mëtejshëm në gjendjen që janë ose pasi janë riparuar. Nuk konsiderohen “mallra të përdorur” veprat e artit, objektet e koleksionit dhe antikitetit gjithashtu dhe metalet e çmuara apo gurët e çmuar sipas parashikimeve ligjore.

Shembull: Një makinë quhet e përdorur nëse pasi është përdorur njëherë është e aftë të ripërdoret përsëri.

c. Ndryshimi “riparimit të mallrave të përdorura” nga “rinovimi” dhe “transformimi”

Mallrat e përdorura në kuptim të këtij regjimi, mund ti nënshtrohen një procesi riparues. D.m.th. një operacion i cili çon në rehabilitimin e mallit të përdorur nëpërmjet të cilit, mallit i kthehen karakteristikat fillestare të objektit në gjendje të re.

Nëse kemi të bëjmë me procese të tilla të cilat sjellin një rinovim të vërtetë të mallrave të përdorura apo një transformim tërësor në raport me mallin origjinal para përdorimit, të cilat e bëjnë mallin e përdorur që të humbasë kualifikimin si mall i dorës së dytë, atëherë ai bëhet një produkt të ri, që tatohet në regjimin normal të TVSH-së si çdo produkt i ri.

Përcaktimi i dallimeve sa më sipër është i rëndësishëm pasi furnizimet e mallrave të përpunuara ose të rinovuara tatohen me TVSH për vlerën e tatueshme të shitjes sipas kuptimit të nenit 37 të ligjit, ndërsa “mallrat e përdorura” të cilat riparohen, tatohen me TVSH vetëm për marzhin duke ju nënshtruar këtij regjimi.

Kështu me “rinovim” kemi të bëjmë kur vlera pa tatimin e elementeve të reja apo të përdorura që vihen në përdorim për rikthimin në gjendjen e mëparshme është më e lartë se vlera e vetë mallit të përdorur, përfshirë këtu edhe kosto të tjera (p.sh. shpenzimet për krahun e punës, shpenzimet e prodhimit apo pjesa e shpenzimeve të përgjithshme që trupëzohen në këtë produkt) pa përfshirë në llogaritje të marzhit të fitimit.

“Transformimi” çon në një modifikim të karakteristikave fillestare të një malli apo produkti dhe shprehet me krijimin e një malli të ri.

c) Veprat e artit, objektet e koleksionit dhe antikitetit

Veprate artit, objektet e koleksionit dhe antikitetit për të cilat zbatohet ky regjim dhe karakteristikat specifike përcaktohen të detajuara në aneksin II të Ligjit.

Mallra për të cilat nuk zbatohet regjimi

a. Mbetjet industriale

Në kuptim të këtij regjimi nuk konsiderohen mallra të përdorura, mbetjet industriale dhe materialet e rikuperueshme. Këto mallra në fakt janë të papërdorshme në gjendjen në të cilën janë dhe përgjithësisht ripërdoren si lëndë e parë. Furnizimet e mbetjeve industriale (hekuri apo plastike) për qëllime të TVSH-së tatohen si mallra të reja me shkallën 20%, dhe nuk mund të tatohen në baze të regjimit të marzhit të fitimit.

Metalet e çmuara apo gurët e çmuar

“Metalet e çmuara dhe gurët e çmuar”, sipas ligjit përjashtohen nga përkufizimi i mallrave të përdorura. Ato i nënshtrohen regjimit normal të TVSH-së si çdo mall tjetër i ri.

Për qëllime të këtij seksioni duhet të dallohen nga njëra anë, metale të çmuar dhe gurët e çmuar dhe gjithashtu, mallrat e tjera të çmuara në veçanti, mallrat bizhuteri.

Metalet e çmuara në fjalë janë ari, argjendi dhe platin, dhe lidhjet e këtyre metaleve me njëri-tjetrin ose me metale të tjera në çfarëdoq proporcioni, në formën e tyre të natyrshme apo në formë lingote, fletë, pluhur, pllaka, etj.

Zbatimi i Regjimit të marzhit të fitimit nga personi i tatueshëm rishitës

Personi i tatueshëm rishitës i mallrave është një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në.

Ai zbaton TVSH sipas regjimit të marzhit të fitimit në transaksionet e shitjes së mallrave të përdorura, veprave të artit, objekteve të koleksionit ose antikuarëve të cilat i janë furnizuar atij brenda vendit nga :

nga një person që nuk është i tatueshëm për TVSH-në. P.sh një individ ishet makinën e tij të përdorur një personi të tatueshëm ri-shitës.

Në këtë rast personi i tatueshëm ri-shitës do të dokumentojë blerjen nga personi i pa-tatueshëm me “Faturë nga Blerësi” pa zbatuar TVSH, në përputhje me ligjin “Për Procedurat tatimore”.

Një person i tatueshëm për TVSH-në i cili nuk zbaton TVSH në faturën e tij të shitjes, për arsyet më poshtë:

Furnizimi i mallit të blerë është blerë pa TVSH pasi është blerë si furnizim i përjashtuar nga TVSH në shitje sipas nenit 54 të ligjit.

Këtu bëjnë pjesë furnizimet e mallrave që janë përdorur vetëm për një veprimtari të përjashtuar nga TVSH, sipas neneve 51 dhe 53, të këtij ligji, në rastin kur këto mallra nuk kanë qenë objekt i së drejtës së zbritjes së TVSH-së.

P.sh. një shoqëri që kryen tërësisht aktivitet të përjashtuar p.sh. lojërash fati shet një makinë lojërash fati, të cilën e ka përdorur gjatë aktivitetit. Në këtë rast personi i tatueshëm dokumenton shitjen tek personi i tatueshëm ri-shitës me faturë tatimore shitje me TVSH (neni 101 i ligjit), pa zbatuar TVSH.

Furnizon një mall për të cilin personi i tatueshëm nuk ka gëzuar të drejtën e zbritjes së TVSH-në në blerje sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit.

P.sh. personi i tatueshëm shet veturën e përdorur të administratorit të shoqërisë për të cilën nuk ka gëzuar të drejtën e zbritjes së TVSH-së në momentin e blerjes.

një person tjetër i tatueshëm ri-shitës, në qoftë se furnizimi i mallrave prej këtij të fundit i është nënshtruar TVSH-së, në përputhje me këtë skemë të marzhit. Pra furnizuesi i mallit ka zbatuar regjimin e marzhit të fitimit dhe ka dokumentuar transaksionin e shitjes me faturë ku nuk zbatohet TVSH në përputhje me nenin 135 të ligjit.

një person i tatueshëm, i cili është subjekt i regjimit për bizneset e vogla dhe furnizon mallra kapital në mënyrë rastësore.

Në këtë rast furnizuesi është një person i tatueshëm i cili përfiton nga përjashtimi për të llogaritur TVSH mbi furnizimet e tij sipas përcaktimeve të seksionit 1, të kreut XI të ligjit, dhe furnizimi që kryhet ka të bëjë me mall kapital të përfshirë në aktivet afatgjata.

Personi i tatueshëm rishitës mund të zgjedhë të zbatojë regjimin e marzhit nëse shet brenda vendit mallra të përdorura, të importuara nga ana e tij për llogari të vetë apo për llogari të të tretëve.

Në këtë rast nuk mund të zbresë TVSH-në e zbatuar mbi vlerën e tatueshme në import nga autoriteti doganor sipas nenit 44 të ligjit, për mallrat e përdorura, veprat e artit, objekte të koleksionit apo antikuare të importuara me qëllim për t'u rishitur nga ana e tij.

E drejta e zgjedhjes për objektet e artit

Bazuar në nenin 133 të ligjit një person i tatueshëm ri-shitës i objekteve të artit, artikujve të koleksionit dhe antikuareve, ka të drejtë të zgjedhë mbi aplikimin e regjimit të marzhit veçanërisht për furnizimet e mallrave të mëposhtme:

të objekteve të artit, artikujve të koleksionit dhe antikuareve, të cilat personi i tatueshëm i ka importuar vetë;

të objekteve të artit, të cilat i janë furnizuar personit të tatueshëm të tatueshëm nga vetë autori apo nga ata që zotërojnë të drejtat mbi to.

Në rast të zbatimit të këtij regjimi për këto kategori objektesh, personi i tatueshëm detyrohet të zbatojë regjimin me zgjedhje për një periudhë të paktën 3 vite ushtrimore dhe vlera e tatueshme për transaksionet e kryera do të jetë në përputhje me nenin 131 të ligjit.

Për furnizimet e objekteve të artit, artikujve të koleksionit dhe antikuareve të importuara nga vetë personi i tatueshëm rishitës, çmimi i blerjes që merret parasysh për llogaritjen e marzhit është i barabartë me vlerën e tatueshme të importit, e përcaktuar në përputhje me nenin 44, të këtij ligji, shtuar me TVSH-në e paguar ose për t'u paguar për importin.

Vlera e tatueshme sipas regjimit të marzhit

Ne zbatim të këtij regjimi vlera e tatimit për t'u paguar “TVSH mbi marzhin” sipas regjimit të marzhit të fitimit llogaritet sipas formulës më poshtë:

$$\text{TVSH mbi marzhin} = [(\text{ÇSH} - \text{ÇB}) / (100\% + 20\%)] \times 20\%$$

Për qëllime të zbatimit të TVSH-së sipas këtij regjimi ligji përcakton se vlera e tatueshme e transaksionit të shitjes nën këtë regjim, për të cilën personi i tatueshëm zbaton TVSH është vetëm për marzhin që ai ka realizuar zvogëluar me vlerën e TVSH-së që lidhet me vetë marzhin.

Marzhi i realizuar nga personi i tatueshëm është i barabartë me diferencën ndërmjet çmimit të shitjes së kërkuar nga personi i tatueshëm rishitës dhe çmimit të blerjes.

“Çmim shitjeje-ÇSH” është vlera totale që personi i tatueshëm rishitës përfiton apo do të përfitojë nga blerësi për shitjen e mallrave të përdorura, veprave të artit, objekteve të koleksionit dhe antikuaret, përfshirë tatimet, taksat, shpenzime doganore, shpenzime dytësore si komisione, shpenzime transporti, ambalazhimi, sigurim, i etj., duke përjashtuar shumat e rimbursuara sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 40, të këtij ligji.

Çmimi i shitjes përbën vlera totale të faturës së lëshuar nga personi i tatueshëm ri-shitës siç përcaktohet në nenin 135 të ligjit.

“Çmim blerje- ÇB” është vlera totale e paguar ose për t’u paguar furnizuesit të mallit.

“Shkalla tatimore-20%” e zbatuar nga personi i tatueshëm rishitës nën këtë regjim është shkalla standarde e TVSH-së.

Shembull

Personi i tatueshëm rishitës blen një autoveturë nga një individ me çmim blerje për vlerën 300.000 lekë. Personi e rishet me çmim shitjeje për vlerën 480.000 lekë. Kështu ai lëshon një faturë për vlerën totale 480.000 leke pa llogaritur TVSH në faturë.

Marzhi i fitimit = Çmimi shitjeje- Çmim blerje= 480.000lekë -300.000 lekë= 180.000 lekë.

*Vlera e tatueshme = Marzhi i fitimit *SHT/(1+SHT)= 180.000 lekë /1.2*

Sa më sipër vlera e tatimit për t’u paguar “TVSH mbi marzhin” sipas regjimit të marzhit të fitimit llogaritet sipas formulës më poshtë:

$T = [(480.000 - 300.000) / 1.2] \times 20\% = [180.000 / 1.2] \times 20\% = 180.000 / 6 = 30.000 \text{ lekë}$

Tatimi për t’u paguar nga personi i tatueshëm ri-shitës është 30.000 lekë. Tatimi deklarohet dhe paguhet në deklaratën e TVSH-së në kutinë përkatëse vlera e tatueshme dhe TVSH mbi marzhin.

Marzhi individual për çdo mall

Llogaritja e TVSH-së sipas nenit 5 të këtij udhëzimi bëhet rast pas rasti për çdo mall. Kjo mënyrë llogaritje zbatohet nga personi i tatueshëm ri-shitës për çdo mall të përdorur, vepër arti, objekt koleksioni apo antikiteti nëse çmimi i shitjes së mallit është (= ose > 50.000 lekë).

Personit të tatueshëm ri-shitës i lind detyrimi për të llogaritur TVSH, dhe ajo bëhet e kërkueshme në momentin kur furnizimi është kryer, dhe lëshohet fatura e shitjes në përputhje me ligjin. Ky është edhe momenti në të cilin marzhi realizohet dhe të gjithë elementët përcaktues të marzhit janë të matshme me siguri.

TVSH e pagueshme mbi marzhin e fitimit në këtë rast llogaritet sipas nenit 6 të këtij udhëzimi dhe deklarohet në kutinë përkatëse të deklaratës së TVSH-së së deklaruar për periudhën tatimore kur është lëshuar fatura e shitjes nga ana e personit të tatueshëm ri-shitës.

8. Faturimi dhe regjistrimet kontabël sipas marzhit individual

Personat e tatueshëm ri-shitës, i cili zbatojnë regjimin e marzhit sipas këtij neni, nuk duhet të llogaritin apo të pasqyrojnë të ndarë vlerën e TVSH-së në faturën e lëshuar. Në çdo faturë të lëshuar që i nënshtrohet regjimit të marzhit, personi i tatueshëm rishitës duhet të shënojë: “Shitje që i nënshtrohet regjimit të marzhit të fitimit”.

Personat e tatueshëm, të cilët kryejnë transaksione që lidhen me mallrat e përdorura, veprat e artit, objektet e koleksionit apo të antikuarëve duhet të mbajnë në mënyrë të ndarë llogaritë për transaksione të kryera me këto mallra, sipas regjimeve të ndryshme që zbatojnë.

9. Marzhi total

Kategoritë e personave të tatueshëm ri-shitës që zbatojnë këtë regjim, janë ata të cilët shesin nën këtë regjim mallra me vlerë të vogël në sasi të mëdha, të së njëjtës natyrë të cilat në regjimin normal të TVSH-së janë të tatueshme me të njëjten shkallë tatimore. Këta persona mund të përlllogarisin marzhin mbi baza mujore.

Në këtë rast siç përcaktohet në nenin 132 të ligjit, vlera e tatueshme për furnizimet e mallrave, për të cilat zbatohet e njëjta tarifë TVSH-je, përbëhet prej marzhit total të realizuar për periudhën tatimore (muajin) për të cilën personi i tatueshëm ri-shitës detyrohet të paraqesë deklaratë sipas nenit 106, të ligjit zvogëluar me TVSH-në, që lidhet me vetë marzhin total.

Marzhi sipas këtij neni llogaritet si total dhe është diferenca ndërmjet vlerës totale të furnizimeve me vlerën totale të blerjeve të mallrave që i nënshtrohen këtij regjimi, të kryera gjatë çdo periudhe mujore, për të cilën personi i tatueshëm ri-shitës detyrohet të deklarojë

5. Regjistrimet kontabël

Personi i tatueshëm ri-shitës që zbaton këtë regjim duhet të mbajë në mënyrë të saktë dhe të regjistruar më vete inventarin kontabël të mallrave për të cilat zbaton marzhin total mujor.

Gjithashtu personat e tatueshëm, të cilët kryejnë transaksione që lidhen me mallrat e përdorura, duhet të mbajnë në mënyrë të ndarë llogaritë për transaksione të kryera me këto mallra, sipas regjimeve të ndryshme që zbatojnë.

6. Faturimi

Pavarësisht zbatimit të marzhit total, personi i tatueshëm ri-shitës është i detyruar të lëshojë faturë shitje për çdo furnizim në momentin e kryerjes së tij në përputhje me ligjin.

Personi e tatueshëm rishitës, i cili zbaton regjimin e marzhit total në faturën e lëshuar për çdo furnizim, nuk duhet të llogarisë apo të pasqyrojë të ndarë vlerën e TVSH-së në faturën e lëshuar. Në çdo faturë të lëshuar që i nënshtrohet regjimit të marzhit, personi i tatueshëm ri-shitës duhet të shënojë: “Shitje që i nënshtrohet regjimit të marzhit të fitimit”.

7. Rregullimi mujor

Nëse gjatë një periudhe mujore vlera totale e blerjeve është më e madhe se vlera totale e furnizimeve të kryera, diferenca i shtohet totalit të blerjeve të muajit pasardhës.

Rregullimi vjetor sipas inventarit

Bazuar në inventarin e mbajtur personi i tatueshëm ri-shitës bën një rregullim vjetor të vlerës së inventarit si më poshtë:

nëse diferenca midis vlerës së stokut të datës 31 dhjetor me vlerën e stokut të datës 1 janar të të njëjtit vit është negative, ajo i shtohet blerjeve të kryera në periudhën e parë të vitit pasardhës;

nëse diferenca midis vlerës së stokut të datës 31 dhjetor me vlerën e stokut të datës 1 janar të të njëjtit vit është pozitive, ajo i zbritet blerjeve të kryera në periudhën e parë të vitit pasardhës.

Deklarimi

TVSH e pagueshme sipas skemës së Marzhit total të llogaritur mbi baza mujore deklarohet në kutitë me këtë emërtim të deklaratës së TVSH-së së deklaruar për periudhën tatimore kur është llogaritur marzhi nga ana e personit të tatueshëm ri-shitës.

Shembull:

Një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në me datë 01.09.2014. Veprimtaria e tij është tregti goma të përdorura automjesh, dhe do të zbatojë regjimin e marzhit total. Inventari i tij me 31.12.2014 në vlerë është 100.000 lekë.

	Mbartje diference inventari	Vlere Blerje mallra totale	Vlere shitje mallra totale	Marzhi pozitiv	Marzh negativ	TVSH e pagueshm e
Shtator	-	100,000	200,000	100,000		16,667
Tetor	-	200,000	150,000		(50,000)	-
Nentor	50,000	100,000	120,000		(30,000)	-
Dhjetor	30,000	150,000	220,000	40,000		6,667
				-		
				-		
JANAR (n+1)	(100,000)	320,000	500,000	280,000		46,667

E drejta e zbritjes së TVSH-së

Personat e tatueshëm ri-shitës nuk kanë të drejtë të zbresin TVSH-në në lidhje me blerjet brenda vendit, importimin e veprave të artit, objektet e koleksionit ose të antikuaereve përsa furnizimet e tyre taten sipas regjimit të marzhit në përputhje me dispozitat e neneve 129 dhe 130, të këtij ligji.

Personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH-në për mallrat që i janë furnizuar nga një person i tatueshëm ri-shitës në qoftë se ky furnizim i është nënshtruar regjimit të marzhit, pasi në faturën e lëshuar për këtë furnizim nuk shfaqet TVSH.

Personi i tatueshëm ri-shitës sipas këtij regjimi furnizon shërbime të tatueshëm me TVSH dhe sipas nenit 74 të ligjit gëzon të drejtën të kreditojë TVSH e mallrave apo shërbimeve të blera nga ai me qëllimi konsumin dhe përdorimin e tyre për qëllime të realizimit të aktivitetit të tij të tatueshëm me TVSH. Këtu përfshihen blerjet për shpenzime të përgjithshme administrative dhe të funksionimit të tij si person i tatueshëm për TVSH-në dhe në asnjë rast nuk përfshihen furnizimet e blera dhe të mbajtura nga ai me qëllim për t'u shitur nën regjimin e marzhit.

11. E drejta për të zbatuar regjimin normal të TVSH-së

Nëse personi i tatueshëm ri-shitës zbaton regjimin e marzhit, atëherë për të ushtruar të drejtën për të zbatuar regjimin normal të TVSH-së duhet të respektohet afati i parashikuar në pikën 4 të nenit 133 të ligjit.

Nëse personi i tatueshëm ri-shitës ka blerë në rrethana të caktuara mallra të cilat janë objekt i këtij regjimi, për të cilat është zbatuar TVSH sipas regjimit normal, atëherë ai ka të drejtën të rishesë ato në regjimin normal të TVSH-së.

Zbritja e TVSH-së në blerje të këtyre mallrave, nuk lind që në momentin e tyre të blerjes por kushtëzohet me momentin e realizimit të transaksionit të shitjes së mallit pra, me momentin e lindjes dhe kërkueshmërisë së TVSH-së në regjimin normal.

Për të ushtruar të drejtën e zbritjes duhet të zotërojë një faturë tatimore me TVSH për mallin në përputhje me ligjin. Në çdo rast periudha nga momenti i blerjes së mallit deri në shitjen e tij nuk mund të tejkalojë periudhën 12 muaj kalendarike.

Neni 79

Rregulla të zbatimit të regjimit të shitjeve me ankand

1. Koncepti i marzhit të realizuar nga organizatori i shitjeve në ankand

Regjimi i TVSH-së së marzhit të realizuar në shitjen me ankand zbatohet nga “Organizatori i shitjeve në ankand” i cili në kuadër të veprimtarisë së tij ekonomike, në emër të tij por për llogari të “Porositësit të shitjes në ankand” nxjerr mallin e porositësit në ankand për t’ia shitur ofertuesit më të mirë.

“Organizator i shitjeve në ankand” është një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në.

“Porositësi i shitjes në ankand” është cildo person, malli i të cilit i jepet për t’u shitur organizatorit të shitjes në ankand mbi bazën e një kontrate, sipas së cilës ai përfiton komision për shitjen.

Mallrat për të cilat organizatori i ankandit zbaton regjimin e marzhit

Për qëllime të këtij neni termi “mallra të përdorura” janë ato siç përcaktohen në nenin 129 të ligjit. Organizatori i ankandit nuk zbaton regjimin e marzhit të realizuar për mallra të ndryshme nga sa përcaktohet në nenin 129.

Veprat e artit, objektet e koleksionit dhe antikitetit për të cilat zbatohet ky regjim dhe karakteristikat specifike përcaktohen të detajuara në aneksin II të ligjit.

Organizatori i ankandit nuk zbaton regjimin e marzhit të realizuar për veprat e artit, objektet e koleksionit dhe antikitetit të ndryshme nga sa përcaktohen në nenin 129.

3. Personi porositës i shitjes në ankand

Organizatori i shitjes i mallrave është një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në sipas ligjit.

Ai zbaton TVSH sipas regjimit të realizuar në shitjen me ankand për transaksionet e shitjes së mallrave të përdorura, veprave të artit, objekteve të koleksionit ose antikuarëve të cilat i kryen në emër të tij por për llogari të “Porositësit të shitjes në ankand” i cili është njëri nga personat e mëposhtëm:

Nga një person qe nuk është i tatueshëm për TVSH-në.

Shembull: Një OJF jo person i tatueshëm sipas nenit 3 të ligjit , e cila në rolin e porositësit ngarkon organizatorin që të shesë në ankand , automjetin e përdorur që bën pjesë në pasurinë e saj, i shfrytëzuar për qëllime të aktivitetit të saj joekonomik jofitimprurës.

Në këtë rast organizatori shitjes në ankand do të dokumentojë blerjen nga personi i pa-tatueshëm me “Faturë nga Blerësi” pa zbatuar TVSH, në përputhje me ligjin për procedurat tatimore.

Një person i tatueshëm për TVSH-në i cili nuk zbaton TVSH në faturën e tij të shitjes, për arsyet me poshtë:

1.Furnizimi i mallit që po kryen përjashtohet nga TVSH në shitje sipas nenit 54 të ligjit. Këtu bëjnë pjesë furnizimet e mallrave që janë përdorur vetëm për një veprimtari të përjashtuar nga TVSH, sipas neneve 51 dhe 53, të këtij ligji, në rastin kur këto mallra nuk kanë qenë objekt i së drejtës së zbritjes së TVSH-së.

Shembull: Një shoqëri që kryen tërësisht aktivitet të përjashtuar p.sh. lojrash fati , në rolin e porositësit ngarkon organizatorin e ankandit të shesë aparatet e lojrave të fatit të shfrytëzuara nga ajo lojë fati të cilën janë të përdorura.

Në këtë rast personi i tatueshëm porositës dokumenton shitjen tek organizatori me format me faturë tatimore shitje me TVSH sipas nenit 101 të ligjit, pa zbatuar TVSH, përse ligji e përjashton këtë transaksion nga TVSH.

i.Porositësi i shitjes në ankand ngarkon organizatorin që të shesë një automjet për të cilin personi tatueshëm nuk ka gëzuar të drejtën e zbritjes së TVSH-në në blerje sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit.

Shembull: Porositësi shet veturën e përdorur të administratorit të shoqërisë për të cilën nuk ka gëzuar të drejtën e zbritjes së TVSH-së në momentin e blerjes, përse ligji nuk e lejon.

Një person i tatueshëm, i cili është subjekt i regjimit për bizneset e vogla dhe furnizon mallra kapital në mënyrë rastësore.

Në këtë rast furnizuesi është një person i tatueshëm i cili përfiton nga përjashtimi për të llogaritur TVSH mbi furnizimet e tij sipas përcaktimeve të seksionit 1, të kreut XI, të këtij ligji, dhe furnizimi që kryhet ka të bëjë me mall kapital të përfshirë në aktivet afatgjata.

Një person tjetër i tatueshëm ri-shitës, në qoftë se furnizimi i mallrave prej këtij të fundit i është nënshtruar TVSH-së, në përputhje me këtë skemë të marzhit. Pra furnizuesi i

mallit ka zbatuar regjimin e marzhit të fitimit dhe ka dokumentuar transaksionin e shitjes me faturë në të cilën nuk zbatohet TVSH sipas nenit 135 të ligjit.

4. Momenti i furnizimit

Furnizimi i mallrave organizatorit të shitjes me ankand publik konsiderohet si i kryer në momentin kur realizohet shitja me ankand publik e këtyre mallrave, që përkon me momentin kur lëshohet fatura e shitjes në ankand për ofertuesin më të mirë.

Në këtë moment organizatori i tatueshëm llogarit me siguri marzhin e realizuar nga shitja në ankand, i cili llogaritet rast pas rasti për çdo shitje të realizuar. Dhe në çdo rast vlera e tatueshme përlllogaritet sipas përcaktimeve të nenit 141 të ligjit

5. Vlera e tatueshme

Në zbatim të këtij regjimi vlera e tatimit për t'u paguar “TVSH mbi marzhin” sipas regjimit të marzhit të realizuar nga shitja në ankand llogaritet sipas formulës më poshtë:

Tatimi = [VTB-(CShA-Komisioni)] x 20%

Marzhi i realizuar në shitjen me ankand nga organizatori që përfaqëson nën këtë regjim vlerën e tatueshme, llogaritet si diferencë e elementeve më poshtë: a) Vlerës totale të faturuar blerësit (VTB); me

(VNP) vlerën neto të porositësit është vlera neto që organizatori i shitjes me ankand i ka paguar apo do t'i paguajë porositësit, e cila përbëhet nga diferenca midis çmimit të shitjes në ankand (ÇSHA) të mallit i cili pretendohet nga porositësi dhe vlerës së komisionit, që organizatori i shitjes në ankand ka marrë ose do të marrë prej porositësit, mbi bazën e kontratës komisionere për shitjen; Vlerën neto që konsiston në çmimin të shitjes së mallit të paracaktuar nga porositësi në kontratë minus komisionin që i paracakton porositësi organizatorit.

Pra $VNP = CshA - Komisioni$

Vlera e tatueshme = $VTB - VNP$

$TVSH = Vlerë\ e\ tatueshme \times 20\%$

“Shkalla tatimore e zbatuar nga personi i tatueshëm ri-shitës nën këtë regjim mbi marzhin e realizuar nga shitja në ankand është gjithmonë shkalla standarde e TVSH-së pra 20% e TVSH-së.

Detyrime të faturimit ndaj blerësit

Organizatori i shitjes me ankand në momentin e realizimit të shitjes me ankand duhet t'i lëshojë blerësit një faturë, në të cilën dallohen veçmas elementet e mëposhtme:

çmimi i shitjes me ankand të mallit që është dhe çmimi i cili është ofruar nga vetë blerësi për të blerë artikullin e shfaqur në ankand.

b) tatimet dhe taksat, taksat doganore, tarifat dhe të tjera të ngjashme. këto janë detyrime të veçanta të cilat mund të aplikohen rast pas rasti në lidhje me shitjen në ankand nëse ka. Në këto

detyrime nuk bën pjesë TVSH që duhet të llogarisë organizatori mbi marzhin e realizuar nga shitja në ankand e mallit.

c) shpenzime dytësore, si: komisione, shpenzime transporti, ambalazhimi, sigurimi etj., që organizatori ia ngarkon blerësit të malli- shpenzime shtesë që duhet të bëhen mbi artikullin e shitur në ankand të cilat përballohen nga blerësi përse janë të nevojshme për ta dërguar artikullin tek blerësi.

Në faturën e lëshuar nga organizatori i shitjes me ankand për blerësin nuk duhet të llogaritet apo të pasqyrohet e ndarë vlera e TVSH-së.

Në çdo faturë të lëshuar që i nënshtrohet shitjes me ankand organizatori i shitjes në ankand duhet të shënojë: “Shitje që i nënshtrohet regjimit të shitjes me ankand” siç përcaktohet në nenin 142 të ligjit.

Nëse fatura nuk i lëshohet blerësit në përputhje me sa më sipër ajo do të konsiderohet e parregullt.

Detyrime të organizatorit ndaj porositësit të ankandit

Organizatori i shitjes në ankand, të cilit i është dorëzuar malli, mbi bazën e një kontrate komisioni për shitjen me ankand, duhet t’i paraqesë porositësit një pasqyrë të detajuar ku vlera neto, sipas nenit 141, shkronja “a”, të këtij ligji, të detajohet si diferencë midis çmimit të shitjes së mallit në ankand që pretendohet nga porositësi dhe vlerës së komisionit për t’u paguar nga porositësi.

Nëse porositësi nuk është person i tatueshëm pasqyra e hartuar sipas pikës 1, të këtij neni shoqëron faturën e lëshuar nga organizatori i shitjes në ankand për të dokumentuar vlerën në blerje të mallit

Ndërsa në rastet kur porositësi vepron si personi i tatueshëm atëherë do të lëshojë faturën e mallit të dorëzuar sipas çmimit të shitjes të përcaktuar në kontratën e dorëzimit të mallit tek porositësi, në momentin e kryerjes së furnizimit në përputhje me nenin 140, të ligjit.

Nëse organizatori i shitjes në ankand mbi bazën e një kontrate komisionere ngarkohet të shesë një mall në ankand ku porositësi është person i tatueshëm, apo malli i dorëzuar nuk përfshihet në përcaktimet e nenit 2, si furnizimet nga porositësi te organizatori dhe ri-shitja nga organizatori tek ofertuesi më i mirë, trajtohen si furnizime kundrejt pagesës sipas regjimit normal të ligjit duke zbatuar TVSH.

Mbajtja e llogarive kontabël

Organizatori i shitjes duhet të mbajë llogari kontabël të detajuara për transaksionet e kryera në kuadër të shitjes në ankand.

Organizatori i shitjes në ankand duhet të mbajë regjistra të veçantë ku të regjistrohen të gjitha detajet e nevojshme dhe të gjitha veprimet e kryera në emër të tij, por për llogari të secilit prej porositesve, si dhe pasqyrat e hartuar në përputhje me nenin 143 të ligjit.

Duhet të disponojë në çdo moment kontratat me të cilat ka marrë në dorëzim mallin nga porositesi ku përcaktohet çmimi minimal i shitjes në ankand i cili pretendohet nga porositesi si dhe komisioni i përcaktuar në vlerë.

Shembull: *Individi A porositesi i shitjes në ankand i dorëzon organizatorit të ankandit një pikturë të krijuar nga vetë ai. Çmimi i shitjes i përcaktuar nga individi është 10.000 lekë dhe komisioni i organizatorit është 1.000 lekë (10% e çmimit të porositesit). Ankandi zhvillohet në Tiranë.*

Çmimi i shitjes në ankand i ofruar nga ofertuesi më i mirë është 15.000 lekë

Shpenzime transporti të pikturës në Durrës ku edhe banon blerësi-ofertues janë 1.500 lekë, të cilat i ngarkohen blerësit.

Sa është TVSH e llogaritur.

$VNP = CshA - Komisioni = 10.000 - 1000 = 9.000 \text{ lekë}$

$VTB = 15.000 + 1.500 = 16.500 \text{ lekë}$

$Vlerë TVSH = [VTB - (CshA - Komisioni)] \times 20\% = (16.500 - 9.000) \times 20\% = 1.500 \text{ lekë}$

Organizatori rezulton me TVSH për t'u paguar për vlerën 1.500 lekë TVSH, vlerë e cila deklarohet në rubrikat përkatëse të librave të shitjes dhe në deklaratën e periudhës tatimore në të cilën është realizuar shitja në ankand.

Organizatori në zbatim të nenit 143 të ligjit do të hartojë pasqyrën dhe lëshon faturë nga blerësi ku detajohen të njëjtat zëra të pasqyrës.

Organizatori lëshon fatura tatimore shitje për blerësin ofertues më të mirë ku detajohen elementet që përbëjnë VTB 16.500 lekë, pa shfaqur në të TVSH-në.

Neni 81 Zbatimi i Udhëzimit

Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi Autoriteti Tatimor dhe Autoriteti Doganor.

[Ngarkohet Autoriteti Tatimor për zbatimin e këtij udhëzimi.](#)

[Kërkesa për rimbursim të TVSH-së, të paraqitura para datës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të vazhdojnë të trajtohen nga drejtoritë rajonale tatimore.](#)

Kërkesat për rimbursim të TVSH-së, të paraqitura në bazë të këtij udhëzimi, do të trajtohen nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit, deri në krijimin e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/4, datë 04.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 07.09.2015)

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 34, datë 05.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 169, datë 11.12.2019)

Neni 82 **Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”, shfuqizohet.

Neni 83 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1 janari 2015.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

SHKËLQIM CANI

MINISTËR I FINANCEVE

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Arben Ahmetaj

Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 12, datë 6 shkurt 2015.

Udhëzim Nr. 6, datë 30.01.2015

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
HELGA VUKAJ

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/1, datë 17.3.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 40, datë 19.3.2015

Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/2, datë 19.3.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 45, datë 26.3.2015.

Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/8, datë 05.06.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 94, datë 09.06.2015.

Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/4, datë 04.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 07.09.2015.

Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/5, datë 05.10.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 09.10.2015.

Ndryshuar me Udhëzim nr. 13, datë 17.05.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 91, datë 30.05.2016.

Ndryshuar me Udhëzim nr. 15, datë 18.05.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 26.05.2017.

Ndryshuar me Udhëzim nr. 16, datë 05.07.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 143, datë 10.07.2017.

Ndryshuar me Udhëzim nr. 22, datë 11.12.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 220, datë 15.12.2017.

Ndryshuar me Udhëzim nr. 5, datë 21.02.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 26.02.2019.

Udhëzim Nr. 6, datë 30.01.2015

Ndryshuar me Udhëzim nr. 34, datë 05.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 169, datë 11.12.2019

Ndryshuar me Udhëzim Nr. 32, datë 25.08.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 154 datë 26.08.2020

Ndryshuar me Udhëzim Nr. 11 datë 13.04.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 66, datë 19.04.2023

Ndryshuar me Udhëzim nr. 27, datë 13.09.2023. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137 datë 20.09.2023.

KODI NK	PËRSHKRIMI
01012990	- - - Të tjera
01013000	- - Gomerë
01019000	- Të tjera
01022905	- - - Të nënklasës Bibos apo të nënklasës Poephagus
01022910	- - - Me peshë jo më shumë se 80 kg
01022929	- - - - Të tjera *
01022949	- - - - Të tjera
01022959	- - - - - Të tjera
01022969	- - - - - Të tjera
01022999	- - - - - Të tjera
01023910	- - - Të llojit shtëpiak
01023990	- - - Të tjera
01029091	- - - Të llojit shtëpiak
01029099	- - - Të tjera

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR 2017

Udhëzim Nr. 6, datë 30.01.2015

01031000	- Kafshë të racës së pastër
01039110	- - - Të një peshe nën 30 kg
01039110	- - - Të një peshe mbi 30 kg
01039190	- - - Të tjera
01039211	- - - - Dosa që kanë pjellë të paktën një herë, të një peshe jo më pak se 160 kg
01039219	- - - - Të tjera
01039290	- - - Të tjera
01041010	- - Të racës së pastër
01041030	- - - Qingja (deri në një vjeç)
01041080	- - - Të tjera
01042010	- - Të racës së pastër
01042090	- - Të tjera
01051111	- - - - Killoçka
01051119	- - - - Të tjera
01051191	- - - - Killoçka
01051199	- - - - Të tjera
01051200	- - Gjela dhe pula deti
01051300	- - Rosa
01051400	- - Pata
01051500	- - Guinea fowl (... të familjes të fazan, pallonj shartuar me)
01059400	- - Shpendë të llojit Gallus domesticus, me peshë jo më shumë se 2 000 g
01059910	- - - Rosa
01059920	- - - Pata
01059930	- - - Gjela dhe pula deti
01059950	- - - Pulë afrikane
01061100	- - Primatet
01061200	- - Balenat, delfinët dhe derrat e detit (gjitarë të llojit cetacea); lopët e detit (gjitarë të llojit sirenia)
01061300	- - Devetë dhe gamilet (Camelidae)
01061410	- - - Lepujt shtëpiak
01061490	- - - Të tjera
01061900	- - Të tjera
01062000	- Zvarranikët (përfshirë gjarpërinjtë dhe breshkat detare)
01063100	- - Shpendët grabitqarë
01063200	- - Psittaciformes (duke përfshirë papagallët, papagall trupvogël, macaës dhe cockatoos)
01063300	- - Strucat; emus (Dromaius novaehollandiae)
01063910	- - - Pëllumbat
01063980	- - - Të tjera
01064900	- - Të tjera
01069000	- Të tjera
03019110	- - - Të llojit Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster (rasat)
03019190	- - - Të tjera (rasat)
03019210	- - - Të një gjatësie më pak se 12 cm (rasat)
03019230	- - - Të një gjatësie prej 12 cm por jo më shumë se 20 cm (rasat)

03019290	- - - Të një gjatësie prej 20 cm ose më shumë (rasat)
03019300	- - Krap (rasat)
03019410	- - - Ton me fletë notuese blu (Thunnus thynnus) (rasat)
03019490	- - - Ton me fletë notuese blu (Thunnus orientalis) (rasat)
03019500	- - Ton me fletë notuese blu, i jugut (Thunnus maccoyii) (rasat)
03019911	- - - - Salmoni i Paqësorit (oncorhynchus nerka, Oncorhynchus gorbuscha, Oncorhynchus keta, Oncorhynchus tshawytscha, Oncorhynchus kisutch, Oncorhynchus masou dhe Oncorhynchus rhodurus), salmoni i Atlantikut (Salmo salar) dhe salmoni i Danubit (Hucho h
03019918	- - - - Të tjera (rasat)
03019985	- - - Të tjera (rasat)

Udhëzim Nr. 6, datë 30.01.2015

Pa veprimtari

Plotëso PO nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

[illegible]

Emri Mbiemri

Nr. i rreshtave mund të shtohet në përputhje me nr. e transaksioneve.

216

Udhëzim Nr. 6, datë 30.01.2015

Libri i shitjeve

Shoqëria

Nipti

Viti

Muaji

Pa veprimtari

Emri i Shoqërisë

Nipti i Shoqërisë

Viti për të cilin plotësohet libri (yyyy)

Muaji për të cilin plotësohet libri - muaji nga 01 deri 12

Plotëso PO nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

Fatura			Blerësi			Totali Shitjeve	Shitjet e përjashtuara	Shitjet pa TVSH	Shitjet që përjashtohen me eksportet	Eksporte malfrash	Furrizime me 0%	Shitje me shkallë 20%		Shitje me shkallë 10%		Shitje me shkallë 6%		Shitje regjistrimi zgjerivive të odhimit/malfrash fitimit (shitje në anksat)		Antingarkesë TVSH në shitje		Borxhi i heq			
Nr. Faturës	Nomeri Seria	Data (dd/mm/yyyy)	Email (regjistrim@qeveria)	Bredhi	NIPT							Vlera e Tatimit	Tosh	Vlera e Tatimit	Tosh	Vlera e Tatimit	Tosh	Vlera e Tatimit	Tosh	Vlera e Tatimit	Tosh	Vlera e Tatimit	Tosh	Vlera e Tatimit	Tosh
a	b	c	d	e	f							g	h	i	j = (i x 20%)	k	l = (k x 10%)	m	n = (l x 6%)	o	p = (o x 20%)	q	r = (q x 20%)	s	t = (s x 20%)
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
							0		0		0		0		0		0		0		0				
Shuma totale						0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0					
Ky fatura shfaqet si fatura e Detyrueshme dhe Brevetë e TVSH-së						ky fatura (0)	ky fatura (0)	ky fatura (1)	ky fatura (2)	ky fatura (3)	ky fatura (4)	ky fatura (5)	ky fatura (6)	ky fatura (7)	ky fatura (8)	ky fatura (9)	ky fatura (10)	ky fatura (11)	ky fatura (12)	ky fatura (13)					

Emri Mbiemri

Shpjegim:

Në rastin kur ky libër do të printohet, për qëllime të ruajtjes/ mbajtjes së dokumentacionit, çdo faqe e printuar duhet të ketë në krye përmbajtjen / rreshtat nga 1 në 12.

Nr. i rreshtave mund të shtohet në përputhje me nr. e transaksioneve.

DEKLARATA E TATIMIT MBI
VLERËN E SHITUAR

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri i Vendosijes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT): (3)

Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm: (4)

Emri Mbiemri i Personit Fizik: (5)

Adresa: (6)

Qyteti/Komuna/Rrethi: (7)

Numri Telefonit:

Informacioni i mësipërm (rubrikat 4, 5, 6, 7) duhet të jetë i saktë dhe i azhurnuar.



[8] Shënoni 'X' nëq gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

TVSH e llogaritur për muajin

- (9) Shitje të përjashtuara
- (10) Shitje pa TVSH
- (11) Shitje të përngjashme me eksportet
- (12) Eksporte mallrash
- (13) Furnizime me shkallë 0%
- (14) Shitje të tatueshme (me shkallë 20%)
- (16) Shitje të tatueshme (me shkallë 10%)
- (18) Shitje të tatueshme (me shkallë 6%)
- (20) Shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të udhëtimit/
të marzhit të fitimit/të shitjeve në ankand (20%)
- (22) Autogarkesë TVSH-së në shitje (reverse charge) (22
x20%)
- (24) Borxhi i keq
- (26) Totali TVSH-së së llogaritur
{(15)+(17)+(19)+(21)+(23)+(25)}

TVSH e zbritshme për muajin

- (27) Blerje të përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH
- (28) Blerje investimi brenda vendit pa TVSH
- (29) Importe të përjashtuara të investimit pa TVSH
- (30) Import mallra të përjashtuara nga TVSH
- (31) Import mallra me shkallë tatimore 20%
- (33) Import mallra me shkallë tatimore 10%
- (35) Import mallra me shkallë tatimore 6%
- (37) Importe të investimit me TVSH 20%
- (39) Blerje të destinuara për realizimin e projekteve
të financuara me donacione/grante 20%
- (41) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 20%
- (43) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 10%
- (45) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 6%

Vlera e tatueshme

TVSH e llogaritur

(9)	0	
(10)	0	
(11)	0	
(12)		
(13)	0	
(14)	0	(15) 0
(16)	0	(17) 0
(18)	0	(19) 0
(20)	0	(21) 0
(22)	0	(23) 0
(24)	0	(25) 0
		(26) 0

Vlera e tatueshme

TVSH e zbritshme

(27)	0	
(28)	0	
(29)	0	
(30)	0	
(31)	0	(32) 0
(33)	0	(34) 0
(35)	0	(36) 0
(37)	0	(38) 0
(39)	0	(40) 0
(41)	0	(42) 0
(43)	0	(44) 0
(45)	0	(46) 0

(47) Blerje të Investimit Brenda vendit me TVSH 20%	(47)	0	(48)	0
(49) Blerje nga fermerët vendas	(49)	0	(50)	0
(51) Autogarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (reverse charge)	(51)	0	(52)	0
(53) Rregullime të TVSH-së së zbritshme	(53)	0	(54)	0
(55) Borxhi i keq	(55)		(56)	
(57) Totali TVSH-së së zbritshme {(32)+(34)+(36)+(38)+(40)+(42)+(44)+(46)+(48)+(50)+(52)+(54)+(56)}			(57)	0
(58) Teprica e TVSH-së së zbritshme për muajin {(26)-(57)} nqs {(26)<(57)}			(58)	0
(59) TVSH I DETYRUESHËM PËR T'U PAGUAR {(26)-(57)} nqs {(26)>(57)}			(59)	0

Data dhe Firma e Personit të Tatueshëm - Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

(Zëvendësuar Deklarata e TVSH me Udhëzim Nr. 11 datë 13.04.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 66, datë 19.04.2023)

Deklaratë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (DTVSH)

1. Numri serialet perdetore nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe shërbën për të azhurmuar regjistrimet tuaj kur parashtet deklaratë.

2. Periudha Tatimore është muaji i parësuar nga dita e parë deri në ditën e fundit. Të gjitha transaksionet (Shitjet, Blerjet) dhe llogaritjet mujore të TVSH-së të kryera gjatë kësaj periudhe duhet të përfshihen në këtë deklaratë.

Të dhëna të Personit të Tatueshëm

3. Numri i identifikues i Personit të Tatueshëm (NPT/NUIS) është numri i vetëm që ju përfaqëson dhe identifikon në të gjitha marrëdhëniet me Administratën Tatimore Qendrore. Npt/Nuis duhet të vendoset detyruesisht në çdo fakturë që lëshoni ose merrni.

4. Emri i Tregtarit i Personit të Tatueshëm është emri i tregtarit të cilin ju jeni regjistruar në QKR ose Drejtoria Rajonale Tatimore sipas legjislatit tatimor në fuqi dhe që tregohet në certifikatën tuaj të regjistrimit si NPT/NUIS.

5. Emri i Mbledhësit i Personit Fizik vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një Person Fizik dhe nuk ka emër tregtar.

6. Adresa tregohet për vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë së tij ekonomike. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën tuaj të NPT/NUIS.

7. Numri i Telefonit (nëse ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë së tij ekonomike.

Shënimi: Nëse ofruesi ndodhet nga të dhënat e rubrikave 4.5 dhe 6.7 ka ndryshuar, jueni të detyruar të deklaroni në këtë, çdo ndryshim pranë QKR-së ose Drejtoria Rajonale Tatimore, kushtojeni i regjistruar.

8. Nëqoftëse ju nuk keni kryer asnjë transaksion gjatë muajit, shënoni një "1" në kutinë 8. Sipas mënyrës së deklaratës, plotësoni datën dhe firmën dhe deklaratën në këtë mënyrë që informacioni i dhënë në deklaratë është i plotë dhe i saktë.

TVSH e llogarituar për muajin

9. Nga kolona "a" "Shitje të përjashtuara" e librit tuaj të shitjeve nxirri totalin e të gjithë shitjeve të pashtuara të muajit dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 9 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen shitjet e përjashtuara sipas Kapitullit 8 Seksioni 1 të ligjit, për të cilat nuk llogaritet TVSH.

10. Nga kolona "b" "Shitje pa TVSH" e librit tuaj të shitjeve nxirri totalin e të gjithë shitjeve pa TVSH të muajit dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 10 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen shitjet të pashtuara në Shqipëri për të cilat nuk llogaritet TVSH.

11. Nga kolona "g" "Shitje të përgjithshme me eksport" të librit tuaj të shitjeve nxirri totalin e të gjithë shitjeve.

12. Nga kolona "gj" "Eksporte mallrash" të librit tuaj të shitjeve nxirri totalin e të gjithë eksporteve të mallrave me shkallë tatimore 0% të bërë për muajin dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 12 të Deklaratës tuaj. Furnizimet Eksporte sipas nenit 57 të ligjit tatohen me shkallë 0%.

13. Nga kolona "h" "Furnizime me shkallë 0%" e librit tuaj të shitjeve nxirri totalin e të gjithë furnizimeve me shkallë tatimore 0% të bërë për muajin dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 13 të Deklaratës tuaj, furnizime sipas Kapitullit 8 Seksioni 3 përveç eksporteve të mallrave që deklarohen në kutinë 12.

14. Nga kolona "i" "Vlera e Tatueshme për shitje me shkallë 20%" nxirri totalin për transaksionet e bërë gjatë muajit të cilat sipas ligjit që i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 20%, dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 14 të Deklaratës tuaj. (Vlera +/)

15. Nga kolona "j" e librit të shitjeve "TVSH për shitje me shkallë 20%", nxirri totalin e tvsh-së për muajin për shitjet me shkallë 20% dhe shumën e përtharë vendosni në kutinë 15 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 15 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së parësuar në kutinë 14. (Vlera +/)

16. Nga kolona "k" e librit të shitjeve "9%-e" e Tatueshme për shitje me shkallë 9% nxirri totalin për transaksionet e bërë gjatë muajit, të cilat sipas ligjit, i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 10% dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 16 të Deklaratës tuaj. (Vlera +/)

17. Nga kolona "l" e librit të shitjeve "9%-e" për shitje me shkallë 10%, nxirri totalin e TVSH-së për muajin për shitjet me shkallë 10% dhe shumën e përtharë vendosni në kutinë 17 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 16 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së parësuar në kutinë 16. (Vlera +/)

18. Nga kolona "m" e librit të shitjeve "9%-e" e Tatueshme për shitje me shkallë 10% nxirri totalin për transaksionet e bërë gjatë muajit, të cilat sipas ligjit, i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 6% dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 18 të Deklaratës tuaj. (Vlera +/)

19. Nga kolona "n" e librit të shitjeve "TVSH për shitje me shkallë 6%", nxirri totalin e TVSH-së për muajin për shitjet me shkallë 6% dhe shumën e përtharë vendosni në kutinë 19 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 19 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së parësuar në kutinë 18. (Vlera +/)

20. Nga kolona "o" e librit të shitjeve "Vlera e Tatueshme për shitje sipas regjistrimit të agjentëve të udhëtimit/ marzhi fitim/ shitje në aneknd" nxirri totalin për transaksionet e bërë gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 20 të Deklaratës tuaj. Këtu shitje të tatueshme i nënshtrohen shkallës 20% të TVSH-së.

21. Nga kolona "nj" e librit të shitjeve "TVSH për shitje regjistrimi agjentëve të udhëtimit/ marzhi fitim/ shitje në aneknd", nxirri totalin e TVSH-së të shitjeve për muajin dhe shumën e përtharë vendosni në kutinë 21 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 21 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së parësuar në kutinë 20.

22. Nga kolona "q" e librit të shitjeve "Vlera e Tatueshme për Autogarakse TVSH në shitje" nxirri totalin për transaksionet për të cilat llogariten autogarakset TVSH në shitje të bërë gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 22 të Deklaratës tuaj. Këtu transaksione deklarohen sipas shkallës tatimore 20% të shitjeve të reduktuara të TVSH-së në shitje sipas legjislatit tatimor në fuqi.

23. Nga kolona "r" e librit të shitjeve "TVSH e autogarakur në shitje", nxirri totalin e TVSH-së për transaksionet për të cilat llogariten autogarakset TVSH në shitje për muajin dhe shumën e përtharë vendosni në kutinë 23 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 23 duhet të jetë e barabartë me vlerën e kutisë 24 shumëzuar me 50% përkatëse standarde dhe ose të reduktuar sipas legjislatit tatimor në fuqi.

24. Nga kolona "s" e librit të shitjeve "Vlera e Tatueshme për veprimet të Borsit dhe keq" nxirri totalin për muajin të transaksioneve sipas nenit 54 të ligjit, dhe vendosni në kutinë 24 të Deklaratës tuaj. Shkalla e zbatueshme e TVSH-së është sipas legjislatit tatimor në fuqi (Vlera +/)

25. Nga kolona "t" e librit të shitjeve "TVSH për veprimet të Borsit dhe keq", nxirri totalin e TVSH-së për arkitimet e Borsit të keq për muajin dhe shumën e përtharë vendosni në kutinë 25 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 25 duhet të jetë e barabartë me vlerën e kutisë 24 shumëzuar me 50% përkatëse standarde dhe ose të reduktuar sipas legjislatit tatimor në fuqi.

26. Llogaritja totale e TVSH-së në këto kapituj për muajin, dhe mbledhja TVSH e llogaritur për shitje të tatueshme me 20% (kutia 15), shitje të tatueshme me 10% (kutia 17), shitje të tatueshme me 6% (kutia 19), TVSH e llogaritur për shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentëve udhëtim/marzhi fitim/ shitje në aneknd, me 20% (kutia 21), TVSH e llogaritur për transaksionet e bërë sipas shërbimeve nga persona jo rezident e autogarakur në shitje me shkallë standarde dhe ose të reduktuar (kutia 23), TVSH e mbledhëse nga veprimet të Borsit të keq me shkallë standarde dhe ose të reduktuar (kutia 25). Shumën plotësoni në kutinë 26. (Vlera +/)

TVSH e zbritshme gjatë Muajit

27. Nga kolona "a" e librit tuaj të Blerjeve "Blerje të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh", nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 27 të Deklaratës tuaj. Këtu do të regjistrohen blerjet e përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh, përveç blerjeve të tilla të kryera për investime të cilat regjistrohen veçmas në kutinë 28. Për blerjet me TVSH jo të zbritshme nuk do të bëhet zbritje e TVSH.

28. Nga kolona "b" e librit tuaj të Blerjeve "Blerje investime brenda vendit pa TVSH". Këtu regjistrohen vendimet e bërë për blerje për qëllime investimi në pasurinë e subjektit të kryera brenda vendit dhe pa tvsh a pa blerje të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh, për investime. Nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 28 të Deklaratës tuaj.

29. Nga kolona "c" e librit tuaj të Blerjeve "Importe të përjashtuara të investimit pa TVSH", nxirri totalin e importeve dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 29 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit.

30. Nga kolona "gj" e librit tuaj të Blerjeve "Import mallra të përjashtuara", nxirri totalin e importeve dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 30 të Deklaratës tuaj. Këtu do të regjistrohen të gjitha importet e mallrave të përjashtuara nga TVSH, përveç importeve të përjashtuara për investime të cilat regjistrohen veçmas në kutinë 29.

31. Nga kolona "d" "Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 31 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 32.

32. Nga kolona "e" "TVSH në Import për mallra me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 32 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 32 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 31.

33. Nga kolona "f" "Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 10%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 10% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 33 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 10%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 34.

34. Nga kolona "g" "TVSH në Import për mallra me shkallë 6%" e librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 34 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 34 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së kutisë 33.

35. Nga kolona "h" "Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 6%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 6% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 35 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 6%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 36.

36. Nga kolona "i" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 36 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 37.

37. Nga kolona "j" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 37 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 38.

38. Nga kolona "k" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 38 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 39.

39. Nga kolona "l" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 39 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 40.

Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 10% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 33 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 10%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 37.

40. Nga kolona "m" "TVSH në Import për mallra me shkallë 10%" e librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotësoni shumën e përtharë në kutinë 34 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 34 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së kutisë 33.

41. Nga kolona "n" "Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 6%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 6% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 35 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 6%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 36.

42. Nga kolona "o" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 36 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 37.

43. Nga kolona "p" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 37 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 38.

44. Nga kolona "q" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 38 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 39.

45. Nga kolona "r" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 39 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 40.

46. Nga kolona "s" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 40 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 41.

47. Nga kolona "t" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 41 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 42.

48. Nga kolona "u" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 42 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 43.

49. Nga kolona "v" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 43 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 44.

50. Nga kolona "w" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 44 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 45.

51. Nga kolona "x" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 45 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 46.

52. Nga kolona "y" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 46 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 47.

53. Nga kolona "z" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 47 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 48.

54. Nga kolona "aa" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 48 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 49.

55. Nga kolona "ab" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 49 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 50.

56. Nga kolona "ac" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 50 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 51.

57. Nga kolona "ad" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 51 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 52.

58. Nga kolona "ae" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 52 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 53.

59. Nga kolona "af" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 53 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 54.

60. Nga kolona "ag" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 54 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 55.

61. Nga kolona "ah" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 55 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 56.

62. Nga kolona "ai" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 56 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 57.

63. Nga kolona "aj" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 57 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 58.

64. Nga kolona "ak" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 58 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 59.

65. Nga kolona "al" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 59 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 60.

66. Nga kolona "am" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 60 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 61.

67. Nga kolona "an" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 61 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 62.

68. Nga kolona "ao" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 62 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 63.

69. Nga kolona "ap" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 63 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 64.

70. Nga kolona "aq" "Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përtharë, në kutinë 64 të Deklaratës tuaj. Këtu regj



**CERTIFIKATË REGJISTRIMI TË
PROJEKTIT/KONTRATËS PËR EFEKT TË TRAJTIMIT SI
FURNIZIM I PËRNGJASHËM ME EKSPORTET**

Formular 7A

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE _____				
Numri i Certifikatës në regjistrin e DRT-së: _____				
1. Emri i zbatuesit/përfutuesit të projektit:		2. NIPT:		
3. Data e fillimit të projektit/kontratës:		4. Data e mbarimit të projektit/kontratës:		
5. Titulli i projektit/kontratës:		6. Donatori i grantit:		
7. Lista e bashkëaplikuesve në certifikatë (kur është e aplikueshme)				
Statusi në kontratë	Emri	NIPT	Kontrata	Kontrollori/konfirmuesi i shpenzimeve
Kontraktor 1	xxxxx	yyyyyy		
Kontraktor 2				
8. Marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar që parashikon mospërdorimin e fondeve për të paguar tatime (referenca e nenit dhe ligjit ratifikues)				
DREJTORI				
Nënshkrimi: _____			Data: _____	

Kjo certifikatë lëshohet në zbatim të nenit 60, pika 1, gërma c), e ligjit nr. 92/2014 "Për TVSH-në në R.SH", i ndryshuar dhe nenit 63/1 të udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 "Për TVSH-në në R.SH", i ndryshuar.

(Shtuar me Udhëzim Nr. 11 datë 13.04.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 66, datë 19.04.2023)

CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT

TË PROGRAMIT/PROJEKTIT

E MËRTIMI I PROGRAMIT/PROJEKTIT

TË DHENA PËR ZBATUESIN / PËRFITUESIN E PROGRAMIT/PROJEKTIT

DATA E FILLIMIT
TË PROGRAMIT/PROJEKTIT

DATA E PËRFUNDIMIT
TË PROGRAMIT/PROJEKTIT

VLERA FILLESTARE E FINANCIMIT TË PROGRAMIT/PROJEKTIT

REFERENCAT LIGJORE

KODI UNIK

DATA E LËSHIMIT

DATA E RISHIKIMIT



DREJTORI I PËRGJITHSHËM
(firmë dhe vulë)

*Në rast të ndryshimit të marrëveshjes dhe/ose programit/projektit, zbatuesi/përfituesi i projektit duhet të njoftojë SASPAC, brenda një afati 5 (pesë) ditor.



Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve

**CERTIFIKATË REGJISTRIMI TË
PROJEKTIT/KONTRATËS PËR EFEKT TË TRAJTIMIT SI
FURNIZIM I PËRNGJASHËM ME EKSPORTET**

Formular 7A

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE _____				
Numri i Certifikatës në regjistrin e DRT-së: _____				
1. Emri i zbatuesit të projektit:		2. NIPT:		
3. Data e fillimit të projektit/kontratës:		4. Data e mbarimit të projektit/kontratës:		
5. Titulli i projektit/kontratës:		6. Donatori i grantit:		
7. Lista e bashkëaplikuesve në certifikatë				
Statusi në kontratë	Emri	NIPT	Kontrata	Kontrollori/konfirmuesi i shpenzimeve
Kontraktor 1	xxxxx	yyyyy		
Kontraktor 2				
.....				
8. Marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar që parashikon mospërdorimin e fondeve për të paguar tatime (referenca e nenit dhe ligjit ratifikues)				

DREJTORI	
Nënshkrimi: _____	Data: _____

Kjo certifikatë lëshohet në zbatim të nenit 60, pika 1, gërma c), e ligjit nr. 92/2014 "Për TVSH-në në R.SH", i ndryshuar dhe nenit 63/1 dhe 63/2 të udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 "Për TVSH-në në R.SH", i ndryshuar.